Llazi HAJDINI

NJERËZ TË SHEKULLIT TË 20^{të} NË PESË FSHATRAT: PORO, ZHUKË, DELISUF, DELLËNJË DHE GRYKË

Tiranë, 2014

Llazi Hajdini

Kushtuar bashkëfshatarëve të mi, që do të kishin merituar diçka më shumë

HYRJE

Është me përgjegjësi të madhe të shkruash me dinjitet për një fshat, ca më tepër për dy tre fshatra apo një krahinë të tërë.

Pas një pune disavjeçare, arrita të grumbulloja material e të dhëna të bollshme e të rëndësishme. Shkoja me shpresën se kisha zbuluar gjithçka, por në punë e sipër, për renditjen e tyre, hasa në probleme, në boshllëqe, në pamundësi të zhbirimit të botës së njerëzve, të prejardhjes, të saktësimit të migrimit e të emigrimit. Sakaq, në disa raste, më shuhej shpresa se mund të depërtoja në çdo fshat, në çdo familje, me pikësynimet e mia. Më është dashur të qëmtoja në thellësi të dhjetëvjeçarëve me durim të madh.

Sepse, një shikim sipërfaqësor nuk ma mbushte syrin dhe mendjen për një punë serioze. Falë dokumentacionit gojor dhe jo gojor, që më vunë në dispozicion dashamirët e dikurshëm dhe ata më të rinjtë, munda t'u afrohesha sa më pranë të vërtetave.

I falënderoj përzemërsisht.

Unë, për asnjë çast nuk iu shmanga asnjë mundimi.

Kam dëshmuar vetëm të vërtetën. Asnjë prind që ka birësuar ose fëmija që është birësuar s'ka pse të rëndohet.

Kjo dukuri ka qenë edhe më parë, është edhe do të jetë, sepse dihet që jo të gjithëve natyra u plotëson dëshirat. Ka nga ata që lindin shumë fëmijë, ka nga ata që lindin pak, por ka edhe njerëz që nuk lindin, prandaj është gjetur rruga e jetës së vazhdueshme me birësime.

Këtu s'ka asgjë të keqe.

Për ngjarje të ndryshme që kanë ndodhur në këta njerëz, vetë, secili le t'i përshkruajë, le t'i plotësojë po të dojë e si të dojë, unë nuk marr përsipër një gjë të tillë.

Jeta njerëzore, si kudo, edhe në këto fshatra, nuk ka kaluar pa shqetësime. Ka pasur, patjetër, shumë gëzime, por ka pasur edhe lëndime e hidhërime. Dhe hidhërimet (vdekjet natyrale) janë objektive, duam apo nuk duam ne, ato do të ndodhin, sepse kemi lindur për të vdekur një ditë. Për vdekjet natyrale, sigurisht që dëshpërohemi dhe hidhërohemi, por, pak nga pak, e harrojmë dhimbjen sepse e dimë që vdekja është e pashmangshme, pavarësisht se në ç'kohë e moshë ndodh ajo. Më shumë gjurmë, dihet, lënë ato ndodhi e vdekje që ngjajnë të rastësishme, ose të shkaktuara nga aksidente të ndryshme dhe, aq më shumë lënë plagë ato me vetëdashje.

Besoj se më mirëkuptoni.

Këtë botim të dytë jam munduar ta saktësoj më mirë me vërejtjet e bëra nga dashamirësit e mi. I falënderoj të gjithë për konstatimet e tyre.

Jam përpjekur që këtë punë ta realizoj më tepër me zemër e me shpirt, se sa me dije. Besoj se nuk e teproj gëzimin e madh që ndjej për kontributin në nxjerrjen dhe ekspozimin e realitetit të gjenealogjisë të njerëzve, sipas fisit, pa harruar të them se mund të ketë akoma boshllëqe, sidomos për emrat e saktë zyrtar dhe prejardhjen e tyre. Informacionet dhe të dhënat, që jepen në këtë botim, i kam mbledhur si thërrimet e bukës në një sofër të madhe për të ushqyer zogjtë tanë që do të vijnë pas nesh.

Nuk pretendoj se puna ime në këtë botim është e përsosur dhe se nuk ka më për tu thelluar më tej. Sikur një njeri nga të parët tanë të na kishte lënë me shkrim kaq material, do të ishte një pasuri e paçmuar për ne sot. Të paktën ne tu lëmë pasardhësve tanë diçka që ata të kenë mundësi të vazhdojnë ta pasurojnë më tej historinë tonë.

Njohja sa më mirë e fiseve ka të bëjë edhe me lidhjet miqësore e krushqitë për dhënie e marrje të vajzave për të bërë martesat dhe për krijimin e familjeve të reja. Sa më e largët të

jetë miqësia, krushqia, aq më të mirë do të jenë pasardhësit tanë, aq më të shëndetshëm do të jenë ata, për rrjedhojë, dhe aq më e mirë është cilësia e shoqërisë njerëzore, dhe e kundërta. Nga martesat brenda gjakut dalin pasardhës me të meta fizike e mendore. Edhe feja nuk e ka lejuar, ashtu si dhe ligjet e shtetit, që të jepen e të merren brenda gjakut. Duhet të ruhemi sa më shumë nga këto marrëdhënie. Për ata që duan të kenë një familje të shëndoshë e cilësore, ky libër mund t'i ndihmojë, duke e studiuar mirë atë, me qëllim që të dinë se ku të marrin apo të japin vajzat për martesë.

Në këtë botim u jam shmangur pikëpamjeve e dallimeve politike, racore, besimeve fetare, etj. Nuk kam sharë e ofenduar asnjë. Kam shkruar vetëm të vërtetën, ashtu siç mi kanë thënë vetë njerëzit, duke shkuar e pyetur shtëpi më shtëpi. Të gjithë e kanë vlerësuar këtë përpjekje dhe kanë dhënë vetë emrat dhe lidhjet familjare e miqësore që kam pasqyruar këtu.

Për realizimin e këtij ribotimi ndjej detyrimin të falënderoj z. Vllas Mërtiri, shkrimtar, i cili më ka ndihmuar, si në mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve, por dhe në saktësimin e një pjese të mirë të tyre, si dhe z. Milto Hyso, për ndihmën e dhënë në përgatitjen e këtij punimi.

I mbushur me dashuri e respekt për vendlindjen, për njerëzit, arrita deri këtu. I bashkova të gjithë në këtë libër me dashuri e respekt, duke menduar dhe aspiruar se të tjerët, pas meje do ta pasurojnë më tej, do ta përsosin, do ta ruajnë në çdo shtëpi si një memorial të gjallë.

Autori

FSHATRAT PORO, ZHUKË, DELISUF, DËLLËNJË DHE GRYKË

Këta pesë fshatra ndodhen në anën e majtë të derdhjes të lumit Vjosë, 6 kilometra më poshtë Urës së Mifolit e 3–6 kilometra larg nga deti Adriatik.

Për sa i takon prejardhjes së emrit të çdo fshati, mendohet që Poro vjen nga fjala Port, sepse thonë që lumi i Vjosës, dikur, para 200 e ca viteve ka qenë i lundrueshëm për mjete të vogla me vela ose me krahë. Këtu vinin e shkarkonin anije e varka të ndryshme të huaja dhe ngarkonin mallrat e vendit për eksport.

Më sa kuptohet, ato sillnin ato mallra që kërkonin njerëzit, industriale apo të tjera si stofra, sheqer, kafe, e të tjera, dhe merrnin që këtej lëkura, lesh, bulmetra si gjalpë e djathë, ullinj, vaj, mish dhe prodhime të tjera.

Këto mallra importi shkonin deri në Fier, në Berat e Vlorë dhe prej andej vinin me transport kafshësh ato që kërkoheshin nga eksporti.

Thuhej nga pleqtë e moshuar se lumi i Vjosës ka qenë i thellë dhe jo i rrëmbyeshëm, vinte ca kurora me përdredhje të mëdha, por lundrohej. Varkat që shkonin deri në Mifol, shkarkonin atje ose në anë të detit në port, e pastaj ngarkonin e iknin. Por kur kalonin në Poro bënin edhe pak pushim dhe te kisha e vogël e Shën Nikollës hidhnin edhe para si besimtarë. Me ato pak para, dhe me ndihmesat e popullit, avash-avash u ngrit kisha më e madhe në vitin 1910. Kjo kishë e Shën Nikollës ka qenë një ndërtesë e madhe, e cila mund të merrte deri 200 njerëz; gjysma e saj ishte me dy kate, në njërën prej të cilave ku në njërën rrinin gratë.

Janë dëgjuar fjalë se para 500–600 vjetëve, fshati Poro është quajtur Spinarica dhe, pas shumë viteve, u quajt Spornica dhe, më vonë, u quajt Poro. Gjithsesi, këto janë fjalë të padokumentuara, prandaj mbetet për t'u besuar prejardhja e emrit nga fjala Port (shiko hartën e shekullit të 13–14).

Ndërsa për fshatin Delisuf, thuhet nga të parët se dikur një nga të parët që është vendosur këtu ka qenë Delo Isufi, po edhe kjo është e pasaktësuar sepse nuk ka asnjë dokument apo trashëgimtar që ta vërtetojë. Një fshat me emrin Delisufanj ndodhet edhe në rrethin e Lushnjes.

Fshati Zhukë thuhet se e ka marrë emrin nga që vendi ka pasur shumë zhuka.

Po ashtu edhe fshati Dëllënjë, nga që ka pasur shumë dëllinja, një bimë apo dru i familjes së koniferëve, në gjininë *Juniperus,* (*Juniperus communis* L.)me gjethe si gjilpëra që bën edhe ca kokrra të vogla të kuqe, kur piqen në vjeshtë, të cilat përdoren për prodhimin e rakisë së dëllënjës, që quhet *Juniperus.*

Këto fshatra kufizohen në Veri nga lumi Vjosë, në Lindje me fshatin Bishan dhe Jallinë e Poros, në Jugë me pyllin e Pishës dhe në Perëndim me detin Adriatik.

Po të shikosh hartën e vjetër duket se lumi i Vjosës ka gjarpëruar përmes këtyre fshatrave, por në fakt Porua dhe Gryka kanë qenë në anën e majtë të lumit, ndërsa Marinëza, Delisufi, Zhuka e Dëllënja kanë qenë në anën e djathtë të lumit Vjosa, deri sa lumi preu nga Bishani e drejt në det, aty ku është edhe sot. Ky drejtim i lumit duhet të ketë ndodhur para 150 vjetëve ose edhe më shumë sepse, siç tregonin pleqtë, pazarin e bënin në Fier, kurse ritet fetare i bënin në kishën e Shën Gjergjit në Pish-Poro. Kjo jetë vazhdoi deri kur lumi Vjosë kaloi në drejtimin që ka sot. E po të shikohet mirë harta e lumit të vjetër kuptohet mirë që ai vinte nga fshati Memkaj nga ana e Fierit (edhe andej ka qenë shtrati i këtij lumi deri vonë, 1955–1960) drejt jugut, afër Hajdinajve dhe Bërdejve, e, më në jug të Shytallarëve afër kishës dhe kthehej drejt perëndimit deri aty ku mbaron fshati Poro dhe kthehej për nga veriu drejt nga Qarrajt e më në veri te Kolajt ose Mitrajt dhe prapë rrotullohej nga shtëpitë e Sheqit të Dëllënjës, d.m.th., nga shtëpitë e Mihal Çunit, te Pali Zarikua në drejtim të jugperëndimit

deri afër Zhukës dhe kthehej nga lindja deri afër 50 metra larg nga po ky lum, te Qarrajt dhe merrte drejtimin nga jugu, duke kaluar pranë shtëpive të Dush Semës e tutje nga Monajt e prapë rrotullohej në drejtim të perëndimit te shtëpitë e Tasi Qorrit e ndërmjet Pilo Lepurit, që ishte nga ana e majtë, nga Pisha, shkonte akoma drejt perëndimit ku kishin shtëpitë Gegajt, Vrushajt, Mbyetallarët e merrte kthesë për nga jugu deri pranë Pishës, rrotullohej për në drejtim të perëndimit deri te Pusi i Grykës, kthehej akoma nga veriu te Dashajt, i afrohej Pyllit të Butë dhe kthehej për nga perëndimi drejt e në det, në Grykën e Vjetër.



Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë në shekullin e 13–14. Në hartë duken Spinarica, Sopi, Apolonia, Zvërneci, Armeni, Vlora, Berati, etj.
(Në Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë)

Lumi i vjetër në shumë vende ka qenë i thellë, duke filluar nga Shytallarët e Poros, te qendra e fshatit Poro deri te Qarrajt, sa që në dimër kishte më shumë se l metër ujë, madje aty ku mbaron fshati, në behar njerëzit zinin peshk e ngjala.

Rrugët me të cilat këto fshatra lidheshin me njëra tjetrën dhe me fshatra të tjerë e me qytetin e Vlorës, para 1946-ës ishin shumë të shtrembra dhe me shumë gropa e baltë në dimër. Për të hyrë në fshatin Poro e me thellë ishin tri rrugë. Njëra ishte afërsisht aty ku është sot rruga e shtruar me asfalt që vjen nga Bishani. Hynte te shtëpia e Zoi Çukos dhe shtrembër e shtrembër vinte në Poro aty ku takohet edhe sot me rrugën që vjen nga drejtimi i jugut. Një tjetër ishte drejt shtëpive të Prendi Koçit, ashtu siç është edhe sot për në qendër të Poros. Rruga e tretë hynte në afërsi të Pishës dhe shkonte anës Fraksios e drejt perëndimit te Pusi i Grykës. Po të shikosh hartën e vjetër të këtyre fshatrave të para Reformës Agrare duken edhe

rrugët edhe shtëpitë e fshatrave të vendosura nëpër pronat e tyre.

Reforma Agrare hapi rrugë të drejta, ato që janë sot dhe shtëpitë u grumbulluan e u sistemuan në parcela në formë kuadrati, siç janë sot.

Në këto rrugë fshatarët qarkullonin, mermin ose jepnin me njeri tjetrin e lidheshin edhe me qytetin me anë të atyre mjeteve të transportit që kishin të asaj kohe që ishin kuajt e qerret me dy rrota të tërhequra me qe ose me buaj.

Si kafshë transporti kanë përdorur kuajt, qetë, buajt si kafshë të larta e të forta për të përballuar vështirësitë e baltës së dimrit.

Këto rrugë të drejta u shtruan me gurë e zhavorr nga shteti pas vitit 1970. Me asfalt janë shtruar pas viteve 2005, po nga shteti.

Një pjesë e lumenjve të vjetër është kthyer në tokë buke ose në to janë bërë ndërtime të ndryshme për banim ose për punë.

Këto fshatra janë marrë kryesisht me bujqësi e me blegtori të paktë. Por ka pasur edhe disa familje që kishin bagëti të imta deri 200 apo 300 krerë dele ose dhi. Në këto 4–5 fshatra kanë qenë afërsisht 120 shtëpi ose fise të ndryshme, të cilat deri në vitin 2010 janë dyfishuar.



Ura e Mifolit mbi Lumin e Vjosës, është ndërtuar në kohën e Zogut, hedhur në erë tre të katërtat e saj nga gjermani 1944, dhe rindërtuar menjëherë pas çlirimit më 1945

Lëvizje demografike ka pasur herë pas here, vinin e iknin për arsye të ndryshme. Më shumë lëvizje brendapërbrenda fshatrave kanë ndodhur pas 1956-ës, kur u bë kolektivizimi i bujqësisë. Në Poro erdhën shumë nga Dëllënja, nga Zhuka, por edhe nga Gryka e nga Delisufi dhe këto për arsye se në Poro ishte shkolla tetëvjeçare dhe e mesme, ambulanca, materniteti dhe lehtësira të tjera që u krijuan.

Besimi fetar ka qenë ai kristjan-ortodoks dhe kanë pasur vetëm një kishë deri 1967. Nga 1967 e deri 1993 nuk kanë pasur kishë. Pas këtyre viteve u rindërtua kisha e Shën Kollit në Poro dhe kisha e Shën Harallambit në Dëllënjë, të cilat frekuentohen jo vetëm nga të moshuarit por edhe nga brezi i ri.

Marrëdhëniet midis familjeve apo fiseve të ndryshme kanë qenë të mira. Nuk ka pasur kurrë grindje serioze për probleme ekonomike apo sociale. Edhe me 3–4 familje myslimane që kanë jetuar në këto fshatra kanë pasur fqinjësi të mirë e mirëkuptim.

DINAMIKA E POPULLSISË

Shtimi i popullsisë për 100 vjetët e shkuara në këto fshatra ka qenë i kënaqshëm. Disa familje janë shtuar më shumë me meshkuj se sa me femra, por ka edhe fshatra që më shumë janë shtuar me femra se sa me meshkuj. Fisi i Loshajve, p.sh., ka 20 meshkuj më shumë se femra. Sikot kanë 13 meshkuj më shumë se femra. Po kështu, në vazhdim, Shyti ka 10 meshkuj më shumë, Dila ka 12, Garro ka 19, Lepuri ka 12, Naçi 9, Hoxhara 8 meshkuj më shumë, etj.

Por ka edhe familje që kanë lindur më shumë femra si, p.sh., te Moçkallarët: femra 31, Kola 15, Çuka 5 femra më shumë, etj.

Ka edhe fise ose familje që janë shuar fare nga që nuk kanë lindur djem, ose për ca kohë kanë lindur vetëm vajza.

Përgjithësisht, natyra e ruan vetë raportin midis meshkujve dhe femrave. Vetë njerëzit e gjejnë balancimin, duke dhënë e duke marrë te njëri-tjetri.

Dhe kështu jeta vazhdon në pafundësi.

Në këto 4–5 fshatrat tona për këto 100 vjetët e fundit janë lindur 994 meshkuj dhe 826 femra, me një diferencë prej 168 meshkujsh më shumë.

Në këto kushte dilte një problem:

Si i bëhej hallit, kur kishte apo ka më shumë djem ose femra më shumë, ku do të martoheshin ata?

Vetë njerëzit e gjenin rrugën e zgjidhjes. Me shokë e miq, ose duke u njohur vetë, ata janë rregulluar dhe kështu jeta ka vazhduar.

Fëmijët janë të barabartë, si djem edhe vajza. Fëmijët janë pasuria më e madhe. Vendi e shoqëria kanë nevojë vazhdimisht për njerëz, prandaj të gjithë pasardhësit tanë s'ka pse të kufizohen apo të tremben nga fëmijët e shumtë.

Në disa vende të botës, shoqëria po plaket, sepse njerëzit nuk martohen, ose kufizohen në lindjen e fëmijëve. Kjo nuk është gjë e mirë. Ka edhe vende po shtohen me shumicë. Kjo është gjë e mirë. Deri sot, shoqëria njerëzore nuk ka arritur të shtohet edhe artificialisht dhe ajo nuk është e sigurt nëse cilësia e shoqërisë njerëzore do të jetë më e mirë nga kjo që është sot. Ndoshta, ajo kohë do të vijë, kur shkenca të thotë fjalën e saj.

Dihet se në shtimin ose pakësimin e popullsisë ndikojnë shumë faktorë: siç janë p.sh.: ekonomikë, sociologjikë, politikë, filozofikë, teologjikë, natyrorë, etj. Pasardhësit tanë do ta shohin vetë nëse popullsia po shtohet, rri e pandryshuar apo po pakësohet, dhe vetë ata, në mënyrë të natyrshme, do ta zgjidhin këtë problem. Nëse një çift lind dy fëmijë, ky është një riprodhim i thjeshtë, që do të thotë se numri i popullsisë mbetet i pandryshuar; kur lindin më shumë se dy, kemi të bëjmë me riprodhimin e zgjeruar, që do të thotë se popullsia vjen duke u shtuar, dhe, e kundërta, kur ata lindin më pak se dy fëmijë, popullsia vjen duke u pakësuar, që do të thotë se kemi të bëjmë me një komunitet në plakje. Ne, hëpërhë nuk kemi pse të shqetësohemi për këtë çështje. Detyra jonë është që të lindim dhe të rritim fëmijë sa më të shëndetshëm, të arsimuar dhe të edukuar.

Të tjerat i zgjidh vetë koha.

Njerëzit në fshatrat tona janë me trup mesatar, të rregullt, të shëndoshë, pa deformime fizike. Ata kanë njohur varfërinë ekonomike, por kurrë sëmundje trashëgimie fiziologjike, kanë qenë analfabetë deri nga mesi i shekullit të 20^{të}, por nuk u ka munguar zgjuarsia natyrale. Kushtet e jetesës i kanë pasur të vështira, por dëshira dhe etja për një jetë më të mirë ka qenë gjithnjë ëndrra e tyre. Koha dhe jeta ecën gjithnjë përpara, me të gjithë zigzaget e saj. Njerëzit janë gjithmonë optimistë për të ardhmen.

Nga fshatrat tona kanë dalë me dhjetëra e dhjetëra kuadro të ndryshëm, me shkollë të mesme e të lartë, në të gjitha fushat. Kemi mësues, agronomë, zooteknikë e veterinerë, policë e oficerë në të gjitha drejtimet, detarë, mjekë, farmacistë, stomatologë, muzikantë, poetë, shkrimtarë, dhe shumë e shumë specialistë ndërtimi e artizanati, kur para 70 vjetëve gjeje vetëm disa djem me shkollë fillore.

Nuk kam marrë përsipër të bëj krahasime për ndryshimet që janë bërë nga 1945 e këtej. Unë i vura vetes detyrë të nxjerr shtimin e popullsisë, ku kanë marrë nuset e ku kanë dhënë vajzat e tyre.

Në natyrë çdo gjë është e lëvizshme. Edhe njerëzit lëvizin nga një vend në një tjetër. Marrin e japin, qëndrojnë e ikin prapë. Asnjë nuk është i palëvizshëm. Emigrimi i sotëm ka nisur të jetë i lirë nga një qytet në një tjetër, nga një vend në një vend tjetër, nga një shtet në shtetin tjetër.

Falënderoj shumë gjithë ata që më kanë dhënë ndihmën për të mbushur këtë fletore me aq sa ata kanë mundur. Kjo punë nuk është meritë e punës time, por edhe e gjithë njerëzve me të cilët kam biseduar dhe që janë treguar të gatshëm për t'i hedhur në letër të gjithë emrat e gjyshërve, të stërgjyshërve, të bijve, të nipërve, të mbesave dhe të stërnipërve e stërmbesave të tyre, të cilët edhe ata vetë, disa nuk i kanë parë me sy, nga që kanë lindur jashtë e nuk vijnë dot të takojnë e të shohin gjyshin e gjyshen të cilët qajnë natë e ditë për gjakun e gjakut të tyre. Më vjen keq për tre familje që nuk munda të shkruaja disa radhë, jo për fajin tim, por se ata vetë nuk deshën (Y.K., Zh.Rr., Y.N.).

Bashkëjetesa midis myslimanëve dhe të krishterëve, siç duket dhe nga lista e emrave, nuk ka qenë ndonjë problem me rëndësi. Sipas besimeve, fëmijëve u vinin emra nga një fe tjetër, që kur fëmija lindej, duke menduar e shpresuar se do të ishin të mbarë dhe do të jetonin më shumë. Sot, disa nga emrat e vjetër, që viheshin më parë, nuk vihen më, fjala vjen: Trush, Prendi, Tonçi, Qirici, Uan, Naun, Zoi, Zogu, Viqe, Qyrane, Dafinë, Lule, Kalie, emra që para 100 vjetëve ishin të modës në Myzeqe. Emrat e rinj, të padëgjuar kurrë, i marrin nga librat, nga filmat, nga ato vende ku djemtë kanë emigruar. Edhe para 50 vjetëve viheshin emra të njerëzve të dëgjuar në botë që kanë bërë histori në luftëra e në revolucione, por sot nuk përdoren më. Sidoqoftë, emra të vjetër apo të rinj, të vendit apo të huaj, nuk përbëjnë ndonjë problem, ata janë shqiptarë. Edhe në fund të botës të venë, prapë ata mbeten shqiptarë.

Pas viteve 1945 ka pasur shumë martesa me myslimanë nga fshatra të tjerë. Tani pas viteve 1990, kur shumë të rinj emigruan jashtë shtetit, po martohen me vajza nga vende të ndryshme të botës e me besime të ndryshme fetare. Si djemtë, dhe vajzat tona, janë martuar, për shembull, me grekë, italianë, turq, moldavë, rusë, izraelitë, etj.

Pas 50 apo 100 vjetëve, të tjerë njerëz do të vijnë, të tjerë emra do të përdoren për fëmijët e lindur . Rëndësi ka që ata të dinë se cilët ishin paraardhësit e tyre. Sikur ne sot të dinim se cilët ishin emrat e të parëve tanë që kanë jetuar para 100 apo 150 vjetëve do të ishte një kulturë, një histori e vlefshme. Po kush do t'i shkruante në atë kohë, kur të gjithë ishin analfabetë, apo kishin kushte që t'i ruanin këto dokumente të vlefshme për sot? Ata tregonin emra, ngjarje e histori po kush i shkruante? Shkolla jonë në fshatin Poro u hap për herë të parë në vitin 1918, po kush u interesua dhe i vlerësoi këto probleme që t'i shkruante?

Asnjë.

Ja, unë sot po shkruaj diçka për njerëzit e çdo familjeje që ka jetuar në shekullin e 20^{të} dhe jeton edhe sot, e më pas.

Ata që do të vijnë pas nesh, me siguri që do ta përpunojnë dhe do ta sistemojnë edhe

më mirë, dhe puna e tyre do t'u shërbejë të tjerëve që do të vijnë më pas. Dëshiroj, që kushdo që do ta marrë në dorë këtë libër, ta ruajë me kujdes për pasardhësit, sepse dikush do ta vlerësojë e do ta pasurojë me emra të tjerë, si një dokument me rëndësi të madhe.

Për sëmundje trashëguese nuk bëhet fjalë fare, me gjithë kushtet e vështira që kanë pasur. Me kënaqësi mund të them se në këto fshatra, njerëzit kanë gëzuar shëndet të mirë, fizikisht e mendërisht. Janë njerëz të bukur, me trup të rregullt, me gjatësi mesatare e të gjatë, deri në 190 cm e jo më shumë, të shëndoshë, janë të fortë fizikisht, të punës e të qejfit, me humor e të qeshur, nuk janë grindavecë e të sherrit janë të shoqërueshëm, miqësorë e të zgjuar.

Po nuk e mohojmë se në këto 100 vjet, në këto 5 fshatra, ka pasur edhe 6-7 persona me pak dobësi trupore e të meta mendore. Ndoshta këto raste, jo për efekt të ndonjë trashëgimie, por të ndonjë rastësie ose defekteve e të traumave pas lindjes. Sëmundje që transmetohen tek pasardhësit, nuk janë trashëguar kurrë.

Nga poliomieliti kanë vuajtur tre persona, e kjo për arsye të mungesës së ilaçeve në atë kohë.

Edhe pas shpërthimit të centralit bërthamor në Ukrainë, pasojat e tij u ndjenë tek ne. Një çift nga fshati ynë lindi dy fëmijë, një djalë e një vajzë me defekte fizike e mendore. Djali kishte kokë të vogël dhe nuk fliste mirë edhe pse u rrit në kushte të mira në familje, por të dy këta fëmijë, duke qenë me zhvillim jonormalë, u dorëzuan në shtëpinë e fëmijës dhe për ta u kujdese shteti. Tani djali jeton, por ka të meta. Vajza nuk jeton. Fëmijët e tjerë ky çift i ka shumë të mirë.

Djali me poliomielit, i datëlindjes 1934 u rrit, ecte avash-avash me paterica, u martua dhe ka lënë trashëgimtarë. Ai jetoi 72–73 vjeç. Vajzat me poliomielit jetuan deri vonë, njëra mbushi moshën 80 vjeç.

Njerëz sakatë ose topallë nuk ka pasur asnjë.

Martesat në afërsi gjaku nuk janë bërë kurrë, prandaj duhet të ruhemi shumë në lidhjen e miqësive e të krushqive, për të pasur sa më të pastër racën njerëzore sepse, nga martesa në afërsi gjaku, dalin pasardhës jo cilësorë. Dalin me të meta mendore e me shumë defekte të tjera fizike, prandaj, për të pasur një familje të mirë të shëndetshme e të saktë, lipset të shikojmë mirë atje ku të marrim e të japim për lidhje martesash. Dhe ky libër i brezave do të shërbejë edhe në këtë drejtim.

Tani që i shkrova gjithë këta emra, e që shumë nga ata nuk jetojnë më, më duket sikur u takova me të gjithë ata që kam njohur nga afër. Më kujtohet xha Markua i nderuar, duke shërbyer në kishë në ato detyrat e tij, më kujtohet papa Spirua, me atë paraqitjen e tij të bukur me rrobat e zeza dhe kambillaf në kokë, që ishte serioz e gjithë autoritet, më kujtohet mësuesi i shkollës Naun Çobo kur rreshtonte nxënësit para shkollës me bilbil, më kujtohen shumë pleq të urtë e të mençur që mblidheshin e flisnin për hallet e problemet e ndryshme të kohës te dyqani i Resulit, më kujtohen shumë burra të fshatit që punonin në arat e tyre me ato parmendat primitive prej druri, apo qerret me bostan kur niseshin për në Pazar, në rresht njëra pas tjetrës, ose tufat e deleve e të dhive që venin e vinin nga kullota. E sa e sa ngjarje nga jeta e përditshme, me gëzimet e hidhërimet e saj.

Për jetën dhe punën në kooperativën bujqësore duhet një Jakov Xoxe që të na i përmendte të gjitha, se ajo qe një periudhë, kur në fshatrat tona u bënë shumë ndryshime të mëdha në të gjitha fushat. U hapën toka të reja, u shpyllëzuan sipërfaqe të mëdha toke, u thanë lumenj e rrëke që ishin tradicionalisht nën ujë, u rritën rendimentet në shumë kultura bujqësore e në blegtori.

Vendin e parmendës së drurit e zuri traktori. Transporti primitiv u zëvendësua me mjete mekanike e motorike moderne. Puna e jeta u gjallërua kudo: në arsim, shëndetësi dhe në aktivitete kulturore sportive.

Po sot?

Shumë të rinj janë larguar nga vendi i tyre, në kërkim të një jete më të mirë, e nuk kthehen më. Kanë emigruar në Itali, në Greqi e deri në Amerikë. I kujtoj tani në moshë të thyer.

Por, le t'i lëmë mënjanë kujtimet e mia.

Duhen përmendur edhe rrugët, edhe elektrifikimi. Rrugët e drejta që kemi sot, janë hapur që më 1946 pas Reformës Agrare; më parë kanë qenë shumë të shtrembra, të ngushta e gjithë baltë. Ato u shtruan me kalldrëm e zhavorr pas viteve 1970 dhe u asfaltuan pas viteve 2005.

E1ektrifikimi u bë në të gjithë zonën tonë, si në të gjithë vendin, më 1968–1969. U bënë edhe kërkime për naftë nga shteti, duke shpuar tre puse të thellësive të mëdha, një në Dëllinjë, një në Delisuf e një në buzë të gjolit, por nuk doli gjë. As ujë i pijshëm nuk u gjet. Uji i pijshëm vjen nga Novosela me anën e tubacioneve, por tani e blejnë të ambalazhuar në bidonë plastikë.

SHKOLLA GJATË PERIUDHËS 1918-2008

Shkolla në Poro u hap për herë të parë në vitin 1918. Në fillim me pak nxënës dhe dalëngadalë numri i tyre rritej çdo vit.

Shkolla e vjetër në Poro

Shkolla e Re "Loni Mone" në Poro

Shkolla e Delisufit "Gori Vrushi"

Mësuesi i parë i shkollës shqipe ishte Thoma Sema nga Ferrasi i Fierit, mësuesi i dytë ishte Prend Gjini nga Porua (i thoshin edhe Dhaskal Prendi), mësues i tretë ka qenë Niso Prifti nga Zhuka. Të tre këta kanë qenë deri në vitin 1924.

Në vitin 1924 erdhi mësues Naun Spiro Çobo nga Struma e Fierit, ose e Beratit. Naun Çobo ishte i përgatitur, kish qenë edhe emigrant ekonomik në Amerikë, dhe atje kish marrë pjesë në shoqëritë patriotike shqiptare të udhëhequra nga patriotë shqiptarë si: Fan Noli, etj. Naun Çobua kontribuoi shumë në ngritjen dhe ndërtimin e shkollës së fshatit Poro. Në fillim, si shkollë ka shërbyer një ndërtesë e Kishës së Shën Kollit, në kushte të vështira. Nuk kishte banka, me pak lapsa e fletore. Nxënësit uleshin në shesh, në rrogoza dhe me mungesa të tjera për një mësim të rregullt. Sidoqoftë, shkolla eci përpara. Si fëmijët, edhe prindërit, ishin të vullnetshëm që të mësonin shkrim e këndim dhe aritmetikë e diçka si punë praktike bujqësore e mësim natyre. Po më shumë ishte edukata që merrnin aty për të ardhmen e tyre.

Sa erdhi, Naun Çobua hodhi idenë për ndërtimin e një shkolle të re dhe, me ndihmën e vetë fshatarëve, filloi ndërtimi i shkollës në afërsi të kishës e në territorin e saj, në pronat e kishës, aty ku është edhe sot. Shkolla u ndërtua me shtylla betoni e me çatma të thurur me kallëm, mbuluar me qeramidhe dhe me dritare të mëdha për dritë e ajër. Ishte vetëm një sallë disi e madhe 10–12 m e gjatë dhe 5–6 m e gjerë, e shtruar poshtë me dërrasë dhe me tavan të lyer me llaç gëlqere. Ngjitur me sallën e shkollës ishte edhe dhoma e banimit të mësuesit, i cili punoi e jetoi aty pa familje deri në vitin 1943.

Mësuesi Naun Çobo ndikoi shumë edhe në përhapjen e ideve patriotike tek fëmijët, dhe, kur filloi lufta kundër fashizmit dhe u përhap ideja për çlirimin e vendit, shumë nxënës

të asaj shkolle dolën partizanë, disa prej të cilëve dhanë edhe jetën për çlirimin e atdheut.

Nga viti 1924 e deri në vitin 1943 ka shërbyer në të katër klasat fillore vetëm një mësues. Mësimin e zhvillonte duke kombinuar programet për secilën klasë, sigurisht me vështirësi, par ai dinte dhe ia dilte mbanë të zbatonte programin e shkollës.

Shkolla e fshatit Dëllënjë "Uani Sota"

Në shkollë vinin djem e vajza, pa asnjë dallim e kufizim.

Është për t'u përmendur se kur erdhi patrioti Jani Minga për inspektim ditën e parë dhe gjeti mësuesin Niso Prifti në shkollë i cili, kur e priti, i uroi mirëseardhjen në shkollë në gjuhën greke, Jani Minga u mërzit shumë, e i tha: "Këtu jepet gjuhë shqipe apo greqisht!". Ky, i turpëruar, i tha se donte për ta respektuar, por ai e pezulloi menjëherë nga puna, pse i foli greqisht!

Mësuesi ishte nga Zhuka dhe aty nuk flitej fare gjuha greke, madje as edhe sot, por si duket ai dinte pak greqisht dhe tha se mos ishte më mirë ta përshëndeste greqisht. Mirëpo, ajo u bë shkak për tu pushuar nga puna. Pas tij erdhi si mësues Naun Çobo, një burrë shumë i mirë e i aftë për edukimin e fëmijëve. Ai fitoi shpejt respektin e të gjithëve dhe fjalën e tij e dëgjonin dhe e zbatonin të gjithë.

Pas Çlirimit, në Poro erdhën shumë mësues e deri më sot vazhdojnë të vijnë për tu dhënë mësim nxënësve, numri i të cilët u rrit nga viti në vit, dhe shkolla fillore u bë 7 vjeçare, 8 vjeçare, dhe më vonë 12 vjeçare bujqësore, e cila funksionoi deri në vitin 1990. Më vonë, shkolla e mesme 12 vjeçare bujqësore u mbyllë. Nxënësit që donin shkollë të mesme shkonin në Novoselë e në Vlorë. Kjo gjendje është edhe sot. Gjatë luftës shkolla u mbyll dhe u hap në vitin l945.

Pas çlirimit të vendit, kanë shërbyer shumë mësues. Unë po i shkruaj një e nga një, me emër e mbiemër, dhe me prejardhjen e tyre:

Pas vitit 1945 kanë qenë mësues:

l - Paqyze Xhyheri	nga Vlora
2 - Llazi Qarri	nga Porua
3 - Guro Panajaja	nga Panajaja
4- Lonidha Konomi	nga Narta
5- Spiro Ceka	nga Narta
6- Apostol Çano	nga Narta
7- Leonora Tafili	nga Vlora
8 - Athina Belina	nga Poro
9- Enver Demi	nga Saranda
10- Xhemal Dibra	nga Vlora
11- Athina Konomi	nga Vlora
12- Kasëm Roshi	nga Vlora
13- Ali Premti	nga Vlora

14- Agim Hazizi nga Vlora
15- Birçe Hasko nga Dukati
16- Ali Barjami nga Tërbaçi
17- Gani Besho nga Tragjasi
18- Bejaze Bërdalli nga Vlora
19- Sofika Vani nga Vlora
20- Kosta Dollo nga Vlora
21- Liri Mata nga Porua
22- Vllasi Franxhi nga Narta
23- Antigoni Ceka nga Narta
24- Eva Xhindi nga Vlora
25- Sanie Manoli nga Kuçi
26- Nexho Bollano nga Himara
27- Violeta Bërdalli nga Porua
28- Kastriot Hyso nga Vlora
29- Leonard Moçka nga Novosela
30- Dhimosten Qirko nga Narta
31- Shuaip Troka nga Bishani
32- Alqi Thano nga Novosela
33- Panajot Xhaxho nga Narta
34- Thodhoraq Konomi nga Narta
35- Dhimitër Konomi nga Narta
36- Jani Dilo nga Gjirokastra
37- Anesti Gjipali nga Kudhësi-Çorraj
38- Arqile Bërdalli nga Porua
39- Barie Hoxhara nga Mifoli
40- Shyqyri Aliaj nga lumi i Vlorës
41- Nuro Lulaj nga Gjormi
42- Marsela Çonçi nga Vlora
43- Desanta Mone nga Lezha
44- Vangjel Stefa nga Zvërneci

Në shkollën Zhukë-Delisuf kanë dhënë mësim:
Kjo shkollë u hap në vitin 1935

1- Niso Prifti nga Zhuka
2- Piro Prifti nga Zhuka
3 -Ahmet Malaj nga Vlora
4- Stavri Koreta nga Bestrova
5- Adile Mehmeti nga Fitore
6- Violeta Bendo nga Panajaja
7- Dhimitër Andrea nga Narta
8- Jani Gjonçari nga Zhuka
9- Trifon Gjonçari nga Porua
10- Petraq Mata nga Porua
11-Vasilika Mata nga Porua

12-Dhimitër Dhima nga Dhërmiu
13-Vangjelina Helmi nga Dëllënja
14-Vjollca Mile nga Porua
15- Nesim Kasa nga Kuçi
16- Vangjel Loshi nga Porua
17- Henri Novruzi nga Tërbaçi
18- Aida Naçi nga Porua
19- Laureta Rrungaja nga Zhuka
20- Neftali Lepuri nga Delisufi
21- Themi Mbyeti nga Delisufi
22- Fatos Avdullai nga Gorishti
23- Shyqyri Aliaj nga lumi i Vlorës
24- Idris Balla nga Vranishti
25- Trifon prifti nga Alibani

Në shkollën e Dëllënjës kanë dhënë mësimi:

Shkolla në Dëllënjë u hap në vitin 1960 dhe ka funksionuar deri në vitin 2005–2006. Pas këtij viti, nxënësit venë në shkollën e Delisufit, pra u mbyll shkollë e Dëllënjës.

Mësuesit që kanë dhënë mësim:

1- Dhimitraq Qirko nga Narta
2- Stavre Gjika nga Gjirokastra
3 - Liri Gjika nga Gjirokastra
4- Viktor Papa nga Narta
5 - Leja Bërdalli nga Porua
6- Pandi Prifti nga Alibani
7 - Fatos Babe nga Palasa
8- Evllo Hudhra (Mërtiri) nga Zhuka
9- Frosina Papa nga Vlora
10- Androniqi Gjiknuri nga Kudhësi
11- Natasha Sota nga Vlora
12- Thodhori Davidhi nga Zhuka
13- Vangjel Loshi nga Porua
14- Vllas Mërtiri nga Porua
15 – Shuaip Troka nga Bishani

Shënim: Të gjithë emrat e mësuesve janë marrë nga vetë banorët e fshatrave, jo nga lista e punonjësve të shkollës. Këtu mund të ketë akoma të pashkruar, se janë harruar pa dashje, prandaj kërkojmë falje. Mund t'i shtoni edhe vetë ata që ju kujtohen.

Kuadro me shkollë të lartë nga këto 4-5 fshatra:

1. Sotir Llambro Mojallia Agronom nga Delisufi
2. Thoma Jani Hudhra Agronom nga Dëllënja
3. Koçi Jani Leshi Agronom nga Porua
4. Niko Uani Mata Agronom nga Porua

5.	Piro Thoma Mërtiri	Veteriner	nga Zhuka
6.	Ligor Lamo Kosta	Veteriner	nga Delisufi
7.	Rajmonda Jani Moçka	Veterinere	nga Porua
8.	Niko Loni Mone	Farmacist	nga Porua
9.	Harrilla Loni Mone	Mjek	nga Porua
10.	Marjana Koli Qarri	Mjeke	nga Porua
11.	Natasha Sotir Sema	Mjeke	nga Zhuka
12.	Llazar Thoma Gjindali	Financier	nga Delisufi
13.	Thanas Josif Lepuri	Financier	nga Delisufi
14.	Todi Sotir Loshi	Ekonomist	nga Porua
15.	Toli Uani Mata	Financier	nga Porua
16.	Sotir Leksi Sema	Oficer	nga Zhuka
17.	Pilo Taqi Bërdalli	Oficer	nga Porua
18.	Llazi Leko Plaku	Oficer	nga Porua
19.	Kostandin Niso Konda	Oficer	nga Zhuka
20.	Vangjel Niso Konda	Oficer	nga Zhuka
21.	Dhori Niso Konda	Oficer	nga Zhuka
22.	Petraq Thanas Davidhi	Oficer	nga Zhuka
23.	Tako Petro Kosta	Oficer	nga Delisufi
24.	Rako Mihal Baba	Oficer	nga Dëllënja
25.	Ardian Niko Çuni	Oficer	nga Dëllënja
26.	Andon Kozma Hajdini	Inxh. Pyje	nga Porua
27.	Dorian Thoma Hudhra	Inxh. Naval	nga Dëllënja
28.	Lorenc Koli Mitro	Inxh. Nafte	nga Porua
29.	Arben Niko Garro	Inxh Miniere	nga Porua
30.	Ksenofon Llazi Hajdini	Regjisor	nga Porua
31.	Niko Loni Helmi	Jurist	nga Dëllënja
35.	Vangjelina Helmi	Biokimiste	nga Dëllënja
36.	Margarita Thoma Mërtiri	Prof As. Dr. Biokimiste	nga Zhuka
37.	Leta Llaqi Qorri	Arsimtare	nga Delisufi
38.	Urani Taqo Konda	Arsimtare	nga Porua
39.	Vita Dhori Hajdini	Arsimtare	nga Porua
40.	Olimbi Taqo Konda	Aktore	nga Dëllënja
41.	Valbona Todi Siko	Arsimtare	nga Porua
42.	Rakela Jani Hoxhara	Arsimtare	nga Porua
43.	Fatmir Sezai Xhafa	Jurist	nga Gryka
44.	Teuta Jorgji Gjonçari	Arsimtare	nga Porua
45.	Anila Jorgji Gjonçari	Mjeke	nga Porua
46.	Elidon Nesti Doçi	Arsimtar	nga Porua
47.	Nonda Jorgji Mata	Kuadër politik	nga Porua
48.	Thoma Stavre Moçka	Kuadër politik	nga Porua
49.	Llazi Dhori Hajdini	Kuadër politik	nga Porua
50.	Rita Kostandin Janka	Kuadër politik	nga Porua
51.	Themi Taqo Mbyeti	Kuadër politik	nga Delisuf

Që nga viti 1965 shkolla 8 vjeçare u bë e detyrueshme për të gjithë, por shumë të rinj e të reja morën edhe arsimin e mesëm, përveç atyre që mbaruan edhe arsimin e lartë, sipas listës që bashkëngjitet këtu.

Nga viti 1990 e këtej, në fshatrat tona ka vetëm shkolla 9-vjeçare, shkolla e mesme, që ishte në Poro, u mbyll.

Mësimi i gjuhës mbetet problem për fëmijët që kanë emigruar dhe për ata që linden jashtë shtetit.

Po le të shpresojmë se edhe ky problem mund të zgjidhet nëpërmjet shtetit tonë dhe atyre ku janë vendosur djemtë tanë.

Ndjenja e patriotizmit, e dashurisë për arsim e kulturë nuk ka munguar kurrë.

Nga këto 4-5 fshatra shkuan partizanë 51 vetë nga të cilët 7 vetë ranë dëshmorë:

Nga fshati Poro:

l. Loni Jani Mone Dëshmor
2. Loli Toli Dila Dëshmor
3. Lili Kostandin Leshi Dëshmor
4. Pilo Kostandin Bërdalli
5. Petro Liço Thano
6. Miço Nasi Kungulli
7. Vangjel Uan Marina
8. Sotir Koli Loshi
9. Llazi Koli Llambro
10. Jota Lili Lepuri
11. Naun Spiro Thano
12. Kozma Vangjel Hajdini
13. Koli Vasil Qarri
14. Llazi Naqo Mitraj
15. Pilo Ndini Leshi
16. Goli Llukë Loshi
17. Niso Llazi Janka
18. Llazi Uan Prifti
19. Jorgji Tika Kungulli
20. Lijo Spiro Naçi
21. Urani Llazi Janka
22. Niko Uani Mata
23. Llambi Ndino Qarri
24. Petro Vasil Bërdalli
25. Miti Llazi Janka
26. Vasil Tilo Belina
27. Xhevit H. Bulla
28. Kostandin Janka
29. Thanas Naqo Kola
30. Petro Kola (Lala)

Nga fshati Zhukë kanë qenë partizanë këta persona:

1. Lio Spiro Rista
2. Uan Kozma Sota Dëshmor
3. Kozma Jorgji Davidhi Dëshmor
4. Sotir Leksi Sema
5. Niso Pilo Rrungaja
6. Perikli Sotir Gjonçari
7. Niko Spiro Rista
8. Vasil Niso Prifti
9. Koli Uan Zaka
10. Petro Pali Gjonçari
11. Caci Leko Gjonçari

Nga fshati Dëllënjë kanë qenë partizanë:

l. Gori Lami Marku
2. Thanas Pilo Thanasi
3. Pali Kristo Helmi
4. Vllasi Lami Marku
5. Josif Tasi Baba

Nga Delisufi dhe nga Gryka kanë qenë partizanë:

1. Loni Toli Ndini
2. Gori Spiro Vrushi Dëshmor
3. Lili Jani Mitrushi
4. Tako Petro Kosta
5. Kristaq Davidh Mbyeti
6. Lili Miti Stefa
7. Lili Llazi Naka Dëshmor
8. Pilo Kozma Prifti
10. Vangjel Spiro Vrushi
11. 10. Mino Dashi
11. Vangjel Leksi Memeci
12. Miti Llazi Kove
13. Jani Leksi Kërri
14. Kici Leksi Dashi
15. Sotir Llambro Mojallia
16. Petro Uan Lepuri
17. Llaq Qorri
18. Josif Qorri
19. Vlash Naka
20. Llambro Lepuri
21. Uan Mbyeti
22. Jani Kërri
23. Gor Mbyeti
24. Vangjel Vrushi
25. Mit Dashi
26. Mit Kove

27. Mino Dashi
28. Lil Marku

Nga këta djem e burra që shkuan partizanë kanë rënë dëshmorë 7 veta:

1. Loni Jani Mone nga Porua
2. Loli Toli Dila nga Porua
3. Lili Ndini Leshi nga Porua
4. Uani Kozma Sota nga Zhuka
5. Kozma Jorgji Davidhi nga Zhuka
6. Gori Spiro Vrushi nga Delisufi
7. Lili Llazi Naka nga Delisufi

Nga fshati Grykë kemi edhe "Një Hero i Popullit":

l. Ilia Kici Dashi.

Pas Çlirimit të tjerë kuadro të ndryshëm në Poro
Kryetarë të pushtetit kanë qenë:

1. Miti Jorgji nga Vlora
2. Llambi Qarri nga Porua
3. Nonda Mata nga Porua
4. Koçi Leshi nga Porua
5. Arqile Llambro nga Porua
6. Gor Sheqi nga Porua

Kryetarë të kooperativës bujqësore pas vitit 1956 kanë qenë:

1. Miti Jorgji në Poro
2. Koli Qarri në Poro
3. Sotir Llambro në Poro
4. Ilia në Poro për 5 fshatra
5. Arshi Telo në Poro për 5 fshatra
6. Naun Thanasi në Dëllënjë për 1 fshat
7. Naun Gjonçari në Zhukë e Delisuf

Kryetarë të Këshillit Popullor të Bashkuar kanë qenë:

1. Rahmi Doraci nga Bishani
2. Nonda Mata nga Porua

Kryetarë të Kooperativës Bujqësore të Bashkuar kanë qenë:

1. Arshi Telo nga Bishani
2. Spiro Pasku nga Vlora
3. Llambrini Ngjelo nga Mifoli
4. Gëzim Çaushi nga Gorrishti
5. Halim Gega nga Dukati

Shënim: Kryetarët e kooperativës bujqësore të bashkuar u emëruan nga pushteti në rreth dhe u aprovuan nga Asambleja e Kooperativës, apo Përfaqësia e tyre.

Deputetë të zgjedhur për gjithë zonën pas vitit 1946 deri 1990 kanë qenë:

1. Vangjel Moçka nga Novosela
2. Mihal Shkurti nga Vlora
3. Niqi Shtylla nga Zhuka
4. Llambrini Laska nga Mifoli
5. Spiro Pasko nga Vlora
6. Llazar Gjindali nga Delisufi

Vangjel Moçka

Mihal Shkurti

Niqi Shtylla

Llambrini Laska

Spiro Pasko

Pas vitit 1990 ka qenë deputetë:

1. Arben Malaj nga Vlora

Arben Malaj

KISHA E SHËN KOLLIT, PORO
HISTORIKU I KISHËS

Poro, 10 janar 2000.

Kisha e Shën Kollit u ndërtua në vitin 1910. Duke pyetur më të moshuarit e fshatit, për sa flitet gojë më gojë, para kësaj ndërtese ka ekzistuar një faltore e vogël, ku kanë shërbyer disa priftërinj me radhë, që nga viti 1800 e deri në vitin 1967, kur u prishën kishat gjatë regjimit komunist. Ndër ata që mbahet mend si prift i parë, mendohet të ketë shërbyer Atë Dhimitër Prifti nga Zhuka. Me vdekjen e tij, emërohet nga Dioqeza e Beratit, Atë Kozma Thërecka. Ai ishte nga Mangalemi i qytetit të Beratit, i cili, kur erdhi këtu, e ndërroi mbiemrin në Prifti. Atë Kozma Prifti vdiq i ri dhe, në vend të tij, erdhi At Nikolla Naçi, i cili ndërroi jetë në prag të ndërtimit të kishës. Vendin e tij e zuri i biri, Atë Spiro Naçi nga Porua. Ai shërbeu në këtë kishë që nga viti 1910 deri në vitin 1950. Nga viti 1933 deri në vitin 1944–1945 ka shërbyer edhe Atë Leksi Sema, i cili kishte si norie[1] tre fshatra Zhukën, Delisufin dhe Dëllënjën, ndërsa Atë Spiro Naçi kishte Poron dhe Grykën deri në vitin 1945. Me transferimin e Papa Leksit në Vlorë, këtu erdhi prift i ri, papa Jani Katrua, i cili edhe ky shërbeu po në këtë kishë deri sa u transferua në qytetin e Lushnjës. Emrat e këtyre dy priftërinjve janë gjetur edhe në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë pasi kanë hipotekuar pronat e kishës në vitin 1946. Në vitin 1946 e këtej kisha ka qenë më e organizuar. Besimtarët ishin më të kujdesshëm, më të bindur dhe vullnetarisht shërbenin si epitrop[2], ose ndihmëtar, psallt[3], etj.

Kisha e Shën Kollit

Epitropi i parë që mbahet mend, dhe që ka shërbyer në kishë qysh nga ndërtimi i saj, ishte Marko Moçka–njeri besimtar dhe shpresëtar i mirë. Ai ndihmoi në ndërtimin e kishës. Si kryeusta ka qenë Zoji Mone nga Vlora. Pas ndërtimit të kishës, Marko Moçka me kredinë dhe popullaritetin që gëzonte në gjithë zonën, këmbënguli që kisha të bëhej më e mirë dhe me afreske nga brenda. Dhe, në fakt, gjithë sipërfaqja e mureve nga brenda ishin të pikturuara me ikona të ndryshme. Këto ikona ishin si një libër i hapur dhe i kuptueshëm për analfabetët, siç ishte enosia jonë. Aty tregohej e gjithë jeta njerëzore, nga krijimi deri në vitet e sotme. Tregohej lindja e Jezu Krishtit, e gjithë jeta e tij, Shën Maria, apostujt dhe gjithë shenjtorët. Në hapësirën e kishës, pranë ikonave kryesore, vareshin kandila vaji dhe për ndriçim përdoreshin qirinj të vendosur nëpër shandanë të mëdhenj, të zbukuruar me lloj-lloj gurësh transparentë e të ndritshëm dhe shumë sende të tjera zbukurimi, me poliela[4] të mëdhenj të varur në tavan, dhe shumë e shumë ornamente e punime artistike, që i jepnin kishës një pamje mjaft të bukur e mahnitëse. Dy kambanat e saj ishin me një zë aq të bukur e të fortë sa dëgjoheshin edhe tre orë larg. Një nga këto kambanë, më e madhja, ishte e taksur, e porositur

[1] Zonë e caktuar (fjalë fetare)
[2] Përgjegjës i Këshillit të kishës (fjalë fetare)
[3] Ata që këndojnë librat në kishë gjatë ceremonive të ndryshme
[4] Abazhurë

atje ku derdheshin jashtë shtetit, nga një besimtar i zonës Rako Kroni Koçi nga Dëllënja. Në kambanë ishte stamposur emri i porositësit dhe adresa e fshatit Poro, por kjo u thye e u shkatërrua nga keqbërësit, kur u mbyllën kishat më 1967, dhe tjetra, më e vogla, humbi pa adresë. Të gjitha pajisjet dhe shumë sende e ornamente të grumbulluara nga vetë epitropi dhe punimi e mirëmbajtja e tyre dhe e gjithë kishës ishte meritë e kujdestarit të saj Marko Moçkës, e klerikëve që kanë shërbyer aty me devotshmëri, për të cilët populli ruan edhe sot respekt e konsideratë të lartë. Kur papa Janin e transferuan në Lushnjë dhe papa Spirua ndërroi jetë, pas vitit 1950, kisha mbeti pa prift për 4 vjet. Në këtë kohë vinin me radhë, herë papa Lipi nga Novosela dhe herë At Mihal Greku nga Alibani që shërbenin në kishën e Poros. Në vitin 1954 hirotoniset[5] në prift, Atë Ilia Koçi, ose siç i thërrisnin papa Lili nga Dëllënja. Ky shërbeu në këtë kishë e në gjithë këto 4-5 fshatra, të asaj kohe, deri në vitin 1967, kur u mbyllën kishat. Papa Lili ishte një klerik i urtë dhe shumë i ndërgjegjshëm, i rregullt e i ndershëm. Pas vdekjes së xha Markos së nderuar, në vendin e tij, këshilli i kishës, zgjodhi ose caktoi si epitrop nipin e tij Lijo Fani Moçkën, që i ngjante xhaxhait të tij, Marko Moçkës. Ai e mbajti detyrën derisa u mbyllën kishat. Ditën që u mbyll kisha, gjithçka u vodh e u dogj, u shkatërrua. Sendet me vlerë u morën nga adoleshentët dhe hajdutët heretikë. U dogjën librat e shërbesave. Ungjilli i Shenjtë, veshjet priftërore, stolitë "mbretërore", e të tjera materiale që ishin siguruar e bërë me shumë mundime për të mirën e kishës dhe të vetë popullit, u shkatërruan. Kisha mbeti vetëm me katër muret dhe çatinë. Më vonë, u përdor si magazinë dhe si shtëpi kulture, ku bëheshin shfaqje artistike e filma, ose bëheshin mbledhje të popullit për probleme të ndryshme ekonomike e politike. Kështu, ndërtesa shërbeu deri në 1980, kur u rrëzua nga një tërmet. Pas vitit 1990, me ardhjen e pluralizmit në Shqipëri edhe këtu shkëndija e parë e demokracisë ndezi zemrat e besimtarëve për të rifilluar ndërtimin e kishës. Në këtë kohë i vetmi prift që rronte ishte Atë Kozma Qirjo nga Bestrova. Ai u thirr dhe bëri shërbesën e Ajazmës për herë të parë mbi rrënojat e kishës së vjetër të Shën Kollit, pas-vitit 1990. Po këtë ditë bëri edhe pagëzimin e një fëmije, që kishte lindur 8 ditë më parë, Arjan Mihallaq Loshin.



Kisha e re e Shën Kollit e ndërtuar në vitin 1993, 10 m larg nga themelet e kishës së vjetër

Me bekimin dhe fondin e Fortlumturisë së tij, imzot Anastas Janullatos filloi ndërtimi i kishës së re me parafabrikate të ardhura gati për montime në korrik të vitit 1993. Në këtë kohë u hodhën edhe mendime për klerikun e ardhshëm. Punimet u bënë nën drejtimin e dhjak Sotiraq Priftit nga Novosela dhe studentit të shkollës Teologjike në Durrës, Z. Dhimitër Kushi nga Mifoli. Të dy këta, kishin mbaruar

[5] Emërohet

vitin e parë të shkollës. Për të vazhduar shkollën teologjike në Durrës, si kandidat për t'u bërë prift i enorisë u propozua Sotir Spiro Prifti, nga fshati Poro, i cili u miratua nga të gjithë përfaqësitë e tre fshatrave të kësaj zone si edhe nga kryesia e Vlorës. Sotiri bëri gati dokumentet që duheshin, sipas kërkesave të shkollës dhe filloi mësimet teologjike me 10 tetor 1993 dhe i mbaroi pas tre vjetësh, më 20 Maj 1996. Ky ka qenë një student nga më të mirët e shkollës (i dyti në gjithë studentët); nga 64 veta që u regjistruan në fillim mundën të mbaronin 16 veta.

Dy javë para se të mbaronte shkolla, Sotiri u hirotonis dhjak. Në datën 29 Qershor 1994 erdhi në Poro Kryeepiskopi Anastasi, bëri bekimin e themeleve dhe vendosi gurin e parë në themelet e kishës në prani të shumë besimtarëve të fshatrave Poro, Zhukë-Delisuf e Dëllënjë. Kisha u ndërtua brenda vitit 1994 dhe u plotësua gradualisht me të gjitha orenditë e nevojshme. U bë edhe më mirë organizimi administrativ, duke plotësuar këshillin e kishës dhe duke emëruar kryetarin e saj dhjakun Sotir Prifti. Për përpilimin e këtij historiku të kishës ndihmuan më të moshuarit e këtyre fshatrave si, Loni Mojallia, Kozma Mojallia, Fili Bërdalli, Lijo Sota, Llazi Llambro, Pilo Shyti e të tjerë[6].

KISHA E SHËN HARALLAMBIT NË DËLLËNJË

Në Dëllënjë ka ekzistuar një pyll me vidha prej një apo dy dynym sipërfaqe. Ky ishte brenda kufirit të arave të Xha Rako Kronit dhe njihej e flitej si pylli i Shën Harallambit. Deri në vitet 1940 nuk ka pasur asnjë shenjë objekti, përveç pyllit të bukur me vidha. Xha Rakua kujdesej dhe e mbante pastër atë territor. Asnjë njeri nuk priste atje ndonjë dru për të bërë qoftë edhe një shkop apo për vegël bujqësore. Këtë e dinin të gjithë dhe nuk qaseshin, se kishin frikë. Rreth viteve 1940, dikujt i polli mendja që atje të vinte një shenjë ku njerëzit të ndiznin ndonjë qiri për nder të këtij ose atij shenjti sipas besimit të secilit. Dhe kështu mori iniciativën një fshatar në Dëllinjë, Pilo Ndini (ose Pilo Gjonça), dhe vendosi dy-tre copë qeramidhe kokë më kokë. Pikërisht aty filluan të ndiznin ndonjë qiri shumë besimtarë, gra e burra. Njëkohësisht u propagandua si vend i shenjtë, duke hapur fjalë se "atij ose këtij iu shfaq në ëndërr, i paçim uratën, kështu e ashtu, bëri ferk, se kështu e si ashtu" dhe kaq u desh që besimtarët, jo që nuk venin të prisnin drurë, por kushdo që mund të kalonte afër pyllit bënte shenjën e kryqit e hiqte kapelën. Kështu dalëngadalë, e për një kohë të shkurtër, te vendi i shenjtë filluan të linin qirinj e pará. Kujdestari, sigurisht që bënte punën e tij duke ndezur qirinjtë çdo ditë e çdo darkë, por edhe lekët që gjente aty i ormiste në një vend të sigurt. Thonë se në këtë iniciativë

Një besimtar para kishës

[6] Marrë nga historiku i kishës, shkruar nga At Sotir Prifti

pati dorë edhe një burrë i mençëm i asaj kohe, Dervish Hekuran Xhafa, që "shëronte njerëz e prishte magjitë".

Pas vitit 1949–1950, kujdestarët ndërtuan një kolibe të vogël me hunj druri e të thurur me purteka dhe lyer me baltë anash e me 10–15 qeramidhe sipër, me një deriçkë të hapur, ku mund të futeshin lekë e të ndizeshin qirinj. Xha Rakua, pronari i vendit, vdiq shumë shpejt, por edhe ky ka pas qenë një nga ata që ruante pyllin e thoshte se atje ishte vend i shenjtë, sepse ishte besimtar i madh. Rreth viteve 1960 besimtarët bënë një dhomë të vogël me tulla e çati të mirë dhe vendosën një apo dy-tre ikona dhe sajuan një kuti ku hidheshin pará. Njerëzit besimtarë u shtuan pak e nga pak dhe kjo punë vazhdoi deri në vitin 1967, kur kishat u mbyllën në gjithë vendin. Ndërsa kisha e madhe e Poros u shndërrua në vatër kulture, ajo e Dëllënjës gjoja u mbyll me çelës që të mos futeshin më njerëz brenda. Në fakt, ata venin dhe hidhnin para te dera ose i hidhnin nga dritarja brenda. Dhe kjo u vërtetua nga verifikimi që bëri një "i deleguar" nga rrethi, se atje venin besimtarë akoma! Kur ai vajti atje dhe hapi derën gjeti me të vërtetë qindra lekë shqiptare dhe shumë monedha të ndryshme metalike të vjetra. Këto para i mori dhe ia dorëzoi njerëzve të pushtetit në fshat dhe porositi që të mos lejonin njerëz që ta frekuentojnë.

Kjo porosi, sigurisht që nuk u zbatua nga besimtarët. Ndërtesa nuk u prish. Pas vitit 1990, aty u ndërtua një tjetër ndërtesë më e madhe dhe u pajis me disa ikona ku njerëzit ndiznin qirinj dhe hidhnin para sipas dëshirës. (Në fakt, rreth 2–3 metra më tej, pikërisht atje ku ishin dhe janë akoma ato 3-4 qeramidhe kokë më kokë, ndizen qirinj edhe sot, nga vajza adoleshente dhe ndonjë grua plakë. Pleqësia e fshatit dhe komuna, pasi siguruan disa të ardhura, ndërtuan rrugën, e asfaltuan deri te kisha në vitin 2008 dhe shkuan autoritete e inauguruan, duke shtruar edhe një drekë në hijen e vidhave të bukur.

Për sa shkrova më sipër, jam vetë dëshmitar që nga koha kur atje s'ka pasur asnjë shenjë e deri më sot , në vitin 2009 që janë bërë të gjitha këto ndryshime tek ai "vend i shenjtë". Unë jam rritur në këtë vend se jam nip i xha Rako Kronit, kam lozur e ruajtur pula deti dhe viçat me gjyshen dhe dajat e mi Thoma e Koli Koçin.

Koha ecën me ndryshimet e saj dhe njerëzit ndryshojnë sipas kohës.

Priftërinjtë që kanë shërbyer në kishën e Poros

1. At Dhimitër Prifti nga Zhuka (s'ka foto)
2. At Kozma (Thërecka) Prifti nga Porua (s'ka foto)
3. At Nikolla Naçi nga Porua (s'ka foto)
4. At Spiro Naçi nga Porua 1910-1950
5. At Aleks Sema nga Zhuka 1933-1945
6. At Jani Katro nga Zhuka 1945-1947
7. At Ilia Koçi nga Dëllënja 1954-1967
8. Nga 1967 deri 1993 nuk kishte as kishë as priftërinj
9. Në vitin 1994 dhjaku Sotir P. Prifti nga Porua

Shënim: Emrat dhe datat janë nxjerrë nga historiku i kishës së Poros që ka shkruar Dhjaku Sotir Pilo Prifti më 10 Janar 2000.



At Spiro Naçi

At Aleks Sema



At Ilia Koçi

Dionis Konda

Jani Llukë Katro

Sotir P. Prifti

FISE DHE FAMILJE TË PESË FSHATRAVE

TASI BABA, DËLLËNJË

Tasi Baba ishte martuar më motrën e Petro Sikos nga Porua, ka lënë dy djem: Spiron dhe Josifin.

Spiro Tasi Baba u martua me Gjena Kristo Helmin nga Dëllënja, ka lënë një djalë, Kostandinin dhe 7 vajza: Vasilinë, Dafinën, Valën, Gorën, Dhoksinë, Marien dhe Donikën.

Kostandin (ose Koçi) Spiro Baba u martua me Lefteri Nasi Titin nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë, Spiron dhe Sonilën.

Vajzat e Spiro Babës:
Vasilika u martua me Koli Bushi, Poro.
Dafina u martua me Kozma Loni Prifti.
Vala u martua me Kozma Thano, Pish-Poro.
Gora u martua me Jorgaq Naun Thanasi, Dëllënjë.
Dhoksia u martua me Niko Jani Hudhra, Dëllënjë.
Maria u martua me Petraq Prifti, Novoselë.
Donika u martua me Palush Nasi Jorgji, Dëllënjë.

Josif Tasi Baba u martua me Ndone Qirjaq Gegën nga Delisufi, kanë dy djem: Kristaqin dhe Thanasin.

Kristaq Josif Baba u martua me Sofie Ndini Zhazhanin nga Delisufi, kanë 5 djem: Fatosin, Ligorin, Sokolin, Adriatikun dhe Besnikun.

Fatos Kristaq Baba u martua me Anila Niko Kozma Rrungaja, Zhukë. Ka një djalë e një vajzë: Lukën dhe Marinelën.

Ligori u martua me Flora Aristir Sema nga Ferrasi, ka l djalë.

Sotiri është i martuar.

Besniku është beqar.

Adriatiku është beqar.

Thanas Josif Baba u martua me Flora Gori Mile nga Himara dhe kanë 4 djem e një vajzë.

Agroni u martua me Irena Vasil Poçi, nga Mekati, kanë dy djem: Agustin dhe Angjelon.

Edmondi u martua me Xhuli Shyqyri Idrizi, nga Pish-Poro, kanë një djalë e dy vajza: Thanasin, Eritean dhe Migenën.

Josif Thanas Baba (I Riu)

Ermiri u martua me italiane, ka një djalë, Tomasin.

Josifi i ri beqar.

Migena është martuar me Florenc Koçi Qorri, Delisufi.

Shënim: Josif e Spiro Baba janë kushërinj me Todin e Rako Babën e Dëllënjës, por jo me Kroni Mitrushin. Kroni Baba nuk është Baba, por është i biri i Mitrush Dylgjerit nga Bishani i Fierit. I thonë edhe Kron Baba se u rrit te Baba Qaforri Mihal Baba: Mihal Baba me të ëmën e Kronit lindi dy djem: Todin dhe Rakon.

Mihal Baba dhe Tas i Baba ishin vëllezër në Dëllënjë, kështu që edhe Josif e Spiro Tasi Baba janë kushërinj me Todi e Rako Mihal Babën. Me

Kronin nuk kanë lidhje farefisnore.

Kroni me Todin dhe Rakon janë vëllezër me një nënë, por jo me një baba.

TODI MIHAL BABA, DËLLËNJË

Todi Mihal Baba u martua me Marien e Llazi Sheqit nga Porua. Aty, te Todi, Maria lindi 1 vajzë, Silën që e rriti Rako Baba, vëllai i Todit, se Todi vdiq e Maria iku shtatzënë dhe lindi te Pilo Prifti në Novoselë, Kristullën. Këtë vajzë, kur u rrit, e martuan me Nasho Bakën në Aliban. (Pilo Prifti është i gjetur dhe i rritur te Papa Lipi i cili e rriti dhe e martoi me Kristullën, të bijën e Maries me Todi Babën nga Dëllënja), Maria te Pilo Prifti lindi 1 vajzë që u martua në Tiranë, po edhe ky djalë që ishte polic u vra në trazirat e 1997, kanë një vajzë. Burri i tretë i Maries është Tonçi Ogari nga Pojani ose Kryegjata. Me këtë ka dy djem e një vajzë Andonin, Leon dhe Liljanën që është martuar me Petraq Tako Kërrin në Delisuf, ka 3 djem.

Maria jeton akoma në Roskovec.

RAKO MIHAL BABA

Rako Mihal Baba u martua me Urani Sema nga Pish-Porua, kanë vetëm l djalë, Fatos Mihalin, ose me saktë Fatos Rako Mihal Baba.

Fatos Rako Baba është martuar me Lizën nga Fieri, kanë një djalë e një vajzë: Bledin dhe Vasilikën.

Vasilika është martuar me Vangjel Uznovën nga Berati, banojnë në Fier.

TILO BELINA

Tilo Belina është me origjinë nga Belina e Fierit. Është martuar me Ngjelinën, motrën e Mihal Hudhrës nga Dëllënja, kanë lënë 4 djem e dy vajza: Vasilin, Lipin, Pandelin, Kozman, Llambën, dhe Athinanë.

Vasil Tilo Belina mori një grua, por ajo u largua menjëherë dhe Vasili mbeti pa grua e pa fëmijë. Rrojti me nënën e tij deri në pleqëri dhe e mbylli jetën në fukarallëk e verbëri në Poro.

Lipi Tilo Belina u martua me Patron nga fisi i Manos nga Narta. Ajo solli një djalë me vete, e cila e kishte me burrin e parë nga Fieri. Djali u rrit te Lip Belina dhe mori mbiemrin Belina. Lipi me Patron lindën një vajzë. Pas vitit 1975 ikën në Fier familjarisht.

Llambi Belina, i cili nuk është fis i Belinës, u martua me vajzën e Mitaq P. Memecit nga Porua, kanë një vajzë.

Pandeli Tilo Belina u martua në Qeparo, vajti dhëndër brenda (kollovar), kanë 3 djem: Bertin, Sotirin, Arqilen.

Berti Pano Belina është martuar me 1 çame nga Vlora.

Sotiri u martua me një vajzë nga Gjirokastra.

Kozma Tilo Belina shkoi në Akërni dhe u martua me Liljana Fani Gllaçin nga fshati Fitore, të ardhur nga Vlora, kanë dy djem e një vajzë: Leonardin, Enon dhe Mirën. Banojnë familjarisht në Tiranë.

Leonard Kozma Belina, me gruan e parë, Endra Plaku (divorcuar) ka një djalë, Alvaron. Me gruan e dytë, Adriana Shapka nga Lezha , ka një djalë, Salvadorin (janë në Greqi).

Isida Kozma Belina është martuar me një grek.

Eno Kozma Belina është martuar me Orjeta Kadri Ymeri nga Peza e Tiranës, kanë një djalë, banojnë në Tiranë.

Vajzat e Xha Tilo Belinës:

Llamba u martua me Lijo Sotën nga Zhuka, kanë dy djem e 5 vajza: Naunin, Kristaqin, Vitën, Kristinën, Donikën, Aretinë dhe Elcën.

Athinaja u martua me një çam nga Vlora, ka një djalë e dy vajza.

(Tregoi Llamba Belina 70 vjeçe - Dhjetor 2008).

RISTAN BELINA

Koçi Belina

Ristan Belina ishte i martuar.

Origjina e Xha Ristanit është nga Belina e Fierit, kanë lënë 3 djem: Koçin, Vllasin dhe Mitin.

Koçi Ristan Belina u martua me vajzën e Uan Thanos në Poro, kanë lënë Nikon, Lulin, Tomin.

Niko Koçi Belina u martua me Luli Niko Gjonin nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Koçin, Arjolën dhe Matildën.

Luljeta Koçi Belina u martua me Kristaq Niko Dila në Poro, kanë një djalë e dy vajza: Ervinin, Klodin dhe Adën.

Tomi Koço Belina u martua me Liljana Kristaq Nakën, e

bija e Senës nga Dëllënja, kanë 2 djem Klejdon dhe Kostën.

Vllasi Ristan Belina u martua me Dhoksie Peti Lera nga Gryka, kanë 3 djem e një vajzë: Theodhorin, Agronin, Alqin dhe Lulin.

Thodhori Vllasi Belina u martua me një vajzë nga Pish-Poro.

Agroni Vllasi Belina u martua me një italiane.

Alqi Vllasi Belina i martuar.

Luli Vllasi Belina u martua me djalin e Stavre Thanos.

Miti Ristan Belina u martua me Kaliopi Naun Kostën nga Çuka e Sarandës, kanë një djalë e një vajzë: Vladimirin dhe Zhanetën.

Vladimir Miti Belina u martua me Vitori Filip Najetën nga Bishani i Fierit, kanë dy djem: Dhimitrin dhe Marion.

Zhaneta Miti Belina u martua me Fredi Vasil Kondën në Poro.

(Tregoi Kaliopi Belina 55 vjeç).

BËRDALLI

Thonë se Bërdallinjtë e kanë origjinën nga Labova e Gjirokastrës. Atje kanë pasur mbiemrin Bushi, por, nga që kanë lëvizur andej-këndej (vërdallë) me bagëti dhe ua ngjitën mbiemrin Vërdalli.

Më i vjetri që mbahet mend ka qenë Pali Bërdalli. Ky la 3 djem e një vajzë: Vasilin, Kostandinin, (Taqin), Vangjelin dhe Zogën.

Zoga Bërdalli u martua me Zoi Matën dhe la Uan Matën dhe Dafinën, nëna e Thoma e Miti Jorgjit nga Vlora.

Vasil Pali Bërdalli kishte për grua motrën e Mitrush Shurdhit nga Dëllënja. La një djalë e dy vajza: Petron, Çevën, që kishte Thanas Bushin dhe Palinën që ishte martuar me Miti Çunin, të dy nga Dëllënja.

Petro Vasil Bërdalli u martua me Likën nga Frakulla dhe kanë lënë 3 djem e 3 vajza: Sotirin, Gorin, Vason, Marien, dhe dy të tjera.

Sotir Petro Bërdalli u martua me Thanasulla Miti Mëhillin dhe kanë vetëm një vajzë që e martuan me Viktorin e Fani Moçkës nga Porua.

Gori Petro Bërdalli u martua me Shpresën nga Këmishtaj e Lushnjës. Me Shpresën kanë një djalë e 3 vajza. Shpresa ka sjellë te Gori një djalë që quhet Arben Bërdalli, ka mbiemrin e Gori Bërdallit, por në fakt s'është Bërdalli.

Vaso Petro Bërdalli u martua me Liljanën nga Këmishtaj e Lushnjës dhe kanë një djalë e dy vajza: Petraqin, Jonidën dhe Anën.

Petraq Vaso Bërdalli u martua me Armanda Niko Jani Hudhrën nga Dëllënja.

Vajzat e Petro Bërdallit:

Maria ose Marika është martuar me Mihal Niçkën në Përmet.

Kostandin (Taqi) Pali Bërdalli.

Taqi Bërdalli u martua me Konxhe Rrapo Kolën. (Për këtë thonë se janë Stefa, po thonë edhe Kola me origjinë nga Stefajt ose Kotët e Zvërnecit). Xha Taqi ka lënë 3 djem e dy vajza: Mitin, Jorgjin, Pilon, Lenën dhe Finen.

Miti Taqi Bërdalli u martua me Konxhen nga familja e Milajve të Poros. Nuk lanë fëmijë.

Fina e Tasi Shytit dhe Konxhe Bërdalli

Jorgji Taqi Bërdalli u martua me Sofijen e Kostandin Qarrit nga Novosela dhe kanë 4 djem e 4 vajza: Nikon, Arqilen, Vllasin, Lefin, Neftën, Violetën, Donikën dhe Elin.

Niko Jorgji Bërdalli u martua me Sofika Llazi Naçin nga Porua, dhe kanë dy djem e dy vajza: Arjanin, Alqivjadhin, Majlindën dhe Elonën.

Arjan Niko Bërdalli u martua me Marjana Todi Sikon nga Porua dhe kanë 3 vajza: Nikoletën, Kostandinën dhe Anamarinë.

Alqi Niko Bërdalli u martua me Anila Dhori Qorrin nga Delisufi, dhe kanë nj djalë e një vajzë: Nikon dhe Sofien.

Arqile Jorgji Bërdalli u martua me Bejaze Haxhiun nga Vlora, dhe kanë dy djem e dy vajza: Arditin, Jorgjin, Aidën, Olën.

Arqile Bërdalli me të shoqen, Bejaze, dhe Llazi Hajdini (në mes)

Aida u martua me Kastriotin në Sheq, Fier.

Ola dhe Aida janë martuar në Sheq, Fier.

Vllasi Jorgji Bërdalli u martua me Rajmonda Fili Gegën nga Delisufi, dhe kanë dy djem: Miltiadhin dhe Kleanthin.

Lefi Jorgji Bërdalli u martua me Mimoza Miço T. Ristën nga Zhuka, dhe kanë dy vajza.

Vajzat e Jorgji Bërdallit:

Nefta u martua me Thoma Hyson në Novoselë, kanë një djalë e 4 vajza.

Violeta u martua me Nexho Bollanon nga Himara dhe kanë dy djem: Nikollaqin dhe Orgesin.

Orgesi u martua me Eda Arshi Bidaj nga Lukova, kanë një vajzë, Violetën.

Donika u martua me Goli Miço Moçkën, Poro, kanë dy vajza e një djalë.

Eli u martua në Sheq të Fierit, ka dy djem, Nikua dhe Arqilea të cilët nuk kanë emigruar, të tjerët banojnë dhe punojnë në emigracion.

PILO TAQI BËRDALLI

Pilo Taqi Bërdalli u martua me Kristulla Spiro Naçin nga Porua dhe kanë një djalë e 3 vajza.

Pilo Bërdalli dhe Sotir Llambro

Agim (Gëzim) Pilo Bërdalli u martua me Florika Trifon Çobankën nga Pish-Porua, kanë një djalë e një vajzë: Spiron dhe Kristën.

Vangjelina Pilo Bërdalli u martua me Aristir Pilo Lepurin nga Porua dhe kanë 4 djem: Ilirjanin, Arbenin, Alketin dhe Arjanin.

Shpresa u martua me Nasi Llazi Hudhrën në Poro.

Drita u martua me Ilia Kito Kolën në Poro.

VANGJEL PALI BËRDALLI

Vangjel Bërdalli u martua me Katerinën nga Kalemajt e Delisufit. Kështu tregon i biri, Fili Bërdalli, 84 vjeç. Deri tani, nuk kemi dëgjuar që të ketë pasur Kalemaj në Delisuf. Ky fis është shuar.

Vangjeli me Katerinën kanë lënë një djalë e dy vajza: Filin, Nijen dhe Ristanën.

Nija u martua në Frakull.

Ristana u martua në Vlorë me Niko Xoxën (Hoxhara) nga Qarri i Fierit, dhe kanë një

djalë e një vajzë: Xhoxhin dhe Elin. Xhoxhi u martua me Katerinën, kanë një djalë e dy vajza. Eli u martua me Selim Begollin dhe kanë një djalë e një vajzë.

Fili Vangjel Bërdalli u martua me Kristina Leko Plakun nga Porua dhe kanë dy djem e 4 vajza: Tolin, Laken, Gjenën, Milikën, Vitën dhe Vjollcën.

Toli Fili Bërdalli u martua me Milika Lijo Marinën, dhe kanë 4 vajza e një djalë: Eltonin, Nertilën, Idën, Dhuratën, Brikelën.

Lake Fili Bërdalli u martua me Lonora Naqo Gjonçarin nga Porua dhe kanë 3 djem e një vajzë: Vangjelin, Erjonin, Marcelin dhe Fluturën.

Vangjel Lake Fili Bërdalli u martua me Xhinën, kanë dy vajza: Kristinën dhe Natashën.

Erjoni Lake Bërdalli u martua me Entela Dila, kanë djalë Filipin. Të tjerët janë beqarë.

Gjena Fili Bërdalli u martua me Tokli Thoma Nasin në Poro, kanë dy vajza e një djalë.

Milika Fili Bërdalli u martua me Tomi Th. Kolën (Mitraj) në Poro.

Vita Fili Bërdalli u martua me Dhimitraq Kozma Markun në Delisuf.

Shënim: Lena u martua me Naun Bregun në Frakull.

Është bijë e Kalemajve. I vdiqën prindërit dhe Lena mbeti e vogël. Vangjel Bërdalli e kishte mbesën e të shoqes. E rritën dhe e martuan me Naun Bregun dhe e konsiderojnë si vajzën e tyre, po në fakt është e bijë e Kalemajve nga Novosela, nuk është Bërdalli.

5 Bërdenj: Fili, Sotiri, Nikua, Pilua dhe Leja

Kalemajt kanë jetuar në Delisuf. Ishin tre vëllezër, Lluka, i cili la një vajzë, Sofijen.

Vasili ka një vajzë, Lenën.

Thomai, ka një djalë, Andrean. Andrea banon në Tiranë. Në Delisuf nuk ka asnjë nga ky fis.

TODI BICERRI

Todi Bicerri ka jetuar në Zonjalli të Poros, thonë se kish ardhur nga Dhërmiu i Himarës, por në Poro s'ka njeri nga fisi i tij. Tregojnë se kish marrë Mëmë Lulen disa vite kur ajo iku nga burri i parë, Uan Garrua, por edhe ky vdiq shpejt në Poro dhe nuk la pasardhës.

VASIL BLECA

Vasil Bleca erdhi familjarisht nga Greqia në vitin 1943. Ishte nga fshatrat e Janinës.

Në atë kohë erdhën disa familje të ikur nga lufta që bëhej atje me Gjermanët. Disa nga këto familje që erdhën në Poro ikën prapë, kur u qetësua situata. Dy familje mbetën dhe janë akoma në Poro.

Vasil Bleca solli gruan dhe një djalë në Poro. Këtu u lindi dhe një vajzë. Pra, kishte Kostën dhe Fanien. Kosta mësoi zanatin e infermierit në shkollë dhe punoi në spitalin e Vlorës deri sa doli në pension.

Kosta Vasil Bleca u martua me Parashqevinë, infermiere, minoritare nga fshatrat e Gjirokastrës, dhe kanë 4 djem.

Fanie Vasil Bleca u martua me Vllasi Pali Kolën nga Porua dhe bënë dy djem e dy vajza: Leonardin, Bledin, Almën dhe Mirelën.

Të gjithë fëmijët e Kostës dhe tre fëmijët e Fanies janë martuar dhe kanë emigruar në Greqi. Vetëm një vajzë e Vllasit u martua, e cila ka mbetur në Vlorë.

THANAS BUSHI, DËLLËNJË

Thonë se Bushi kur erdhi në Dëllënjë solli dy fëmijë të vegjël, Thanasin dhe Linën që mori Pilo Ndini në Dëllënjë.

Bushi kish marrë të motrën e Thoma Hoxharës. Thoma Hoxhara erdhi me të ëmën te Bushi se i vdiq i ati dhe e ëma mori djalin, Thoman dhe erdhi te vëllai, Bushi. Aty në Dëllënjë u rrit Thomai dhe prandaj i thoshin edhe Thoma Bushi, por nuk është Bushi, është Hoxhara.

Thoma Hoxhara kur u martua shkoi në Poro dhe aty janë djemtë e tij edhe sot.

Thanas Bushi u martua me Çevën e Vasil Bërdallit nga Porua dhe kanë lënë i djalë e 5 vajza: Sotirin, Kalien, Valën, Tinën, Llambën dhe Vjollcën.

Sotir Thanas Bushi u martua me Dhora Lako Mbyeti nga Dëllënja dhe kanë lindur 5 djem e një vajzë: Nikon, Halin, Artanin, Bertin, Harrillën dhe Leonorën.



Sotir Th. Bushi

Niko Sotir Bushi u martua me Rajmonda Llazi Rrungajën nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Sotiraqin, Monikën dhe Rajmondën.

Mihal Sotir Bushi u martua me Lindita Ismet Xhelo nga Selenica, kanë një djalë e dy vajza: Odisenë, Dorinën dhe Dajanën.

Artan S. Bushi u martua me Engjëllushe Banarakun nga Bishani Fier, kanë dy djem e një vajzë: Antonion, Anestin dhe Esmeraldën.

Berti S. Bushi u martua me Xhuliana Piro Dhanën nga Pish-Porua, kanë një djalë e një vajzë: Angjelon dhe Analizën.

Harrilla S. Bushi u martua me Denisa Jorgaq Sheqin nga Porua, kanë një vajzë, Debora.

Leonora S. Bushi u martua me Vasil Qarrin në Mifol, kanë dy djem.

Vajzat e Thanas Bushit:

Kalia është martuar me Uan Hajdinin në Poro, ka dy djem e 3 vajza.

Vala u martua me Thanas Sotën në Bestrovë.

Tina u martua me Gori Markun në Dëllënjë.

Llamba u martua me Llazi Buallin në Verrias.

Vjollca u martua me Aristir Bitën në Verrias.

Vita Th. Bushi u martua me Petro Leksi Kërrin në Delisuf.

Bush Hila la Thanas Bushin dhe Linën e cila u martua me Pilo Ndinin në Dëllënjë.

Tani, të gjithë djemtë e Thanas Bushit mbajnë zyrtarisht mbiemrin Hila

Në Dëllënjë ka jetuar edhe një Gori Bufi, por ai nuk ka lënë fëmijë. Nga ky fis nuk ka njëri tjetër.

KOÇI DHE NDINI BUSHI

(Nga ky fis nuk ka asnjë mashkull në Dëllënjë ose në zonën tonë).

Janë shuar.

Koçi Bushi la vetëm një djalë, Spiron, dhe dy vajza: Aspasinë dhe Artininë.

Spiro Bushi la vetëm një vajzë, Gjenën, që u martua me Hekuran Xhafën në Vlorë.

Aspasia e Koçi Bushit u martua me Pali Sotir Qorrin në Delisuf dhe ata kanë lënë Llaqi Qorrin, Finën dhe Lenën.

Fina u martua me Taqo Spiro Ristën në Zhukë, ndërsa Lena u martua me Mihal Lili Lepurin në Poro (Gryka Pishë).

Artinia e Koçi Bushit u martua me Rako Kroni Koçin në Dëllënjë, e cila lindi një djalë, Andrenë, dhe dy vajza, Sofien dhe Marien. Sofia u martua me Uan Priftin në Poro dhe Maria me Dhori Hajdinin në Poro.

Për Llaqi Pali Qorrin, i biri i Aspasisë dhe Andrea R. Koçi, i biri i Artinisë të Koçi Bushit. Për më shumë të dhëna, shih në familjet e Qorrit dhe Koçit.

Ndini Bushi, i vëllai i Koçi Bushit ka lënë vetëm një vajzë, Çevën që ishte martuar me Pilo Thanasin në Dëllënjë. Lanë Sotirin, Nasin, Varvarën dhe Janën.

Sotir Thanasi e Nasi (Jorgji) Thanasi jetuan e u shtuan në Dëllënjë.

Varvara u martua me Thoma Mihal Petovën.

Jana u martua me Vasil Kungullin në Poro, më pas me Thoma Mërtirin, në Zhukë.

BULLAJT E POROS

Në Poro ka qenë me shtëpi edhe Hysni Bulla. Xha Hysniu kishte edhe 3 vëllezër të tjerë: Myslymin, Hasanin dhe Beqirin. Në Bishan kanë qenë edhe kushërinjtë e tyre, Telo Bulla e të tjerë.

Bullajt i kanë pasur shtëpitë në Murris, një lagje e madhe e Bishanit, që kufizohej me Poron. Ndërsa Hysni Bulla, kur u nda nga vëllazëria e tij, ndërtoi shtëpinë brenda sektorit ose brenda kufirit të Poros dhe ky kufizohej me Murrizin.

Bullajt janë shtuar shumë gjatë shekullit të kaluar. Këta katër vëllezër, kanë qenë afërsisht të datëlindjes 1880–1985, nga 4, sot janë bërë rreth 60 apo 70 frymë. Kjo gjë nuk vihet re vetëm te Bullajt, por në gjithë Bishanin. Ata kanë lindur shumë fëmijë, shumica nga 7, 8, 10 e 12 fëmijë, edhe në të tjerë fshatra ka pasur shtesa të shumta, por jo kaq sa Bishani. Vetëm në këto vitet e fundit që djemtë kanë emigruar, janë pakësuar lindjet në përgjithësi, se më parë nuk u bënte përshtypje, ishte e modës ose ishin në garë se kush mund të lindte sa më shumë fëmijë e, mundësisht, më tepër djem. Shtesa natyrale është mënyra më e mirë, e domosdoshme për shtimin e popullsisë të një vendi.

Dhe Bishani e ka kryer "detyrën" në shekullin e 20të.

Hysni Bulla ishte martuar me dy gra. Me të parën kishte 4 djem: Novruzin, Meton, Xhevitin dhe Dinon. Me gruan e dytë kishte dy ose 3 djem të tjerë, por kishte edhe vajza, dhe të gjithë të shëndetshëm e të mirë, punëtorë e të shkathët në të gjitha drejtimet. Të gjithë kanë jetuar e punuar aty, u martuan dhe u shtuan.

Bullajt janë të shumtë. Ky fis ka ardhur në Murris nga Matogjini i Smokthinës. Aty janë shtuar e kanë shkuar edhe në Bishan. Në Bishan ka qenë Telo Bulla, i cili ka lënë Arshiun, Ramizin e të tjerë. Edhe këta kanë djem e vajza plot. Në Murris kanë qenë 4 djemtë e Beqir Bullës, të cilët janë lindur në Bishan ose në Murris. Ata ishin 4 vëllezër: Myslim Bulla, Hasan Bulla, Beqir Bulla dhe Hysni Bulla. Edhe Adem Bulla ka qenë kushëri me këta. Të gjithë kanë jetuar në Murris, lagje e Bishanit. Kur u rritën, u martuan dhe u ndanë si vëllazëri. Hysni Bulla kaloi në kufirin e Poros, në perëndim të fshatit, kufi me Murrizin. Aty u shtua e u shumua.

HYSNI BEQIR BULLA

Ishte martuar dy herë. Gruan e parë e kishte marrë në Boçovë të Fierit, Rabushen dhe me të lindi 4 djem: Novruzin, Meton, Xhevitin dhe Yzedinin. Me gruan e dytë, Qamilen nga Boçova, lindi 3 djem e dy vajza: Kadriun, Laverin, Xhelon, Zabekon dhe Fatushen.

Novrus H. Bulla

Novrus Hysni Bulla u martua me Refie Metushin nga Boçova dhe lindën 4 djem e një vajzë: Hamdiun, Rremon, Baçin, Qaniun dhe Shpëtimen.

Hamdi Novrus Bulla u martua me Sose Dano Dule nga Martina e Fierit. Kanë 3 djem e dy vajza: Bardhin, Viktorin dhe Lulin.

Rremo Novrus Bulla u martua me Lirën nga Llakatundi. Kanë 3 djem e 3 vajza (nuk i dimë emrat sepse kanë emigruar).

Bahir (Baçi) Novrus Bulla u martua me Bukuroshen nga Bishani i Fierit, kanë dy fëmijë: Mandin dhe Nertilën.

Mandi Bahir N. Bulla u martua më një grua nga fshati Fitore i Vlorës.

Nertila Bahir N. Bulla u martua me Maksi Dosin në Bishan.

Qani Novrus Bulla u martua me Lirën nga Boçova e Fierit, kanë dy djem e një vajzë.

Shpëtime Novrus Bulla u martua në Vajkan të Fierit.

Meto Hysni Bulla u martua me Hyri Troka nga Bishani i Vlorës. Kanë 7 djem e dy vajza: Bilbilin, Syrjain, Shuaipin, Neimin, Luanin, Safetin, Besnikun, Lirinë dhe Sadinenë.

Bilbil Meto Bulla u martua me Ervehenë nga Radostina e Fierit. Kanë një djalë e 5 vajza: Ermirin, Thëllëzën, Irenën, Shqiponjën, Entelën dhe një tjetër.

Shuaip Meto Bulla u martua me Letën nga Risilia e Vlorës. Kanë 3 djem: Ilirin, Admirin dhe Bedriun.

Neim Meto Bulla u martua me Donikën nga Vajkani i Fierit. Ka një djalë, Saimirin e dy vajza.

Luan Meto Bulla u martua me Ramizen nga Boçova e Fierit, kanë dy djem e 3 vajza: Gentin, Elsonin, Manjolën, Fatimen dhe Erën.

Safet Meto Buna u martua me Mondën nga Patosi. Ka dy djem e një vajzë: Geraldin, Ledionin dhe Sonilën.

Sonila Safet Buna u martua në Roskovec.

Liri Meto Buna u martua me Hekuranin në Çipllak, Fier.

Sadihana Meto Bulla u martua me Isan në Peshtan, Fier.

Shënim: Besniku u vra aksidentalisht, i pamartuar.

Besim Meto Bulla u martua me Nertila Avdul Aliaj nga Bishani, kanë një djalë.

ADMIR SYRJA M. BULLA

U martua me Leonorën nga Vlora, kanë një djalë.

Thëllëza Syrja M. Bulla u martua në Tiranë.

Irena Syrja M. Bulla u martua.

Shqiponja Syrja M. Bulla u martua në Hoxharë të Fierit.

Entela Syrja M. Bulla u martua në Drizë të Fierit.

Ilir Shuaip M. Bulla u martua, por kanë emigruar.

Admir Shuaip Bulla u martua me Irenën nga Korça.

Bedri Shuaip Bulla u martua në Mallkeq të Vlorës.

XHEVIT HYSNI BULLA



Namik Xhevit Bulla

U martua me Pajame Doracin nga Bishani. Kanë 4 djem e 5 vajza: Besnikun, Selamin, Ladin, Durimin, Burbuqen, Xhevrien, Bardhën, Teftën dhe Liljanën.

Namik Xhevit Bulla u martua dy herë. Me gruan e parë, Afërdita Muharrem Plepi nga Zharrëza, ka dy djem e 3 vajza: Klemendin, Nertilin, Albanën, Enkelejdën dhe Marcelën. Me gruan e dytë, Halime Hito Hitaj nga Bolena, kanë një vajzë: Ketjonën.

Klemend Namik Xh. Bulla u martua me Elmira Kalajn nga Levani. Ka dy vajza: Afërditën dhe Stelën.

Albana Namik Bulla u martua me Agim Xhoxhajn në Berat.

Enkelejda Namik Bulla u martua me Leonard Malajn në Akërni, nga Bolena.

Të tjerët aktualisht janë beqarë.

Selam Xhevit Bulla u martua me Nebien nga Kërkova, kanë 3 djem e një vajzë: Nanin, Lalin, Erjonin dhe Zamirën.

Nani Selam Xh. Bulla u martua me Falien nga Llakatundi.

Lali Selam Bulla u martua me Orjetën nga Cakrani, kanë një vajzë, Elician.

Erjon Selam Bulla u martua me Zamirën nga Pish-Poro, kanë dy djem: Aleksandërin dhe Xhevitin.

Zamira Selam Bulla aktualisht është beqare.

Ladi Xhevit Bu1la u martua me Merjeme Murat Hoxhën nga Zhupani i Fierit. Kanë dy djem e një vajzë: Arsenin, Yllin dhe Irvën. Të tre aktualisht janë beqarë.

Durim Xhevit Bulla u martua me Teftën nga Patosi, kanë një djalë e dy vajza: Mariusin, Aurorën dhe Meritën.

Aurora Durim Xh. Bulla u martua me Bertin në Oshtimë.

Merita Durim Xh. Bulla u martua me Kostandin Xarën në Sarandë.

Mariusi aktualisht është beqar.

Vajzat e Xhevit H. Bullës:

Burbuqja u martua me Xhyher Bendajn në Panaja.

Xhevria u martua me Astrit Tozajn në Kërkovë.

Bardha u martua me Ladin në Armen.

Tefta u martua me Bertin në Picar.

Liljana u martua me Mimi Pilo Kushin në Mifol.

Yzedin Hysni Bulla u martua me Naxho Hoxha nga Bishani. Kanë dy djem e 4 vajza: Nekiun, Anestin, Diturinë, Yllkën, etj.

Neki Yzedin Bulla u martua me Lirika nga Vajkani i Fierit. Ka dy djem e dy vajza: Adin, Benin, Jetën dhe Blerinën.

Adi Neki Y. Bulla u martua me Irena nga Kolonja e Lushnjës. Kanë një djalë, Andrean.

Beni Neki Y. Bulla u martua me Marjanën nga Kolonja e Lushnjës.

Jeta Neki Y. Bulla u martua në Ballsh.

Blerina Neki Y. Bulla aktualisht është beqare.

Dituri Yzedin Bulla u martua në Oshtimë.

Yllka Yzedin Bulla u martua në Frakull.

KADRI HYSNI BULLA

U martua me Xhevahire Dosin nga Bishani; kanë 4 djem e 4 vajza: Yzeirin, Hysniun. Gëzimin, Rasimin, Manushaqen, Florin, Adilian dhe Teutën.

Yzeir Kadri Bulla u martua me një grua nga Roskoveci Fier, kanë dy djem e një vajzë: Izmirin, Danielin dhe Elën.

Hysni Kadri Bulla u martua me Viton nga Patosi, kanë 3 vajza: Fridën, Lolën dhe Anën.

Gëzim Kadri Bulla u martua me Yllkën nga Sheqi i Fierit, kanë një djalë dhe një vajzë: Zhonaton dhe Ardinën.

Besim Kadri Bulla u martua me Ermira nga Hoxhara e Fierit, kanë dy vajza: Frederikën dhe Laurën.

Manushaqe Kadri Bulla u martua në Kuqan të Fierit.

Florika K. Bulla u martua në Mifol.

Teuta K. Bulla u martua në Kuqan të Patosit.

LAVER HYSNI BULLA

Laver Hysni Bulla u martua me Bukuroshe Shaqo Aliaj nga Bishani, kanë dy djem, Asqerin, Sadikun dhe 3 vajza.

Asqeri Laver Bulla u martua me Yllka nga Kanina, kanë një djalë, Laverin e dy vajza.

Sadik Laver Bulla u martua me Flamuren nga Bilishti, kanë një djalë e dy vajza: Llukën. Bukuroshen dhe Sarën.

Xhevdet (Xhelo) Hysni Bulla u martua me Nimete Trokën nga Çerveni i Fierit, kanë dy djem e 3 vajza: Nailin, Altinin, Filen, Alketën dhe Rovenën.

Nail Xhelo Bulla u martua me Afërdita Bersin nga Roskoveci, kanë dy vajza: Klodianën dhe Paulën.

Altin Xhelo H. Bulla u martua me Vojsavën nga Armeni, kanë një djalë, Lorencin e një vajzë.

File Xhelo Bulla u martua me Beni Dosi në Bishan.

Alketa Xhelo Bulla u martua me Ladi Thanon në Pish-Poro të Fierit.

Rovena Xhelo Bulla u martua me Vangjel Bulon në Himarë.

Vajzat e Hysni Bullës:

Zabekua u martua me Dalip Tringa në Vlorë.

Fatushja u martua me Nuri Dervishin në Vlorë.

Shënim: Shikoni sa janë shtuar pasardhësit e xha Hysni Bullës, brenda një shekulli. Sipas numrit që janë këtu del se janë shtuar 71 meshkuj e 71 femra. Është për t'u theksuar se të gjithë bishanasit kanë një shtim të kënaqshëm të njerëzve. P.sh., Eqerem Hysni Bulla ka lënë 12 fëmijë. Po si ky ka edhe shumë të tjerë në Bishan.

Qani N. Bulla Bukuroshe Bulla Bahir N. Bulla

NAUN ÇOBO MËSUESI I POROS

Naun Çobua ishte nga Struma e Roskovecit, erdhi në Poro si mësues i shkollës Fillore që u hap për herë të parë në vitin 1917-1918. Ai vinte nga Amerika ku kish qenë si emigrant ekonomik, e, atje, bashkëpunoi me organizatat patriotike shqiptare dhe mori detyrë të vinte në Shqipëri e të hapte shkollën në Poro. Në Poro punoi nga viti 1918 deri në vitin 1943, pa familje. Ai solli një djalë të vetëm, Llukanin, i cili kreu shkollën në fshatin tonë dhe rrinin bashkë për ato vite, nga klasa e parë e deri në të tretën. Pastaj shkolla u mbyll për ndonjë vit nga lufta e filloi prapë në vitin 1945 e në vazhdim.

Naun Çobo

Xha Nauni, sa punoi në shkollën e Poros, mbahet mend si njeriu më i mirë dhe më i aftë për ato vite. Gëzonte respekt nga të gjithë bashkëfshatarët në Poro, dhe më gjerë. Pati shok e miq, saqë për çdo rast feste apo gëzim, mësuesi thirrej e vihej në qoshe e i dëgjohej fjala nga të gjithë.

Pas Çlirimit atij iu dha titulli "Mësues i Popullit".

Origjina e Çobajve thoshin se ishte nga Gramshi. Në Strum erdhi Spiro Çobo.

Spiro Çobo ishte martuar me Konxhe Mankën nga Sheqishtja e Fierit dhe lanë tre djem e një vajzë, Kozman, Lipin, Naunin dhe Varvarën.

Naun Spiro Çobo ishte martuar me Sofie Trifon Prifti nga Marinëza e Fierit dhe lanë një djalë e dy vajza: Llukanin, Nastën dhe Anën.

Nasta u martua me Llazar Papën në Bubullimë të Lushnjes, kurse Ana nuk u martua.

Llukan Naun Çobo u martua me Elida Liko Peto nga Pojani i Fierit dhe kanë një djalë e dy vajza: Jovani, Valbona dhe Xhuljeta.

Llaz Hajdini dhe Llukan Çobo me të shoqen,

Jovan Llukan Çobo u martua me Mikena Andrea Prevazi nga Pojani i Fierit dhe, aktualisht, kanë një djalë e një vajzë: Luka dhe Lidia.

Valbona Llukan Çobo u martua me Andrea Stefani në Fier. Andrea është nga Përmeti.

Xhuljeta Llukan Çobo u martua me Nasi Daka në Fier.

Naun Çobo iku në Amerikë, në Boston, para se të martohej. Atje punoi dhe u lidh me shoqërinë "Vatra". Pas gjashtë vjetësh erdhi në fshat dhe u martua. Pas disa kohësh iku përsëri në Amerikë, bashkë me disa shokë nga fshati. Atje ndenji afro 20 vjet. U kthye në Shqipëri para vitit 1912 dhe, kur Ismail Qemali erdhi për në Vlorë, Nauni, bashkë me disa patriotë, e shoqëroi nga Libofsha deri në Vlorë, dhe mori pjesë në ngritjen e Flamurit më 28 Nëntor 1912.

Naun Çobo kishte bërë 5 klasë shkollë greqishte në Berat, para se të shkonte në Amerikë. Ai punoi shumë edhe në Strum për hapjen e shkollës shqipe por, bejlerët e asaj kohe, nuk e lejuan. Mbas çlirimit, Naunit iu dha titulli "Mësues i Popullit".

Në vitin 1956, fshati Poro e ftoi dhe i dha titullin "Anëtar nderi" i fshatit Poro.

KRONI ÇALA, ZHUKË

Kroni Çala kishte grua Pulien nga (Pa saktësuar), kanë lindur Pilon dhe Menën (Melpomenin), e cila u sëmur nga poliomieliti që e vogël dhe nuk u ngrit dot në këmbë, gjithë jetën ka ecur zvarrë apo të themi këmba-doras. Është rasti të them se në këto 4–5 fshatra për të cilët kam marrë të dhënat për këta njerëz, vetëm dy persona kam gjetur ose tre të tillë me këtë sëmundje. Kjo e para, një vajzë e Koli Kondës në Zhukë, dhe Nasi Loshi në Poro. Nasi jetoi, u martua la dhe fëmijë, por gjithë jetën zvarrë e me paterica. Vdiq në moshën 70 vjeçare, edhe Melpomeni Kron Çala e tillë aktualisht është 80 vjeç, vajzë e plakur.

Pilo Kroni Çala u martua me Ollga Kostë Llija nga Vlora, dhe patën 6 fëmijë: Panon, Agronin, Gonën, Lizën, Thoman dhe Anetën.

Pano Pilo Çala u martua me Garrufela Andon Kumbulin nga Çuka e Sarandës, kanë një djalë e 3 vajza: Nardin, Nertilën, Edlirën dhe Aurorën.

Agron Pilo Çala u martua me Vjollca Tako Gegën nga Delisufi, kanë dy djem: Aurelin dhe Enean.

Nardi Pano Çala u martua me Eva Harrilla Pjetrin nga Qarri Fier, kanë një vajzë, Kristina.

Gona Pilo Çala u martua me Arshi Haxhi Hametin në Vlorë.

Liza Pilo Çala u martua me Vasillaq Kozma Ngjelon në Novoselë.

Aneta Pilo Çala u martua me Kristaq Vasil Konomin në Nartë.

Thoma Pilo Çala u martua me Selvi Sefer Selimi nga Laçi, jetojnë në Tiranë, kanë një djalë e një vajzë: Gentin dhe Bertën.

MIHAL JORGJI ÇUNI, SHEQ–DËLLËNJË

Mihal Jorgji Çuni ka ardhur në Dëllënjë nga Matkëza e Fierit. Aty është martuar me Kostandine Zariko Sheqin, nga Dëllënja, kanë 3 djem e 3 vajza, Mitin, Vasilin, Kozman, Sofien, Finen dhe Sijën.

Miti Mihal Çuni u martua me Pavlinën e Vasil Bërdallit nga Porua. Kanë lindur 4 djem e një vajzë: Andonin, Todin, Lijon, Nikon dhe Marien.

Miti Çuni

Andon Miti Çuni u martua me Leonora Spiro Gegën nga Delisufi, kanë 4 djem e 4 vajza: Arqilen, Minellën, Mihalin, Ilian, Liljanën, Vangjelinën dhe Artën.

Arqilea A. Çuni u martua me Safete Kadri Çelën nga Ballshi, kanë dy djem e një vajzë: Fatjonin, Marjolin dhe Irmën.

Minella A. Çuni u martua me Rajmonda Gori Sheqin nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Gertin, Minedën dhe Jonidën.

Mihal A. Çuni u martua me Deida Raqi Gonin, kanë një djalë e dy vajza: Eminin, Paulën dhe Leonorën.

Ilir A. Çuni u martua me Enkelejda Dhimitër Markun nga Llakatundi, kanë një vajzë, Xhelitën.

Vajzat e Andon Çunit:

Liljana u martua me Zenel Shenkon nga Smokthina e Vlorës.

Vangjelina u martua me Llambi Miti Jankën në Poro.

Arta u martua në Berat. Kanë emigruar në Itali.

Drita u martua në Vlorë.

Todi Miti Çuni u martua me Nefta Thoma R. Nasin nga Porua, kanë dy djem e 4 vajza: Mikelin, Gramozin, Mozën, Mondën, Lumturinë dhe Ilirianën.

Mikel T. Çuni u martua në Topojë, kanë një vajzë, kanë emigruar në Greqi.

Gramoz T. Çuni ka emigruar në Itali.

Vajzat e Todi Çunit:

Moza është mbytur në Vjosë dhe një ka vdekur në moshë l3 vjeçe.

Monda u martua në Aliban me Mihallaq Llazi Lenën.

Lumturia u martua me Thoma Bibën në Zvërnec.

Iliriana u martua me një djalë nga Gorrishti në Vlorë.

Lio Miti Çuni u martua me Jollanda Uan Mbyetin nga Delisufi, kanë 3 djem: Dhimitrin, Anestin dhe Adriatikun.

Dhimitri u martua në Orikum.

Anesti u martua në Orikum, ka dy djem.

Adriatiku aktualisht është beqar.

Niko Miti Çuni u martua me Saveta Loni Nakën nga Dëllënja, kanë dy djem: Adrianin dhe Agronin.

Adrian N. Çuni u martua në Tiranë, ka një djalë.

Agron Niko Çuni u martua me vajzën e Miço Perikli Gjonçari, ka vetëm një djalë, Aleksin. Gruaja e dytë dhe e tretë janë të huaja.

Shënim: Mihal Jorgji Çuni dhe gruaja e tij, Kostandine Zariko Koçi ishte kushërira e Pali Zariko Koçit po nga Matkëza. Pali dhe Kostandina janë bijtë e Koçi Ristës nga Matkëza.

Edhe Themi Koçi në Vlorë është nga fisi i Pali Zariko Koçit nga Matkëza. Themiu kishte 4 motra: Kostandinën e Mihal Çunit, Finen e Miti Kolës në Vlorë, Likën në Marinës dhe (Pa saktësuar), e kishte Jani, shofer në Vlorë.

VASIL MIHAL ÇUNI

U martua me Sofien e Naun Kolës nga Porua, kanë 3 djem, Llambin, Filin, Vllasin dhe 3 vajza, Kristullën dhe Kostandinën dhe një tjetër.

Llambi Vasil Çuni u martua me Vita Sotir Gjekën nga Pish-Porua, kanë dy djem e një vajzë: Vangjelin, Petraqin dhe Gjenovefën.

Vangjel Llambi Çuni u martua me Eli Miti Dhamon nga Pish-Porua, kanë dy djem e një vajzë.

Petraq Ll. Çuni u martua me Alketën nga Topoja e Fierit, kanë një djalë e dy vajza.

Gjenovefa Ll. Çuni u martua me Arben Skëndajn nga Kuçi, kanë 3 djem.

Vllasi Vasil Çuni u martua me Vita Bibën nga Zvërneci, kanë 3 djem: Piron, Gramozin dhe Elidonin.

Piro Vllasi Çuni u martua në Vlorë, kanë një djalë e një vajzë.

Gramoz V. Çuni u martua në Vlorë, kanë një djalë, Elidonin.

Elidon V. Çuni u martua me një vajzë korçare në Tiranë.

Ollga Vasil Çuni u martua me Koçi Mingën (Kordhishti), në Pish-Poro.

Kristulla V. Çuni u martua me Llazi Spiro Shytin në Pish-Poro.

Kostandina V. Çuni u martua me Vasil Petron në Pish-Poro. Kanë emigruar në Itali.

KOZMA MIHAL ÇUNI

Kozma Mihal Çuni

U martua me Aspasi Leksi Dashin nga Gryka, kanë 3 djem e 4 vajza: Thoman, Gjergjin, Sotirin, Neftën, Tanën, Kristinën dhe Vitën.

Thoma K. Çuni u martua me Marie Sotir Jankën nga Porua, kanë dy djem e 5 vajza: Piron, Dritanin, Millën, Shpresën, Donikën, Anastasinë dhe Aspasinë.

Piro Thoma Çuni u martua me Yllka Ferjat Hamitin nga Picari i Vlorës, kanë dy djem: Julianin dhe Leonardin.

Dritan Th. Çuni u martua me Alda Mirashi nga Lezha.

Milla Th. Çuni u martua me Lio Sollakun në Pish-Poro, kanë djem e vajza.

Shpresa u martua me Genc Petanin nga Vlora, ka dy vajza.

Donika u martua me Lefter Kominin në Derviçan të Gjirokastrës.

Anastasia u martua me Kristaqin nga Greqia, ka dy djem.

Aspasia u martua me një grek, të dyja motrat jetojnë në Greqi, ka një djalë.

Jorgji (ose Xhoxhi) Kozma Çuni u martua me Parashqevi Dhori Guberja nga Beshishti Vlorë, kanë 3 djem: Vironin, Harrillën, Agimin.

Viron Jorgji Çuni u martua me Leta Kristaqin në Topojë të Fierit dhe ka dy djem.

Harrilla J. Çuni është i martuar.

Agim Jorgji Çuni u martua me Irena Peço Kroni Mitrushin nga Dëllënja, kanë një vajzë.

Sotir Kozma Çuni martuar me Ksanda Gori Thanasi nga Dëllënja. Kanë një djalë e tre vajza: Eri, Anila, Rovena dhe Denisa.

ÇUKOLLARËT

Çukot në Poro janë shumë të hershëm, thonë se e kanë origjinën nga Erseka, dhe prej andej kanë shkuar në Lushnjë dhe nga Lushnja në Mbrostar të Fierit disa vjet dhe, më pas, erdhën në Poro, po edhe në Poro janë banorë që para vitit 1900. Më i vjetri që mbahet mend ka qenë Dhimitri ose Mitrua.

Mitro Çukos i lindën dy djem, Pali dhe Ndini. Palit i lindën Kroni dhe Zoji.

Ndinit i lindën Pilua dhe Tana.

Kroni Pali Çukos i lindën Ksanda dhe Fili. Ksanda u martua me Thoma Kozma Loshin nga Porua dhe lindën 4 djem e dy vajza. Këta shkuan në Vlorë në vitin 1950.

Fili Kroni Çuko u martua me Stavrullën e Nikolla Thanos (ardhur nga Janina 1944 në Poro familjarisht) dhe me Stravullën lindën 4 vajza.

Zoi Pali Çuko u martua me të bijën e Llukë Lakut në Poro, kishte vetëm një vajzë, Ristanën. Ristana u martua me Petro Memecin në Poro dhe lindi 3 djem e 3 vajza.

Ndini Mitro Çuko u martua me të motrën e Llazi Gonit nga Delisufi, lindën Tanën dhe Pilo Çukon. Tana u martua me Kili Leshin në Poro, mbas ca kohësh Kili vdiq e Tana u martua prapë me një këpucar në Vlorë me emrin Siku, i cili kishte një djalë. Me Tanën nuk lindën fëmijë.

Pilo Ndini Çuko u martua me Marien, e bija e Nasi Hajdinit nga Porua. Lindën një djalë e 4 vajza.

Fëmijët e Pilo Çukos: Koli, Olimbia, Kaliopi, Llambrinia dhe një vajzë që vdiq 7-8 vjeçe.

Koli Pilo Çuko, e kanë kthyer mbiemrin, këtu e kanë Mitro, nga emri i të atit të babagjyshit që quhesh Mitro. Pra, Koli Pilo Mitro u martua me Neta Ndoci Palin (me mbiemrin Guri), malësor nga Malësia e Shkodrës, kanë lindur dy djem: Lorencin dhe Ardin.

Koli Çuko, djali, nusja e djalit, nëna e Kolit dhe kushëriri, Llazi Hajdini

Lorenc Koli Mitro u martua me Arta Sadik Jaushin nga Lumi i Vlorës, kanë 3 vajza: Antonetën, Albën dhe Françeskën.

Ardi Koli Mitro u martua me Eva Ylli Boraj nga Vajza e Vlorës, kanë një djalë e një vajzë: Djanin dhe Paulën.

Olimbi Pilo Çuka u martua me Halil Xhindin në Vlorë dhe kanë vetëm një djalë, Oliverin.

Kaliopi Pilo Çuko u martua me Agim Fejzullahun në Korçë dhe kanë dy djem e një vajzë, Bledin, Aurelin dhe Danielën.

Llambrini Pilo Çuko u martua me Pandi Kristo Liçon në Vlorë dhe kanë 3 vajza.

Shënim: Pilo Ndini Çuko ka ikur nga Porua i vogël, që kur vdiq i ati Ndini, agallarët e fshatit e ndoqën dhe në tokat e mira të Ndini Çukos u vendosën Bërdejtë që ishin krahë pune dhe akoma s'ishin stabilizuar në Poro. Pilua u rrit në Vlorë e punoi jorganxhi deri në

pleqëri.

Nipërit e tij, d.m.th., dy djemtë e Kolit, punojnë e jetojnë në Tiranë. Nga ky fis i Çukollarëve janë sot dy djemtë e Kolit dhe një djalë i Ardit, e në qoftë se djali i Ardit Djani nuk do dojë ose nuk do mundi të lindi djem, fisi i tyre do të shuhet patjetër, prandaj unë (xhaxhi Ll. H.) kushëriri i tyre, dëshiroj dhe uroj që Djani i vogël sot, kur të rritet të marrë një nuse të mirë dhe të lindi sa më shumë djem.

Kjo dëshirë është me siguri edhe dëshira e të parëve të tij.

ÇAUSH ÇELA

Çaush Çela erdhi në Poro si infermier dhe ka punuar për disa vjet në të gjithë zonën për 5-6 fshatra. Ishte njeri i mirë dhe shumë i zoti në praktikë për zanatin e tij, por më vonë dolën infermierë pasi mbaruan shkollën e infermierëve në Vlorë dhe e zëvendësuan atë.

Çaushi ishte nga Smokthina. Erdhi rreth vitit 1950 dhe u martua në Poro e nuk u largua më nga Porua.

Çaushi u martua me Katen e Dhori Loshit, lindën 3 djem e një vajzë: Kane, Piron, Llambin, Agronin, dhe Vasilikën.

Piro Çaush Çela është martuar me Florika Miti Titin nga Dëllënja, kanë një djalë.

Agroni u martua me Mozën, kanë një djalë, Saimirin.

Llambi u martua me l vajzë nga Elbasani, kanë dy djem.

Vasilika Çaush Çela u martua me Kozma Petro Kolën në Poro.

KRISTO DAFINA

Kristo Dafina kishte ardhur nga Dhërmiu dhe ka jetuar gjithë jetën e tij deri në pleqëri në Poro, por sot nuk ka asnjë nga fisi i tij.

Ka pasur një djalë, por ai, me vdekjen e të atit, xha Kristos, iku, por asnjë s'e di me saktësi se nga shkoi. Dikush thotë se iku në Fier e disa thonë se është parë shumë vite më parë në Pish-Poro të Fierit.

Fshati nuk ka asnjë të dhënë për Vasilin e Kristo Dafinës, i vetmi djalë që kishte, kur ishte gjallë në Poro.

LEKSI DASHI, GRYKË

Leksi Dashi la 3 djem dhe 3 vajza: Tinin, Kicin, Manin, Ngjelën, Finën dhe Sijen.

Ngjela Leksi Dashi u martua në Poro me Koli Gjonçarin.

Fina u martua me Vasil Kolën (Mitraj) në Poro.

Sija u martua me Kozma Çunin në Sheq Dëllënjë.

Miti Mani (Thoma) Dashi u martua me Dafina Uan Dokon nga Ferrasi i Fierit, kanë 4 djem dhe dy vajza: Vasilin, Fanin, Arqilen, Thoman, Millën dhe Liljanën.

Vasil Miti Dashi u martua me Lira Loni Mojallia nga Delisufi, kanë një djalë e 3 vajza: Artanin, Nolën, Rovenën dhe Dritën.

Artan Vasil Dashi u martua me Ilma Lefter Hudhrën nga Porua, kanë dy vajza: Anisën dhe Jonidën.

Nola Vasil Dashi u martua me Jorgji Llazi Greku në Aliban, kanë një djalë.

Rovena Vasil Dashi u martua me Keti Jani Petanin në Levan,

Drita Vasil Dashi u martua me Lorenc Trifon K. Moçkën në Poro.

Llazi Mani Dashi u martua me Sila Jani Markun nga Dëllënja, kanë 3 djem e 4 vajza: Josifin, Fatmirin, Kostën, Rajmondën, Antonetën, Valbonën dhe Gradionën.

Josif Llazi Dashi u martua me Vangjelina Tako Kërrin nga Delisufi, kanë 3 djem: Olsin, Florianin dhe Llazin.

Fatmir Llazi Dashi u martua me Rovena Llaqi Romën nga Frashëri i Fierit, kanë dy djem: Ergenin dhe Adrianon.

Kosta Llazi Dashi u martua me Rajmonda Lefter Hudhrën nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Lorencin, Orsilën dhe Martinën.

Vajzat e Llazi Dashit:

Rajmonda u martua me Gramoz Nelo Priftin në Aliban, kanë 3 vajza.

Andoneta u martua me Nesti Todi Kolën (Mitraj) Poro, kanë dy djem e një vajzë.

Albana u martua me Kristaq Lamo Kostën në Delisuf, kanë një djalë e një vajzë. (Kristaqi vdiq në vitin 2008, fëmijët i la të vegjël në Itali).

Gradiola u martua me Ligor Pano Koçin në Dëllënjë, kanë një djalë, Paulon.

FANI MITI DASHI, DELISUF

U martua me Veronikën nga Vlora, kanë 3 djem: Sandrin, Kreshon, dhe Mitin.

Sandri Fani Dashi u martua me Desa Sokrat Kolën (Mitraj) nga Porua.

Arqile Dashi u martua me Bena Çumani Aliajn nga Amonica e Vlorës, kanë një djalë e një vajzë: Kristaqin dhe Enkelejdën.

Thoma Miti Dashi u martua me Minushe Idai Mënaj nga Kërkova e Vlorës, kanë një djalë e 4 vajza: Valentinin, Lauretën, Dafinën, Lefterinë dhe Vasilikën.

Vajzat e Miti Dashit:

Milla u martua me Thoma Lijo Marinën në Poro.

Liljana u martua me Apostol Taqi Semën në Ferras, Fier.

KICI LEKSI DASHI, GRYKË

U martua me Lina Themi Matën nga Mesaraku i Armenit, kanë 4 djem e 3 vajza: Vangjelin, Lefterin, Vasilin dhe Ilian.

Vangjel Kici Dashi u martua në Levan, Fier.

Lefter Kici Dashi u martua me Afërditën (çame) nga Vlora.

Vasil Kici Dashi u martua në Himarë (u divorcua). Me gruan e dytë ka një djalë.

(Për të gjithë Dashajt tregoi Koçi Dashi 75 vjeç, në vitin 2008).

ILIA KICI DASHI

Ilia Kici Dashi "Hero i Popullit"

Ilia u lind në Vlorë sepse Kici ka ikur shpejt nga Gryka, rreth vitit 1950. Ilia ishte ushtar marinar në Flotën Detare në Durrës. Kryente shërbimin në anije luftarake e cila ishte e mbushur me armatim dhe lëndë luftarake të rëndësishme. Natën, kur të gjithë shokët flinin, plasën kaldajat dhe anija mori zjarr, dhe kishte rrezik që, nga çasti në çast, anija të hidhej në erë, dhe jo vetëm anija që ishte në afërsi të Durrësit, por edhe një pjesë e qytetit të hidhej në erë nga armatimi i rëndë që kishte anija. Ilia u fut në mes të flakëve të zjarrit dhe shkoi e mbylli saraçineskat e tubove nga dilte lënda djegëse e bëhej flakë. Ishte një moment mjaft kritik që të gjithë të hidheshin në erë. Duke u futur drejt në zjarr, Ilia i mbylli tubat, zjarri u shua, por vetë u dogj e vdiq. Për këtë akt trimërie e sakrifice, duke dhënë jetën për të shpëtuar shokët anijen dhe më tej se kaq, Kuvendi Popullor e shpalli Hero "Hero i Popullit". Kooperativa Bujqësore e bashkuar Poro i bëri shtëpi të re Kici Dashit dhe një dhomë të shtëpisë e bëri muze kushtuar Ilia Dashit.

Ilia Kici Dashi

Ilia Kici Dashit i jepet Titulli "Hero i Popullit"

Dekret për dhënie titulli në mbështetje të nenit 58 të Kushtetutës, me propozim të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë i jep titullin "Hero i Popullit" Ilia Kici Dashit (pas vdekjes) me këtë motivacion:

"I edukuar nga partia me frymën revolucionare të vetëmohimit për çështjen e popullit e të socializmit, i pajisur me ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë, me disiplinë të hekurt e të ndërgjegjshme, me shpirtin e iniciativës e të sakrificës, me vendosmërinë revolucionare, karakteristike të njeriut tonë të ri, për mbrojtjen e pronës socialiste dhe për vënien e interesit të përgjithshëm mbi gjithçka, me dashurinë luftarake të pakufishme për shokët e punës e të luftës, më 19.7.1976, në përleshje me flakët e zjarrit që shpërthyen papritmas në anijen luftarake ku shërbente, duke u hedhur përnjëherësh me trupin e vet mbi burimin e zjarrit, ra heroikisht në krye të detyrës luftarake, duke shpëtuar anijen dhe duke mbrojtur shokët nga rreziku i zjarrit".

Tiranë, më 14.08.1976. Nr. i dekretit: 5426.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Sekretari: Telo Mezini

Kryetari: Haxhi Lleshi

Shënim: Shih dhe gazetat: "Luftëtari" 26 gusht 1976, 5 gusht 1976, "Zëri i Rinisë", 7 gusht 1976, "Drita" 15 gusht 1976, "Bashkimi" 15 gusht 1976, "Zëri i Populli" 15 gusht 1976, "Zëri i Rinisë", 28 gusht 1976.

PETRO LLAMBRO DASHI

Petrua u martua me Vala Lepurin, kanë lënë 3 djem dhe 3 vajza: Koçin, Sotirin, Vllasin, Athinanë, Lirën dhe Melpomenin.

Koçi P. Dashi u martua me Zoica Kristo Marinën nga Porua, kanë 4 djem e një vajzë: Leonidhën, Sokratin, Bertin, Fatmirin dhe Lidën.

Koçi Dashi

Leonidha K. Dashi u martua me Donika Todi Dokon nga Divjaka, kanë një djalë e dy vajza: Kristin, Enerjetën dhe Erjonën.

Sokrat K. Dashi u martua me Gjena Reuf Cenajn nga Vajza e Vlorës, kanë një djalë e një vajzë: Nertilën dhe Florianin.

Nertila K. Dashi u martua me Genin në Vlorë.

Berti K. Dashi u martua me Valbona Llazi Qorrin nga Delisufi, kanë një djalë, Marion.

Fatmir Koçi Dashi u martua me Klarida Zoto Rrapajn nga Kërkova e Vlorës, kanë 3 vajza: Paulën, Vakutinën dhe Danielën.

Lida K. Dashi u martua me Vangjel Filip Diamantin në Nartë.

Shënim: Fëmijët kanë emigruar në Itali e Greqi.

SOTIR PETRO DASHI

Sotir Petro Dashi u martua me Llamba Ndoni Trifonin nga Semani, kanë një djalë, Agronin.

Agron S. Dashi u martua me Lauretën nga Semani, aktualisht nuk ka fëmijë.

Vllasi P. Dashi u martua me Marie Dhori Guberën nga Armeni, kanë një djalë e 3 vajza: Gëzimin, Donikën, Netën dhe Entelën.

Vajzat e Petro Dashit:

Athinaja u martua me Thoma Hoxharën në Mifol.

Lira u martua me Thoma Llazi Hudhrën në Poro.

Melpua u martua me Miço Priftin në Novoselë.

TINI LEKSI DASHI

Tini Dashi u martua me Zoicën e Kristo Shytit nga Porua, me të cilën kishte dy vajza, Goren dhe Ollgën. Gruaja e dytë e Tinit ishte Urani Petani nga Ferrasi i Fierit. E ëma e Tinit ishte e bija e Sotir Qorrit nga Delisufi.

Foni Tini Dashi

Tini Dashi me Uraninë kanë lënë 5 djem e dy vajza: Fonin, Themiun, Pilon, Nasin, Luçin, Vitën dhe Savetën.

Foni Tini Dashi u martua me Rita Llazi Panon nga Delisufi, kanë dy djem e dy vajza: Ladin, Benin, Jetën dhe Naunkën.

Ladi Foni Dashi u martua me Eglantina Nezon nga Fitorja Novoselë, kanë një djalë e dy vajza, jetojnë në Greqi.

Beni Foni Dashi u martua me Kelën nga Vlora, kanë një djalë e një vajzë.

Naunka Foni Dashi u martua me Nesti Sotir Moçkën në Poro.

Jeta Foni Dashi u martua me Ilir Dhori Qarrin në Novoselë.

Themi Tini Dashi u martua me Ana Sotir Loshin nga Porua, kanë dy djem e dy vajza: Astritin, Dorianin, Shpresën dhe Donën.

Astriti Themi Dashi u martua me Marcelën nga Levani.

Dorian Th. Dashi, aktualisht është beqar.

Shpresa Th. Dashi u martua me Lamo Semën në Levan.

Dona Th. Dashi u martua me Arjan Çobon në Fier.

Pilo Tini Dashi u martua me Leta Bocajn nga Vlora, kanë dy djem e një vajzë: Edin, Oltin dhe Anilën.

Thanas Tini Dashi u martua me Angjelina Demon nga Saranda, kanë një djalë e një vajzë: Filipin dhe Luljetën.

Filip Nasi Dashi u martua me Liza Fisai Maskën nga Kropishti.

Luljeta Nasi Dashi u martua me Edi Vllasi Kungullin nga Porua.

Luçi Tini Dashi u martua me Gona Vangjel Gega nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë: Ilirin, Gertin dhe Seldën.

Selda Luçi Dashi u martua me Ermalin, në Fitore Novoselë.

Iliri dhe Gerti aktualisht janë beqarë.

Vajzat e Tin Dashit:

Vita u martua me Kozma Nikolla Thanon Poro.

Saveta u martua me Niko Llazi Hudhrën në Poro.

ANDREA DAVIDHI, ZHUKË

Janë të ardhur nga Krutja e Lushnjës. Atje kanë fis të gjerë.

Jorgji Davidhi me gruan e tij, Licën nga fshatrat e Fierit, erdhën në Zhukë me 3 djemtë e tyre, Andrenë, Thoman e Kozman.

Në Zhukë u rritën, u plakën dhe e mbyllën jetën e tyre.

Nuk janë shumë të hershëm në Zhukë.

Andrea Jorgji Davidhi ishte martuar me Gonxhe Kito Gjonin nga Pish-Porua, dhe kanë lënë 3 djem e dy vajza: Thanasin, Prokopin, Thodhoriun dhe Vangjelinën.

Thanas Andre Davidhi u martua me Jorgjie Petro Linën nga Frakulla, kanë 7 fëmijë: 4 djem e 3 vajza: Petraqin, Kristaqin, Dhimitrin, Vasillaqin, Neftën, Athinanë, Liljanën.

Petraq Thanas Davidhi u martua me Verën nga Tirana, kanë një djalë e dy vajza: Edin, Majlindën dhe Enkelejdën. Me gruan e dytë, nga Tirana, nuk ka fëmijë. Petraqi ishte oficer. Vdiq në vitin 1996.

Edi Petraq Davidhi, u martua me një vajzë nga Fieri, ka një vajzë.

Kristaq Thanas Davidhi u martua me Lefteri Miço Manguti nga Livadhjaja e Sarandës. Kanë një djalë e një vajzë: Eltonin dhe Mirelën.

Elton Kristaq Davidhi u martua me Ilda Lefi T. Qorrin nga Delisufi, kanë një djalë, Kristo Davidhin.

Dhimitër Thanas Davidhi u martua me Milika Nako Lekën nga Dukati, kanë një djalë e një vajzë: Radianin dhe Rovenën.

Radiani aktualisht është beqar ndërsa Rovena u martua në Tiranë me një djalë nga Tepelena.

Vasillaq Thanas Davidhi u martua me Thanasulla Sotir Pano Kolën, ose Mitraj, nga Porua, kanë dy vajza: Jorgjien dhe Katinën, jetojnë në Greqi.

Nefta Thanas Davidhi u martua me Ferit Maskën në Tiranë. Me origjinë nga Shëngjergji i Tiranës. Kanë një djalë e dy vajza.

Athina Thanas Davidhi u martua me Vangjel Pjetri në Levan. Kanë një djalë e dy vajza.

Liljana Th. Davidhi aktualisht është e pamartuar.

Prokop Andrea Davidhi u martua me Fina Sotir Janka nga Porua. Kanë 7 fëmijë: Aleksandrin, Arbenin, Ardianin, Gramozin, Xhulietën, Valbonën dhe Albanën.

Aleksandër P. Davidhi u martua me Flora Koçi Sallakun, nga Pish-Porua; jetojnë në Itali.

Arben P. Davidhi u martua me Edlira Muhamet Llanajn nga Cakrani Fierit, kanë një vajzë, jetojnë në Greqi.

Ardiani P. Davidhi u martua me Elca Pilo Stefën nga Dëllënja, kanë dy vajza: Andreinën dhe Simonën.

Gramoz P. Davidhi aktualisht është beqar.

Xhuljeta P. Davidhi u martua me Ilia Jani Lerën nga Delisufi dhe kanë një djalë e dy vajza.

Valbona P. Davidhi u martua me Ilir Spiro Priftin nga Frakulla, kanë një djalë e një vajzë.

Albana P. Davidhi u martua me Edi Pilo Plakun nga Dëllënja, kanë një djalë, jetojnë në Itali.

Thodhori Andre Davidhi u martua me Aleksandra Ligor Llazin nga Çuka e Sarandës,

kanë 3 djem e një vajzë: Artanin, Fjodorin, Edmondin dhe Mirandën.

Artan Thodhori Davidhi u martua me Marcela Sotir Ristën nga Novosela, (bijë e Sofie Sotir Jankës nga Porua) Artani ka një djalë, Thodhori Davidhin (i riu).

Fjodor Th. Davidhi u martua me Betën në Tiranë, me origjinë nga Kukësi, kanë një vajzë, jetojnë në Greqi.

Edmond Th. Davidhi aktualisht është beqar.

Mirela aktualisht është beqare.

VANGJELINA ANDREA DAVIDHI

Vangjelina u e martuar në fillim me Lijo Uan Matën me të cilin lindi një djalë me të, Petraq Matën. Liua u mbyt në det, kur ishte ushtar. Vangjelina la djalin (ja mbajtën prindërit e Lijos), dhe iku tek prindërit në Zhukë. Ajo u martua prapë me Todi Naqo (Kola) Mitraj në Poro dhe me Todin lindi 5 djem: Apostolin, Agimin, Anestin, Spiron dhe Mikelin. Pra, Vangjelina lindi 6 djem.

THOMA JORGJI DAVIDHI

Thoma Jorgji Davidhi u martua me Fina Kristo Sotën nga Zhuka, kanë lënë dy djem e 4 vajza: Mihalin, Ligorin, Valën, Kristinën, Marinaqin dhe Andonetën.

Mihal Davidhi dhe Llazi Hajdini, Durrës 2009

Mihal Thoma Davidhi u martua me Fanie Petro Moçkën nga Novosela, kanë një djalë e një vajzë: Ermalin dhe Dafinën, banojnë në Mifol.

Ligor Thoma Davidhi u martua me Nefta Danaj nga Pish-Porua, kanë një djalë, Thoman e një vajzë.

Vala Th. Davidhi u martua me Sokrat Lipin nga Beshishti, kanë 9 femijë: 5 djem e 4 vajza.

Kristina Thoma Davidhi u martua me Dhori Ristën nga fshati Fitore, kanë dy djem e një vajzë.

Marinaqi Thoma Davidhi u martua me Piro Todi Rrapin, kanë dy djem e një vajzë.

Andoneta Thoma Davidhi u martua me Themi Sollakun nga Pish Porua, kanë dy djem e dy vajza.

KOZMA JORGJI DAVIDHI

Kozma Jorgji Davidhi ishte martuar me Sofie Xoxi Rrungajën nga Dëllënja, kanë një djalë: Jorgjin, (i vunë emrin Jorgji për të kujtuar gjyshin e tyre).

Jorgji Kozma Davidhi u martua me Kristina Sotir Thanasin, kanë një djalë e dy vajza: Edmondin, Lubjanën dhe Enkeletën.

Edmond J. Davidhi u martua me një vajzë nga Novosela.

Lubjana J. Davidhi u martua me një djalë në Tiranë.

Enkelejda J. Davidhi u martua në Durrës dhe të dyja, me të motrën, kanë shkuar në Lushnjë, punojnë e jetojnë atje familjarisht.

Kozma Davidhi shkoi partizan. Është dëshmori LNÇL.

TOLI DILA

Dilajt e kanë origjinën nga Daullasi i Fierit, ishin 3 vëllezër: Nashua, Tilua dhe Gori Dila.

Nasho Dila la dy femijë: Tolin dhe Licën.

Lica u martua në Novoselë.

Toli Nasho Dila u martua me Pulije Nakën nga Delisufi dhe kanë lënë 6 fëmijë, Nikon, Pilon, Lolin, Stavren, Kristullën dhe Letën.

Niko Toli Dila u martua me Aleksien nga Beshishti, kanë 6 djem e dy vajza: Janin, Nasin, Tokliun, Arqilen, Kiçon, Peçon, Margaritën dhe Natashën.

Jani Niko Dila u martua me Athina Priftin nga Piluri i Himarës dhe kanë 3 djem e dy vajza: Sokratin, Benardin, Agronin, Elvirën, Enerjetën.

Agroni Jani Dila u martua me Rudina Ngjelën nga Alibani. Aktualisht nuk kanë fëmijë.

Sokrat Jani Dila u martua me Sofien nga Alibani, kanë dy djem: Janin dhe Nikon.

Blenardi Jani Dila u martua me Jana Raqi Lili Markun nga Delisufi, kanë një djalë, Enean.

Elvira Jani Dila u martua me një grek.

Erjona Jani Dila u martua me Maksim Galën nga Tepelena.

Që të gjashtë fëmijët e Jani Dilës kanë emigruar në Greqi.

Nasi Niko Dila u martua me Ristana Ndin Zhazhanin nga Gryka, kanë dy djem e dy vajza: Artanin, Sokolin, Mirandën dhe Rudinën.

Artan Nasi Dila u martua me Aulona Ismet Xhelaj nga Selenica e Vlorës.

Sokoli aktualisht është beqar.

Miranda N. Dila u martua me Arqile Zakën në Divjakë.

Rudina aktualisht është e pa martuar.

Tokli Niko Dila u martua me Violeta Miço Kungullin nga Porua, kanë dy djem e dy vajza: Dritanin, Genin, Blertën, Milikën.

Peço Niko Dila u martua me Vangjelina Llazi Garron nga Porua, kanë 3 djem dhe një vajzë, Elidonin, Ilirin, Eduardin dhe Shpresën.

Elidon Peço Dila u martua me Enesjela Fili Tr. Kolën nga Porua, kanë një djalë: Markon.

Ilir Peço Dila u martua me Almën nga Çerma e Lushnjës, kanë një djalë e një vajzë: Aleksandrin dhe Vangjelinën.

Eduard Peço Dila u martua me Jeta Llazi Marinën nga Porua, kanë një vajzë: Nataljan.

Arqile Niko Dila u martua me Vasilika Fili Çukon nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Lulëzimin, Sotiraqin dhe Entelën.

Entela Arqile Dila u martua me Erjon Lake Bërdallin në Poro, kanë një djalë: Filipin.

Kristaq Niko Dila u martua me Luljeta Koçi Belinën nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Ervinin, Klodetën dhe Lenadën.

Vajzat e Niko Dilës:

Margarita u martua me Vllasi Thoma Mërtirin nga Porua, ajo vdiq e re, ka lënë një djalë e dy vajza, Admandin, Erjetën dhe Joridën.

Natasha Niko Dila u martua me Kozma Petanin në Aliban.

Erjeta Vllas Mërtiri u martua me një italian, Mikele Kolona.

PILO TOLI DILA

Pilo Toli Dila u martua me Stasa Petanin nga Frakulla, kanë një djalë e 5 vajza: Aristirin, Linën, Nelin, Silën, Naunkën, Elcën.

Aristir Pilo Dila u martua me Irena Malo, u divorcuan, pastaj u martua me Marjana Preng ..... nga Puka.

Lina u martua me Sotir Kolën në Poro.

Neli u martua me Ligor Lepurin në Poro.

Sila u martua me Ilo Prendin në Mifol.

Naunka u martua me Lefter Diamantin në Vlorë.

Elca u martua me Spiro Qarrin në Aliban.

LOLI TOLI DILA

Ishte partizan, dëshmor i LANÇ-it.

STAVRE TOLI DILA

Stavre Toli Dila u martua me Sena Vangjel Hajdinin nga Porua dhe lindën një vajzë: Florikën, të cilën e kanë martuar me Alkes Miço K. Nasin në Poro.

Stavre Toli Dila me të shoqen, Senën

Kristulla Toli Dila u martua me Koli Rako Koçin nga Dëllënja, kanë lënë 3 djem e një vajzë.

Leta Toli Dila u martua me Petro Semën në Vlorë, kanë 4 djem e 3 vajza: Vasillaqin, Spiron, Benin, Artanin, Vjollcën, Mirelën dhe Anën.

Stavre Dila me të shoqen, Senën e Hajdinajve, fatkeqe dhe fatmirë. Fatkeqe sepse i vdiq burri i parë, Kristaq Naka dhe e la me katër fëmijë të vegjël. Sena fatmirë se u martua me Stavre Dilën, një djalë i rritur, po i pamartuar që e kish dashur para se ajo të martohej në Dëllënjë, po nuk ia dhanë prindërit e saj. Fati ia solli me vonesë në gji, po tani me 4 femijë. Ky e mori pa hezitim dhe lindi një vajzë të bukur e të zgjuar.

Stavre Dila ishte dhe mbeti një burrë i urtë, i mirë, besnik dhe baba i dashur për të gjithë fëmijët e përbashkët. Të pesë fëmijët i rritën bashkë e i martuan. Jetën e kaluan bukur, me lodhje, por në dashuri e harmoni të plotë.

Sena e la në moshën 78 vjeçare Stavren, por atë po e mbajnë mirë të pesë fëmijët e tyre, edhe pse janë të larguar në emigracion.

Të dy kanë qenë njerëz shumë të rregullt në jetë, në familje e në shoqëri.

LETA TOLI DILA, PORO–VLORË

Leta T. Dila u martua me Petro Semën në Vlorë, por me origjinë nga Novosela. Petro me Letën kanë 4 djem e 3 vajza: Vasilin, Spiron, Benin, Artanin, Anën, Vjollcën dhe Mirelën.

Vasil P. Sema u martua me Lindita Banaj nga Ferrasi, kanë 1 djalë e l vajzë: Ervisin dhe Adjolën.

Ben P. Sema u martua me Lavdijen nga Kuçi i Vlorës, ka dy djem: Eristonin dhe Petron.

Artan P. Sema aktualisht është beqar.

Spiro P. Sema u martua.

Vasili ka dy djem: Enean dhe Andin.

Vajzat e Petro Semës:

Ana u martua me Kujtimin nga Korça, ka një djalë e një vajzë.

Vjollca u martua me Spiron nga Qeparoi.

Mirela aktualisht është beqare.

NESTI DOÇI

Nesti Doçi erdhi nga Pish-Porua dhe u martua me Dritën e Llazi Uan Priftit, më të cilën ka vetëm një djalë. Ai u fejua me një vajzë nga Tepelena, student në Universitetin e Tiranës.

LLUKË DOKO, DËLLËNJË

Llukë Doko la një djalë e dy vajza, Uanin dhe Sofien me Kristinën.

Sofia u martua me Gori Plakun në Poro.

Kristina (ose Tina) u martua në Zhukë me Uan Zakën.

Uan Llukë Doko u martua me Naunka Kristo Shtëmbarin nga Qarri i Fierit, kanë lindur 3 djem e një vajzë: Themiun, Tolin, (Nelin), Lijon dhe Kristullën.

Themi Uan Doko u martua me Vala Nasi Pjetrin nga Bishani i Fierit, kanë 4 djem e 3 vajza: Anestin, Mikën, Miçon, Altinin, Mirandën, Zanën dhe Yllkën.

Anesti u martua me Milikën nga Glina e Gjirokastrës, kanë një djalë e një vajzë: Arjanin dhe Marien.

Miço Themi Doko u martua me Nilën nga Gjokallia e Fierit.

Altini u martua me Mozën nga Levani.

Toli (Neli) Uan Doko u martua me Sotira Niso Rrungaja, kanë dy djem e 3 vajza: Dritanin, Arsenin, Almën, Blertën dhe Liljanën.

Dritani u martua me Entelën nga Semani, kanë një djalë dhe një vajzë: Endritin dhe Sarën.

Arseni u martua me Alma Vasil Gegën në Dëllënjë.

Alma u martua me Peçi Pali Gjonin në Dëllënjë.

Blerta u martua me Kristaq Cullajn Pojan, Fier.

Liljana u martua me Gentian Dimon në Pojan, Fier.

LIO UAN DOKO

Lio Uan Doko u martua me Androniqi Tasi Mërtiri nga Beshishti, kanë 4 djem: Mondin, Fatmirin, Erjonin dhe Florencin.

Mondi Lio Doko u martua me Meli Thoma Gjonin nga Pish-Porua, kanë dy vajza.

Fatmir Lio Doko u martua me një vajzë nga Bishani i Fierit.

Erjon Lio Doko u martua me Ritën nga Cerkovina.

Florenc Lio Doko aktualisht është beqar.

QIRIC NAUN GARRO

Qiric Garro ka ardhur nga Gjirokastra.

Garrajt janë banorë të hershëm në Poro.

Ishin tre vëllezër: Nauni cili la Qiricin, Uani la Pulien dhe Neftën dhe Petrua që nuk kishte fëmijë, por ai birësoi Janon që e martoi me mbesën e tij, Pulien e Uanit.

Petro Garrua nuk la femijë, birësoi Janon e Ristan Nasit nga Porua. Ndërsa Nauni u martua dhe mori gruan nga Kungujt e Poros. Kur vdiq Nauni ajo shkoi te vëllezërit e saj, te Kungujt.

Qiric N. Garrua u rrit te Kungujt, e pastaj doli me shtëpi më vete. I thoshin edhe Qiric Kungulli, kur ishte i ri, po në fakt është Garro. Duket se, ose Nauni e ndoqi të ëmën e Qiricit, ose ajo e la Naunin dhe iku me djalin. Kjo nuk dihet me saktësi. Ndërsa Uani u martua me Lulen, të bijën e Nasi Gegës dhe u lindën dy vajza, Pulija dhe Nefta.

Origjina e Garrajve thoshin se e kishin nga Gjirokastra.

Qiric Naun Garro u martua dy herë, e para ishte e bija e Spiro Moçkës nga Novosela, por shpejt u nda me të. Nuk lindën fëmijë. U martua për herë të dytë me Pulien nga Risilia. Me këtë u lindën 4 djem: Pilua, Llazi, Vangjeli dhe Nikua.

Pilo Qiric Garro martuar me Marie Tasi Gjonçarin (nga Novosela mund të ketë qenë), e bija e Sako Moçkës nga Porua.

Maria ishte binjake me një vajzë tjetër, Ksandën që mori Pali Helmi. Marien e gjeti në rrugë Zoji Tasi Hyso nga Porua (bebe e sapolindur), e mbështjellë me rroba dhe e lënë në rrugë të fshatit me qëllim që kush ta gjente, ta merrte. Dhe ashtu ndodhi. Pse e lanë në rrugë prindërit e saj nuk dihet me saktësi, thonë se kanë qenë shumë të varfër e nuk mund t'i rrisnin dy binjake.

Marien e rriti Zoi Tasi Hyso dhe e martoi me Pilo Q. Garron.

Pilua me Marien lindën e rritën 5 djem e 3 vajza: Llambin, Naunin, Sotirin, Vasillaqin, Dritanin. Maria ka qenë e fejuar me Gori Vrushin, më parë, por kur ai u vra partizan, ajo u fejua dhe u martua me Pilo Garron, në Poro.

Llambi Pilo Garro u martua me Majlindën nga Gryka e Semanit dhe kanë një djalë e një vajzë: Dorianin dhe Donikën.

Naun Pilo Garro u martua me Zhanin nga Peshkëpia e Vlorës dhe kanë 3 vajza: Ledën, Delën dhe Sonilën.

Sotir Pilo Garro u martua me Rita Naun Premçin nga Sheqi, Fier dhe kanë dy djem: Xhulianon dhe Angjelin.

Llazi Qiric Garro me të shoqen, Fanien

Vasillaq Pilo Garro u martua me Bonën nga Burreli, ka dy djem: Andrean dhe Jorgon.

Dritan Pilo Garrua u martua me Festime Neki Çelën nga Tepelena, kanë një djalë, Piron.

Të tria vajzat e Pilo Garros janë martuar.

LLAZI QIRIC GARRO

Llazi Q. Garro u martua me Fanie Pali Minon nga Vlora, mbesa e Laze Hënës, e cila u rrit nga Uan Marina. Bashkë lindën dy djem e 6 vajza: Minellën, Nestin, Dafinën, Vangjelinën, Vasilikën, Lenin, Tulin dhe Rajmondën.

Minella Llazi Garro u martua me Nola Llukë Gjonin nga Dëllënja dhe kanë 3 djem: Leonardin, Ermalin dhe Llazin.

Nesti Llazi Garrua u martua me Rajmonda Vangjel Vilën nga Fieri, kanë një vajzë, Stefanën.

Vajzat e Llazi Garros:

Dafina u martua me Loli Mino Jankon nga Porua.

Vasilika u martua me Mitaq Llazi Kolën (Mitraj), Poro.

Tuli u martua me Andrea Petro Liçon, Grykë-Seman.

Eleni u martua me Dhori Koli Grekun në Aliban.

Monda u martua me Peçi Lluka Moçkën në Novoselë.

VANGJEL QIRIC GARRO

Vangjel Q. Garro u martua me Marie Vasil Gjonin nga Dëllënja. Kanë 3 djem e një vajzë: Leonidhën, Lijon, Donikën (Një djalë nga këta u vra, ra nga makina e vdiq. Ishte 17 vjeç).

Lijo Vangjel Garro u martua me Liljana Trifon Koçin nga Dëllënja, dhe kanë një djalë e një vajzë: Albanon dhe Lilikën.

Leonidha Vangjel Garrua u martua me Majlindën nga Saranda, kanë një djalë e një vajzë: Valandin dhe Marien.

Donika V. Garro u martua në Pish-Poro.

NIKO QIRIC GARRO

Niko Garro u martua me Liri Llazi Markun nga Gryka, kanë 4 djem: Ladin, Benin, Adrianin, Agronin dhe një vajzë.

Niko Qiric Garro

Ladi u martua dhe ka dy vajza.

Beni u martua dhe ka dy djem e një vajzë.

Aleksandri u martua dhe ka dy djem e një vajzë.

Agroni u martua, por aktualisht nuk ka fëmijë.

Nikua ka banuar në Sazan dhe tani është në Vlorë.

Një bijë e Garrajve ishte martuar te Liçajt e Skelës në Vlorë dhe ka lënë femijë, po emrat nuk ua dimë.

PETRO VANGJEL E NAUAN GARRO

Janë të hershëm në Poro. Thoshin se kishin ardhur nga Gjirokastra. Petro Garrua nuk kishte fëmijë, birësoi një djalë, Janon e Ristan Nasit dhe ky u njoh me emrin Jano Garro.

Vëllai i Petro Garros, Naun Garrua, ka pasur Lulen e Nasi Gegës. Ajo i lindi dy vajza, Pulien, që mori Jano Garrua, dhe Neftën, që mori Lamo Përri në Dëllënjë. Uani vdiq më shpejt se Petro Garrua. E shoqja, Lulja, mori Neftën dhe u martua me Todi Biserrin në Halimucë (Lagje e Poros), atje ajo nuk lindi, Todi vdiq. Nefta u martua me Lamo Përrin dhe Mëmë Lulja rrojti shumë. Edhe Lamo Perri vdiq e la dy vajza me Neftën, të cilat Nefta i mori të vogla e shkoi në Vlorë e u martua me Kristaq Baraj nga Kuçi i Vlorës dhe me të lindi një djalë, Miço Baraj. Naun Vangjel Garrua ka pasur gruan nga Kungujt dhe ajo lindi Qiricin, të cilin e mori me vete e shkoi te njerëzit e saj, te Kungujt. Qirici u rrit te Kungujt dhe ca kohë i thërrisnin Qiric Kungulli. Duket se, ose Nauni e ndoqi të ëmën e Qiricit, ose ajo e la Naunin e iku me djalin. Kjo nuk dihet me saktësi. Ndërsa Nauni mori Lulen e Nasi Gegës dhe lindën 2 vajza: Pulien e Jano Garros dhe Neftën e Lamo Përrit. Pulia e Uan Garros dhe Janua i Petro Garros (ish i Ristan Nasit) u rritën te Petro Garrua dhe u martuan.

Mëmë Lulja dhe e bija, Nefta

JANO GARRO

Jano Garrua nuk është Garro, por ishte biri i Ristan Nasit nga Porua. Ristan Nasi kishte 3 djem Kozman, Janon dhe Thoman. I vdiq e shoqja dhe Janua e Thomai ishin të vegjël.

Jani Garro

Janon e mori dhe e rriti Petro Garrua, e birësoi, se vetë nuk kishte fëmijë. Janua u martua me të mbesën e Petro Garros, vajzën e vëllait, Pulien e Uan Garros, të cilën e kish lindur me Lulen të bijën e Nasi Gegës nga Delisufi. Me Pulien Janua lindi një djalë, por u vdiq i vogël dhe ca kohë më vonë vdiq edhe Pulija, e shoqja e Janos.

Pas disa kohe, Janua mori të motrën e Jorgji Sotës nga Vlora, dhe më të lindi dy djem e një vajzë: Kristullën, Ristanin dhe Kristaqin.

Kristulla u martua në Qenas me Naun Kolën e ka 3 djem e dy vajza.

Ristan Jano Garro u martua me Lirinë, çobane nga Bestrova, dhe kanë 3 vajza.

Kristaq Jano Garro u martua me Kristinën e Nasi Naçit nga Vlora, kanë një djalë e një vajzë. Vajzën e ka të martuar, jeton në Itali.

Xha Janos i vdiq edhe gruaja e dytë, duke i lënë fëmijët të vegjël. Xha Janua mori një grua të ve, pa fëmijë, të shoqen e Llazi Koves nga Gryka, e cila ishte shumë e mirë dhe jetoi

disa vjet me Xha Janon. I rriti e i martoi fëmijët e Xha Janos, po nuk rrojti shumë, vdiq. Xha Janua vdiq pas ca kohe, shumë i dëshpëruar, sepse varrosi tri gra.



Kristulla Jani Garro me burrin, Naun Kolën, me fëmijët e tyre, në mes Llazi Hajdini

FETA GASHI, ZHUKË

Feta Gashi është nga fshati Shënmëri e Kukësit. Ka qenë nënoficer në ushtrinë bregdetare të kufirit. Ishte martuar me Violeta Ilia nga Narta e Vlorës, kanë lindur dy djem e 6 vajza: Gëzimin, Kujtimin, Bukurinë, Sosen, Dritën, Valentinën, Vasilikën dhe Nadiren.

Gëzim Feta Gashi u martua me Aurelën (çame) nga Fitorja, kanë dy vajza.

Kujtim Feta Gashi u martua me Dallëndyshen nga Picari i Vlorës, kanë një djalë: Bernardin.

Vajzat e Fetaut:

Bukuria u martua me Zako Arapin në Bishan.

Sosja u martua me Viron Llaqi Lepurin në Poro.

Drita u martua me Janin në Nartë.

Valentina u martua me Viron Kristaq Priftin në Aliban.

Vasilika u martua me Vasillaq Niso Thanon në Poro.

Nadireja ishte martuar me Vangjel Loshin në Poro. Lindi një djalë e dy vajza, u sëmur e vdiq e re. Ishte dentiste në fshat.

ISMAIL IBRAHIM GASHI

Ismail Ibrahim Gashi është nip i Feta Gashit nga Shënmëria e Kukësit. Erdhi në Zhukë pas viteve 1990, familjarisht punon e jeton në fshat. Janë njerëz të mirë, janë përshtatur plotësisht në jetën e myzeqarëve. Është i martuar me Jeta Murat Balajn, kanë dy djem e një vajza: Albertin, Bledarin, dhe Marinelën; të tre të cilët aktualisht janë beqarë.

SIMON GEGA, GRYKË

Simon Gega ka ardhur shpejt në Poro dhe ka qenë me shtëpi nga ana e Vjosës, në fund të fshatit Poro dhe në lindje të Sheq-Dëllënjës. Ishte në tokat e tij me një sipërfaqe prej disa hektarë tokë.

Kishte ekonomi të mirë dhe ka qenë burrë i zoti. Sa qe i ri, agallarët nuk e mundën dot, por kur ai u plak, e ndoqën nga arat e veta dhe ai shkoi të jetonte në Grykë.

Xha Simoni kishte 3 djem me gruan e parë: Dhimitrin, Nikon dhe Rrapin. Dhimitri mbeti në Grykë, ndërsa Nikua shkoi në Vlorë.

Dhimitër Simon Gega, martuar me motrën e Petro Dashit nga Gryka, la një djalë e një vajzë: Filin dhe Kristinën.

Kristina u martua me Tako Petro Kostën në Delisuf.

Fili Dh. S. Gega u martua me Llambën e Loni Liços nga Dëllënja dhe kanë 3 djem e 7 vajza: Pandeliun, Vasillaqin, Bertin, Vangjelinën, Likën, Mondën, Elcën, Florën, Athinanë dhe një tjetër.

Pandeli Fili Gega u martua me Netën, të bijën e Aristirit nga Zvërneci, kanë dy djem e një vajzë: Sandrin, Nikon dhe Sofien.

Vasillaqi u martua me Donika Tomi Qorrin nga Delisufi, kanë një djalë e 3 vajza: Jorgjin, Elsedën, Pranverën dhe Anitën.

Berti u martua me Qeratinën nga Sheqishtja e Fierit, kanë një djalë e l vajzë: Filipin dhe Anën.

Vajzat e Fili Gegës:

Vangjelina u martua me Llambi Jorgji (Kungulli) Tikën në Poro.

Monda u martua me Vllasi Jorgji Bërdallin në Poro.

Elca u martua në Gjirokastër.

Flora u martua me Cicon dhe ka një djalë, Piron.

Athinaja u martua me Peço Loni Helmin në Dëllënjë.

NIKO SIMON GEGA

Niko Simoni shkoi në Vlorë dhe u martua me Sullën, e bija e Jot Kolës nga Porua.

Niko Simoni me Sullën kanë lindur dy djem e dy vajza.

Vangjel Niko Simoni u martua me Sotira Dhori Monen nga Porua, kanë dy djem e dy vajza: Piron, Luçianën, etj.

Milika Niko Simoni u martua me Llambi Stringën nga Frakulla në Vlorë, kanë 3-4 fëmijë.

Shënim: Thonë se Simon Gega kishte dy djem e një vajzë, Dhimitrin, Nikon dhe Anën.

Ana Simon Gega u martua në Vlorë me Kostandin Gjonça dhe kanë një djalë, Xhoxhin.

VASIL SPIRO GEGA, DELISUF

Gegajt janë nga Risilia e Vlorës.

Spiro Gega la 3 djem: Vasilin, Takon, Sotirin.

Vasil Spiro Gega u martua me Gjena Llazi Koven nga Gryka, kanë dy djem e 4 vajza: Llazarin, Spiron, Vangjelinën, Uraninë, Kristinën dhe Androniqin.

Llazar Vasil Gega u martua me Olimbi Lijo Ristën nga Zhuka, kanë një djalë e dy vajza: Vasillaqin, Rovenën dhe Floridën.

Vasillaq Llazar Gega u martua me Brunilda Pilo Hajdinin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Samuelin dhe Melisën.

Rovena Llazar Gega u martua me Aleksandër Mino Jankun në Poro, ka dy vajza: Gabrielën dhe Martinën.

Florida Llazar Gega u martua me Fatjon Ligor Lepurin në Poro, s'kanë fëmijë.

Spiro Vasil Gega u martua me Miranda Nasi Dokon nga Pish-Poro, kanë një djalë e dy vajza: Kevin, Paulën dhe Arjolën.

TAKO SPIRO GEGA

Tako Spiro Gega u martua me Ristana Loni Priftin nga Dëllënja dhe kanë një djalë e 4 vajza: Fatmirin, Vjollcën, Katerinën, Mellaninë dhe Dritën.

Fatmir Tako Gega u martua me Jolanda Sali Hilën, kanë 3 vajza.

Katerina u martua me Kristaq Llambron në Aliban.

Vjollca u martua me Agron Pilo Çalën në Delisuf.

Mellania u martua me Leko Lamo Ngjela në Aliban.

Drita u martua me Pandeli Petro Kërrin në Delisuf.

Sotir Spiro Gega u martua me Katerina Pavllo Dhimën nga Dukati, kanë 3 djem: Mihallaqin, Arqilen dhe Dritanin.

Mihallaq S. Gega u martua me Kozetën nga Gjirokastra, ka dy vajza: Marien dhe Katerinën. Jetojnë në Greqi.

Arqilea Sotir Gega u martua me Sofika Harrilla Moçkën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Sotiraqin dhe Leonorën.

Dritan Sotir Gega u martua me Klodiana Moçkën nga Novosela, kanë një djalë e një vajzë. Jetojnë në Itali.

Spirua dhe Andon Gega ishin vëllezër të ardhur në Grykë nga Risilia.

Andon Gega ishte martuar tre herë, por me asnjë grua nuk pati fëmijë. Gruaja e tretë solli me vete katër fëmijë, Vangjelin, Ndonin, Dhorën dhe Silën.

RISTAN GEGA

Ristan Gega erdhi prapa nënës së tij tek Qirjaq Gega. I ati i tij, në një nga fshatrat e Fierit, e ka pasur mbiemrin Titi. Edhe Ristani duhej të kishte mbiemrin Titi, por ia kanë ndryshuar në Delisuf, te baba qafori, Qirjaq Gega.

Ristani kishte edhe tre motra: Lena, Kija dhe Vitorja.

Lena u martua me Gjergj Mbyetin në Delisuf. Kija u martua me Koç Rrungajën në Zhukë dhe Vitorja u martua diku nga Lushnja.

Ristani u martua me Nefta Xoxi Sava nga Zhuka dhe ka 1 djalë e tre vajza: Filipi, Donika, Leta dhe Natasha.

Filipi u martua me Gonën nga Topoja e Fierit, Donika u martua me Koçi Nasi Jorgjin në Dëllënjë, Leta u martua me Llambi Jani Naçin në Poro, kurse Natasha u martua në Gradishtë të Lushnjes.

VANGJEL GEGA

Vangjel Gega ka ardhur prapa nënës së tij tek Andon Gega në Delisuf. Vangjeli kishte edhe një motër, Dhora, e cila u martua në Fier. Ai u martua me Dhoksie Uani Mile nga Porua.

PIRO VANGJEL GONI, ZHUKË

Piro Vangjel Goni është i biri i Niso Thanos nga Porua, sepse Nisua kish marrë të ëmën e Piros, të bijën e Vangjel Gonit, nga Zhuka. Nuk shkuan shumë kohë të martuar dhe u ndanë, (e bija e Vangjelit me Nison). Ajo iku shtatzënë te i ati në Zhukë dhe atje lindi Piron. Xha Vangjeli nuk kishte djem, kishte vetëm këtë vajzë. Djalin e rriti gjyshja e gjyshi, (Xha Vangjeli me të shoqen) dhe i vunë emrin Piro e mbiemrin Goni, d.m.th., Piro Vangjel Goni, po në fakt është Piro Niso Thano.

Megjithatë Pirua u rrit në një shtëpi të varfër por shumë të ndershme, Pirua mori edukatën e Vangjel Gonit që njihej në të gjithë fshatrat e kësaj krahine si burrë jashtëzakonisht i mirë.

Piro Vangjel Goni (Piro Niso Thano) është martuar me një vajzë nga Topoja e Fierit, por ajo aktualisht nuk ka lindur fëmijë dhe janë detyruar të marrin një djalë të motrës së nuses dhe ta birësojnë me dokumente të rregullta. Ai mban emrin Niku Piro Goni.

Më kanë thënë se Erjoni aktualisht është rreth 18 vjeç. Unë dëshiroj dhe uroj që Erjoni t'u ngjajë si babës së tij, po më shumë të ngjajë nga gjyshi i tij (nga nëna) Vangjel Gonit të respektuar në shoqëri e në miqësi.

PREND GJINI

Kish ardhur nga Jagodina e Fierit. I thoshin edhe Prendi Dhaskali, sepse, ose ka qenë vetë mësues diku andej, ose ka pasur të atin mësues.

Prendi la dy djem në Poro, Josifin dhe Tonçin.

Tonçi kish marrë gruan nga Petanajt e Frakullës dhe la Viqen, që u martua me Llazi Çukon në Bishan të Fierit dhe Ristanën që u martua me Miti Mëhillin (E mori dhëndër brenda). Ai ishte nga Bubullima e Lushnjës.

Josif Gjini la dy djem: Taqon dhe Vasilin.

Taqua u martua me një vajzë të Peti Lerës nga Gryka, po vdiq i ri e nuk la fëmijë.

Vasil Josif Gjini iku nga Porua i pamartuar. Shkoi në Frakull e, më vonë, thonë, se prapë është larguar nga Frakulla. Nuk dihet se është apo nuk është, ka lënë apo s'ka lënë pasardhës.

Vasil Gjini u martua me Lenin në Frakull.

GJONÇARAJT E POROS

Gjonçarajt janë nga Gjonça e Fierit. Së andejmi shkuan diku në fshatrat e Lushnjës dhe prapë u kthyen në Novoselë e, më në fund, u vendosën përfundimisht në Poro.

Aleks Gjonçari la 3 djem: Qirjaqin, Spiron dhe Lekon.

Qirjaqi u martua me Ksandën dhe kanë dy femijë: Kolin dhe Mihalin.

Koli mori Ngjelën e Leks Dashit nga Gryka dhe lanë Naqon, Kilin, Petron, Filen, Sofijen dhe Linën.

Naqo Koli Gjonçari u martua me Marien nga Pish-Porua dhe kanë lënë një djalë e 4 vajza: Sotirin, Gjenën, Nolin, Donikën dhe Almën.

Kilo Koli Gjonçari u martua me Galinën e Kito Kërrit nga Gryka, kanë Kristaqin, Vangjelin, Minellën dhe Ollgën.

Kil Gjonçari me gruan e tij, Galinën

Petro Koli Gjonçari u martua dhe ka lënë: Lilën, Neljadën dhe Artën.

Lila Petro Gjonçari ka një djalë, Peçon.

Vajzat e Koli Gjonçarit të Poros:
Filja u martua me Kozma Rrungajën në Zhukë.
Sotira u martua me Piro Priftin në Zhukë.
Lira u martua me Themi Milon në Novoselë.

Spiro Gjonçari në Mifol la Vllasin dhe Sotirin që ishte prokuror. (Këto të dhëna m'i ka dhënë Kil Gjonçari).

MIHAL QIRJAQ GJONÇARI

Ishte martuar me Sijën e Tasi Qorrit nga Delisufi. Kanë 5 djem e dy vajza: Mitin, Jorgjin, Trifonin, Themiun, Marikën dhe Vitën.

Miti M. Gjonçari u martua me Letën nga Kotajt e Zvërnecit, kanë 4 vajza: Lidën, që është martuar në Zvërnec, Djanën, që u martua me një grek, Vjollcën që është martuar në Aliban, Veronika është martuar në Mifol.

Jorgji M. Gjonçari u martua me Milika Dhori Monen nga Porua dhe kanë 4 vajza: Teutën, Silvanën, Anilën, Dejsanën.

Gjenço M. Gjonçari u martua me Leonora Vangjel Subashin nga Zvërneci, kanë Mondin dhe Renën.

Trifon M. Gjonçari u martua me Jorgjie Nikolla Thanon nga Porua. Kanë Kleon dhe Rozetën. U aksidentua për vdekje në Greqi.

Rozeta u martua me Kleo Pandeli Milen nga Porua.

Themi M. Gjonçari u martua me Donika Perikli Kolën nga Porua. Kanë një djalë e një vajzë: Mirin dhe Eldën.

Marika u martua me Llambi Dokon në Aliban.

GJONÇARI, ZHUKË

Gjonçarajt kanë ardhur në Zhukë para vitit 1900. Ishin 3 vëllezër: Sotiri, Pali dhe Qirici.

Sotir Gjonçari ka 3 djem dhe dy vajza: Zoin, Periklin, Naunin, Sofien dhe Ndinen.

Sofia u martua me Thoma Koçin në Dëllënjë.

Ndinja martua me Petro Monen në Poro.

Zoi S. Gjonçari ka lënë: Filin, Fanin, Kiton dhe Janin.

Fili Z. Gjonçari u martua me Kasjani Llazi Kostën nga Zvërneci, kanë dy djem: Arbenin dhe Mondin.

Arben Fili Gjonçari u martua me Liljana Koçi Kungullin nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Aleksin, Antean, Antonetën.

Kito Zoi Gjonçari

Edmond Fili Gjonçari u martua me Marika Tako Kërrin nga Delisufi, kanë një djalë, Emanuelin.

Kito Zoi Gjonçari u martua me Liri Vasil Hilën nga Zhuka, kanë dy djem e 4 vajza: Xhoxhin, Artin, Mirandën, Natashën, Gjenovefën dhe Almën.

Xhoxhi K. Gjonçari u martua me Nertila Toli Bërdallin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Fatjonin dhe Xhojan.

Arti K. Gjonçari u martua me Aurela Kristaq Naçin nga Sheqishtja e Fierit, kanë një djalë, Kristianin.

Miranda K. Gjonçari u martua me Jani Vangjel Dumin nga Mifoli, kanë një djalë, Jurindin.

Natasha K. Gjonçari u martua me Agim Todi Kolën (Mitraj) në Poro, kanë një djalë e një vajzë: Andin dhe Elën.

Gjenovefa K. Gjonçari u martua me Ndreko Pali Loshin.

Alma u martua me Kristaq Fani Qarrin, Mifol. Kanë një djalë, Stefanin.

Fani Zoi Gjonçari ishte martuar me Elvirën nga Novosela. Kanë një djalë e një vajzë, Eltonin dhe Elvirën.

Elton Fani Gjonçari u martua me një italiane dhe kanë dy djem dhe një vajzë.

Elvira Fani Gjonçari u martua me Artan Vasillaq Mërtiri në Poro.

Jani Zoi Gjon]ari u martua me Vangjelina Fili Çuko nga Porua dhe kanë dy djem e dy vajza: Ervini, Andi, Erdita dhe Nikoleta.

Perikli Sotir Gjonçari u martua me Fanie Loni Liço nga Dëllënja, dhe kanë dy djem e dy vajza, Toli, Miço, Kristina dhe Marjana.

Toli Perikli Gjonçari u martua me Verdhiqin nga Dhërmiu dhe kanë djem e vajza (Janë në Greqi).

Miço Perikli Gjonçari u martua me Ndine Pandeli Kove në Delisuf; kanë një djalë e një vajzë, Edin dhe Danielën.

Kristina Perikli Gjonçari u martua me Luçi Jani Mbyeti në Delisuf dhe kanë tre vajza e një djalë, Luiza, Floreta, Shpresa dhe Genti.

Marjana Perikli Gjonçari u martua me Beni Llazi Malo në Aliban. Ka dy djem deri në vitin 2010.

Naun S. Gjonçari u martua me Kate Mani Dashin nga Gryka, kanë 5 djem e dy vajza: Andoni, Leonidha, Vasua, Sotiri, Astriti, Donika dhe Vjollca.

Naun Sotir Gjonçari

Leonidha N. Gjonçari

Andon N. Gjonçari u martua me Yllka Thoma Gjindalin nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë: Arsenin, Romeon, Amicën.

Lonidha N. Gjonçari u martua me Milla (Donika) Koçi Mbyetin, kanë dy djem: Marcellon dhe Saimirin.

Vaso Naun Gjonçari u martua me Liljana Jani Kërrin nga Delisufi, kanë një djalë e një vajzë: Eltonin dhe Gertën.

Sotir Naun Gjonçari u martua me Drita Gjergji Mbyetin nga Delisufi, kanë një djalë e dy vajza: Gjergjin, Sidorelën, Adelën.

Astrit Naun Gjonçari u martua me Miranda Dinush Caushin nga Penkova, kanë dy djem: Brunon dhe Klajdin.

Vajzat e Naunit:

Donika u martua me Stavri Taqo Hyson, Novoselë.

Vjollca u martua me Niko Vangjel Vrushin Delisuf. Kanë 3 djem: Fatjonin, Arbenin dhe Aldon.

PETRO PALI GJONÇARI

Pali Gjonçari kish marrë Lulen e Spiro Loshit dhe lindën Petron, etj.

Petro P. Gjonçari martuar me Varën e Nakajve nga Mifoli, kanë lindur një djalë e 5 vajza: Palin, Margaritën, Liljanën, Athinanë, Zoicën dhe Elcën.

Pali Petro Gjonçari u martua me Teuta Miço Ristën nga Porua, kanë dy vajza: Paulën dhe Varvarën.

Margarita P. Gjonçari u martua me Kristaq Tasi Shytin nga Zhuka.

Liljana P. Gjonçari u martua me Fani Lapajn nga Piluri, aktualisht janë në Risili.

Athina P. Gjonçari u martua me Mitaq Petro Memecin në Poro.

Zoica P. Gjonçari u martua me Roland Koli Qarrin në Poro.

Elca P. Gjonçari aktualisht është beqare.

QIRIC GJONÇARI

Qiric Gjonçari u martua me të bijën e Llambro Marinës nga Porua, kanë 3 djem e një vajzë: Llazin, Gorin, Vangjelin dhe Ollgën.

Llazi Qiric Gjonçari martuar me Lina Trifoni nga Alibani, ka dy djem e 4 vajza, Todi, Nikua, Aleksandra, Sotira, Aneta dhe....

Gori Q. Gjonçari u martua me Kristulla Vasil Kungullin nga Porua, kanë dy djem e dy vajza: Pandelin, Lefterin, Andonetën dhe Teftën.

Pandeli Gori Gjonçari u martua me Alketa Haxhiun nga Gërneci Vlorë, kanë dy vajza:

Valentinën dhe Françeskën.

Lefter Gori Gjonçari u martua me Silvana Thanas Sheqin nga Porua, kanë një djalë Aleksandrin.

Vajzat e Gori Gjonçari:

Andoneta u martua me Stavri Noje Ninin në Vlorë.

Tefta G. Gjonçari u martua me Nikun nga Radhima, kanë një djalë e një vajzë.

VANGJEL QIRIC GJONÇARI

Ka ikur familjarisht në Akërni. Është martuar dy herë. E para ishte Ristana, e bija e Tonçi Kolës nga Poro. Ristana vdiq e re. Vangjeli mori për gruan e dytë nga Dhërmiu.

GJINDALI, DELISUF

Gori Gjindali ka Uani Gjindalin dhe Nënën e Vangjel Tole Ndinit, Uraninë.

Uan Gori Gjindali u martua dy herë. Gruaja e parë ishte e bija e Jot Moçkës nga Porua. Ajo vdiq shpejt e nuk la fëmijë. Uani mori grua të dytë të ve, Elenën me një djalë të vogël me vete, Thoman. Ajo ishte e bija e Uan Notës nga Ferrasi. Kish vëlla Kozma Ndinin e të tjerë. Ishte e martuar me Llambi Çuhaj, në Pojan, Llambi Çuhaj vdiq i ri dhe e shoqja mori djalin e vogël, Thoman dhe u martua me Uan Gori Gjindalin në Delisuf. Djali i vogël, i biri i Llambi Çuhajt, u regjistrua me mbiemrin Gjindali dhe quhet Thoma Gjindali, e jo Thoma Çuhaj, por në fakt është i biri i Llambit dhe duhet të kishte mbiemrin e Çuhajt. Me që erdhi i vogël e u rrit te Uan Gjindali, ka pranuar mbiemrin Gjindali.

Tani Uan Gjindali me nënën e Thomait, Elenën e Uan Notës, kanë edhe një djalë e një vajzë tjetër: Mihalin dhe Marikën.

Uani me djalin e vajzën ikën në Vlorë dhe atje kanë banuar.

Thoma Gjindali mbeti në Delisuf me familjen e tij.

Mihal Uan Gjindali u martua me Qyrana Thanas Dhimën nga Dukati, kanë dy djem e një vajzë, ndër të cilët, Fredin, Liljanën.

Fredi Mihal Gjindali u martua me Bruna Serjanin nga Dukati, kanë dy vajza: Dajanën dhe një tjetër.

Liljana Mihal Gjindali u martua me Tonin nga Tepelena.

Marika Uan Gjindali u martua me Spiro Uan Liçon nga Dëllënja, në Vlorë (se Spirua ka shkuar në Vlorë pas vitit 1950, me Filin e vëllezërit e tjerë), kanë 3 djem e një vajzë: Arjanin, Vasilin, Ervinin dhe Mozën.

Arjan Spiro Liço është martuar me një vajzë nga Bestrova.

Moza Spiro Liço u martua me Niko Llazin e Mihal Priftit (Qoromidhas), nipi Fil Shytit.

Vasili dhe Ervini, aktualisht janë beqarë.

THOMA GJINDALI

Në të vërtetë është Thoma Llambi Çuhaj nga Pojani i Fierit.

Thoma Gjindali u martua me Nijen e Spiro Vangjel Gjonit nga Dëllënja (Urani Gjoni), kanë 3 djem e një vajzë: Filin, Llazarin, Ligorin dhe Yllkën.

Thomai ka ardhur i vogël prapa nënës te Uan Gjindali në Delisuf, është i biri i Llambi Çuhajt nga Pojani. Babai Llambi vdiq i ri. E ëma, Elena Uani Nota u martua me Uan Gjindali, por në fakt është Çuhaj.

Fili Thoma Gjindali u martua me Tina Jani Markun nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë: Lorencin dhe Entelën.

Llazar Thoma Gjindali u martua me Shezie Beqir Dautin nga Tërbaçi i Vlorës, kanë 3 vajza: Einën, Erinën dhe Ermirën. (Llazari është ekonomist financier i lartë, ka qenë edhe deputet i zonës në vitet para 1990-ës). Ka emigruar familjarisht në Greqi.

Ligor Thoma Gjindali u martua me Elca Lijo Sotën në Delisuf, kanë një djalë e dy vajza: Aleksandrin, Elionën dhe Fluturën.

Elvira u martua me Fisnik Koçi Petanin në Fitore, Novoselë.

Flutura u martua me Florenc Rebai, banon në Bishan, Fier.

Aleksandri aktualisht është beqar.

Yllka Thoma Gjindali u martua me Andon Naun Gjonçari në Delisuf.

VASIL GJONI, DËLLËNJË

Vasil Gjoni me Llambrininë kanë lënë dy djem dhe 3 vajza. Miçon, Llukën, Athinanë, Vasilikën dhe Marien.

Miço Vasil Gjoni u martua me Marie Thoma Çobankën nga Bishani Fierit, kanë 3 djem e 3 vajza: Ligorin, Taqon, Lilën, Netën, Sofikën dhe Mozën.

Ligor Miço Gjoni u martua me gruan e parë, Monda Gorin nga Bishani Fierit, kanë dy djem, Bledin e Albanin dhe një vajzë. Me gruan e dytë, që ka marrë nga fshati Fitore, nuk ka fëmijë, kanë emigruar në Itali.

Taqo Miço Gjoni u martua në Vlorë, kanë një djalë e një vajzë.

Neta Miço Gjoni u martua me Peço Kronin (Baba) Mitrushi nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza.

Sofika Miço Gjoni u martua me Arqile Koçi Hila në Dëllënjë, kanë 4 vajza.

Mimoza Miço Gjoni u martua me Berti Grekun në Aliban.

Shënim: Pas vitit 2000, Miçua ka shkuar familjarisht në Vlorë.

LLUKË VASIL GJONI

Llukë Gjoni u martua me Milika Kristaq Sotën nga Vlora, kanë 3 djem e dy vajza: Sokratin, Tolin, Fredin, Nolën dhe Liljanën.

Sokrat Llukë Gjoni u martua me Enkelejda Koçi Gjonin (tjetër fis ky në Dëllënjë). Toli Llukë Gjoni u martua.

Fredi Llukë Gjoni u martua me Leda Themi P. Nakën nga Porua.

Nila Llukë Gjoni u martua me Minella Llazi Garron në Poro.

Liljana u martua me Artur Ndinin në Novoselë.

Vajzat e Vasil Gjonit:

Athinaja u martua me Niso Llambron në Grykë, ka 3 djem e 3 vajza: Filin, Pilon, Petraqin, Kristinën, Vasilikën dhe Donikën.

Vasilika u martua me Koli Uan Zakën në Zhukë.

Maria u martua me Vangjel Qiric Garron në Poro.

Vasil Gjoni në Dëllënjë nuk ka të bëjë me fisin e Gjonajve të tjerë.

PALI GJONI, DËLLËNJË

Pali Gjoni është nip i Vangjel Gjonit.

Vangjel Gjoni ka ardhur nga Memkaj i Fierit. Vangjeli ka dy femijë: Spiron dhe Mitin.

Spirua pati me Konxhen: Palin, Sotirin, Nikon, Vasilin dhe Uraninë.

Pali Spiro Gjoni u martua me Marie Gori Thanon nga Porua, kanë 6 djem e një vajzë: Nikon, Lijon, Koçin, Thoman, Miçon, Petraqin dhe Valën.

Lio Pali Gjoni u martua me Gjenën nga Beshishti, kanë një djalë e 4 vajza: Robertin, Elcën, Lauretën, Eglën dhe Matildën.

Koçi Pali Gjoni u martua me Vita Lio Sotën nga Delisufi, kanë dy djem e dy vajza: Altinin, Leonardin, Albanën dhe Letën.

Leja Pali Gjoni u martua me Elca Stavre Plakun nga Delisuf, kanë një djalë e një vajzë: Arditin dhe Leonardon.

Miço Pali Gjoni u martua me Filen nga Resulaj i Selenicës, kanë një djalë e një vajzë: Glion dhe Inën.

Petraq Pali Gjoni u martua me Alma Neli Dokon nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Aldonin, Marien dhe Silvanën.

Vala Pali Gjoni u martua me Llukë Naun Moçkën në Novoselë.

Roberti Lio P. Gjoni u martua me Bona Belajn nga Selenica, kanë një djalë e një vajzë, Mondën dhe Françeskon.

Elca u martua me Koçi Pano Koçin në Dëllënjë, kanë 3 djem e një vajzë.

Laureta Lio Gjoni u martua me Mikel Todi Kolën, në Poro, kanë dy djem.

Egla u martua me Genti Dokon Pish-Poro.

Matilda u martua në Frakull.

Koçi Pali Gjoni u martua me Vita Lijo Sotën nga Delisufi, kanë dy djem e dy vajza: A1tinin, Leonardin, Albanën dhe Ledën.

Altini u martua me vajzën e Pilo Plakut.

Leonard Koçi Gjoni u martua në Pish-Poro.

Albana K. Gjoni u martua me Todi Dokon në Aliban.

Leda K. Gjoni u martua me Klajdi Llukë Gjonin në Dëllënjë.

Shënim: Këta janë fis tjetër nga Gjonajt në Dëllënjë.

Thoma Pali Gjoni

Thoma Pali Gjoni u martua me Adelina Ndoni Gegën nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Anilën, Eltonin dhe Eliadën.

Anila Th. Gjoni u martua me Minella Pali Nakon në Pish-Poro.

Elton Th. Gjoni u martua me Barona Dhimitër Priftin nga Zhuka.

Eliada aktualisht është beqare.

Lijo Pali Gjoni u martua me Elca Stavre Plakun nga Delisufi, kanë një djalë e 1 vajzë: Arditin dhe Leonorën.

Miço Pali Gjoni u martua me File Resulin nga Selenica, kanë një djalë e një vajzë: Inën dhe Glionin, aktualisht janë beqarë.

Petraq Pali Gjoni u martua me Alma Neli Dokon në Dëllënjë, kanë dy vajza e një djalë: Marien, Silvanën dhe Renaldon.

SOTIR SPIRO GJONI

Sotir Spiro Gjoni është martuar me Nefta Lepurin nga Novosela, (gruan e parë) kanë një djalë e një vajzë: Apostolin dhe Netën.

Apostol Sotir Gjoni u martua me Vali Dokon nga Pish-Porua, kanë një djalë e një vajzë: Florin dhe Gertën.

Neta Sotir Gjoni u martua me Vllasi Miti Mëhillin në Poro, kanë dy djem dhe një vajzë.

Niko Spiro Gjoni u martua me Athina Loni Rrapin nga Pish-Porua, kanë një djalë e dy vajza: Mondin, Lulin dhe Lidën.

Mondi Niko Gjoni u martua me Nika Llazi Ndoni në Sheq Marinës Fier. kanë 3 djem: Nardin, Fabion dhe Xhulion.

Vasil Spiro Gjoni u martua me Liri Priftin në Novoselë, kanë një djalë, Gentin.

Genti Vasil Gjoni u martua me një franceze, ka dy djem.

Urani Spiro Gjoni u martua me Thoma Gjindalin në Delisuf, ka 4 djem e një vajzë.

Shënim: Sa ishte gjallë, Pali thoshte shpesh se origjina e mbiemrit të tyre ishte nga Garrojt e Poros, por shumë të largët.

Mund të kenë ardhur nga Qenasi i Fierit. Pali ka ardhur i vogël në Dëllënjë, pra ka lindur andej, jo në Dëllënjë.

Maria e Pali Gjonit e kishte teze Naunkën e Nas Daulles, d.m.th., Naunka e Nasit dhe Konxhja e Gor Thanos ishin motra.

Shënim: Për Themi Koçin, Nefta e Todi Vrushit jep këto të dhëna, sepse asnjë nuk e sqaron mirë problemin se i biri kujt ishte Themi Koçi dhe 4 motrat e tij.

Themi Koçi ishte kushëri me Lili Koçin. Ishte martuar me të bijën e Miti Stefës nga Gryka (Miti Stefa dhe Naun Stefa ishin vëllezër). Këta kanë banuar në Grykë. Nauni la 3 djem Pilon, Llazin, dhe Todi Stefën. Todi mbeti në Grykë, Zhukë e në Dëllënjë deri në fund të jetës, ndërsa Pilua e Llazi shkuan në Vlorë që në moshë të re.

Ndërsa Miti Stefa ka lënë Lilin dhe Valën që ishin në Vlorë. Valën e kish marrë Themi Koçi. Lili Stefa ka punuar infermier në Vlorë.

Themi Koçi me Valën ka 3 vajza e një djalë: Eftalinë, që u martua me Harrilla Demën, Kristinën në Tiranë, etj.

Konxhja dhe Naunka e Nasit ishin motra.

Themi Koçi ishte nga Dëllënja, kushëri me Lil Koçin.

HAJDINAJT

Hajdinajt e kanë origjinën nga Gjirokastra, nga Labova e Kryqit, ka thënë babai Dh. H, por mundet që të jenë nga Gllava e Tepelenës. Janë të besimit kristjan–ortodoks.

Më konkretisht, cila është origjina e Hajdinajve të Poros? Ajo që dihet me saktësi është se Fone (Ksenofon) Hajdini ka zbritur në Myzeqe dhe ka ndenjur disa kohë në Mifol e pastaj djemtë e tij, Nasi dhe Vangjel Hajdini, erdhën në Poro dhe këtu u shtuan më tepër. Në Myzeqenë e Vlorës përmendet më i vjetri Fone Hajdini, fillimisht ka qenë në Mifol.

FONE HAJDINI

Dhori Hajdini, Josif Naka dhe Loni Helmi

Në Vlorë kam njohur mirë Velo Hajdinin nga Gorrishti. Ai kishte një djalë, rreth 45 – 50 vjeç. Që të dy, babë e birë, ngjanin shumë me xha Vangjel Hajdinin tonë dhe me djemtë e nipërit e tij: Uanin, Kozmanë, Pilon dhe Xhoxhin.

Velo Hajdini më thoshte, në vitet 1970–1975, se gjyshi i tij kishte ardhur në Gorrisht nga Tepelena ose nga fshatrat e Gjirokastrës, bashkë me një vëlla. Ata merreshin me bagëti, dhe mbetën në Gorrisht. Vëllai tjetër i gjyshit të tij, pas ca kohe, iku nga Gorrishti dhe zbriti në Myzeqe. U shkëputën si familje. Mendoj se, pikërisht ky vëlla i Velos, është stërgjyshi ynë, Fone Hajdini.

Edhe në Orikum, kam njohur dy djemë të rinjë, vëllezër, Tomorr e Medin Hajdini, nga Gllava e Tepelenës. Ata zunë punë në Orikum, në fermë, dhe po aty u martuan. Tani mund të jenë në Orikum, ose mund të kenë emigruar në Itali. Që të dy ata ngjanin shumë me pasardhësit e Nasi Hajdinit në Poro, gjyshi ynë. Ishin dy djemë të gjallë, të zotë, të punës e të muhabetit. Nga pamja e jashtme ata kishin shumë pika të përbashkëta me ne. Mua më flisnin gjithmonë "O kushuri".

Edhe një djalë 30 vjeçar, nga Borshi i Sarandës, që kam njohur në vitet 1989–1990, kishte shumë tipare të afërta me ne. Ishte gati-gati kopje e Thanas Hajdinit, i cili quhej Ilir Hajdini.

Duke njohur mirë njerëzit, kryesisht në linjën e meshkujve, të fisit tim dhe duke i krahasuar ata që përmenda më lartë, them me bindje të plotë se ne të gjithë Hajdinajt e Poros jemi të një gjaku me Hajdinajt e Gorrishtit, të Gllavës dhe të Borshit.

Është e pranuar edhe shkencërisht që gjaku i ngjan gjakut të vetë, pavarësisht se mund të jetë edhe i largët, 7–8 breza. "Gjaku nuk bëhet ujë", thotë populli.

Fone Hajdini la dy djem e një vajzë: Thanasin, Vangjelin dhe Anën (Qyranën). Nasi dhe Vangjeli fillimisht u futën hyzmeqarë me kontratë te Çukallarët e Poros, për një kohë dhjetëvjeçare dhe me disa kushte të asaj kohe, që këta si djem duhej t'i martonte dhe në fund t'u jepte një pjesë të pasurisë, diçka nga bagëtia. Nasi arriti dhe u martua atje te Çukallarët, ndërsa Vangjeli nuk u martua atje dhe, për shpenzimet e martesës, mori një pjesë të bagëtisë, bashkë me atë pjesë që i takonte për kohën e punës dhjetëvjeçare. Kështu, ata dolën nga Çukallarët, e filluan jetën në shtëpinë e tyre dhe në disa toka "paraspore", kullota e pyje pranë Lumit të Vjosës në lagjen e Poros, Marinëz.

Thanas Fone Hajdini u martua me Sofien, e bija e Rrapo Kolës nga Stefajt apo Kotet me origjinë nga Zvërneci të cilët jetonin në Grykë dhe bashkë lindën një djalë e një vajzë: Dhorin dhe Marien.

Dhori Nasi Hajdini u martua me Marie Irakli (Rako) Koçin nga Dëllënja, lindën dy djem e 4 vajza: Llazin, Menin, Filen, Vangjelinën, Vidën dhe Raqin.

Vangjelina me të birin, Edin

Llazi, vëllai, Raqi dhe dy djemtë e Llazit, Thanasi dhe Ksenofoni

Llazi Dhori Hajdini u martua me Ferdhite Milo Gjideden nga Iliasi i Himarës dhe kanë lindur dy djem e një vajzë: Thanasin, Fonin dhe Ketën.

Melpomeni Dhori Hajdini u martua me Llaqi Kostandin Naçin nga Porua dhe kanë 4 djem e një vajzë: Arqilen, Leonardin, Gjergjin, Thoman dhe Natashën.

Llazi Hajdini me nusen e tij, Vide Gjidede

File Dhori Hajdini u martua me Koli Petro Cakun në Elbasan dhe kanë një djalë e dy vajza: Mikelin, Orjetën dhe Evisin.

Llazi, Meni, Filja, Vangjelina, Vida dhe Raqi, 2014

Keli (Mikeli) i Files ka dy vajza.

Orjeta ka një djalë e një vajzë.

Evisi ka dy vajza.

Vangjelina Dhori Hajdini u martua me Lekmi Banushin në Vlorë dhe kanë një djalë, Edin.

Vita u martua me Pandeli Stefën në Fier dhe kanë 3 vajza, Rovenën, Elisën, Irvën.

Uan V. Hajdini me gruan, Kalijen dhe fëmijët

Raqi Dhori Hajdini u martua me Liza Kostandinin dhe kanë një vajzë e një djalë, Magin dhe Dorin.

Edi Banushi u martua me Sonila Vangjel Vëngun nga Vlora dhe kanë dy djem, Mateon dhe Damjanin.

VANGJEL FONE HAJDINI

Vangjel Fone Hajdini u martua 3 herë. Gruaja e parë ishte nga Laskajt e Mifolit. Ajo vdiq e re, nuk la fëmijë. Edhe gruaja e dytë, e motra Pali Shytit nga Porua, vdiq e re dhe nuk la fëmijë. Gruaja e tretë Maria, e bija e Llukë Sheqit nga Porua lindi 3 djem e një vajzë: Uanin, Kozman, Miçon dhe Senën.

Ana Fone Hajdini u martua me Irakli Papulasi nga Preveza dhe lindën Mitin.

Miti I. Papulasi u martua me Marien nga Novosela dhe kanë një vajzë, Sijen.

Sija u martua me Taqo M. Konda në Vlorë.

Uan Vangjel Hajdini u martua me Kalije Thanas Bushi nga Dëllënja, kanë dy djem e 3 vajza: Pilon (Periklin), Xhoxhin, (Jorgjin), Letën, Donikën dhe Nolin.

Llazi, Vita, Kristua dhe Afroviti

Pilo Uan Hajdini u martua me Urani Pali Nakën nga Porua, kanë 5 vajza e një djalë: Anilën, Julianën, Brunildën, Albën, Kozetën dhe Aleksandrin.

Anila u martua me Sotir Jani Markun nga Dëllënja.

Juliana u martua me Irakli Mihal Dimo në Pojan.

Brunilda u martua me Vasillaq Llazar V. Gegën në Delisuf.

Alba u martua me Gentian Pilo L. Rista në Delisuf.

Kozeta Pilo Hajdini u martua me Arben Apostol Todi Mitraj në Poro.

Aleksandri aktualisht është beqar.

Vajzat e Uan Hajdinit:
Leta u martua me Llazar Shkurtin në Pish-Poro.
Noli u martua me Miço Golemin në Verrias Fier.
Donika u martua me Kosta Petro Liçon në Grykë të Fierit.

Jorgji (Xhoxhi) Uan Hajdini u martua me Liri Thoma Mishtakun nga Sheqishtja, Fier, kanë një djalë e një vajzë.

KOZMA VANGJEL HAJDINI

U martua me Jana Vangjel Shyti nga Zhuka, lindën l vajzë e 5 djem: Jorgjien, Andonin, Filipin, Petraqin, Sotirin, Vangjelin.

Jorgjia u martua me Sokrat Thoma Kërrin nga Pish-Porua, lindën 4 djem: Dritanin, Fabianon, Aristirin dhe Fatjonin.

Andon Kozma Hajdini u martua me Vera Ramadan Lilën nga Qesarati i Tepelenës, kanë një djalë e dy vajza: Ronaldon, Aurorën dhe Borën.

Vangjel Kozma Hajdini u martua me Sadushen nga Cakrani i Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Arditin, Marjanën.

Filip Kozma Hajdini u martua me Djana Vasillaq Kostën nga Delisufi, kanë një djalë e një vajzë: Olsenin dhe Renatën.

Petraq Kozma Hajdini u martua me Alma Bush Thomai nga Fieri, kanë një djalë e një vajzë: Valentinon dhe Nerjanën.

Sotiraq Kozma Hajdini u martua me Blerina Mitaq Mitraj (Kola) nga Porua. Kanë dy vajza: Janën dhe Xhestikën.

Shënim: Filipi dhe Petraqi janë binjakë, siç ka qenë edhe gjyshi i tyre, xha Vangjel Hajdini me një tjetër.

MIÇO VANGJEL HAJDINI

Miço Vangjel Hajdini ishte vëllai më i vogël i Uanit dhe Kozmait, ishte i datëlindjes 1931. U martua me Kristullën e Lami Banit nga Ferrasi, lindën dy djem e dy vajza: Arqilen, Arjanin, Marjanën dhe Xhulin.

Arqile M. Hajdini u martua me Mimoza Sokrat Petro nga Fieri dhe kanë një djalë dhe një vajzë, Miltionin dhe Eriseldën.

Arjan Miço Hajdini u martua me Fize Skënder Gega nga Dermenasi i Fierit. Kanë dy vajza: Anxhelën dhe Krisin.

Marjana Miço Hajdini u martua me Laze Bregun nga Patosi, kanë dy djem: Marion dhe Artanin.

Xhuli Miço Hajdini u martua me l grek, Anastas Mavrogalon, kanë një vajzë

Theodhora-Maria (kanë regjistruar dy emra bashkë).

Shënim: Miçua vdiq para vitit 1985. Gruaja dhe fëmijët emigruan në Greqi në vitin 1991.

SENA VANGJEL HAJDINI

Sena u martua me Kristaq Loni Nakën në Dëllënjë, kanë lindur 3 vajza e 1 djalë: Sofikën, Margaritën, Liljanën dhe Vladimirin.

7 burra Hajdini: Llazi, Pilua, Andoni, Xhoxhi, Filipi, Petraqi, Sotiri dhe Sokrat Kërri para tavolinës

Sofika është martuar në Poro me Sotiraq Nasi Shytin.

Margarita u martua me Kristaq Kil Gjonçarin në Poro.

Liljana u martua me Tomi Koçi Belina nga Porua.

Sena ka dhe një vajzë me Stavre Dilën, Florika e cila u martua me Aleks Miço Nasi në Poro.

Shënim: Sena ishte e martua me Kristaq Nakën në Dëllënjë, por Kristaqi vdiq shpejt dhe la 3 vajza e një djalë. Sena mori fëmijët dhe erdhi në Poro tek e ëma dhe vëllezërit, të cilët i bënë shtëpi më vete, ku rriti fëmijët. Por e kërkoi Stavre Tali Dila aty në Poro i cili e kish kërkuar edhe para se ajo të martohej në Dëllënjë, por nuk ja kishin dhënë prindërit e saj. Tani që Sena u kthye prapë, por me 4 fëmijë, Stavre Dila, që ishte akoma beqar, e kërkoi dhe e mori me 4 fëmijë. Bashkë lindën një vajzë Florikën; i rritën e i martuan të 5 fëmijët, të cilët u bënë të mirë.

Florika Stavre Dila u martua në Poro me Aleks Miço Nasin. Një rast shumë i rrallë ky i Senës që kish 4 fëmijë dhe e mori një djalë beqar. Që të dy ishin njerëz shumë të mirë dhe jetën e kaluan në harmoni të plotë duke e respektuar njëri-tjetrin.

SINAN HAZIZI

Sinan Hazizi erdhi familjarisht në Poro rreth viteve 1920–1925. Ai erdhi nga Bishani i Fierit ose nga Boçova i martuar me Bylyrën. Bylyrja solli me vete edhe dy djem e një vajzë që i kishte lindur me burrin e parë, dhe me burrin e dytë. Me burrin e parë, Shefit Bushin nga Levani, Bylyrja kishte lindur Tabenën dhe Hamitin. Më pas ajo kish qenë e martuar edhe në Karbunarë të Vlorës dhe kish lindur Nekiun me Yzeir Hasllan Shehun, dhe burrë të tretë kish marrë Sinanin, që erdhi në Poro, dhe me këtë lindi edhe një vajzë, Nurien.

Tabenia, e bija e Bylyrës dhe e Shefit Bushit nga Levani, u martua me Abedin Tetenin nga Leskoviku. Ai jetoi ca kohë në Bishan e më pas shkoi në Llakatund, ku jetoi shumë vite dhe pastaj shkoi familjarisht në Ferras, aty ka dy djem e një vajzë: Zietin, Pëllumbin dhe Feriden, me mbiemrin Teteni, Feridea u martua në Kaninë.

Hamit Shefit Bushi u martua me Hava Osmën Sulon nga Ferrasi i Fierit dhe kanë 4 djem e 4 vajza: Rrapin, Barjamin, Shefitin, Pajtimin, Safeten, Paqyzen, Ikejan dhe Zadiren.

Rrapi Hamit Bushi u martua me Myzejenin nga Vlora, kanë 3 djem e një vajzë: Leonardin, Gentianin, Mikelin dhe Marcelën.



Rrapi Hamit Bushi

Barjam H. Bushi u martua me Minushe Dylber Delikon nga Tomorrica e Beratit, kanë dy djem: Emirjanin dhe Erjonin.

Emirjan Barjam H. Bushi u martua me Lina Moron nga Berati, kanë një djalë e një vajzë: Kristianin dhe Alesjan.

Shefit H. Bushi u martua me Lindita Bedriun nga Çeprati i Vlorës, kanë një djalë e dy vajza: Xhulianon, Burbuqen dhe Lidën.

Pajtim H. Bushi u martua me Trëndafile Hamit Likaj nga Mavrova, kanë 3 djem: Antonio dhe dy të tjerë, jetojnë në Itali.

Safete H. Bushi u martua në Qarr të Fierit me Sali Velajn.

Paqyzea u martua me Nuri Arapin në Kullë të Durrësit.

Zadirea u martua.

Bylyrja kishte dhe një vajzë me Yzeir Hasllanin në Karbunarë, (motra e Nekiut), Xhevrien, që u martua në Ferras me Muharrem Arapin.

Neki Yzeir Hasllan Shehu u martua me Fanie Petro Sikon nga Porua. Këta u martuan me dashuri, pa pëlqimin e familjes së Fanies, dhe nuk u pajtuan kurrë deri sa jetuan Nekiu e Fania. Nekiu me Fanien lindën 4 djem: Petritin, Beharin, Yzeirin dhe Agronin.

Petrit Neki Hasllani u dashurua me Ritën, vajzën e Lio Naçit në Poro, por nuk u martuan. Me Petritin lindi një vajzë, Florën, e cila u rrit nga vetë Rita, te i ati dhe e ëma. Flora u martua në Tiranë me Gëzim Hoxhën. (Flora është bija e Petrit Neki Hasllanit nga Porua).

HILAJT, DËLLËNJË

Hilajt e Dëllënjës janë të ardhur nga Dukati. Kanë qenë tre vëllezër: Llazi, Lili dhe Pilua. Lili dhe Pilua nuk ndenjën shumë në Dëllënjë. Ata ikën në Vlorë ku qëndruan deri në pleqëri.

Në Vlorë kanë lënë djem e vajza.

Llazi tregonte se origjinën e kanë nga Porua e Fierit, kishin vajtur disa kohë në Dukat e pastaj erdhën në Dëllënjë. Llazi nuk u largua më, ndërsa Lili e Pilua ikën në Vlorë, para vitit 1940. I ati i tyre quhej Nasi Hila.

Llazi Nasi Hila ishte martuar me Stasën nga fisi i Përrojve, e motra e Lijo Përrojit nga Vlora. Stasa mbahet mend në Dëllënjë si një grua mjaft e zonja, punëtore, mikpritëse dhe shumë e shkathët nga goja, Xha Llazi ka qenë burrë i urtë, punëtor i mirë e i ndershëm.

Të dy, Stasa me Llazin, lindën e rritën 5 femijë, 4 djem e një vajzë: Koçin, Filipin, Nojën, Cenin dhe Marigon.

Koçi Llazi Hila u martua me Dafina Jani Dhimitrin nga Pish Porua dhe lindën 4 djem e një vajzë: Arqilen, Sokratin, Peçin, Vason dhe Sofikën.

Arqile Koçi Hila është martuar me Sofika Miço Gjonin nga Dëllënja, kanë 4 vajza.

Sokrat Koçi Hila u martua me një vajzë nga Derviçani, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Peçi Koçi Hila u martua me Majlinda Koçi Kordhishtin nga Pish Porua, kanë një djalë, Amarildon dhe një vajzë.

Vaso Koçi Hila u martua me Afërdita Todi Plakun nga Dëllënja, kanë dy djem, Gentin, Leonardin dhe një vajzë.

Filip Llazi Hila u martua me Pulije Kozma Monen nga Bishani i Fierit, kanë dy vajza: Milikën dhe Vasilikën. Milika u martua me një djalë të mirë, por fatkeqësisht u mbyt në det dhe la dy djem të vegjël, Angjelon dhe Kriston. Ata po i rrit e ëma, Milika, në Greqi.

Noje Llazi Hila (Noja e ka emrin Stiliano) u martua me Thanasulla Gori Thanasin nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Maksin, Teutën dhe Belën.

Noja Llazi Hila, Thanasulla, e shoqja e Nojes, dhe Llazi Hajdini

Maksi Noje Hila u martua me Lena Dhori Qorrin nga Delisufi, kanë dy djem e dy vajza: Stilianon, Erën dhe Anën.

Ceni Llazi Hila (Dhimosten e ka emrin) u martua me Lefteri Çukën nga Gjirokastra, kanë 4 djem dhe dy vajza: Arbenin, Artanin, Arturin, Bensikun, Enkelejdën dhe Marcelën.

Arben Ceni Hila u martua me Elona Refail Dalipin, kanë një djalë e një vajzë.

Artan Ceni Hila u martua me Lona Novrus Sadikun nga Frakulla, kanë një djalë, Kevin. Të tjerët aktualisht janë beqarë.

Marigoja e Llazi Hilës u martua në Novoselë me Pandeli Moçkën, ka dy djem, Agronin dhe Nestin dhe një vajzë, Mirandën.

Lili Nasi Hila u martua me Lina (ishte shërbëtore te Dr. Aliu në Vlorë) dhe me të lindi

dy djem e 4 vajza: Aristirin, Panon, Ninian, Liljanën, Kristinën dhe Natashën.

Aristir Lili Hila, u martua me Athinanë nga Pojani, kanë një djalë, Mondin.

Pano Lili Hila u martua me Leonorën nga Mifoli, kanë dy djem.

Pilo Nasi Hila u martua me Naunkën e Gori Plakut nga Porua, kanë 4 djem e 3 vajza: Kristaqin, Tolin, Jorgaqin, Thanasin, Lizën, Irinin dhe Gjenovefën.

Kristaqi u martua me Tefta Tashi Papa nga Himara, kanë një djalë e një vajzë: Janin dhe Marinaqin.

Toli u martua me Donikën nga Fieri, kanë dy djem një vajzë: Armandon, Ermalin dhe Lelën.

Thanasi u martua me Mira Leja Prifti nga Novosela, kanë një djalë e dy vajza.

Vajzat e Pilo Hilës:

Liza u martua me Dule Havarin nga Dukati, Orikum.

Irini u martua me Petraq Harapashin në Vlorë.

Gjenovefa u martua me Gorin.

(Tregoi Filip Hila 70 vjeç).

HILAJT, ZHUKË

Në Zhukë kanë qenë edhe Stavre Hila dhe Vasil Hila. Këta dy vëllezër ishin djemtë e Llambro Hilës nga Vlora. Nuk kanë të bëjnë me Hilajt e Dëllënjës.

Llambro Hila ka qenë njeri i mirë, punëtor, i thjeshtë. Në vitin 1939–1940 u hap lufta e punë s'kishte. Ata erdhën familjarisht e u vendosën në shtëpinë e Niso Priftit për pak kohë. Pastaj ndërtuan një shtëpi të vogël me kashtë dhe aty jetuan deri nga viti 1965.

Vasil Hila jetoi në Zhukë deri sa u hap punë në Akërni, kur u bë fermë, dhe ky shkoi familjarisht. Atje duhet të jenë djemtë e tij edhe sot.

Stavre Hila u aktivizua me Lëvizjen Nacional-Çlirimtare dhe shkoi partizan. Në Vlorë Stavri kishte punuar këpucar, dhe në Zhukë rregullonte këpucë e opinga për fshatarët e, pastaj, edhe për partizanët.

Pas Çlirimit ishte nënoficer në Tiranë. Me dëshirën e tij, Reparti Ushtarak e dërgoi në shkollën ushtarake dhe doli oficer e dalëngadalë bëri karrierë. Punoi në Fier deri sa doli në pension.

Djemtë e tij janë në Fier.

Gruan e kishte nga Novosela, Leta Moçka, e bija e Jot Moçkës.

PETI HELMI, DËLLËNJË

Peti Helmi la Naqe Helmin.

Naqe Helmi la Kriston, Vasilin, Palin dhe Nasin.

Vasili la Llambin, Sotirin, Katen dhe Vangjelinën.

Pali është në Llakatund. Gruan e ka marrë te Gjonçarajt e Mifolit.

Nasi Helmi u martua me Vitën e Vangjel Fitës nga Vlora dhe ka lënë Vangjelin, Aristirin, Lijon, Sokratin, Margaritën dhe Tatjanën.

KRISTO HELMI

Kristo Helmi u martua me Marie Vrushin nga Delisufi dhe kanë lindur Vasilin, Palin, Nasin dhe Gjenën.

Vasil Kristo Helmi u martua me Marie Themi Nakën nga Delisufi, kanë lindur dy djem e dy vajza: Llambin, Sotirin, Katjan dhe Angjelinën.

Llambi Vasil Helmi u martua me Evrionomi Gori Thanasin nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë: Artanin, Fatjonin dhe Aurelën.



Thoma J. Hudhra, Llazi Hajdini, Llambi Helmi

Artan Ll. Helmi u martua me Xhuljeta Miço Hudhrën nga Dëllënja, kanë dy vajza: Simonën dhe Sabrinën.

Fatjoni aktualisht është beqar.

Aurela Ll. Helmi u martua me Altin Jani Gjokën nga Pish-Porua, ka dy djem.

Sotir Vasil Helmi u martua me Donika Q. Plakun nga Dëllënja, kanë dy vajza: Orkidën dhe Silvanën.

Orkida u martua me Edi Miço P. Gjonçarin në Delisuf.

Vajzat e Vasil Helmit:

Katja u martua me Pano Sotir Thanasin (Jorgji), në Dëllënjë.

Angjelina u martua me Agim Bushin nga Korça, por i ardhur në Vlorë.

PALI KRISTO HELMI

Pali Kristo Helmi u martua me Ksanda Tasi Gjonçari, nga Gjonçarajt e Novoselës, kanë lindur dy djem e 3 vajza: Spiron, Kristaqin, Sofikën, Naunkën dhe Ritën.

Spiro P. Helmi u martua me Ritën nga Skrofotina, kanë një djalë e 3 vajza.

Sofika u martua me Llazar Ristën në Bishan të Fierit, kanë dy vajza.

Naunka u martua me Naun Sema në Ferras, kanë dy djem e një vajzë.

Rita u martua me Bertin në Vlorë.

Gjena Kristo Helmi u martua me Spiro Babën në Dëllënjë.

NASI KRISTO HELMI

Nasi Kristo Helmi u martua me Vita Vangjel Thomain (Fitja) nga Vlora, kanë 4 djem e 4 vajza: Vangjelin, Aristirin, Ligorin, Sokratin, Lirinë, Mimozën, Margaritën dhe Tatjanën.

Vangjel N. Helmi u martua me Enkelejda Leko Nakën nga Dëllënja, kanë dy djem: Klajdin dhe Aldon.

Aristir N. Helmi u martua me Luljetën nga Frashëri i Fierit, kanë një djalë e një vajzë:

Masimon dhe Aridën.

Ligor N. Helmi u martua me Almën nga Sheq - Marinëza e Fierit, kanë një djalë, Egjin.

Sokrati aktualisht është beqar.

Liria N. Helmi u martua me Vasil Pilo Ndinin nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë.

Mimoza u martua me Aleksandër Nasi Rrungajën në Dëllënjë, kanë dy djem e një vajzë.

Margarita u martua në Topojë të Fierit, me Sotirin, kanë lënë një vajzë, (ka vdekur).

Tatjana u martua me Arti Miço Thanon në Poro, ka dy vajza.

LONI HELMI

Loni Helmi ishte martuar me Marie Davidhin (motra e Andre Davidhit) nga Zhuka, kanë lindur 5 djem e dy vajza: Thoman, Llazin, Miçon, Nikon, Peçon, Kristinën dhe Uraninë.

Thoma (Tomi) Loni Helmi u martua me Nefta Uan Mbyetin nga Delisufi, kanë 5 djem e 3 vajza: Koçin, Filipin, Arqilen, Mikelin, Eduardin, Lizën, Millën dhe Donikën.

Dhori Hajdini, Josif Naka, Loni Helmi

Koçi Th. Helmi u martua me Eminenë nga Gërneci i Vlorës, kanë këta fëmijë, Arjetin, Riseldën dhe Emiljanon.

Filipi u martua me Lidën nga Sheq-Marinëza e Fierit, kanë një djalë, Kevin.

Arqilea u martua me Lida Pilo Plakun, kanë një vajzë.

Mikeli u martua me Afërditën nga Fieri.

Eduardi u martua me një italiane, quhet Mojra, ka një djalë dhe një vajzë.

Liza u martua me Llazi Vangjel Marinën në Poro, kanë një djalë e 4 vajza: Ervinin, Julindën, Anilën, Enerjetën dhe Renatën.

Milla Thoma Helmi u martua me Piro Vllas Markun në Dëllënjë.

Donika u martua me Arben Jani Moçkën në Poro.

LLAZI LONI HELMI

Llazi L. Helmi u martua me Gjena Joti Veron nga Risilia, kanë pesë fëmijë: Harrillën, Gjergjin, Kristaqin, Leonorën dhe Kozetën.

Harrilla u martua me një vajzë nga Fieri, kanë një vajzë.

Gjergji e ka marrë nusen nga Fieri.

Kristaqi u martua në Frakull, ka dy vajza.

Leonora u martua me Vasil Priftin nga Vajkani i Fierit.

Kozeta u martua me një djalë nga Vajkani i Fierit.

Të gjithë kanë emigruar në Itali.

Niko Loni Helmi u martua me Dhoksien nga Fieri ka dy vajza: Brikenën dhe Anitën

Miço Loni Helmi u martua me Milika nga Qarri i Fierit, ka djem e vajza.

Peço Loni Helmi u martua.

Vajzat e Loni Helmit:

Kristina u martua me Kristaq Mërtirin në Frakull.

Urania u martua me Jani Bregun nga Frakulla.

THOMA HOXHARA

Thoma Vangjel Hoxhara është nga Hoxharajt e Mifolit. I ati, Vangjeli, vdiq shpejt. Ai shkoi te motra Sofia në Babicë ca kohë dhe pastaj shkoi te motra tjetër, nëna e Thanas Bushit në Dëllënjë. Aty në Dëllënjë, u martua.

Thoma Hoxhara u martua me Finen e Mihal Çunit nga Sheqi i Dëllënjës. Lindën 3 djem e 3 vajza: Kolin, Kozman, Janin, Naqen, Dhoksien dhe Silën.

Thomai, deri 1940 ishte në Dëllënjë, pastaj erdhi në Poro familjarisht ku punoi si shërbëtor në kishën e Shën Kollit.

Koli Thoma Hoxhara u martua me Vasilika Spiro Babën nga Dëllënja, kanë 5 djem: Mihallaqin, Thoman, Edmondin, Jorgaqin dhe Vironin.

Koli Th. Hoxhara dhe Llazi Hajdini

Mihallaq Koli Hoxhara u martua me Anila Leko Kolën nga Porua, kanë 3 djem: Kristianin, Nikollën dhe Andrenë.

Thoma Koli Hoxhara u martua me Rita Fili T. Kolën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Edmondin dhe Kristinën.

Edmond Koli Hoxhara u martua me Shpresa Todi Kolën nga Libofsha, aktualisht kanë një djalë, Mateon.

Jorgaq Koli Hoxhara u martua me Rudina Filip Vrushin nga Portëza e Fierit.

Viron Koli Hoxhara u martua me Erjona Niko Kungullin nga Porua.

Vajzat e Thoma Hoxharës:
Naqja u martua në Sheq Marinëz, Fier.
Dhoksia u martua në Novoselë me Sotir Moçkën.
Sila u martua në Pish-Poro me Rrapi Kriston.

KOZMA THOMA HOXHARA

Kozma Th. Hoxhara u martua me Kostandina Tasi Shyti nga Zhuka, kanë dy djem, Alketin e Joridin edhe dy vajza.

Kozma Th. Hoxhara

Alket Kozma Hoxhara u martua me Anila Aristir Kolën, nga Roskoveci, kanë një djalë: Kozman.

Joridi Kozma Hoxhara u martua me Rozeta Miço Kolën nga Kolkondasi i Fierit.

Njëra nga vajzat e Kozma Hoxharës u martua në Gjokalli dhe tjera në Pish-Poro të Fierit.

JANI THOMA HOXHARA

Jani Hoxhara u martua me Kristina Petro Memecin nga Porua dhe kanë 3 vajza: Rakelën, Alidën, Mozën.

LLAZI TILO HUDHRA, GRYKË

Llazi Tilo Hudhra ka ardhur në Grykë nga Dukati po edhe në Dukat të vajtur ishin.

Mendohet se kanë ardhur nga Përmeti.

Llazi ka qenë djalë i vetëm. Kishte një motër që e pati marrë Leksi Kërri në Grykë.

Llazi Hudhra u martua me Kristullën e Naun Stefës nga Gryka. Ajo kishte 3 vëllezër: Pilon, Llazin dhe Todi Stefën. Pilua e Llazi Stefa shkuan në Vlorë që në moshë të re. Todi jetoi në Grykë, në Zhukë. Në fund jetoi në Dëllënjë.

Xha Llazi Hudhra ka lënë 7 djem e dy vajza: Thoman, Trifonin, Aristirin, Lefterin, Nikon, Xhoxhin, Nasin, Aretinë dhe Kostandinen.

Trifon Llazi Hudhra u martua me Vitore Loni Liço nga Dëllënja, kanë 3 djem e një vajzë: Kristaqin, Astritin, Garitin dhe Mondën.

Kristaq T. Hudhra martuar me Arta Vllasi Milon në Poro, kanë dy djem: Kristianin dhe Andonetën.

Astrit T. Hudhra u martua me Rovena Berti Gjinin nga Ferrasi, aktualisht kanë një vajzë.

Garit T. Hudhra u martua me Marcela Lutfi Memën nga Gjormi, jetojnë në Itali.

Monda T. Hudhra u martua me Vangjel Priftin në Marinës të Fierit.

Thoma Llazi Hudhra u martua me Lira Petro Dashin nga Gryka, kanë një djalë e 3 vajza: Tolin, Lanin, Mirën dhe Likën.

Toli Thoma Hudhra u martua me Vjollca Lipi Gjokën nga Pish-Porua, kanë dy djem: Thoman dhe Elidonin.

Lani u martua me Jorgo Nonda Matën në Poro.

Mira u martua me Fredi Raman në Frashër, Fier.

Lika u martua me Lulin në Seman të Fierit.

Aristir Llazi Hudhra u martua me Jorgjie Uani Mbyetin nga Delisufi, kanë një djalë e 3 vajza: Mariglenin, Dritën, Shpresën dhe Donën.

Marigleni u martua me Ledjana nga Frakulla, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Vajzat e Aristirit janë martuar të tre në Pish-Poro.

Lefter Llazi Hudhra u martua me Leta Lijo Ristën nga Zhuka, kanë një djalë e 4 vajza: Besmirin, Ngjelinën, Ilmën, Lidën dhe Zanën.

Ngjelina u martua me Ilia Petro Lepurin në Delisuf.

Ilma u martua me Alti Vasil Dashi në Delisuf.

Zana u martua me Elton Gaqi Doko në Aliban.

Lida u martua me Llazi Dashin në Delisuf.

Niko Llazi Hudhra u martua me Saveta Tini Dashin nga Gryka, kanë një djalë e një vajzë: Benin dhe Vasilikën.

Beni Niko Hudhra u martua me Zoica Halim Sinën nga Gjormi, kanë dy djem: Mateon dhe Aleksin.

Vasilika u martua me Raqi Lekon në Pojan, Fier.

Xhoxhi Llazi Hudhra u martua me Nefta Jorgji Tikën (Kungulli) nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Bledarin, Fatjonin dhe Danielën.

Bledari Xh. Hudhra u martua me (Pa saktësuar), jetojnë në Greqi.

Fatjoni u martua me Ilda Miço K. Markun nga Delisufi.

Nasi Llazi Hudhra u martua me Shpresa Pilo Bërdallin nga Porua, kanë dy djem e dy

vajza: Ermirin, Gertin, Kelën dhe Ronën.

Ermiri u martua me Ertila Dani Koçi Mëhillin në Poro.

Kela u martua me Lirimin në Panaja.

Rona u martua me Ilirin në Pojan.

Gerti aktualisht është beqar.

Vajzat e Llazi Hudhrës:

Aretia u martua me Nasi Gjonçën në Mifol.

Kostandina u martua me Harrilla Hyson në Novoselë.

VANGJEL KOLI HUDHRA

Vangjel Koli Hudhra ishte martuar me Kaliopi Ndini Buallin nga Verriasi i Fierit. Kanë lindur dy djem 3 vajza: Aristirin, Dafinën, Lenën, Kristinën.

Aristir Vangjel Hudhra u martua me Sofie Jani Leshin nga Porua, kanë 4 djem e dy vajza: Aleksandrin, Vironin, Pandeliun, Mihalin, Lirinë dhe Liljanën.

Aleksandër Aristir Hudhra u martua me Laureta Zaim Danudhin nga Berati, kanë dy vajza e një djalë: Andrean, Sofikën dhe Stelën.

Viron Aristir Hudhra u martua me Fatbardha Lavdim Hekuran Çepelen nga Bishani, Vlorë, kanë dy djem e një vajzë: Marion, Sivjonin dhe Valentinën.

Pandeli Aristir Hudhra u martua me Matilda Nazar Aliajn nga Bishani Vlorë.

Mikel Aristir Hudhra aktualisht është beqar.

Liri A. Hudhra u martua me Osman Mina Memetin në Shkozë, Vlorë, kanë 3 djem.

Liljana A. Hudhra u martua me Bashkim Selamet Jahon nga Llakatundi, kanë një djalë.

RISTAN KOLI HUDHRA

Ristan Koli Hudhra u martua me Vitën, që kishte qenë e martuar më parë dhe solli te Ristani një djalë e një vajzë që quheshin Vasil dhe Kristina.

Vasili u rrit e u largua në Memaliaj. Atje punon si traktorist. Ka krijuar familje dhe ka fëmijë.

Kristina është martuar në Novoselë me Todi Konomin.

Vita u martua me Ristanin, lindën një vajzë, e cila u martua me Lefi Kozma Markun në Delisuf. Kjo vajzë e vetme e Ristanit quhet Pulije Ristan Hudhra. (Tani e ka mbiemrin Marku).

MIHAL KRISTO HUDHRA, DËLLËNJË

I ardhur nga Dukati i Vlorës, në Dëllënjë. Mihal Hudhra ishte martuar me Ristana Mitrush Kondën, po nga Dëllënja, kishte një djalë e dy vajza: Janin, Frosinën dhe Uraninë.

Mihal K. Hudhra

Jani Mihal Hudhra u martua me Naunka Kil Gjokën nga Pish-Poro dhe kanë 6 djem e 5 vajza: Miçon, Thoman, Nikon, Bertin, Mihallaqin, Kristaqin, Vasilikën, Stasininë, Vidën, Liljanën dhe Meritën.

Miço Jani Hudhra u martua me Evlloqi Thoma Mërtirin nga Zhuka, kanë një djalë e 3 vajza: Alvin, Anitën, Xhulietën dhe Rudinën. Banojnë në Amerikë.

Thoma Jani Hudhra u martua me Shpresa Perikli Mitraj nga Porua, kanë dy djem e dy vajza: Dorjanin, Foretën, Besnikun dhe Blerinën.

Blerina u martua me Filip Pano Koçin në Dëllënjë.

Niko Jani Hudhra u martua me Dhoksie Spiro Babën nga Dëllënja, kanë 3 vajza: Marjetën, Albën dhe Armandën.

Marjeta u martua me Sokol Zakën në Dëllënjë.

Alba u martua me Elidon Perikli Ristën Novoselë.

Armanda u martua me Petraq Vaso Bërdalli në Poro.

Berti Jano Hudhra u martua me Violeta Jorgji Rrungajën nga Zhuka, kanë një djalë e një vajzë: Oltin dhe Eneidën.

Mihal Jani Hudhra u martua me Alma Sotir Minon nga Pish-Porua, kanë një djalë e një vajzë: Kristianin dhe Tizjanën.

Kristaq Jani Hudhra u vra nga rrufeja, bashkë me një kushëri të tij, në datën 7.02.1983. Kushëriri ishte Piro Kozma Hudhra, 17-18 vjeç.

Vajzat e Jani M. Hudhrës:

Vasilika u martua me Thanas Gori Moçkën në Novoselë.

Stasinia u martua me Stefan Thanas Qorrin në Delisuf.

Vida u martua me Petraq Thanas Moçkën në Novoselë.

Liljana u martua me Fjodor Niko Gavanin në Babicë.

Merita u martua me Filip Garit Xamon në Novoselë.

Motrat e Mihal Kristo Hudhrës:

Ngjelina u martua me Tilo Belinën në Poro.

Sofia u martua në Novoselë me babanë e Pilo Priftit (Dëshmor i LANÇ-t nga Novosela).

KOZMA LLAZI HUDHRA

Të vjetër në Dëllënjë.

Llazi Koli Hudhra ishte martuar me Varvarën, me të cilën kanë lindur dy djem e 3 vajza: Kozman, Tasin, Marien, etj.

Maria u martua në Dëllënjë me Vllasi Lami Markun.

Kristina u martua në Dëllënjë me Nasi Xoxi Rrungajën.

Pulija u martua me Llaqi Loshin në Dëllënjë.

Kozma Llazi Hudhra u martua me Ariti Ndini Thomon nga Pish-Poro, kanë lënë 6 djem e 3 vajza: Thomain, Pirron, Pandeliun, Viktorin, Todin, Llambin, Vangjelinën, Lenin dhe Lefterinë.

Thoma Kozma Hudhra u martua me Kristina Jorgo Pagunin nga Livani i Delvinës, kanë dy djem e një vajzë: Kristaqin, Odisenë dhe Dhoksien. Aktualisht janë beqarë. Të gjithë kanë emigruar në Greqi.

Dhoksie Thoma K. Hudhra u martua me një sarandjot në Greqi.

Pandeli Kozma Hudhra u martua me Milika Filip Hilën nga Dëllënja, kanë dy vajza: Anicën dhe Paulën. Banojnë në Dëllënjë.

Anica Pandeli Hudhra u martua me Albert Gashin nga Kukësi dhe banojnë në Delisuf.

Pilua u vra nga rrufeja në vitin 1983, bashkë me një kushëri të tij, në moshën 22 vjeçare. I pamartuar.

Viktor Kozma Hudhra u martua me Drita Sotir Sallakun nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë: Pirron, Aleksin dhe Klaudian.

Todi Kozma Hudhra u martua me Irena Llazi Ferrën nga Topoja e Fierit. Kanë dy djem: Fabion dhe Denisin.

Llambi Kozma Hudhra u martua me Elona Ligor Panon Kola (Mitraj) nga Porua. Kanë dy djem: Fladion dhe Ervisin, aktualisht janë beqarë.

Vangjelina Kozma Hudhra u martua me Pandeli Qirjaq Plakun në Dëllënjë.

Leni Kozma Hudhra u martua me Ladi Kristaq Nakën nga Dëllënja, banojnë në Poro.

Lefteri Kozma Hudhra u martua me Niko Vangjel Miçin në Livan, Sarandë.

Tasi Llazi Hudhra u martua në Vlorë me Vitën dhe kanë 4 djem e dy vajza: Dhorin, Ilian, Aleksandrin, Gjergjin, Netën dhe Vefin.

Dhori Tasi Hudhra u martua me një vajzë nga Narta. Kanë emigruar në Greqi.

Ilia Tasi Hudhra u martua me Leni Hyson nga Novosela, kanë një djalë e një vajzë, kanë emigruar në Greqi.

Aleksandër Tas Hudhra u martua me një vajzë nga Kukësi, kanë një djalë e një vajzë.

Gjergji Tasi Hudhra u martua me një vajzë nga Alibani.

Neta Tasi Hudhra u martua në Vlorë.

Vefi Tasi Hudhra u martua me Milon nga Vlora.

Të gjithë kanë emigruar.

Shënim: Llazi Hudhra ishte kushëri i afërt me Mihal Hudhrën në Dëllënjë dhe kushëri i largët me Llazi Hudhrën, Vangjel Hudhrën e Ristan Hudhrën që ishin në Grykë. Tregon Pandeli Kozma Hudhra, Dëllënjë, 15.11.2009.

Edhe me Hudhrajt në Vlorë janë të një gjaku. Janë myzeqar të gjithë Hudhrajt, por kanë banuar edhe në Dukat për disa vjet. Kanë lëvizur ca andej e ca këtej.

ZOI TASI HYSO

Zoi Tasi Hyso është nga Hysot e Novoselës, dhe ka ardhur në Poro rreth vitit 1900. Pati një djalë: Taqo Hyson.

Taqo Hyso u martua me Margën e Ndino Qarrit nga Porua dhe lanë dy djem e 4 vajza: Miçon, Jorgjin, Ollgën, Dhoksien, Silën dhe Lizën.

Miço Taqo Hyso u martua me Milla Niso Mojallinë nga Porua dhe kanë një djalë e një vajzë: Arbenin, dhe Shpresën.

Jorgji Taqo Hyso u martua me Lola Troqen nga Tragjasi dhe kanë një djalë e një vajzë: Florianin dhe Adilen.

Ollga Taqo Hyso u martua me Jorgji Todi Vidhin në Vlorë.

Vasilika u martua me Pilo Leko Plakun në Poro.

Sila u martua me Sotir Naqo Gjonçarin në Poro.

Liza u martua me Niko Rucin nga Dhërmiu.

Shënim: Miço Hyso iku familjarisht nga Porua dhe u vendos në Akërni në vitin 1985. Aty mori edhe prindërit, por vetë nuk rrojti shumë. Vdiq i ri, me dy fëmijë, një djalë, Arbeni, dhe një vajzë.

Jorgji jeton në Vlorë familjarisht.

ELMAS INATI

Erdhi nga Boçova e Fierit. Ishte martuar me Salën. Kishte një vajzë e një djalë, Hashirenë dhe Malon.

Sala kish dhe 3 djem të tjerë me tjetër burrë, Sadushin, Safetin dhe Ismailin, po ata u rritën gjetkë dhe jetuan në Vlorë.

Edhe Elmazi iku familjarisht në Vlorë, rreth vitit 1950.

Haxhire E. Inati u martua në Kaninë herën e parë, por u divorcua shpejt. Pastaj u martua me Refat Çamin dhe lindën 3-4 djem.

Malo Elmaz Inati u martua me Klementina Grillon nga Vunoi dhe lindën një djalë e dy vajza, Mondin, Elcën dhe Idën. Jetojnë në Vlorë.

JANKAJT E POROS

Jankajt e Poros janë banorët më të hershëm, në mos të parët e fshatit.

Thonë se kanë ardhur nga Dukati dhe janë vendosur në stane, diku afër Pishës, dhe me shtëpi në afërsi të kishës së Shën Kollit.

Më i hershmi i Jankajve njihet ose mbahet mend Janko Leka, me dy vëllezërit e tij, Kosta dhe Thanas Leka.

Janko Leka la 3 djem: Qirjaqin, Gaqin, dhe Mitin.

Kosta nuk la fëmijë.

Thanasi la Gori Jankën.

Qirjaqi, i biri i Jankos, la Petron, Kostandinin dhe Lilon.

Këtu është kthyer edhe mbiemri nga Leka në Janko, për të kujtuar gjyshin e tyre, që ishte njeri i dëgjuar.

Nëna e Petros, e Lilos dhe e Kostandinit ishte bijë nga Ristajt. Ndoshta nga Ristajt e Zhukës se edhe ata janë banorë të atjeshëm dhe shumë të hershëm.

Petro Janka, i biri i Qirjaqit, la Taqon dhe Minon.

Lilua vdiq i pamartuar.

Kostandin Qirjaq Janka u martua me Djellën, e bija e Ndini Leshit, nga Porua, ka lënë 3 djem e 3 vajza: Trifonin, Lekon, Xhoxhin, Ritën, Gjenën dhe Ristanën.

Trifon Kostandin Janka, u martua me Marie Llazi Gjata nga Ferrasi, ka 4 djem e një vajzë: Genardin, Alfredin, Arbenin, Sokolin dhe Anilën.

Trifon K. Janka me Llazi Hajdinin

Genard Trifon Janka, u martua me Leonora Gjergji Bushon nga Pogradeci, kanë një djalë e një vajzë: Trifonin dhe Angjelën.

Alfred Trifon Janka është martuar me Anastasi Pali Deden, nga Shpati i Elbasanit, ka një djalë dhe një vajzë, Argjirin dhe Artenisën.

Arbeni vdiq aksidentalisht në Elbasan në moshën 17 vjeçare.

Sokol Trifon Janka u martua me Marjana Bahmanin nga Zvicra, kanë dy djem e një vajza: Martinin, Joelin, dhe Elisën. Jetojnë në Poro. Kanë ndërtuar një shtëpi të re, pas viteve 1997.

Anila Trifon Janka, u martua me Altin Ilia Veliaj nga Gjormi i Vlorës dhe jetojnë në Vlorë.

Leko Kostandin Janka u martua me Gjenovefa Thanas Qorrin nga Delisufi, kanë dy djem: Eduardin dhe Kostandinin.

- Eduard Leko Janka, u martua me Anila Themi Mbyetin nga Delisufi dhe kanë një djalë, Arqilen.

Xhoxhi Kostandin Janka, u martua me Rajmondën nga Beshishti, kanë një djalë e një vajzë: Ervinin dhe Entelën.

Entela Xhoxhi Janka, u martua me Arti Vasil Sikon në Poro.

LLAZI JANKA, PORO

Llazi Gaqo Janka është martuar me Marien nga Mbyeti i Fierit. Kanë lënë 4 djem e dy vajza: Mitin, Nison, Lipin, Trifonin, Uraninë dhe Vitoren.

Niso Llazi Janka vdiq i pamartuar. Ishte partizan. Në prag të Çlirimit u sëmur rëndë dhe vdiq. Nuk është shpallur dëshmor.

Miti Llazi Janka u martua me Ritën e Thanas Mitros nga Delisufi. Janë divorcuar, por kanë një djalë, Leonidha Kolën, banon në Delisuf. Ky është regjistruar Lonidha Kola, por në fakt është Lonidha Miti Janka.

Miti Janka, pasi u nda me Ritën, u martua me Ollgën, të bijën e Petro Kolës nga Porua dhe ka 3 djem e një vajzë: Viktorin, Llambin, Raqin dhe Sotirën.

Viktor Miti Janka, u martua me Drita Petro Kerrin nga Delisufi dhe kanë një djalë, Dhimitrin dhe një vajzë.

Llambi Miti Janka.

Raqi Miti Janka, u martua me Teutën nga Tirana dhe kanë një djalë e dy vajza: Renaton, Kriston dhe Oltën.

Lipi Llazi Janka është martuar me Margarita (Lola) Lili Milon nga Vlora dhe kanë dy djem e një vajzë: Albertin, Arjanin dhe Enerjetën.

Albert Lipi Janka, u martua dy herë. Gruaja e parë i vdiq dhe me të ka një djalë dhe një vajzë, Ronaldon dhe Matildën. Me gruan e dytë, Laureta Ndoni Kolën nga Porua, ka një djalë e një vajzë.

Trifon Llazi Janka

Arjan Lipi Janka u martua me Merita Llukë Hyson nga Novosela, ka një vajzë dhe një djalë, Armelën dhe Endritin.

Enerjeta Lipi Janko u martua me Albin Sejdiraj, me të ka një djalë, Albano Janka.

Trifon Llazi Janka, u martua me Hajdhica Jani Ruçin nga Dhërmiu, kanë një djalë e 3 vajza: Klementin, Mondën, Vasilikën, Lauretën.

Klement T. Janka, u martua me Alketa Lijo Kungullin nga Porua, kanë dy vajza, Kristinën dhe Eritën.

Vajzat e Llazi Jankës:

Urania u martua me Rrapi Kordhishtën nga Pish-Porua e Fierit dhe kanë 4 djem: Lefterin, Sotiraqin, Arqilen dhe Alfredin; banojnë në Vlorë.

Vitore Llazi Janka, u martua me Gavril Sheshin nga Gjirokastra, kanë tri vajza, banojnë në Tiranë.

Shënim: Në Vlorë ka të tjerë Janka dhe janë të një fisi, por pak të largët, ndërsa të tjerë me mbiemrin Janko nuk janë të një fisi. Disa emra, siç e konstatoni, nuk kemi pasur mundësi t'i saktësojmë. Jankajt e Poros janë pasardhës të Thanas Lekës. Që të dy, Thanasi dhe Jankua, ishin vëllezër me mbiemrin Leka. Më vonë njeri, Gori e pasardhësit e tij, shkuan në Vlorë dhe mbajnë mbiemrin Janka, kurse pasardhësit e Jankos mbetën në Poro, po me mbiemrin Janka.

Vajzat e Kostandin Jankës:
Gjena u martua me Koçi Uani Lepurin në Delisuf.
Rita u martua me Leko Çerkezin në Vlorë.
Tana u martua me Petro Veron në Babicë.

Shënim: Vetëm Rita ka vetëm një djalë, kurse Gjena dhe Tana, nga një tabor me fëmijë.

Thonë se Kostandin Janka ka pasur një motër të martuar në Zvërnec të Vlorës me Llukë Stefën. Ajo u vra nga ballistët në Pishë të Poros me gjithë djalin e saj të vogël, sepse i gjetën dokumente që transportonte për partizanët në Poro. Ajo grua quhej Ksandra Stefa.

Këtë histori e konfirmojnë Trifon K. Janka dhe Vangjel Stefa nga Zvërneci.

SOTIR MITI JANKA

Sotir Miti Janka u martua me Pulije Pali Dhanën nga Pish-Porua e Fierit dhe kanë 4 djem e 4 vajza: Pilon, Andrean, Thodhoriun, Llambin, Marien, Finen, Sofien dhe Vasilikën.

Pilo Sotir Janka, u martua me Dritën nga Babica.

Andrea Sotir Janka, u martua me një nga Çuka e Sarandës.

Llambi Sotir Janka u martua me vajzën e Peço Loshit dhe ka dy djem.

Marie Sotir Janka u martua me Thoma Kozma Çunin nga Dëllënja dhe kanë 7 fëmijë.

Fina Sotir Janka u martua me Prokop Andrea Davidhin nga Zhuka dhe kanë 7 femijë.

Sofie Sotir Janka u martua me Sotir Ristën në Novoselë.

Vasilika Sotir Janka u martua me Adhurim Dredhën nga Kanina dhe banojnë në Vlorë.

PETRO QIRJAQ JANKA

Petro Q. Janka u martua me Ristanën nga Nushjat e Mifolit. Kanë dy djem: Taqon dhe Minon. Petro Janka vdiq shpejt, djemtë i la të vegjël. Ristana u martua me Nasi Katron duke i marrë me vete edhe djemtë.

Taqo Petro Janka, në moshën 20 apo 22 vjeçare u vra rreth vitit 1940–1941 dhe nuk u mor vesh si u vra e ku u vra. Pra iku i pa u martuar e pa lënë fëmijë.

Mino Petro Janka u martua me Liri Marinin nga Frakulla, kanë lindur 4 djem e 3 vajza: Lolin, Peçin, Nestin, Ardianin, Donikën, Natashën dhe Verën.

Që nga viti 1950 deri 1966 Minua banoi familjarisht në Vlorë. Atje kishte edhe të ëmën. E ëma ka vdekur në Vlorë. Në vitin 1967 Minua erdhi familjarisht në Poro dhe atje mbylli dhe jetën.

Loli Mino Janka u martua me Dafina Llazi Garron nga Porua, kanë një djalë e një vajzë.

Peçi Mino Janka u martua me Zenepen nga Resulaj në Vlorë.

Nesti Mino Janka u martua me Elisabeta Niko Liçon nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë.

Ardian Mino Janka u martua me Shpresa Zoi Thomain nga Delisufi, aktualisht kanë një djalë.

Donika u martua në Mifol.

Natasha u martua me Risto Dhimën në Pojan.

Vera u martua në Zvëmec.

FISI I KATROVE

Në fshatin Poro të rrethit Vlorë, ka jetuar edhe fisi i katrove, janë të vjetër aty, që para vitit 1900. Më i madhi, apo më i vjetri që mbahet mend, ka qenë Miho Katro. Thonë se mund të jenë nga Gjirokastra.

Miho Katro ka qenë me shtëpi në vendin ku edhe sot quhet *Strone*. Nga vendasit ai vendi quhej *Sheqi i Miho Katros*, më në jug të fshatit, pranë *Fraksios e Pishës*.

Thonë se Miho Katro ka dy djem dhe një vajzë, Palin, Llukën dhe nënën e Tilo Belinës në Poro.

Pali katro la vetëm një djalë, Nasin. Nasi u rrit jetim, duket se prindërit i vdiqën të rinj dhe Nasin e mori për ta rritur Marko Moçka në Poro, meqenëse ai nuk kishte djalë, dhe e bëri si djalin e vetë, mbase dhe e birësoi. Nasi, kur u rrit, iku e doli nga shtëpia e Marko Moçkës dhe bëri shtëpinë e vetë në jug të fshatit, pranë Pishës, pranë Sopit të Shtëpive, ose Zonjallisë.

Nasi nuk pati fëmijë, edhe pse u martua dy herë, me Sofijen nga Alibani, motra e Nasho Malos, dhe me Ristanën nga Nushajt e Mifolit. Ristana solli me vete dy djem që i kishte me Petro Jankën nga Porua.

Llukë Katrua la Lenën dhe Janin.

Lena u martua dy herë. Me burrin e parë, Naun Subashi në Zvërnec, bëri dy vajza, Elpiniqin dhe Filen. Pas vdekjes së Naunit në moshë të re, Lena u martua me Lami Rrapin në Pishë Poro të Fierit. Dy vajzat e saj u rritën në Zvërnec dhe u martuan në Vlorë. Elpiniqi u martua me Sotir Kostandin Janko, kurse Filja u martua me Shaqo Gjondedën nga Tërbaçi.

Tek Lamo Rrapi në Pishë Poro, Lena gjeti një vajzë, Dafinën, e cila u martua me Nasi Jorgjin në Dëllënjë. Me Lamon, Lena bëri tre vajza e dy djem, Pulien, Athinanë, Stasën, Spiron dhe Stefanin.

Pulija u martua me Todi Lili Koçin në Dëllënjë. Athinaja u martua me Niko Gjonin në Dëllënjë. Stasa u martua me Pano Leshin në Mifol. Spirua dhe Stefani shkuan në fshatin Fitore, i afroi xhaxhai i tyre, Kristo Rrapi. Stefani u martua në Poro, me të bijën e Vangjel Moçkës.

Jani Llukë Katro u rrit 17–18 vjeç në Poro, jetoi me nënë plakë, Stasën. I ati i Janit, Lluka, vdiq i ri, dhe Jani, që i vogël, u aktivizua dhe shërbeu në kishën e Shënkollit në Poro, aty pranë, në jug të kishës, kishte shtëpinë. Jani mësoi disi mirë librat e kishës dhe i këndonte librat me zë të lartë e të mirë, gati përmendësh. Rreth moshës 20 vjeç, zuri punë si postier në Tiranë, me ndihmën e Miti Semës, xhaxhai i papa Lekos. Pas 2–3 vjetësh në Tiranë, Jani u sistemua me punë si postier, dhe shtëpi, në Vlorë. Rreth viteve 1943–1944 u martua me Gjena Trifon Shello (sahatçi nga lagja Çole). Janin e sistemoi në Vlorë Llaqi Miti Sema. Llaqi, ose Mihal Miti Sema, me Filip Gjergjin kishin një dyqan me pije alkoolike në Tiranë. Jani Katro në Tiranë, në fillim filloi punën si punëtor në dyqanin e pijeve, pastaj, me ndihmën e tyre dhe të papa Lekos, u punësua si postier në Tiranë dhe Vlorë.

Jani Llukë Katro

Në vitin 1943–1944, Jani u vesh prift, shkoi familjarisht në Zhukë dhe shërbeu si prift

në tre fshatra, Zhukë, Delisuf dhe Dëllënjë. Në Zhukë kishte një djalë të vogël, Xhoxhin (Jorgjin).

Gjena mori me vete në Zhukë, motrën e saj, Milika Shello, e cila vinte në shkollën e Zhukës.

Në vitin 1946–1947, papa Jani shkoi në Lushnje, bashkë me djalin e tij, Jorgjin. Ai punoi si prift në Lushnje deri në vitin 1967, kur u mbyllën kishat. Në Lushnje u lindën edhe Evrinomi, Vangjeli dhe Filipi.

Jorgji, kur u rrit, jetoi e punoi në Tiranë si mekanik. Ai ka lënë Endri Katro, mjek patolog; mund të ketë edhe fëmijë të tjerë.

Vangjel Jani Katro banon në Lushnje, është i martuar me Nesajete Spahiu, me të cilën ka një vajzë, Klorida, dentiste, e cila ka emigruar në Amerikë.

Filipi ka emigruar në Itali.

Evrinomi ka dy djem e një vajzë, banojnë në Vlorë.

Stefan Lami Rrapi (Djali i Lenës) ka marrë vajzën e Vangjel Moçkës nga Porua.

Spirua, djali i Lenës, e ka marrë nusen nga Lamajt në Ferras.

ELMAZ KARAFILI

Elmaz Karafili është nga Rodeshi i Skraparit. Erdhi në Poro i punësuar te agallarët e atyre viteve para 1932–1933. Njeri i vetëm, punoi si bekçi, roje të arave të fshatit dhe paguhej nga agai. Në Poro u martua dhe ndërtoi shtëpi. Nuk pati fëmijë me Sofien nga Malot e Alibanit, të cilën më parë e kishte Nasi Katrua. Jetoi në Poro deri në pleqëri të madhe. Vdiq në Poro rreth vitit 1970–1972.

Rreth vitit 1950 mori një djalë të rritur, edhe për punë si hyzmeqar por, pasi e pa që ishte njeri i mirë e i zoti, e birësoi me shpresë që të rrinte e t'i pleqëronte të dy, si Elmazin edhe Sofien. Dhe e birësoi, por për pak vite. Djali, Enver Dibra quhej, iku nga Elmazi dhe shkoi në Vlorë. Atje u martua e ndërtoi edhe shtëpi, lindi fëmijë dhe u shkëput plotësisht nga Elmazi e Sofia, të cilët nuk u larguan nga Porua.

Sofia kishte motër të shoqen e Leka Dumit nga Mifoli. Këto ishin motrat e Nasho Malos nga Alibani.

KITO KËRRI, GRYKË

Kito Kërri erdhi te Leksi Kërri 6 vjeç se e kishte kushëri të parë nga nëna, por nuk ishte Kërri. Aty, nga që u rritën bashkë, mori mbiemrin Kërri. Erdhi nga Mifoli dhe atje quhej Kito Marko Nako, pra ishte i biri i Marko Nakos nga Mifoli.

Kito Marko (Nako) Kërri u martua me Sofie Petro Priftin nga Alibeaj i Fierit, kanë dy djem dhe 3 vajza.

Tako Kito Kërri u martua me Liri Jani Toskën nga Pish-Porua, kanë 5 djem e 5 vajza: Petraqin, Dhimitraqin, Todin, Harrillën, Kiton, Evllon, Vangjelinën, Andonetën, Shpresën dhe Marikën.

Petraq Tako Kërri u martua me Liljana Tonçi Logarin nga Kryegjata e Fierit, kanë 3 djem: Fatjonin, Arjanin, Kristaqin. Aktualisht të gjithë janë beqarë.

Dhimitraq Tako Kërri u martua në Kallm të Fierit. Ka një djalë e 3 vajza: Nakon, Aldën, Elvirën dhe Selinën.

Todi Tako Kërri u martua me Bona Agim Telo Bullën nga Bishani, kanë dy djem e një vajzë: Françeskon, Pavllon dhe Sarën.

Harrilla Tako Kërri u martua me Beta Vangjel Dhanon në Pishë-Poro, kanë një vajzë.

Kito Tako Kërri u martua me Florida Kozma Leksin nga Pish-Porua, kanë një vajzë.

Vajzat e Tako Kërrit:

Evllo u martua me Janaq Nelo Priftin në Aliban.

Vangjelina u martua me Josif Llazi Dashin në Delisuf.

Andoneta u martua me Vangjel Ristën në Gredh, Fier.

Shpresa u martua me Aleksandër Vangjel Grekun në Aliban.

Marika u martua me Edi Fili Gjonçarin në Poro.

KOÇI KITO KËRRI

Koçi Kito Kërri u martua me Stasini Lili Koçin nga Dëllënja, kanë 4 djem e dy vajza: Nikon, Vasillaqin, Lefterin, Thanasin, Uraninë dhe Margaritën.

Niko Koçi Kërri u martua me Lidën (rritur te Jani Marku në Dëllënjë), kanë dy djem e një vajzë: Radianin, Aleksandrin dhe Briseldën.

Vasillaq Koçi Kërri u martua me Kladia Mino Nakën nga Delisufi, kanë dy djem: Enrikun dhe Danielin.

Lefter Koçi Kërri u martua me Eklida Selman Kokën nga Dukati, kanë një djalë e një vajzë: Denisin dhe Alesjan.

Thanas Koçi Kërri u martua me Bruna Sotir Nasi Minen nga Pishë-Porua, kanë një djalë e një vajzë: Thanasin dhe Martinën.

Vajzat e Koçi Kërrit:

Urania u martua me Themi Çukon në Ferras.

Margarita (Rita) u martua me Petraq Llazi Rrungajën, nga Dëllënja.

LEKSI KËRRI

(Të ardhur nga ana e Fierit)

Leksi Kërri ishte martuar me Marien e Tilo Hudhrës, motra e Llazi Hudhrës nga Gryka, dhe me të ka lindur Mitin, Zoicën, Janin, Andrean, Petron dhe Neftën.

Miti Leksi Kërri u martua me Marien nga Levani dhe kanë lindur 3 djem e 6 vajza: Kristaqin, Ligorin, Leonidhën, Vitoren, Nolën, Dhoksien, Sofien, Lenin dhe Lirën.

Kristaq Miti Kërri u martua me Jorgjie Vangjel Moçkën nga Porua, kanë dy djem e 3 vajza: Artanin, Mitin, Donën, Marinelën dhe Marjanën.

Ligor Miti Kërri u martua në Semani, Fier, kanë dy djem, jetojnë në Itali.

Leonidha Miti Kërri u martua me Mirelën nga Pusi i Mezinit në Vlorë.

Vajzat e Miti Kërrit:

Vitoria u martua në Grykë të Semanit, Fier.

Nola u martua në Topojë.

Dhoksia u martua në Sheq-Marinëz.

Sofia u martua në Aliban te Dokajt.

Leni u martua në Vlorë.

Lira u martua në Topojë, Fier.

Jani Leksi Kërri u martua me Kristulla Dhori Loshin nga Porua, kanë 4 djem e një vajzë: Raqin, Vasillaqin, Piron, Ilian dhe Liljanën.

Raqi Jani Kërri u martua me Lena Vangjel Vrushin nga Delisufi, kanë dy djem e dy vajza: Admirin, Klerjanin, Klodianën dhe Orkidën.

Vasillaq Jani Kërri u martua me Niqi Vasil Gegën nga Delisufi, kanë 3 djem: Aurelin, Emiljanon dhe Lidanin.

Piro Jani Kërri u martua me Donika Gori Lepurin nga Delisufi, kanë 3 vajza: Nedën, Janën, Kristinën.

Ilia Jani Kërri u martua me Drita Nasi Jorgjin nga Dëllënja, kanë 3 vajza: Isidën, Ornelën dhe një tjetër.

Liljana u martua me Vaso Naun Gjonçarin nga Delisufi, kanë një djalë e një vajzë: Oltin dhe Gertën.

Andrea Leksi Kërri u martua me Kristina Pali Lalën nga Mifoli, kanë 3 djem e dy vajza: Thanasin, Nikon, Tilin, Tulën dhe Luçianën.

Thanas Andrea Kërri u martua me Tasha Llaqi Loshin nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë: Elsonin, Aldon dhe Idën.

Niko A. Kërri u martua me Letën nga Fieri, kanë një djalë, Mirin. Nikua vdiq nga një sëmundje e keqe.

Tili A. Kërri u martua me Tefta Petro Lepurin nga Delisufi, kanë dy djem: Maldinin dhe Andrean.

Tula A. Kërri u martua te Gazhelajt në Orikum.

Luçiana u martua në Vlorë.

PETRO LEKSI KËRRI

Petro Leksi Kërri u martua me Vita Thanas Bushin nga Dëllënja, kanë 3 djem e 4 vajza: Minellën, Pandin, Arqilen, Ritën, Jorgjien, Dritën dhe Donikën.

Minella P. Kërri u martua me Luljetën nga Kërkova, kanë një djalë e një vajzë: Çanin dhe Sonilën.

Pandi P. Kërri u martua me Drita Tako Gegën nga Delisufi, kanë dy djem: Petraqi dhe

një tjetër.

Arqile P. Kërri martuar me një vajzë nga Panajaja, kanë një djalë e një vajzë, jetojnë në Itali.

Vajzat e Petro Kërrit:

Rita u martua në Kolonjë, Lushnjë.

Jorgjia u martua në Libofshë.

Drita u martua me Nipin e Miti Jankës në Poro.

Donika u martua me Mondi Koçi Lepurin në Poro.

Zoica, e bija e Leksi Kërrit, u martua me Vasil Thanon nga Vlora, jetuan në Poro dhe Vasili punoi në Kishën e Poros. Lindën fëmijë, por nuk u rrojtën. Të dy vdiqën në Poro, të moshuar.

Nefta Leksi Kërri u martua me Todi Spira Vrushin në Delisuf, kanë 3 djem e 3 vajza: Llazarin, Dhimitraqin, Piron, Lizën, Jorgjien dhe Dritën.

Vasil Thano (Patatja) kishte një vajzë me gruan e parë, Marinaqin. Ajo u martua në Vlorë me Petrit Daqen.

KRISTO KOLI KONDA, ZHUKË

Koli Konda ishte nga Voskopoja e Korçës, kishte ardhur me bagëti pranë fshatit Mojalli të Fierit, në anë të Lumit Seman, përballë Libofshës. Aty jetoi me shtëpi e me stanin e dhënëve. Ai la një djalë e një vajzë, Kriston dhe Kalien. Kalia u martua në Zhukë të Vlorës me Naun Trifonin dhe la Dhimitër Trifonin (ose Dhimitër Kalien). Dhimitri shkoi në Fier dhe ka lënë Kiço Trifonin, Gorin, Peçon, Todin dhe Sofijen.

Edhe Kristo Koli Konda shkoi në Zhukë e u martua me Sofien që ishte e motra e Llazi Zarikos nga Libofsha. Me Sofien bëri 4 djem e një vajzë: Nison, Kolin, Palin, Llambin (Lamon) dhe Marien. Maria u martua me Tefi Shyti n në Zhukë.

Niso Kristo Konda u martua me Vala Koli Moçka nga Novosela dhe la 3 djem: Kostandinin, Dhorin dhe Vangjelin, ata lindën në Zhukë dhe u bënë të tre oficerë. Niso Kristo Konda shkoi në shkollë në Janinë dhe mësoi për prift e u vesh prift në vitin 1935 e më pas shkoi familjarisht në Pish-Poro të Fierit; atje shërbeu në kishën e Shën Gjergjit deri sa vdiq.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, familja e tij u lidh me lëvizjen, djemtë shkuan partizanë dhe të tre u bënë oficerë.

Kostandin Niso Konda u martua me Vita Petro Petani nga Frakulla, kanë lënë 5 djem e 3 vajza: Vllasi, Leja, Minella, Artani, Alberti, Vera, Lika dhe Aristea.

Vangjel Niso Konda u martua me Gonin nga Berati, kanë 3 djem e 3 vajza: Mika, Aleksandri, Landi, Vefi, Lindita dhe Florika.

Dhori Niso Konda u martua me Naunka Hali Semën nga Pish-Porua, kanë dy djem. Të gjithë pasardhësit e Papa Nisos kanë banuar e banojnë në Tiranë.

Lamo Kristo Konda iku i vogël në Vlorë. Pas Çlirimit shkoi në Tiranë dhe u bë mekanik, u martua me Vitën nga Tirana, kanë 4 djem e dy vajza: Petraqin, Xhulin, Sofikën, Petritin (Peti), Pandin, Astritin.

KOLI KRISTO KONDA

Koli K. Konda u martua me Kalie Laskën nga Mifoli, kanë lënë dy djem e 6 vajza: Sotirin, Vasilin, Naqen, Llambrininë, Melpon, Zoicën dhe Uraninë.

Kol Konda dhe e shoqja, Kalija

Vasil Konda

Sotir Koli Konda u martua me Kasjani Llazi Dëmën nga Bunavia e Vlorës, kanë dy djem e 5 vajza: Arqilen, Julin, Verën, Almën, etj.

Arqile Sotir Konda u martua me Burbuqe Boci nga Bolena dhe ka lënë dy djem e një vajzë, Aureli, Andi dhe Ida.

Vasil Koli Konda u martua me Liri Rasho Benin, kanë 3 djem e 3 vajza: Mondin, Valterin, etj.

Mondi Vasil Konda u martua me një vajzë nga Bishani, ka 3 djem.

Valter Vasil Konda u martua me Keli Nushi, nga Mifoli, kanë një djalë.

Djemtë e Kol Kondës shkuan me punë në fermën e Akërnisë, aty morën edhe prindërit

dhe gjithë të tjerët. Pleqtë vdiqën në Akërni. Fëmijët e Kolit janë në Akërni.

PALI KRISTO KONDA

Pali Konda ka jetuar në Zhukë deri në vitin 1956 e më pas shkoi në Vlorë familjarisht. Në Vlorë janë fëmijët, nipër e mbesa.

Pal Konda dhe e shoqja, Ana

Vasil Konda

Sokrat, Janaq dhe Lefter Konda

Pali Kristo Konda u martua me Ana Piro Rredhin nga Mifoli, kanë 6 djem e dy vajza: Sokratin, Lefterin, Janaqin, Piron, Manthon, Thanasin, Leonorën dhe Dritën.

Sokrat Pali Konda u martua me Leni Kiço Lati nga Dhërmiu i Vlorës, kanë dy djem: Gjergjin dhe Nikon.

Gjergji Sokrat Konda u martua.

Niko Sokrat Konda u martua me një vajzë nga Gjirokastra, kanë një djalë e një vajzë.

Lefter Pali Konda u martua me Liza Ciko Taton nga Himara, kanë dy djem e një vajzë: Julin, Ervinin dhe Anën.

Juli Lefter Konda u martua me një vajzë nga Gjirokastra, kanë dy djem.

Ervin Lefter Konda u martua me një greke, ka një djalë.

Janaq Pali Konda u martua me Oli Pali Gjonçën nga Frakulla, kanë një djalë e dy vajza: Ilirin, Sonilën dhe Enkelejdën.

Piro Pali Konda u martua me Zana Hamdi Liçajn nga Vlora, kanë dy djem e një vajzë: Endritin, Harallambin dhe Valbonën.

Mantho Pali Konda u martua me Tatjana Shefqetin nga Selenica, kanë dy vajza: Linën dhe një tjetër.

Thanas Pali Konda u martua me Etleva Mihal Niçkën nga Përmeti, kanë një djalë e një vajzë: Pavllon dhe Enxhën.

Vajzat e Pal Kondës:

Leonora u martua me djalin e Llaq Nushit nga Mifoli.

Drita u martua me Piro Gori Leshin nga Mifoli, Vlorë.

LAMO KRISTO KONDA

Lamo K. Konda u martua me Vitën nga Skela e Vlorës, kanë 3 djem: Petritin, Astritin dhe Pandin.



Niso Konda, në seminarin e Janinës para se të vishej prift

Pandi Lamo Konda u martua me gruan e parë nga Tirana, kanë 3 djem. Me gruan e dytë nga Puka ka dy djem e një vajzë.

Petrit Lamo Konda u martua me Vali Markon nga Roskoveci, kanë dy djem: Artin dhe Gentin.

Arti Petrit Konda u martua me një angleze, kanë një djalë.

Genti aktualisht është beqar.

Astrit Lamo Konda u martua me një vajzë nga Tirana, kanë një vajzë.

Dy vajzat e Lamo Kondës, Xhuli dhe Sofika, janë martuar në Tiranë.

HEROI I SHTANGËS
ALEKSANDËR VANGJEL KONDA

Aleksandri u lind në Fier më 21 prill 1960. Me mbarimin e shkollës 8-vjeçare u fut në punë dhe më shumë iu kushtua sportit të peshëngritjes.



Aleksandër Vangjel Konda

Në moshën 17 vjeçare arrin të fitojë normat dhe të thyejë rekorde në peshëngritje. Në moshën 18-vjeçare, me një peshë trupore 67.5 kg, shpallet Kampion i të Rinjve për vitin 1978.

Në vitin 1981, Aleksandri e përmirësoi rekordin në stilin e shkëputjes, nga 127.5 kg në 135.5 kg.

Në vitin 1982 konkurroi në peshën trupore 82.5 kg dhe, nga rezultatet që arriti, u bë Kampion i padiskutueshëm i kësaj peshe. Në mars të vitit 1983 ... ai theu rekordin e deriatëhershëm, në stilin e shtytjes, nga 163 kg në 180 kg.

Në maj të vitit 1983, në takimin Ndërkombëtar në Turqi, Sandri zuri vendin e parë, duke përmirësuar rekordin kombëtar dhe duke manifestuar një përgatitje të lartë fizike dhe teknike.

Në mars 1984, në Kupën e Republikës, konkurroi në peshën 90 kg, duke arritur të ngrejë peshën 200 kg në stilin e shtytjes; pesha e parë e ngritur në këtë masë në historinë e peshëngritjes shqiptare.

Në Kampionatin Evropian në vitin 1985, zhvilluar në Varshavë të Polonisë, arriti të ngrejë në stërvitje në stilin e shtytjes peshën 210 kg.

Më 1 maj 1987 pëson një aksident rrugor me pasojë vdekjen në moshën 27 vjeçare. Aksidenti është version zyrtar i policisë amerikane. Varrimi i bëhet në Nju Jork të SHBA nga më shumë se 300 shqiptarë.

Më 25 shkurt të vitit 2005, babai i Aleksandrit, pas shumë e shumë përpjekjesh, mundimesh e shpenzimesh, i solli eshtrat e Sandrit dhe, në datën 26 shkurt 2005, bëhet ceremonia e rivarrimit të peshëngritësit të madh në varrezat e Sharrës në Tiranë pranë varrit të nënës së tij të nderuar, Antigoni Konda. Me këtë rast Federata e Peshëngritjes Shqiptare i jep titullin "Simbol i peshëngritjes Shqiptare", ndërsa Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve i akordoi Medaljen e Artë për merita në fushën e Sportit, me motivacionin: "Për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe përhapjen e sportit të peshëngritjes si dhe rezultatet e larta të arritura në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare".

Qofsh i paharruar o Sandër!

Shënim: Marrë nga libri i Shpëtim Camit me titull "Heroi i Shtangës", Tiranë, prill 2007.

JOTI KOLA (DASHI)

Joti Kola ka ardhur prapa nënës së vetë te Kola dhe mori mbiemrin Kola, por në fakt është nga fisi i Dashajve, se atje ka qenë e martuar e ëma. Dy vëllezërit e tjerë, Pali dhe Uani kanë mbiemrin Kola.

Joti Kola (Dashi) kishte dy djem e dy vajza: Dhorin, Miçon, Sullën dhe Janën.

Dhori Joti Kola u mbyt aksidentalisht në lumin e Vjosës, i pamartuar.

Sulla u martua në Vlorë me Niko Simon Gegën nga Gryka.

Jana u martua me Jani Lami Markun në Dëllënjë.

Miço Joti Kola (Dashi) u martua herën e parë në Dëllënjë, me Ristanën e Tonçi Kolës nga Porua, por shpejt u ndanë, ajo iku shtatzënë dhe lindi një djalë. Djalin e ka marrë Mihal Lepuri në Poro, e ka birësuar me dokumente të rregullta dhe quhet Vasil Mihal Lepuri. Ai është i biri i Miço J. Kolës nga Porua. (I thërrasin Nonda Lepuri).

Miço J. Kola, pasi u nda me Ristanën, shkoi në Dukat, u martua atje me Lena Konomin dhe kanë dy djem e dy vajza: Jakon, Armandon, Liljanën dhe Marien.

UAN KOLA

Uan Kola ishte vëlla me Pali Kolën dhe Joti Kolën. Me Jotin ishte vëlla me një nënë, kurse me Palin ishte vëlla me nënë e babë (Kola).

Pali dhe Uani kanë mbiemrin Kola, sepse janë djemtë e Kristo Kolës nga Porua.

Uan Kola ishte martuar me Dafinën më të cilën ka një djalë e një vajzë, sepse vdiq i ri.

Kur vdiq Uani, e shoqja, Dafina, mori të dy fëmijët, Lijo Kolën dhe Nijen, e u martua me një burrë në fshatin Marinëz. Atje nuk lindi fëmijë, por rriti e martoi djalin e saj Lijon dhe vajzën e saj Nijen.

Vajza u martua në Hamallaj, edhe Liua u martua dhe ka 5–6 fëmijë, djem e vajza. Pas vitit 1992 emigroi me fëmijët në Greqi dhe vdiq në Lucaj të Athinës.

PALI KOLA

Pali Kola u martua me Lenën, të bijën e Kozma Loshit nga Porua. U lindën 4 djem e 3 vajza: Fani, Petrua, Todi, Vllasi, Kalie, Sija, dhe Kristina.

Fani Pali Kola u martua me Goni Stavre Lepurin nga Novosela, kanë 3 vajza e një djalë: Marjanën, Vasilikën Lenën dhe Leonardin.

Fani Pali Kola

Marjana u martua me Mustafa Sulo Mustafajn nga Mazhari, banojnë në Vlorë.

Vasilika u martua me Ylli Rahmi Mborjen në Vlorë.

Lena u martua me Ilia Tasi Mustaqin nga Cerkovina.

Leonard Fani Kola u martua dhe ka një djalë e një vajzë: Liton dhe Anastasien.

Petro Pali Kola u martua me Nastasia Sokrat Taton nga Himara, kanë 3 vajza e një djalë: Teutën, Linditën, Mimozën dhe Mikelin.

Teuta u martua me Llambi Petanin nga Vlora.

Lindita u martua në Vlorë me Ardi Llazi Karafilin nga Berati.

Mikel P. Kola u martua dhe ka një djalë e një vajzë.

Moza aktualisht është beqare.

Todi Pali Kola u martua me Arsino Kozma Xhahon nga Fieri, dhe kanë një djalë, Pavlin e një vajzë.

Pavli Todi Kola u martua me Vjollca Sotir Hoxharën nga Mifoli, ka një djalë e një vajzë: Pavjolin dhe Andrën.

VLLAS PALI KOLA

Vllas Pali Kola u martua me Fanien e Vasil Blecës nga Porua (grek i ardhur në Poro në vitin 1944 nga Lufta e Dytë Botërore. Disa u kthyen prapë në vendin e tyre, ndërsa dy familje nuk ikën, Nikolla Thano dhe Vasil Bleca). Nga martesa e Vllasit me Fanien e Vasil Blecës u lindën dy djem e dy vajza dhe kanë jetuar në Vlorë. Në vitin 1992 kanë emigruar familjarisht në Greqi.

Vllasi me Fanien kanë vdekur e kanë lënë Leonardin Bledin, Almën, dhe Mirelën.

Leonard Vllas Kola është martuar me Silvana Belerin dhe kanë dy vajza.

Edhe Bledi është martuar. Një vajzë e Vllasit u martua, ndërsa një tjetër jo.

Të gjithë kanë emigruar në Greqi.

IRAKLI KOLONJARI

Irakli Kolonjari është nga Kolonja e Lushnjës, erdhi i pa martuar. Erdhi në Poro dhe u martua me Katerinën, e cila ishte grua e ve se i kishte vdekur i shoqi, Tonçi Kola. Ajo kishte një djalë dhe 3 vajza me Tonçin: Janin, Ristanën, Lefterinë dhe Dafinën.

Me Lakon lindi edhe një djalë e një vajzë: Nikon e Margaritën.

Jani Tonçi Kola u martua me Fanien nga Gjirokastra dhe kanë 4 djem e 4 vajza. Ishte punëtor te Moçkallarët në Novoselë, dhe aty qëndruan familjarisht ku kanë rritur edhe fëmijët. Ai ka Anestin, Pilon, Bertin, Ladin, Almën, Milikën, Kristinën dhe Aurorën.

Margarita Lako Kolonjari u martua me Toli Gjergji Mbyetin në Delisuf dhe ka një djalë e një vajzë: Nikon dhe Margaritën.

Katerina ishte bija e Lami Markut nga Dëllënja, e cila u martua në fillim me Tonçi Kolën dhe pastaj me Lako Kolonjarin nga Kolonja e Lushnjës.

NIKO LAKO KOLONJARI

Niko Kolonjari u martua me Liri Lijo Marinën nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Bledarin, Klodetën dhe Jerinën. Aktualisht të tre janë beqarë.

(Tregoi Niko Kolonjari 40 vjeç).

PETRO KOLA, GRYKË

Petro Kola ka punuar te Dashajt e pastaj te Kërrajt e Grykës. Ishte djalë i edukuar dhe Llambro Rredhi e mori dhëndër brenda, e martoi me vajzën e tij, Margën. Petrua me Margën lindën 4 fëmijë: Thoman, Filipin, Linën dhe Marien.

Pas ca kohë Petrua me Margën u ndanë. Marga mori dy djemtë e s'u martua më, ndërtoi shtëpi më vete dhe rriti djemtë e saj. Vajzat i kishte të martuara.

Petrua mori grua tjetër, Aretinë e Thanas Mitros nga Delisufi. Kjo solli dy djem të vegjël, që i kishte lindur me burrë tjetër. Solli Leonidhën që e kishte me Miti Llazi Jankën dhe Kozman që e kishte me Thoma Palin. Vajzat e Petros që i kishte me Margën, njërën e mori Andrea Zoi në Frakull dhe ajo ka lindur 7 djem, ndërsa Marien e mori Kozma Uan Prifti në Poro, dhe kjo ka lindur 5 djem e dy vajza.

Thoma Petro Kola u martua me Leta Gjergji Mbyetin nga Delisufi, kanë 3 djem e dy vajza: Florianin, Valterin, Endrin, Lumturinë dhe Almën.

Florian Th. Kola u martua me Denisa Sotiraq Hudhrën nga Daullasi, s'kanë fëmijë.

Valter Th. Kola u martua me Jonida Koroveshin nga Petova e Fierit.

Endri aktualisht është beqar.

Alma u martua me Adrian Thoma Shytin në Pish-Poro.

Lumturia u martua në Berat me Lenc Sokolin.

Fili Petro Kola u martua me Elide Llaqi Sojën nga Daullasi, aktualisht nuk ka fëmijë.

Petro Kola me Ritën lindën edhe dy fëmijë: Raqin dhe Natashën.

Sotiraq Petro Kola është martuar me Maron nga Alikoka e Babicës, kanë 3 vajza: Gertën, Kristinën, Vasullën. Jetojnë në Greqi familjarisht.

Natasha Petro Kola u martua me Thoma Thanas Vrushin në Delisuf, kanë dy djem: Gramozin dhe Adriatikun.

Leonidha (Miti Janka) Petro Kola u martua me Gjenovefa Jorgji Kungullin (Tika) nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Majolin, Borin dhe Nelën.

Kozma (Th. Pali) Petro Kola u martua me Lumturi Trifon Turtullin nga Shtyllasi i Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Aleksandrin dhe Aretinë.

PETRO KOZMA KOLA (LALA)

Kozma Kola ishte nga Jagodina e Fierit, i thoshin edhe Kozma Lala, për ta dalluar nga Kolajt e tjerë në Poro, me të cilët nuk kishte të bënte.

Petro K. Kola u martua me Sofien e Lili Priftit nga Porua, kanë lindur 3 djem e 4 vajza: Andonin, Kozman, Thoman, Ollgën, Valentinën, Letën dhe Lefterinë.

Ollga u martua me Miti Llazi Jankën në Poro.

Andon Petro Kola u martua me Liri Vasil Loshin nga Porua dhe kanë lindur 3 djem e 4 vajza: Agronin, Gencin, Petron, Donikën, Mozën, Lauretën dhe Anetën.

Agron Ndoni Kola u martua me Arta Thoma Imbështarin nga Sheqishtja, dhe kanë dy djem: Enean dhe Valentinon.

Genci Andon Kola u martua me një italiane me emrin Patricia, kanë dy vajza.

Petro Andon Kola aktualisht është beqar.

Donika u martua me Ligor Pano Kolën në Poro.

Moza u martua me Arqile Dumin në Sheq-Marinës.

Laureta martuar me Berti Lipi Jankën në Poro.

Aneta aktualisht është beqare.

Kozma Petro Kola u martua me Vasilika Çaush Çelën në Poro, kanë një djalë e dy vajza: Astritin, Silvanën dhe Linditën.

Astrit Kozma Kola u martua me Rovena Koçi Th. Jorgjin nga Dëllënja, kanë një djalë.

Silvana u martua dhe u divorcua.

Thoma Kola dhe Lefi Prifti

Thoma Kola

Lindita u martua në një fshat të Fierit.

Thoma Petro Kola u martua me Suzana Guri Arapin nga Vlora, kanë 3 vajza: Danielën, Senadën dhe Klean. Thomai banon në Vlorë, që nga viti 1975.

Kozma Kola (i vjetër) la 4 djem, Trushin, Tonçin, Petron dhe Naunin. Nauni vdiq i ri.

TRUSHI KOLA

Trushi Kozma Kola u martua dhe ka dy djem: Stavren dhe Vasilin.

Stavre Trushi Kola u martua me Marie Naun Thanasi nga Dëllënja, dhe kanë 8 fëmijë.

Harrilla Stavre Kola u martua me Albana Vllasi Kosta nga Pish-Porua, kanë një djalë e një vajzë, Aleksandrin dhe Fraklinën.

Ilir Stavre Kola u martua me Eltiona Llazar Priftin nga Marinëza e Fierit.

Bledar Stavre Kola u martua me Denada Dhimitraq Todi Koten Dëllënjë, kanë një vajzë, Stelën.

Vasil Trushi Kola u martua me Saveta Luç Naçin nga Zhuka.

Kozma Kola (nuk ka të bëjnë me Kolajt e tjerë, janë tjetër fis). Ai ka ardhur shpejt në Poro. Ka lënë 4 djem: Naunin, Trushin, Tonçin, Petron.

Nauni vdiq i ri.

Trushi la dy djem: Stavren dhe Vasilin.

Tonçi la një djalë e 3 vajza: Janin, Ristanën, Dafinën dhe Lefterinë. (Tonçi kishte Katerina Lami Markun).

Vajzat e Tonçi Kolës:

Ristana u martua herën e parë me Miçon e Jot Kolës nga Porua (tjetër fis Dashi), por iku shtatzënë dhe lindi një djalë që e ka marrë Mihal Lepuri. E ka birësuar. U martua me Vangjel Gjonçarin dhe lindi 4 djem e dy vajzë: Alfredin, Llaqin, Jorgaqin, Rajmondën, Vasilikën. Ristana vdiq e re.

Lefteria u martua me Miti Gjokën në Pish Poro.

Dafina u martua me Vasillaq Thoma Mërtirin në Poro.

Katerina pasi i vdiq Tonçi, me të cilin kishte 4 femijë, u martua prapë me Lako Kolonjarin me të cilin bëri dy fëmijë, Nikon dhe Margaritën.

Lakua ishte pa grua. Edhe me Lakon lindi një djalë e një vajzë: Nikon dhe Margaritën.

Djali i Tonçit shkoi punëtor në Novoselë dhe u martua me një vajzë nga Gjirokastra.

PETRO KOSTË MIHO, DELISUF

Kosta Mihua la tre djem me gruan e parë, Petron, Vasilin dhe një tjetër që vdiq fare i vogël. S'kishte njeri që të kujdesej për të.

Kosta u detyrua të marrë një grua tjetër me dy vajza të vogla. Ajo ishte Djella e Rrapo Kolës me dy vajzat e saj, Sofijen dhe Konxhen.

Vajzat e Rrapo Kolës u rritën te Kostë Mihua, i cili i martoi ato në Poro. Një e mori Nasi Hajdini, Sofien, ndërsa Konxhen e mori Taqi Bërdalli.

Petro Kostë Mihua dhe Vasil Kostë Mihua janë djemtë e Kostë Mihos, i cili kish ardhur në Zhukë që nga Fieri. Origjina më e vjetër e Kostë Mihos thoshin se ishte nga Selaniku, ardhur në Korçë.

Që nga Korça vajtën ca kohë në Durrës dhe atje kanë mbetur nga ky fis me mbiemrin Miho. Nga Durrësi Kosta iku në Berat dhe nga Berati në Fieri e, në fund, u vendos e mbeti në Delisuf. Arsyeja pse ka lëvizur kaq shumë nuk dihet me saktësi, por duhet të kenë qenë vetëm arsye ekonomike, sepse temperamenti i të gjithë pasardhësve të Kostë Mihos janë njerëz të butë e punëtorë. Fisi i tyre është shtuar goxha, kanë lindur djem e vajza të cilët kanë bërë djem e vajza të shëndetshme.

Petro Kostë Mihua ishte martuar me Janën, motrën e Kostandin Markut nga Zhuka dhe bashkë kanë lindur 3 djem e dy vajza: Miçon, Takon, Lamon, Finën dhe Kalien.

Petro e Vasil Kosta, thonë se ka pasur një motër dhe ajo ishte martuar në Daullas të Fierit dhe atje bëri 4 djem: Kili Daullen, Thoma (Majin) Daullen, Luçin dhe Nasi Daullen.

Nasi Daullja, kur u rrit, shkoi në Vlorë dhe u martua me të motrën e të shoqes së Gori Thanos nga Porua e me të lindi 4 djem e një vajzë. Ata ishin: Lipi, Vllasi, Dhimitraqi, Pirua dhe Ola.

Petro Kosta e kishte si nip Nasi Daullen dhe mbanin miqësi të vazhdueshme. Po kështu edhe me Gori Thanon, Nasi mbante miqësi të rregullt deri vonë. Edhe djemtë e tyre vazhdojnë edhe sot miqësinë. Janë kushërinj, nënat motra. Naunka Daullja dhe Konxhe Thano ishin bijat e Koçi Hyso nga Novosela.

Miço Kosta (Miho) u martua në Delisuf.

Miço P. Kosta u martua dy herë. Gruaja e parë ishte e bija e Themi Nakës nga Delisufi, por ajo nuk jetoi, vdiq në vitin e parë të martesës. Miçua mori (pas Sofijes së Themi Nakës) Athinanë, bijën e Vasil Priftit nga Novosela dhe me të lindi 7 djem e dy vajza: Kostandinin, Janin, Vasillaqin, Nikon, Thoman, (Tomin), Trifonin, Palushin, Marigon dhe Marinaqin.

Kostandini vdiq fare i vogël. Jani vdiq afërsisht 16 vjeçar, u vra aksidentalisht nga një moshatar i tij me shkop, në grindje fëmijësh.

Tomi u vra edhe ky aksidentalisht me një predhë murtaje që e gjeti në kullotë të bagëtive nga Kallënga ku ushtria kish bërë qitje. Ajo i plasi në dorë dhe e bëri copa-copa....

Edhe një vajzë, Marigoja, ka vdekur e vogël fare.

Të tjerët u rritën dhe u martuan e u shtuan si më poshtë:

Vasillaq Miço Kosta (Miho) u martua me Dhorën, e bija e Llazi Panos (Llazi Plaku) nga Delisufi. U morën me dashuri, u rrëmbyen) dhe shkuan në Fier te xhaxhai, Tako Kosta. Atje nusen e la disa ditë dhe Takua e nxori nuse, më pas, erdhën në shtëpinë e tyre në Delisuf. Të dy bashkë lindën 3 djem e 3 vajza dhe i rritën me shumë mundime e fukarallëk. Për fatin e tij të keq, Vasillaqi vdiq i ri dhe Dhora, me shumë përpjekje i rriti të gjithë fëmijët e, kur shumë bashkëfshatarë ikën për në Itali ilegalisht dhe legalisht, ikën edhe këta që të

gjithë për në Itali dhe atje u rregulluan me punë e shtëpi. U martuan që të gjithë me djem e vajza shqiptare, konkretisht:

Vasillaq Miço Kosta me të shoqen, Dhorën

Jovan Vasillaq Kosta (Miho) u martua me Monika Niko Kolën (Mitraj) nga Porua, kanë një djalë e një vajzë.

Vilson Vasillaq Kosta u martua me Marcela Llazar Lili Koçin nga Dëllënja, ka një fëmijë.

Florenc V. Kosta u martua me Sidorela Sotir N. Gjonçarin nga Delisufi, aktualisht nuk ka fëmijë.

Djana V. Kosta u martua me Filip Kozma Hajdinin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Orsenin dhe Renatën.

Esmeralda Vasillaq Kosta (Miho) u martua me Koçi Nasi Rrungajën nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë.

Albana Vasillaq Kosta (Miho) u martua me Niko Loshin nga Porua, kanë dy vajza.

Shënim: Nga të gjithë djemtë e Petro Kostës, disa mbajnë mbiemrin Kosta e disa Miho, prandaj këtu në këtë fletore mund të ketë gabime në mbiemra për secilin. Korrigjimet le t'i bëjnë vetë, siç i kanë dokumentet personale sepse unë nuk i kam marrë në bazë të dokumenteve të secilit, por i kam shkruar ashtu siç më kanë treguar.

Niko Miço Kosta (Miho) u martua me Olimbi Miti Kolën nga Vlora. Kanë lindur 3 djem e dy vajza: Klementin, Eritonin, Edmondin, Mirjetën, Suzanën.

Niko Miço Kosta

Të gjithë fëmijët e Nikos janë të emigruar.

Klement N. Miho u martua me Enerjetën e Pëllumb Labaj nga Vajza e Vlorës dhe ka një djalë e një vajzë.

Elton N. Kosta u martua e Erjona Kujtim Sadikun nga Lubonja, Armeni dhe ka një djalë, Alerion.

Suzana N. Miho u martua me Niko Yzeirin nga Ploça.

Të tjerët aktualisht janë beqarë.

Trifon Miço Kosta u martua me Liri Ndini Zhazhanin nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë: Neritanin, Julianin dhe Ildën.

Neritan Trifon Kosta (Miho) u martua me një italiane.

Juliani aktualisht është beqar.

Ilda T. Kosta u martua me Fatjon Feruzajn nga Vermiku, Vlorë.

Palush Miço Kosta (Miho) u martua 4 herë. Me gruan e parë ka një vajzë, me të dytën dhe të tretën nuk ka pasur fëmijë, me gruan e katërt, nga Daullasi, ka një djalë, Aldin.

Marigoja e Miço Kostës vdiq 8 vjeçe.

Marinaqi e Miço Kostës është martuar me Mihal Petro Lepuri në Novoselë, kanë një djalë e dy vajza.

Edhe Blerta Palush Miho, që e ka me gruan e parë, është martuar me Tomi Luçin në Marinëz të Fierit, në vitin 2008.

TAKO PETRO KOSTA

Tako Petro Kosta u martua me Kristina Dhimitër Simonin nga Gryka, kanë dy djem e një vajzë: Spiron, Vllasin dhe Jorgjien.

Takua, Thanasi, Lamua dhe Llazi me Raqin

Spiro Tako Kosta u martua me Elvira Todi Çalën nga Fieri dhe kanë një djalë e një vajzë: Altinin dhe Alketën.

Vllasi Tako Kosta u martua me Lefteri Jorgji Marinin nga Libofsha, kanë dy djem e një vajzë: Sokolin, Malvithin dhe Matildën.

Jorgjie Tako Kosta u martua me Rrapi Loni Mërtirin, kanë 3 djem: Ervinin, Dritanin dhe Ilirin.

Takua ishte partizan, u martua pas Çlirimit, punoi në Fier oficer dhe në Azotik. Në Fier banojnë djemtë e tij. Takua vdiq rreth vitit 2000. Kristina jeton akoma (2009).

LAMO PETRO KOSTA (MIHO)

Ishte i martuar me Lena Ndini Kondin nga Ferrasi dhe kanë 3 djem e dy vajza: Ligorin, Viktorin, Kristaqin, Vangjelinën dhe Liljanën.

Lamo Kosta

Ligor Lamo Kosta (Miho) u martua me Rajmonda Jani Moçkën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Erinin dhe Ericën.

Viktor Lamo Kosta u martua me Ermirën nga Daullasi, kanë dy djem e një vajzë: Erikun, Emiljanon dhe Florianën.

Kristaq Lamo Kosta u martua me Valbona Llazi Dashin, kanë një djalë e një vajzë. Kristaqi vdiq i ri në Itali, fëmijët janë me nënën në Itali.

VASIL KOSTA MIHO

Ishte vëlla me Petro Kostën. Kish marrë për grua të parë Janën, të bijën e Tasi Qorrit nga Delisufi. Ajo vdiq e re dhe nuk la fëmijë.

Nasi Vasil Kosta me gruan e tij, Maria

Vasil Kosta mori për grua të dytë Senën nga Daullasi, i Fierit dhe la vetëm një djalë, Nasin.

Nasi Vasil Kosta u martua me Marie Kili Dokon nga Pish-Porua e Fierit dhe lindi një djalë e dy vajza: Kostandinin, (Koçin) Sofikën dhe Donikën.

Koçi Nasi Kosta u martua me Lida Vasil Janon me origjinë nga Berati por jetojnë e banojnë në Fier. Ka dy djem: Manjolin dhe Anestin.

Manjol Kostandin Kosta u martua me Blerinën në vitin 2008. U detyruan të martohen para vdekjes së Lidës, e cila nuk vonoi e vdiq e re. Edhe nëna e Koçit, d.m.th., gjyshja e Manjolit, u sëmurë rëndë. Nasi kish vdekur që në vitin 2005.

Koçi e martoi djalin, Manjolin.

Djali tjetër i Koçi Kostës, Anesti, aktualisht është beqar. Banojnë në Fier, që nga viti 1950.

Vajzat e Petro Kostës:

Fina u martua me Trifon Kolën në Poro.

Kalia u martua me Gori Rrapin në Pish-Poro dhe ka 4 djem: Janin, Thoman, Vasillaqin dhe Arqilen.

LLAZI KOVE TIKA, DELISUF

Duhet të jenë vllahë me origjinë, por nuk e dimë se nga kanë ardhur.

Kove Tika ishte martuar me Vara Loni Sharrën nga Baltëza e Fierit, kanë Llazin, Tanën, Likën, dhe Nijen.

Llazi Kove Tika u martua me Vasilika Lapi Qarrin nga Mifoli, kanë lindur 8 fëmijë: Mitin, Panon, Lilin, Marien, Dafinën, Gjenën, Kristinën dhe Margën.

Miti Llazi Kove u martua me një nga Selenica, por u ndanë shpejt, pa fëmijë. Edhe me gruan e dytë, nga Frakulla, nuk lindi fëmijë. Edhe ajo iku shpejt. Miti mbeti pa fëmijë. U plak e vdiq në Delisuf.

Pano Llazi Kove u martua me Marie Ndoni Rozen në Varosh, Gjirokastër, kanë dy djem e 5 vajza: Antigonin, Vangjelinën, Kostandinën, Vasilikën, Lirinë, Todin dhe Petraqin.

Todi Pano Kove u martua me Majlinda Rraman Hiton nga Vajza e Vlorës, kanë dy djem e një vajzë: Albanon, Marjusin dhe Rominën.

Petraq Pano Kove u martua me Mimoza Mino Nakën nga Delisufi, kanë një djalë, Mateon.

Antigoni Pano Kove u martua me Petraq Nasi Nakën në Mifol.

Vangjelina u martua me Jani Miço Kungullin në Poro.

Kostandina u martua me Miço Perikli Gjonçarin në Delisuf.

Vasilika u martua me Llazi Koli Gjeçin në Fier.

Lira u martua me Miço Peçi Hudhra-Muçaj në Fier.

Lili Llazi Kove u martua me Milika Rrapi Zaka nga Dëllënja, kanë 3 djem e dy vajza: Sotirin, Laken, Artanin, Donikën dhe Silvanën.

Lake Lili Kove u martua me Vera nga Gjirokastra, kanë dy djem e një vajzë.

Sotir Lili Kove u martua në Levan të Fierit, kanë një djalë e një vajzë. Jetojnë në Itali.

Artan Lili Kove u martua me gruan e parë nga Patosi, ka një vajzë, me gruan e dytë nga Pojani, ka Lilin dhe Rubenin.

Donika Lili Kove u martua me Llukan Lijo Koçin në Poro, kanë dy djem, e një vajzë.

Silvana Lili Kove u martua në Pojan.

NASI KIÇUA

Nasi Kiçua erdhi nga Jagodina e Fierit. Kish marrë për grua motrën e Trush Kolës në Poro dhe me të lindi vetëm një djalë, Trifonin.

Trifon Nasi Kiçua u martua me Çantën e Joti Moçkës nga Porua dhe lindi dy djem, Llazin e Tolin dhe tre vajza.

Llazi Trifon Kiço u martua dy herë. Me gruan e parë ka një djalë Altinin, me të dytën aktualisht s'ka fëmijë.

Toli Nasi Kiçua u martua me (Pa saktësuar) nga Dhërmiu, kanë një djalë e 7 vajza: Trifonin, Elvirën, Xhanën, Elisabetën, Masildën, Elenin, Letën dhe Kristinën.

PRENDI KOÇI

Prendi Koçi e ka origjinën nga Libofsha. Ka banuar ca kohë në Cerkovinë dhe në Selenicë dhe, prej andej, erdhi në Poro, rreth viteve 1920.

Prendi ishte i martuar me Dafinën nga Zvërneci dhe me të lindi një vajzë e një djalë: Sofijen, që kish marrë Kristo Përri në Dëllënjë, dhe Lion.

Lio Prendi Koçi u martua me Llamba Kostandin Moçkën nga Porua, kanë dy djem e 4 vajza: Llukën, Thomain, Milikën, Kristinën, Vasilikën dhe Florën.

Lluka Lio Koçi u martua me Donika Lili Koven nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë: Pëllumbin Arditin, dhe Matildën.

Thoma Lio Koçi u martua me Neftali Mino Priftin nga Marinëza e Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Ilirjanin dhe Llambrininë.

Milika Lio Koçi u martua me Petraq Jani Naçin nga Porua.

Vasilika Lio Koçi u martua me Fredi Pulon në Zvërnec.

Flora Lio Koçi u martua me Nasi Gjonçën në Mifol.

Kristina Lijo Koçi u martua me Petraq Jani Naçin, kanë një djalë e dy vajza, Vasillaqi, Fatjona dhe Eriselda.

RAKO KRONI KOÇI NIKOLLA, DËLLËNJË

Në Dëllënjë thonë të gjithë se familja e këtyre fiseve janë nga të parët.

Nikolla la Kocin, Koçi la Kronin, Kroni la Rakon, Rakua la Andrenë, Thoman dhe Kolin, Sofien e Marien, Andrea la dy vajza, Thomai la Panon dhe Takon, Pano la Koçin, Filipin, Arjanin, Golen, Elpiniqin, Taku ka dy djem e 3 vajza: Arqilen, Patron, Dhoksien, Afërditën e Dhimon.

Nikolla la Koçin. Koçi la Kronin, Kroni la Rakon.

Xha Kroni gruan e parë e kishte marrë te Naçajt në Seremlli të Fierit. Nuk lindi fëmijë me të. Mori gruan e dytë në Qenas të Fierit te Tankajt. Me këtë lindën 3 djem: Uani, Rakua e Lonidha. Uani e Lonidha ishin në shkollë për priftërinj në Berat, por vdiqën nga kolera 18-20 vjeç.

Rakua në Dëllënjë u rrit e u martua me gruan e parë, Artininë e Koçi Bushit nga Dëllënja, me të lindi një djalë e dy vajza: Andrenë, Sofien dhe Marien.

Në këtë kohë edhe Kronit i vdiq e shoqja e dyta që kish marrë në Qenas, edhe pse në moshë të madhe, plakun e detyruan të merrte një grua të tretë për punët e shtëpisë, sepse kishin shumë mall e gjë të gjallë. Ishin rreth 50 lopë me viça që mileshin, kishin disa hyzmeqarë, por punët e grave ata s'i bënin dot. Kështu, Kroni mori Parashqevinë (Viqën) nga Shkurtajt e Pish-Poros. Ajo ishte shumë punëtore, e urtë, por e madhe në moshë, e pamartuar. Me Kronin mundi të lind një vajzë të bukur shumë. Thonë se këta, Kroni sidomos, u vu në sedër sepse lindi gruaja edhe kjo në moshë të madhe. Ai e mori më shumë për punë, por ja që ajo u dha një vajzë të bukur si hëna, Djella. Në këtë kohë, edhe i biri i Kronit, Rakua kishte marrë një grua të dytë, Patron nga Qenasi, se e para kish vdekur më 1914. Tani edhe Rakua kishte fëmijë, me gruan e dytë. Kishte Thoman, kur lindi edhe Djella e Xha Kronit. Diella u rrit e u martua në një familje të pasur. Thonë se nga marazi u sëmur e vdiq brenda vitit, nuk la femijë. E ëma e Djellës, ose e shoqja e Kronit, jetoi shumë, vdiq rreth vitit 1965.

Rako Kroni Koçi u martua me gruan e parë, Artininë e Koçi Bushit nga Dëllënja, lindi Andrenë, Sofien dhe Marien.

Andrea Rako Koçi u martua me Urani Koli Prifti nga Zhuka dhe u lindën dy vajza: Kristulla dhe Ndina.

Kristulla u martua me Petro Uan Lepurin në Delisuf dhe vdiq që në lindjen e parë, la një djalë, Stefan Petro Lepurin. Ai është martuar e jeton në Vlorë.

Dy vëllezërit, Thoma e Koli Koçi

Ndinja u martua me Mina Josif Nakën në Delisuf dhe ka 4 djem e 5 vajza.

Sofia Rako Koçi u martua me Uan Kozma Priftin në Poro, lanë 4 djem.

Maria u martua me Dhori Hajdinin, la dy djem e 4 vajza.

Xha Rakos, gruaja e parë që i vdiq, Artinia i la një djalë e dy vajza, Andrenë, Sofien dhe Marien, mori një grua tjetër nga Qenasi, Patron e Monajt me të cilën lindën Thoman dhe Kolin.

Thoma Rako Koçi u martua me Sofie Sotir Gjonçarin nga Zhuka dhe lindi dy djem, Panon dhe Kristaqin.

Pano Thoma Koçi u martua me Sotira Loni Priftin nga Dëllënja dhe lindën 4 djem e një vajzë: Koçin, Filipin, Arjanin, Golen dhe Elpiniqin.

Llazi, Panua, Takua dhe Sotira e Lira, Dëllënjë

Koçi Pano Koçi u martua me Elca Lio Gjonin nga Dëllënja, kanë 3 djem e një vajzë: Leonidhën, Nestin, Ledionin dhe Mirelën.

Filip Pano Koçi u martua me Blerina Thoma Hudhrën nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë: Enrikun dhe Sofien.

Arjan Pano Koçi u martua me Floreta Bardhosh Maskën nga Kanina, kanë një djalë e një vajzë: Thoman dhe Xhovanën.

Ligor Pano Koçi u martua me Gradiola Llazi Dashin nga Delisufi, kanë një djalë, Paulon.

Elpiniqi Pano Koçi u martua me Dritan Thoma Monen në Pish-Poro. Të gjithë fëmijët e Panos kanë emigruar në Itali.

Tako Thoma Koçi u martua me Liri Jorgji Dokon nga Pish-Poro, kanë dy djem e 3 vajza: Arqilen, Dhimitrin, Patron, Dhoksinë dhe Afërditën.

Arqile Tako Koçi u martua me Erjona Vasil Cerkën nga Bishani i Fierit, kanë dy djem e një vajzë: Kriston, Aleksandrin dhe Leonorën.

Patra Tako Koçi u martua me Anastas Semën nga Ferrasi.

Dhoksie Tako Koçi u martua me Kristaq Lio Marinën në Poro, kanë 3 djem.

Afërdita Tako Koçi u martua me Eduard Mihal Milon.

Dhimo Kapedani do të martohej në Gusht 2009 me një vajzë nga Pojani i Fierit, po fati i zi i tij në fund të Qershorit 2009, një muaj para se të martohej, humbi jetën në një aksident me makinë në Itali.

Në Dëllënjë ishte një Jorgji Sheqi (Koçi), një fis me Zariko Koçin, që la Themi Koçin, i cili shkoi në Vlorë dhe punoi mullixhi.

KOLI RAKO KOÇI

Koli R. Koçi është nga Dëllënja. Në vitin 1951 shkoi në Vlorë familjarisht dhe në vitin 1966 vajti vullnetarisht në Poro me gjithë familje, si dhe disa të tjerë.

Koli ishte martuar me Kristulla Toli Dilën nga Porua, kanë lindur 3 djem e një vajzë: Vasilin, Llambin, Nasin dhe Liljanën.

Vasil Koli Koçi u martua me Milika Kozma Markun nga Gryka, kanë një djalë e 3 vajza: Altinin, Mozën, Rovenën dhe Elonën.

Altini është martuar me Anila Peço Moçkën.

Moza u martua me Genci Stavre Thanon në Poro, kanë një djalë e një vajzë.

Rovena u martua me Vaso Mone në Qenas Fier.

Elona u martua.

Llambi Koli Koçi u martua me tre gra, por as me një nuk ka lindur fëmijë.

Nasi Koli Koçi u martua me Moza Barjam Çelën nga Qishbardha e Vlorës dhe ka dy vajza e një djalë: Andrean, Rafaelën dhe Danielën.

Liljana Koli Koçi u martua me Thanas Llazi Sheqin në Poro, kanë një djalë e 3 vajza: Eduardin Linditën, Silvanën dhe Aurorën.

PALI ZARIKO KOÇI, DËLLËNJË

Pali Zarikua duhet të jetë nga Matkëza e Fierit. I thoshin edhe Pali Zariko Sheqi, por ndoshta nga që ishte në lagjen Sheq të Dëllënjës. Ai është i biri i Zariko Koçit.

Pali Zariko Koçi me gruan e parë ka vetëm një djalë Lilin, që shumë vonë u vesh prift, Papa Lili. Me gruan e dytë, që mori nga Pish-Porua, nuk lindi fëmijë. Ajo kishte lindur një vajzë te Nakajt, ku ka qenë e martuar në Pish-Poro, po këtu me Pali Zarikon nuk lindi. Vajzën e saj që kish lënë në Pish-Poro, Vidën, e mori Llazi Naçi, ose Llazi i Papa Spiros në Poro. Nga këto, nënë e bijë edhe Papa Spirua, u lidh më shumë me miqësi me Pali Zarikon në Sheq, Dëllënjë.

Papa Lili Koçi u martua me Maria Spiro Gegën nga De1isufi dhe lindën 5 djem, Todin, Trifonin, Llazin, Koçin, Vasilin dhe 3 vajza.

Papa Lili Koçi

Todi Lili Koçi u martua me Pulije Loni Rrapin nga Pish-Porua dhe kanë 6 djem e një vajzë: Josifin, Aleksin, Robertin, Minellën, Dhimitrin, Sotiraqin dhe Elvirën.

Josif T. Koçi u martua me Rajmonda Marko Zakën nga Gorica e Lushnjës, kanë një djalë, Saimirin.

Aleks T. Koçi u martua me Fatbardha Zoto Kapllanin nga Kanina, kanë dy djem e një vajzë: Romeon, Aurelin dhe Violën.

Robert Todi Koçi u martua me Violeta Vasil Zanin nga Kanina, aktualisht nuk ka fëmijë.

Minella T. Koçi u martua me Arta Beshir Qëndron nga Koshtani i Tepelenës, kanë një djalë e një vajzë: Frederikun dhe Lorelën.

Dhimitër T. Koçi u martua me Linditën nga Sheqi i Fierit, kanë dy djem: Brunon dhe Mikelin.

Sotiraq T. Koçi u martua me Bruna Filip Lalën nga Mifoli, kanë dy djem: Atirion dhe Markon.

Elvira T. Koçi u martua me Kristaq Miço Gjonin në Dëllënjë, kanë një djalë e një vajzë: Renaldon dhe Ildën.

Trifon Lili Koçi u martua me Marika Pulerin nga Dramashishti i Gjirokastrës, kanë 3 djem e 3 vajza: Kristaqin, Arbenin, Kujtimin, Artën, Aurelën dhe një tjetër.

Kristaq Trifon Koçi u martua me mbesën e Kristaq Sotës nga Vlora, ka një djalë.

Arben Trifon Koçi u martua me Rovena Kozma Çunin nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë, kanë emigruar në Itali.

Kujtim Trifon Koçi u martua me të bijën e Pilo Sollakut nga Pish-Porua. Ka një djalë, Kristaqin.

Llazar Lili Koçi u martua me Ola Kuqin nga Topoja e Fierit, kanë dy djem e dy vajza: Piron, Albitin, Linditën dhe Mirelën.

Koçi Lili Koçi u martua me gruan e parë, Vasilika Puler Këllezin nga Gjirokastra, ka 3 djem e një vajzë: Gëzimin, Klodin, Lilin, Kristianën. Me gruan e dytë, Xhema, ka një djalë: Andrean.

Vasil Lili Koçi u martua me Natasha Beshishtin, kanë një djalë e 5 vajza: Arjanin, Milikën, Jorgjien, Irenën, Anilën dhe Vangjelinën.

UAN SHKURTI



Uan Shkurti ishte nga Pish-Porua, vëllai i Parashqevisë (Viqes) që kish marrë Kroni Koçi nga Dëllënja.

Uani kish shkuar në Itali që kur ishte djalë i ri dhe atje punoi disa vjet në një fermë blegtorale. Ishte djalë shumë i bukur, por nuk ishte martuar dhe pas shumë kohe u kthye te e motra në Dëllënjë, te Rako Kroni Koçi. Bukurinë trupore e ruajti deri në pleqëri të thellë. Vdiq në vitin 1967.

Në Dëllënjë ka banuar, disa kohë, Kozma Dumi i cili erdhi nga Vlora. Nuk ndenji shumë dhe iku prapë në Vlorë. Ai kishte marrë Viqen e Xha Labo Qishës nga Dëllënja. Kishte 2–3 djem, i madhi quhej Jani Dumi. Tani të gjithë janë në Vlorë.

MITRUSH KONDA, DËLLËNJË

Banor i vjetër në Dëllënjë. Tokat e Mitrushit ishin pikërisht aty ku sot ndodhet fshati Dëllënjë dhe deri ku janë varrezat e fshatit. Ai la dy djem e një vajzë: Tanën, Jorgjin dhe Taqon.

Tana u martua me Mihal Hudhrën në Dëllënjë.

Jorgji vdiq i ri.

Taqua shkoi në Vlorë dhe u martua me Sijën e Mitit të Gjeros, ose Miti Irakli Papulasit.

Irakli Papulasi ishte i ardhur nga Preveza e Janinës së Greqisë. Pse e si kish ardhur nuk dihet, por me saktësi dihet ajo që ai ishte vendosur në Nartë se kishte pasur kushërinjtë, por më e saktë që duhet të jetë ngulur atje nga që në atë fshat flisnin greqisht dhe ai atje është marrë vesh më mirë nga ana e gjuhës. Ishte në moshë të madhe.

Gjerua (ose Irakli Papulasi) u martua me Anën, ose Qyrana siç i flisnin, motra e Nasi Hajdinit e Vangjel Hajdinit.

Taqo Mitrush Konda u martua me Sije Miti Papulasi dhe lindën dy djem e 4 vajza: Miçon, Aristirin, Lizën, Uraninë, Andonetën dhe Olimbinë.

Miço Taqo Konda u martua me Zhaneta Kosta Shkurtin nga Fieri, kanë dy djem: Erjonin dhe Altinin.

Erjon Miço Konda u martua në Angli me një bullgare, kanë një djalë, Kristaqin.

Të dy djemtë e Miços kanë emigruar në Angli. Miçua banon familjarisht në Vlorë.

Aristir Taqo Konda u martua me Margarita Vasil Priftin nga Vlora, kanë një djalë e një vajzë, Gentin dhe Julianën.

Liza Taqo Konda u martua me Buli Konomin nga Himara, kanë vetëm një vajzë, Arjanën.

Arjanën e martuan me Arjan Daja nga Tirana. Në vitin 1991 emigruan në Greqi. Arjana me Arjanin lindën dy vajza: Marien dhe Verën.

Fatkeqësisht Arjana u vra aksidentalisht nga makina në Greqi. Arjan Daja u kthye në Tiranë dhe u martua me një tjetër duke ia lënë vajzat gjyshes së tyre, Lizës. Pas pak kohe vdes edhe Buli, i shoqi i Lizës dhe tani Liza po rrit vajzat e së bijës atje në Greqi, të cilat janë në shkollë të mesme. Liza tani është 70 vjeçe, por bën kurajë për të rritur vajzat e së bijës që i ka si molla dhe për të cilat tregon mjaft kujdes.

Urani Taqo Konda është martuar me Agim Çelikun në Tiranë, kanë dy vajza, Aurorën dhe Sonilën.

Aurora u martua me Elton Mingën nga Tirana, ndërsa Sonila u martua me Andi Erebara në Tiranë.

Urania me Agim Çelikun jetojnë në Tiranë.

Aneta Taqo Konda u martua në Elbasan me Sulejman Sulon, kanë 3 vajza, Anduerën, Oltën dhe Eraldën. Edhe këta kanë emigruar familjarisht në Greqi.

Olimbi Taqo Konda u martua me Fatos Shambllin në Korçë, kanë dy djem: Kastriotin dhe Gentin.

Të gjithë kanë emigruar në Greqi.

Kur vdiq i ati i Sijes, Miti i Xha Gjeros ose Miti Papulasi, Marija e shoqja e Mitit, u martua në Vlorë me babanë e Fonit e të Senës. Me të Marija bëri Nasho Bishën dhe Vitën. Sijen e mori Kristo Dhamo dhe e rriti se kishte të bënte me të shoqen. Kjo ishte motra e Vasil Derollit. Ai e martoi me Taqo Kondën.

Nasho Bisha ka lënë dy djem e një vajzë, Vangjelinën me gruan e parë.

DY MOTRAT DHE KUSHËRIRI

Dy vajzat e Jaje Sijës, Urania dhe Olimbia, vajzat e Taqo Kondës.

Urania një volejbolliste e mirë në Vlorë dhe mësuese fizkulture në Tiranë; si edhe Olimbia, një kurbate me def te një film shqiptar.

(Në foton më poshtë jemi në një dasmë kur Urania martoi vajzën e dytë në Tiranë).

Dy motrat (vajzat e Taqo Kondës dhe Sijes), Urania dhe Olimbia me kushëririn Llazi Hajdini

3 VËLLEZËRIT KUNGULLI

Kanë ardhur nga Voskopoja e Korçës me bagëti dhe janë të vjetër në Poro.

Mund të them me bindje se janë me prejardhje çobanësh, se edhe pasardhësit e tyre deri më sot janë nga blegtorët më të mirë të krahinës. Edhe fëmijët e vegjël të tyre, sa ngrihen në këmbë, e kanë mendjen të venë prapa deles apo dhisë, e kur rriten, 8-10 vjeç, janë në gjendje të njohin cilindo qengj apo kec të vogël se e kujt dele apo e kujt dhie i përket ky ose ai, edhe pa qenë nëna e tyre prezent. Janë mjaft të çuditshëm e të aftë. Asnjë i madh s'e ka aftësinë e kësaj race të Kungujve që të njohë apo të ketë kaq pasion për bagëtitë e imta, në gjithë zonën e Myzeqesë.

Nga pleqtë më të vjetër të Kungujve mbahen mend 3 vëllezërit: Koli, Gjergji dhe Kozmai.

Koli la 3 djem: Naqon, Qirkon dhe Kostën.

Gjergji la Tikën dhe Llukën.

Thonë se Kozmai u vra në fshat nga agallarët, arsyen s'e dinë.

Xha Naqo Kungulli kish marrë gruan nga Dokot e Dëllënjës dhe la dy vajza: Finën dhe Sofijen.

Finën e mori Vasil Qarri në Poro, ndërsa Sofijen e kish marrë Lili Mone në Poro.

Fina lindi Kolin, Miço Sijën dhe Galinën.

Sofia u martua me Lili Mone, lindi 3 vajza: Zoicën, Melpon, Lirin.

Qirko Koli Kungulli ka lënë 3 djem: Nasin, Dhorin, dhe Vangjelin.

Kosta Koli Kungulli la Vasilin.

Tike Gjergji Kungulli la Jorgjin.

Llukë Gjergji Kungulli la Silën.

Nasi Qirko Kungulli u martua me Athina Tasi Qorri dhe lanë Tanën, Miçon, Fanien dhe një djalë, Thoman që vdiq brenda 2–3 ditëve, në vitin 1942, kur ishte 10–11 vjeç, nga gjembi i trëndafilit që e shpoi te gjuri darkën e Pashkës Madhe.

Tana Nasi Kungulli u martua me Kozma Balliun në Nartë dhe lindi 3 djem, Llazin, Vangjelin, Tolin dhe 4 vajza, Jolanda, Natasha, Leonora dhe Teuta.

Fanie Nasi Kungulli u martua me Kostandin Markun nga Babica në Vlorë, kanë djem e vajza.

Miço Kungulli polic, me një shokun e tij, oficer Sotir Sema

Miço Nasi Kungulli u martua me Vita Lamo Tanka nga Beshishti i Vlorës, kanë lindur 8 djem e një vajzë: Janin, Nashon, Petraqin, Golin, Kristaqin, Garitin, Lonin, Benin, dhe Letën.

Leta Miço Kungulli u martua me Tokli Niko Dilën në Poro.

Jani Miço Kungulli u martua me Lika Pano Koven nga Delisufi, kanë 3 djem: Lencin, Armandin, Ervinin.

Nasho Miço Kungulli u martua me një vajzë nga fisi Berberi në Nartë, kanë 3 vajza.

Petraq Miço Kungulli u martua me Gjena Laver Hoxhën nga Peshkëpia e Vlorës, kanë një djalë, Eltion Petraq Kungulli, dhe dy vajza.

Goli Miço Kungulli u martua me Verën nga Vajza e Vlorës, kanë dy djem, Gertin dhe Altinin.

Kristaq Miço Kungulli u martua me Zana Feta Bonjakun nga Treblova, kanë dy djem: Adin dhe Klodin.

Garit Miço Kungulli u martua me Rajmondën nga Grecallia e Fierit, kanë një djalë e një vajzë, me gruan e dytë nga Frakulla ka një djalë.

Loni Miço Kungulli u martua me Evën nga Grecallia e Fierit, kanë një djalë e një vajzë.

Beni Miço Kungulli u martua me Zanën nga Krasti Tepelenës, kanë një djalë, Xhulianon dhe një vajzë.

Shënim: Nëna e këtyre 9 fëmijëve, Vita, vdiq e re. Miçua i ka rritur me shumë mundime, por fëmijët u bënë të gjithë të mirë. Edhe babanë e mbajtën dhe e trajtuan mirë, siç e meritonte. Miçua ka qenë burrë i zoti, i dashur dhe i ndershëm.

Shumica e djemve janë të emigruar. Edhe babanë e morën në Itali dhe pleqëroi për shumë vite atje deri pak ditë para se të ndahej nga jeta. E sollën në Poro, ku vdiq e u varros në Poro me shumë nderime e respekt nga bashkëfshatarët e të afërmit e tij, shokë e miq të shumtë.

DHORI QIRKO KUNGULLI

U martua me Ngjelinën nga Frakulla. Kanë lindur dy djem e 4 vajza: Pilon, Vllasin, Marien, Naunkën, Tinën dhe Valën.

Pilo Dhori Kungulli u martua me Goni Kosta Guberën nga Beshishti, kanë dy djem: Arqilen dhe Viktorin.

Arqile Pilo Kungulli u martua me Labikën nga Treblova, kanë një djalë e dy vajza: Spiron, Klajdën dhe Danielën.

Viktor Pilo Kungulli u martua me Lola Haki Myrtajn nga Trevllazëri, kanë dy djem: Ervinin dhe Gabrielin.

Vllasi Dhori Kungulli u martua me Vangjelina Spiro Karon nga Himara, kanë dy djem e dy vajza: Eduardin, Alfredin, Elvirën dhe Mirelën.

Eduard Vllasi Kungulli u martua me Luljeta Nasi T. Dashin nga Delisufi, kanë një djalë e një vajzë: Stilianon dhe Vasilikën.

Alfred Vllasi Kungulli u martua me Sonila Arqile Pano Kolën (ose Mitraj) nga Porua, kanë një vajzë, Adelinën.

Mirela Vllasi Kungulli u martua me Sotiraq Zoton në Himarë, kanë një djalë e një vajzë.

Elvira aktualisht është beqare.

VANGJEL QIRKO KUNGULLI

Vangjel Kungulli u martua me Kalien e Kristo Vanit, të cilën e rriti daja i saj, Pali Gjonçari në Zhukë, sepse babai i saj vdiq dhe e ëma u martua me Naun Kolën (Ose Mitra) në Poro dhe atje lindi edhe 3 vajza të tjera.

Vangjeli me Kalien lindën 4 djem: Lion, Koçin, Llazin dhe Sotirin, i cili u mbyt aksidentalisht në lumin Vjosë.

Lio Vangjel Kungulli u martua me Fina Simonin nga Beshishti, kanë 4 djem e 5 vajza: Vasillaqin, Kleanthin, Elidonin, Armandon, Natashën, Marianthin, Elenin, Mirandën dhe Alketën.

Lijo Vangjel Kungulli dhe Llazi Hajdini

Vasillaq Lio Kungulli u martua me Shpresa Trifon Koçin nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë: Frederikun dhe Xhulianën.

Kleanth Lio Kungulli u martua me Bruna Taqo Thanasin nga Zvërneci, kanë një djalë e dy vajza: Ilia, Aleksia dhe Stefania.

Elidon Lio Kungulli u martua me Rovena Llazi Marinën nga Porua dhe kanë: një vajzë, Gjesika.

Armando Lio Kungulli u martua me Silva Selimin nga Kërkova, ka një djalë, Noelin.

Vajzat e Lijos:

Natasha u martua me Dhimitraq Thoma Mërtiri, kanë dy fëmijë, Julianin dhe Lorenën.

Marianthi u martua me Dhimitër Llaz Shyti në Poro, kanë dy fëmijë, Marion dhe Aldën.

Eleni u martua me Anesti Bombaj në Selenicë, kanë dy fëmijë, Ladin dhe Violën.

Miranda u martua me Llukan Mitraj në Selenicë, kanë dy fëmijë, Klodin dhe Kostën.

Alketa u martua me Ristan Janka, kanë dy vajza, Kristi dhe Erika.

Koçi Vangjel Kungulli u martua me Olimbi Lekën nga Dukati, kanë një djalë e 3 vajza: Sotirin, Klarën, Liljanën dhe Albanën.

Sotir Koçi Kungulli u martua me Bruna Miti Thanon nga Sheqishtja e Fierit, kanë dy vajza: Marien dhe Kristën.

Llazi Vangjel Kungulli u martua me Niqi Llambi Barulin nga Çuka e Sarandës, kanë një djalë e 5 vajza: Anestin, Bonën, Elean, Enkeletën, Nertilën dhe Shpresën.

VASIL KOSTË KUNGULLI

Vasil Kosta Kungulli u martua me Janën e Pilo Thanasit nga Dëllënja dhe lindi dy vajza: Kristullën, që u martua me Gori Gjonçarin në Zhukë, dhe Margaritën, që u martua me Arqile Llazi Llambron në Poro.

Vasili u vra aksidentalisht në Ujë të Ftohtë të Vlorës kur po vinte në punë në Distileri se ai kish zënë punë ose do të zinte punë. Duke shkuar në këmbë rrugës, i erdhi makina nga prapa dhe e përplasi pranë një shtylle betoni tek plazhi në anë të detit. Jana mbeti me dy vajzat e vogla në Poro. Pas ca kohe u martua me Thoma Mërtirin në Zhukë, duke marrë edhe vajzat me vete.

Jana çoi atje dy vajza, gjeti tek Thomai edhe 4 djem e një vajzë, lindën bashkë edhe 3 djem e 3 vajza. Kështu rritën dhe edukuan 13 fëmijë, të cilët u bënë shumë të mirë dhe me shkollë të mesme e të lartë. Nga fëmijët e tyre ka sot në Poro, në Tiranë, Greqi, Itali dhe në

Amerikë. Vasil Kungullit s'i përmendet më emri, sepse nuk ka lënë djem.

LLUKË GJERGJI KUNGULLI

Llukë Kungulli la vetëm një vajzë, Silën, që u martua me Jorgji Leshi nga Mifoli. Atje lindi djem e vajza, por si gjithë nënat e tjera edhe kjo shtoi racën e burrit, emri i Llukës nuk thirret më. Pra edhe ky e mbylli me një vajzë dhe u shua nga defteri.

TIKË GJERGJI KUNGULLI

Tika la vetëm një djalë, Jorgjin.

Jorgji Tikë Kungulli u martua me Ndinen e Petro Sikos nga Porua, lindën 5 djem, Nikon, Llambin, Llukanin, Mihallaqin, Harrillën e 5 vajza, Niqi, Liza, Nefta, Vali dhe Miranda.

Shënim: Tikë Kungulli është nga Belina e Fierit. Erdhi prapa nënës së tij kur ajo u martua për herë të dytë me Gjergji Kungullin. Pra, nuk është nga fisi Kungulli, por, ngaqë u rrit tek Kungujt, mori mbiemrin Kungulli dhe si baba u njoh Gjergji. Të gjithë djemtë e Jorgji Kungullit e kanë kthyer mbiemrin nga Kungulli në Tika. Që janë tjetër fis këtë e vërteton edhe pamja e jashtme e djemve të Jorgjit, këta ndryshojnë në pamje me ata të Kungujve se kanë trup më të madh dhe hundën pak më të kthyer.

Niko Jorgji Tika (Kungulli) u martua me Leni Vangjel Hudhra nga Gryka, kanë 5 vajza: Lidën, Mirandën, Erjonën, Enerjetën dhe Shpresën.

Lida Niko Tika u martua me Adrian Çoni Bashin në Topojë të Fierit.

Erjona u martua me Viron Koli Hoxharën në Poro.

Enerjeta u martua me Kleanth Dokon në Libofshë.

Miranda aktualisht është beqare.

Shpresa aktualisht është beqare.

Llambi Jorgji Tika u martua me Vangjeli Fili Gegën nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë: Artanin, Rezartin, dhe Riketën.

Llukan Jorgji Tika u martua me Lefteri Qerem Xhaferin nga Armeni, kanë një djalë e një vajzë: Klajdin dhe Eglantinën.

Llaqi Jorgji Tika u martua me Silvana Peço Moçkën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Enean dhe Anën.

Harrilla Jorgji Tika aktualisht është beqar.

Vajzat e Jorgji Kungullit:

Niqi martuar në Bishan të Fierit.

Liza është martuar në Armen.

Nefta martuar me Xhorxhi Llazi Hudhrën në Poro.

Vali martuar me Vangjel Llambi Kolën në Poro.

JANKO LEPURI

Thonë se Janko Lepuri kishte ardhur nga Lekli i Tepelenës në Novoselë tek Leprajt (pse e si nuk dihet) dhe aty mori mbiemrin Lepuri.

Te Leprajt ka qenë hyzmeqar. Jankua u martua në Novoselë dhe lindi 4 djem: Kolin, Josifin, Kriston dhe Kozman.

Kristua dhe Kozmai mbetën në Novoselë.

Koli Lepuri erdhi në Poro, la 4 djem: Gorin, Lilin, Lekon dhe Pilo Lepurin. Gori Koli Lepuri me gruan e parë la Llambron dhe Filen, që u martua te Petanajt në Ferras. Me gruan e dytë, Ksandën nga Shënpjetra, ka lënë Vangjelin dhe Kristinën që u martua me Todi Zakën në Vlorë.

Llambro Gori Lepuri u martua me Ksandën nga Fieri, kanë lënë Tolin, Llazarin, Raqin, Ritën, Lizën, Marien dhe Jorgjien.

Toli Llambro Lepuri u martua me Lirën e Koli Qarrit nga Porua, kanë lënë një djalë e 3 vajza: Rezartin, Vefin, Lidën dhe Almën.

Llazar Llambro Lepuri u martua me Moza Sotir Moçkën nga Porua, kanë dy djem.

(Shënim: Djemtë e Uan Lepurit e kanë kthyer mbiemrin nga Lepuri në Janko).

Vangjel Gori Lepuri u martua me Kristinën nga Gjonçajt e Fierit dhe kanë Arqilen, (Miçon), Stavren, Kristin, Leonidhën, Fredin, Vasilikën dhe Dritën.

Miço Vangjel Lepuri u martua me Llambrini Vangjel Marina nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Ardin, Stavren dhe Angjelën.

Miço Vangjel Lepuri

Ardi Miço Lepuri u martua me Marsela Malaj në Bishani, kanë një djalë.

Stavre Vangjel Lepuri u martua me Li1jana Stavre Thanon nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Nildin dhe Joanën.

Kristaq Vangjel Lepuri u martua me Violeta Piro Priftin nga Zhuka, Vlorë, kanë 3 vajza: Dëshirën, Inën, Elën.

Fredi Vangjel Lepuri u martua me Elvira Myrto Kërkovën nga Karbunara e Vlorës, kanë një djalë e një vajzë: Xhulianon dhe Valentinën.

Leonidha Vangjel Lepuri u martua me Enelinën nga Panajaja, kanë dy djem: Vangjelin dhe Brunon.

PILO LEPURI

Pilo Lepuri u martua me gruan e parë, Jana Rista nga Zhuka e cila vdiq e re dhe nuk la fëmijë. Gruaja e dytë ishte e bija e Kristo Rrushit nga Frakulla me të cilën lindi Neftën dhe Llaqin. U martua me gruan e tretë, File Loshaj nga Porua me të cilën lindi Aristirin, Ligorin, Minellën, Leonorën dhe Donikën.

Pilo Lepuri me të shoqen, Filen

Llaqi Pilo Lepuri u martua me Ritë Vasil Kola nga Porua.

Nefta Pilo Lepuri u martua me Pandeli Vanin nga Porua, që jetojnë në Vlorë që nga

viti 1950, kanë një djalë dhe 4 vajza; të gjithë të martuar e me fëmijë. Djali, Vllasi Pandeli Vani, është martuar me Fetijen (çame), kanë një djalë dhe një vajzë, jetojnë në Itali.

Aristir Pilo Lepuri u martua me Vangjelina Pilo Bërdalli nga Porua, kanë 4 djem: Ilirjanin, Arbenin, Alketin dhe Arjanin.

Ilirian A. Lepuri u martua me një vllahe nga Zvërneci.

Arben A. Lepuri u martua me një vllahe nga Zvërneci.

Alket A . Lepuri u martua me Zana Jani Monen nga Porua.

Arjan A. Lepuri u martua me një vllahe nga Zvërneci.

Aristiri ka mbi 30 vjet që banon në Zvërnec dhe ndoshta, nga njohja e fëmijëve, janë bërë edhe krushqitë me vlleh të Zvërnecit.

Ligor Pilo Lepuri u martua me Neftali Pilo Dilën nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Edmondin, Fatjonin, Blertën.

Edmond Ligor Lepuri u martua me Ardiana Toli Gj. Mbyetin nga Delisufi, kanë një vajzë.

Fatjon Ligor Lepuri u martua me Elvira Llazar Gegën nga Delisufi.

Minella Pilo Lepuri u martua me Liza Lipi Nakën nga Delisufi, kanë 4 vajza.

MIHAL LILI LEPURI, PORO

Mihal L. Lepuri u martua me Lena Pali Qorrin nga Delisufi dhe nuk lindën fëmijë. Morën dhe birësuan një djalë të Ristana Tonçi Kolës, e cila e kishte me Miço Joti Kolën (Dashi) nga Porua. Ristana ishte e martuar me Miço Kolën, por shpejt e la dhe iku shtatzënë, u martua me Vangjel Gjonçarin.

Djalin që kishte me Miçon, ia dhanë Mihal Lili Lepurit me emrin Nonda Mihal Lepuri, por Mihali e ka regjistruar me emrin Vasil Mihal Lepuri dhe tani ka këtë emër, Vasil Mihal Lepuri, zyrtarisht.

Jota Lili Lepuri

Jota Lili Lepuri u martua me Katerina Spiro Rista nga Zhuka dhe lanë dy djem e tre vajza: Sotiraqin, Janaqin, Janullën, Vangjelinën dhe Sofikën.

Sotiraq Jota Lepuri u martua me Jana Lluka Profka dhe kanë 4 vajza: Enerjada, Vilma, Greta dhe Anjeza.

Janaq Jota Lepuri u martua me Klementina Gori Lule nga Qarri i Fierit dhe kanë tre vajza: Ina, Elisa, Tiana.

Janulla Jota Lepuri u martua me Vasil Stavre Prifti në Vlorë, ka tre djem.

Vangjelina Jota Lepuri u martua me Leonidha Kola (Mitraj) në Poro. Ka një djalë e dy vajza. (Vangjelina është birësuar nga Mihali, vëllai i Jotës, sepse nuk kishte fëmijë).

Sofika Jota Lepuri u martua me Shezai Seferi nga Dhëmblani i Tepelenës; banojnë në Vlorë dhe kanë (deri në vitin 2010) një djalë e një vajzë.

THOMA LILI LEPURI

Thoma Lili Lepuri u martua me Urani Qirjaq Naçin nga Frakulla, kanë një djalë e 3 vajza: Nikon, Valentinën, Rajmondën dhe Mirelën.

Niko Thoma Lepuri u martua me Alma Perikli Kolën nga Porua, kanë një vajzë, Alestian.

Valentina u martua me Pandeli Stavre Moçkën në Poro.

Rajmonda u martua me Edmond Vllasi Milen në Poro.

Mirela u martua me Pëllumb Karafilin në Vlorë, aktualisht kanë një vajzë.

UAN LEPRI, DELISUF

Uan Lepuri, i një fisi me Leprajt e Novoselës, (djali i dytë i atij që sot është rreth 80 vjeç) nuk e ka të qartë të shpjegojë si e kur kanë ardhur Leprajt në Delisuf.

Uan Lepri ka lënë 5 djem: Petron, Josifin, Koçin, Gorin dhe Minon.

Petro Uan Lepri u martua herën e parë me Kristullën e Andrea Rako Koçit nga Dëllënja me të cilën lindi një djalë, Stefanin. Kristulla vdiq menjëherë pas lindjes, djalin e rritën me vështirësi. Pas kësaj, Petrua mori një tjetër grua, Kaliopi Loni Rrungajën nga Zhuka dhe me të cilën lindën 4 djem e dy vajza: Sotiraqi, Ilia, Trifoni, Spirua, Marinaqi dhe Tefta.

Stefani, i Petro Lepurit dhe i Kristullës, u martua në Vlorë me Djana Qatip Canaj nga Sevasteri, dhe ka dy djem: Erjonin e Bledin dhe një vajzë, Kristullën.

Sotiraq Petro Lepuri u mamia me Teftën nga Xhyherina dhe ka dy vajza: Klodianën dhe Anxhelën.

Ilia Petro Lepuri u martua me Angjelina Lefter Hudhrën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Valerion dhe Alesian, jetojnë në Itali.

Trifon P. Lepuri u martua me Laura Trifon Janon në Pish-Poro, kanë dy vajza.

Spiro P. Lepuri u martua me Eriselda, nga Pish- Porua, kanë një vajzë dhe një djalë, Megin dhe Aleksin.

Marinaqi P. Lepuri u martua me Kristaq Kostën (Jorgo Guberja) në Mifol, kanë dy vajza dhe një djalë, Danjela, Klaudeta dhe Arbri.

Tefta P. Lepuri u martua me Sotir Andrea Kërrin në Delisuf, kanë dy djem, Maldin dhe Andrean.

Josif Uan Lepuri u martua me Orfani Jorgji Matën nga Porua, kanë 4 djem: Harrillën, Thoman, Janin dhe Nestin.

Harrilla Josif Lepuri u martua me Luçianën nga Xhyherina dhe ka një djalë e një vajzë: Arditi dhe Adesa.

Thoma Josif Lepuri u martua me Irenën nga Shkodra, dy vajza: Erjona dhe Kenica.

Jani Josif Lepuri u martua me Leonora V. Gega nga Delisufi, ka Ermalin dhe Gretën.

Nesti Josif Lepuri u martua me Sofika Miti Qorrin nga Delisufi, kanë një djalë dhe dy vajza: Kristi, Flutura dhe Neviena.

Gori Uan Lepuri u martua me Leonora Uan Mbyetin nga Delisufi, kanë një djalë e dy vajza: Filipin, Donikën dhe Teutën.

Filip Gori Mbyeti u martua me Lavdijen nga Kanina, kanë dy djem e dy vajza, Olti, Klesta, Nadja dhe Odri.

Donika Gori Lepuri u martua me Piro Jani Kërrin në Delisuf; kanë tre vajza, Oneda, Orjana dhe Kristjana.

Teuta Gori Lepuri u martua me Toli Peço Qorrin në Delisuf.

Mino Uan Lepuri u martua me Ristana Kostandin Moçkën nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Robertin, Marjanën dhe Marcelën.

Robert Mino Lepuri u martua me një vajzë nga Libofsha.

Marcela u martua me Fredi Naun Nasin në Poro.

Marjana është divorcuar, Sarandë.

Nertila aktualisht është beqare.

(Shënim: Këta nuk kanë të bëjnë me Leprajt e Poros).

Koçi Uan Lepri u martua me Gjena Kostandin Janka nga Porua, kanë 4 djem: Dhimitraqin, Vasillaqin, Edmondin dhe Vladimirin.

Dhimitraq Koçi Lepri u martua me Monda Leço Hibrin nga Dukati, kanë një djalë e një vajzë: Emiljanon dhe Blertën.

Vasillaq Koçi Lepri u martua me Laureta Ismet Dalipin nga Bishani, kanë dy djem: Julin dhe Voldon.

Edmond Koçi Lepuri u martua me Donika Petro Kërrin nga Delisufi, kanë një djalë.

Vladimir Koçi Lepuri u martua me një italiane, s'kanë fëmijë.

KILI DHE KOSTANDIN LESHI

Të dy vëllezërit kanë ardhur nga Berati në Selevec dhe pastaj shkuan në Poro.

Kili ishte martuar me Tanën, të bijën e Ndini Çukos nga Porua. Nuk pati femijë. Vdiq i ri. Ka qenë burrë i zoti dhe i dëgjohej fjala në fshat. Ka qenë edhe në pleqësinë e fshatit për shumë vjet.

Kostandin Leshi ishte martuar me Ristanën nga fisi i Kolajve të Vlorës. (Nga ky fis ka qenë një Koço Kola dhe 3 motra të tij, nga të cilat një e kishte Stefan Leka dhe një Llukë Dardha. Koçua ka djem me banim në Vlorë.

Ndini Leshi u martua me Ristanën, ka lënë 3 djem e një vajzë: Janin, Pilon, Lilin, dhe Djellën e cila ishte martuar me Kostandin Jankën në Poro.

Jani Ndini Leshi u martua me Gjena Pali Mbyetin nga Pish-Porua dhe kanë dy djem e 5 vajza: Rakon, Koçin, Kristinën, Sofien, Vangjelinën, Marien dhe Donikën.

Rako Jani Leshi u martua me Kulla Kiço Gjokën nga Himara, dhe ka 4 djem e 3 vajza: Nikon, Milin, Lefterinë, Arjanin, Luljetën, Letën dhe Donikën.

Niko Rako Leshi u martua me Elona Pilo Simonin nga Ferrasi dhe ka dy djem: Ilirjanin dhe Andrean.

Mili aktualisht është i pamartuar.

Lefteri dhe Ariani kanë vdekur të pamartuar.

Vajzat e Rakos janë martuar.

KOÇI JANI LESHI

Koçi Jani Leshi është martuar me Tatjana Shaskën nga Dushkaraku i Vlorës dhe kanë dy vajza dhe një djalë, Ola, Isidora dhe Andi.



Koçi Jani Leshi

Andi Koç Leshi u martua dhe ka një vajzë.

(Shënim: Koçi Jani Leshi e ka ndërruar mbiemrin dhe e ka bërë Kosta, ka marrë emrin e Gjyshit për mbiemër).

Vajzat e Jani Leshit

Kristina u martua me Miço Ristën në Poro.

Sofia u martua me Aristir V. Hudhrën në Delisuf.

Vangjelina u martua me Vangjel Nakun në Berat.

Maria u martua me Naun Papën në Pojan, Fier.

Jorgjia u martua me Andon Thanasin në Pojan, Fier.

Pilo Ndini Leshi u martua në Vlorë me Krisanthin Dhimitër Nxorit nga Çatista e Gjirokastrës, kanë lënë një djalë e një vajzë: Dhimitrin dhe Letën.

Dhimitër Pilo Leshi u martua me vajzën e Pilo Nakës nga Mifoli dhe ka dy djem: Spiron dhe Lijon.

Leta P. Leshi u martua me Vangjel Mihal Dafllën nga Dhërmiu, banon në Vlorë.

Dhimitraqi ka emigruar familjarisht në Greqi.

Lili Ndini Leshi u vra partizan dhe është dëshmor i LNÇL.

PETI LERA, GRYKË

Peti Lera u martua me Frosina Kostallarin nga Babica e Vlorës, kanë lindur 4 djem e 5 vajza: Jani, Andrea, Kostandini, Spirua, Lina, Nomi, Sofia, Gjena dhe Dhorka.

Jani Peti Lera u martua me Dafinën nga Kryegjata e Fierit, (motra e Stefan Kronit), Stefani ka marrë Konxhen e Kristo Marinës nga Porua). Jani me Dafinën kanë lindur një djalë, Miçon.

Miço Lera banon në Fier.

Jani me gruan e dytë, Margarita Llazi Koven nga Gryka, ka 7 fëmijë: Yllin (ose Ilia), Ladin, Artanin, Natashën, Neftën, Dritën dhe Luizën.

Ylli Jani Lera u martua me Xhulieta Prokop Davidhin nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Françeskon, Elionën dhe Mimozën.

Ladi Jani Lera u martua me Valbona Andon Markun nga Delisufi, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Artan Jani Lera u martua me Entela Jorgji Lalën nga Mifoli, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Natasha u martua me Aleksandër Nasi Gjonçën në Mifol.

Nefta u martua me Petraq Llambro Kaçanin në Nivicë, Sarandë.

Drita u martua me Romeon në Mifol.

Luiza u martua me Thodhoraq Koli Mbyetin në Delisuf.

Andrea Peti Lera u martua me Ollgën nga Dukati, kanë dy djem: Tolin dhe Llazarin.

Toli Andrea Lera u martua me Ritën nga Vlora, kanë dy djem.

Llazar Andrea Lera u martua me një vajzë nga Vlora, kanë dy djem e një vajzë.

Kostandin Peti Lera u martua me Urani Loni Sikën nga Porua dhe ka banuar në Vlorë (Loni u largua nga Porua që në vitin 1950). Kanë dy djem e një vajzë: Vasillaqin, Kastriotin dhe Marjanën.

Vasillaq K. Lera u martua, ka emigruar në Amerikë.

Kastriot K. Lera u martua, jeton në Amerikë.

Marjana u martua dy herë.

Kostandini ka vdekur para disa vjetësh, ndërsa Urania ka emigruar me djemtë.

Pilo Peti Lera u martua me Fotina Jani Papën nga Çuka e Sarandës, kanë një djalë e 3 vajza: Vangjelinën, Llambën, Vasilikën dhe Nikollën.



Pilo Peti Lera

Nikollaqi u martua me Mirela Niko Gjonin nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë: Kristin dhe Angjelën.

Angjelina Pilo Lera u martua me Sofokli Servet Ramon nga Saranda, kanë 3 vajza.

Llamba u martua me Aristotel Themi Tashin në Verrias të Fierit.

Vasilika u martua me Edmond Jorgji Semini në Verrias të Fierit, kanë dy vajza.

Vajzat e Peti Lerës:

Lina u martua me Kito Zojin në Frakull.

Nomi u martua me Andrea Meshtarin në Sheqishtë, Fier.

Sofia martua me Vangjel Rrungajën në Dëllënjë.

Dhoksia u martua me Vllasi Belinën në Poro.

Gjena u martua me Gori Sheqin në Poro.

NASI MITI LERA, GRYKË

Miti Lera e ka prejardhjen nga Priftajt e Libofshës. Në Vlorë erdhi 7 vjeç. U rrit dhe mësoi zanatin e përgatitjes së mullinjve të blojës me ujë. Ka ndërtuar disa mullinj bloje me ujë nëpër fshatrat e Vlorës si atë të Grabianit, Xhyherinës, Vranishtit, në Kuç, në Bolenë, Tërbaç, etj. Me punën e tij vuri pak pasuri, por agallarët nuk e donin. Ndërsa ai rezistonte me forcë, ata vunë njerëz dhe e helmuan.

Miti e kishte marrë gruan nga Çunajt e Libofshës, Sofien, edhe ajo grua e zonjë dhe trime, besnike e të shoqit. Kur i helmuan burrin, Sofia mori djemtë e vegjël, Nasin dhe Kozman, dhe u fsheh për të mos i gjetur vrasësit. Shkoi në thellësi të Myzeqesë, te Peti Lera në Grykë. Me Peti Lerën xha Miti njiheshin që të vegjël se të dy ishin nga Libofsha, pra ishin shok fëmijërie dhe kishin miqësi të përhershme. Kështu që Peti Lera i strehoi dhe i ndihmoi djemtë derisa ata u rritën. Për të humbur edhe gjurmët, Peti u ndërroi edhe mbiemrin djemve, dhe ua vuri Lera, por në të vërtetë nuk është ky mbiemri i Mitit.

Kur djemtë u rritën dhe u martuan, dolën me shtëpi më vete.

Kështu më ka treguar Minella Nasi Lera në Korrik të vitit 2009.

Nasi Miti Lera u martua me Gjena Kristo Ristanin nga Babica dhe lindën 3 djem e 6 vajza: Minellën, Vasilin, Thomain, Antigonin, Marinaqin, Vitoren, Mirandën, Natashën dhe Linditën.

Minella Nasi Lera u martua me Leni Llazi Fishekun nga Topoja, kanë dy djem: Ritvanin dhe Ervinin, aktualisht janë beqar.

Minella Nasi Lera

Vasil Nasi Lera u martua me Përparime Shehun nga Tepelena, kanë një djalë e një vajzë: Zamirin dhe Dhuratën.

Thodhori Nasi Lera u martua me Violeta Bastri Balilin, kanë dy djem e 3 vajza: Adriatikun, Ermalin, Aldën, Matildën dhe Arjolën.

Vajzat e Nasi Lerës:

Antigoni u martua me Agim Aliaj në Dukat të Vlorës.

Vitoria u martua me Mihal Demën (divorcuar) në Selenicë.

Miranda u martua me Andrea Fani Gllaçin, Fitore, Vlorë.

Natasha u martua me Fatmir Hoxhën në Vlorë.

Lindita u martua me Ilir Temën në Tiranë.

KOZMA MITI LERA

Kozma Miti Lera u martua me Jorgjie Gjinin (ose Qarri nga Novosela) dhe ka lënë 5 djem e dy vajza: Ilian, Thoman, Ligorin, Dhimitraqin, Fonin, Lutën dhe Kristinën.

Ilia Kozma Lera u martua me vajzën e Llazi Ogiçit nga Topoja.

Thomai u martua me Natashën në Topojë.

Ligori është martuar në Pojan.

Dhimitri në Itali.

Foni u martua në Vlorë.

Fëmijët e Kozmait kanë emigruar, shumica në Itali.

LON LAME LIÇO, DËLLËNJË

Lon Liço ishte martuar me Varvara Kristo Xharon nga Porua. Kanë lënë një djalë e 4 vajza: Naunin, Fanien, Llambën, Lirën dhe Vitën.

Naun Loni Liço u martua me Vala Uan Zakën nga Zhuka, kanë një vajzë e 3 djem, edhe një djalë të birësuar.

Djali i birësuar është Niko Kozma Marku nga Gryka, arsyeja është se Nikos i vdiq e ëma dhe nuk kish njeri ta rriste, e mori Naun Liçua me dëshirë për ta rritur, po edhe për ta bërë djalin e tij, megjithëse ai me gruan e tij lindën edhe 3 djem. Nikua u rrit te Naun Liçua në Dëllënjë dhe, bashkë me vëllezërit e tjerë, nënë e babë i kanë trajtuar mirë, siç i rritën dhe ata. Pra, ai quhet Niko Naun Liço, po në fakt është Niko Kozma Marku.

Niko Naun Liço u martua me Lumturi Nasi Jorgjin, kanë një djalë e dy vajza: Ervinin, Eklevën dhe Blertën.

Ervin Niko Liço u martua me Blerta Mihal Lio Ristën nga Zhuka, kanë dy djem: Nikollën dhe Benin.

Ekleva Niko Liço u martua në Lushnjë.

Blerta N. Liço u martua me Nesti Mino Jankën në Poro.

Petro Naun Liço u martua me Monda Vasil Priftin, kanë një djalë e dy vajza: Gentianin, Anën dhe Brikelën.

Gentian Petro N. Liço u martua me Armela Josif Shabanin nga Frashëri Fierit.

Ana Petro Liço u martua me Marjon Naun L. Sotën në Delisuf.

Brikela Petro Liço u martua me Rrahman Lolajn nga Bolena e Vlorës.

Raqi Naun Liço u martua me Leta Kito Zoin nga Frakulla, kanë dy djem e një vajzë: Armandin, Lorin dhe Silvën.

Armando Raqi N. Liço u martua me Elona Baçi Pajën nga Patosi, kanë një vajzë.

Aristir Naun Liço u martua me Anife Alliajn nga Gjormi i Vlorës, kanë dy vajza e një djalë: Mirën, Mateon dhe Anisën.

Vajzat e Naun Liços:

Vangjelina u martua me Thoma Monen në Pish-Poro të Fierit.

Arta u martua me Viron Llazi Loshin në Vlorë, ka dy djem.

UAN LAME LIÇO

Uan Lame Liço ishte vëlla me Loni Liçon dhe Koli Liçon.

Uan Liçua ishte martuar me Katen, motra e Kron (Babes) Mitrushit nga Dëllënja, kanë lindur 4 djem, Filin, Mihalin, Kristaqin dhe një tjetër.

Fili Uan Liçua u martua me Gorën e Tin Dashit nga Gryka, nuk kanë fëmijë.

Mihal Uan Liço u martua me një vajzë nga Durrësi.

Kristaq Uan Liço u martua në Vlorë.

Spiro Liço u martua me Marika Uan Gjindalin nga Delisufi.

Kol Liço

Kol Liço në Dëllënjë u martua me Licën, të bijën e Laze Hënës nga Porua, kanë lindur vetëm një vajzë, Kristinën, që u martua me Loni Mërtirin nga Pish-Porua e Fierit. Koli Liçua vdiq i ri dhe e shoqja, Lica, u martua me Marko Stronen në Seman të Fierit dhe atje lindi disa djem.

Katja e kishte vëlla nga nënë Kron Dylgjeni (Baba). Babai i saj ishte nga Bishani i Fierit

LOSHI

Thonë se Loshajt kanë ardhur shumë shpejt në Poro. Disa pleq, me kujtesë të mirë, thoshin se Loshajt kanë ardhur nga Lezha në Kavaklli të Fierit dhe, prej andej, erdhën në Poro, por Todi Loshi, që e ka shkruar shumë pak historikun e Loshajve, thotë se Loshajt nuk kanë ardhur nga Lezha, por kanë ardhur nga Skrapari, një lagje i vogël me 5–6 shtëpi ndërmjet Cerkovinës dhe Oshtimës së Vlorës.

Mendimi im është që mund të jetë edhe kështu, si thotë Todi Loshi, por mund të jetë edhe siç thoshin pleqtë para 30 e ca vjetëve, të cilët kanë biseduar disa herë me njëri-tjetrin në fshat. Kur pleqtë e vjetër bisedonin për këto probleme, neve nuk i vlerësonim dhe t'i dinim mirë thëniet e tyre.

Më i vjetri nga Loshajt ka qenë Tini. Tini Loshi la 3 djem: Kozman, Spiron dhe Kolin.

Kozma Loshi la Vasilin, Thoman, Konxhen, dhe Lenën.

Spiro Loshi la Lonin dhe Lulen, që kish marrë Pali Gjonçari në Zhukë. Loni vdiq i ri, pa u martuar.

Kol Loshi la Llukën, Sotirin dhe Filen, që kish marrë Pilo Lepuri nga Gryka.

Këta të tre, Koli i kishte lindur me gruan e dytë. Gruaja e parë e Kolit ishte nga Frakulla, nga Naçajt dhe me të lindi Marien, që kish marrë Loni Mojallia, gruaja e parë.

Konxhe Kozma Loshi u martua me Miti Sakon në Vlorë, ka dy djem e një vajzë, Sotiraqin, Mihalin dhe Jorgjien.

Lena e Kozma Loshit u martua me Pal Kolën në Poro.

Ka qenë edhe një Jorgji Loshi; ai la 3 djem: Palin, Dhorin dhe Kristaqin.

Pali i Jorgji Loshit la Markon dhe Llazin të cilët shkuan në Vlorë dhe atje kanë djem e vajza.

Dhori Jorgji Loshi la Palin, Janin dhe Katen.

Kristaqi vdiq i ri, dhe e shoqja mori djalin, Llaqin e u martua në Pish-Poro. Llaqi Loshi u rrit atje dhe erdhi në Dëllënjë, u martua me Pulien, motra e Kozma Hudhrës, dhe kanë një djalë, Viktor Loshin dhe dy vajza, Natashën dhe Teutën.

Llukë Koli Loshi u martua me Pulije Priftin nga (Pa saktësuar) dhe kanë lënë 6 djem e dy vajza: Zojin, Golin, Filin, Llambin, Nasin, Petron, Niqen dhe Finen.

Zoji Llukë Loshi u martua me Patrinën nga Beshishti dhe kanë dy djem: Nikon dhe Vangjelin.

Niko Zoi Loshi u martua me Leonora Koçi Biba nga Zvërneci, kanë dy djem: Mondin dhe Saimirin.

Vangjel Zoi Loshi u martua me Nadire Feta Gashi (gruaja e parë) nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Gentiani, Erida, Viola. Nadireja vdiq e re, Vangjeli mori një grua tjetër, Ritën, vajzën e Qemal Totos nga Vlora, me të cilën aktualisht nuk ka fëmijë.

Goli Llukë Loshi u martua me Goren, të bijën e Vangjel Simonit nga Beshishti, kanë banuar në Vlorë, kanë një djalë e një vajzë. Kanë emigruar në Angli. Të dy fëmijët janë martuar.

Fili Llukë Loshi u martua me Vida Uan Marinën, kanë një djalë dhe 5 vajza: Kristaqin, Violetën, Mondën, Almën, Florën dhe Elcën.

Kristaqi Fili Loshi u martua me një vajzë nga Bibajt e Zvërnecit, kanë një djalë dhe tre vajza: Filipi, Ilma, Doloreza dhe Anisa.

Llambi Llukë Loshi u martua me Dhoksie Lili Nakën nga Delisufi, kanë dy djem e një

vajzë: Ladin, Aurelin dhe Valin. (Lili Naka - Dëshmor i LNÇL).

Vladimir Llambi Loshi u martua me Vjollca Fadil Kamberi nga Vlora dhe kanë dy fëmijë, Mario dhe Kjara.

Aurel Llambi Loshi u martua me një vajzë nga Mifoli.

Vali është martuar me Kristaq Nushi.

Nasi Llukë Loshi u martua me Jorgjie Kiço Gjoka nga Himara, kishte dy djem e dy vajza. Një djalë i vdiq 16–17 vjeç, ndërsa Mitaqi dhe Teuta u rritën, u martuan dhe kanë fëmijë. Kanë emigruar në Greqi. Atje kanë marrë edhe të ëmën, Jorgjien; Nasi vdiq në vitin 2008.

Nasi Llukë Loshi (në karrocë), gruaja e tij, Jorgjia dhe një mik nga Novosela

Petro Llukë Loshi (Peçua) u martua me Rudina Kiço Gjipalin nga Dukati, kanë një djalë e 4 vajza: Fatmirin, Shpresën, Engjëllushen, Lauretën dhe Boranën.

Engjëllushja u martua me Leonard Peço Qorrin në Delisuf.

Laureta u martua me Arben Gori Bërdallin në Poro.

Borana aktualisht është e pamartuar.

SOTIR KOLI LOSHI

Sotir Koli Loshi u martua me Sofie Mihal Çunin nga Dëllënja, kanë dy djem e 4 vajza: Todin, Vllasin, Andonetën, Mellaninë, Anën dhe Lizën.

Todi Sotir Loshi është martuar tri herë. Me gruan e parë, Sofie Sotir Zoi nga Pish-Porua, ka 2 djem, Xhoxhin dhe Llazin. Me të u divorcua dhe, pas disa vjetësh, mori Veziko Bocajn nga Ramica. Me Vezikon kanë një vajzë, Donikën.

Todi Loshi, Llazi Hajdini dhe Thoma Çuni

Me Vezikon kaluan shumë mirë deri sa të dy dolën në pension por, fatkeqësisht, Vezikua u sëmur papritur dhe shumë shpejt Todin e la vetëm dhe në dëshpërim të thellë. Pas 3–4 vjetësh të vdekjes së Vezikos, Todi u detyrua të marrë një grua tjetër, por edhe me këtë fati nuk e ndihmoi, sepse Todit i ra një paralizë, duke i bllokuar një dorë e një këmbë, nga ana e majtë. Nuk i mungon kujdesi i jashtëzakonshëm i Lelasë, e bija e Shyqyri Gorrishtit, por tani nuk është më ai Todi që duhej të ishte. Edhe tani në moshë të kaluar, nuk i la fati të pleqëronin si dëshironin ata. Shpesh herë Todi bie në dëshpërim të madh, por Lelaja, një grua fisnike dhe e kulturuar, e mban me kurajë dhe po i shton jetën me të gjitha shërbimet e nevojshme.

Todi, që nga viti 1960 shkoi në Vlorë, atje u arsimua me shkollë të lartë, punoi e jetoi

Vllas Loshi

në kushte shumë të mira ekonomike. Edhe sot Todin e kanë zili gjithë njerëzit që e njohin për zotësinë e aftësitë personale të tij për përballimin e jetës personale e familjare.

Fëmijët e Todi Loshit janë martuar dhe shumuar, kanë emigruar jashtë shtetit dhe kanë ndërtuar jetën e tyre, ndërsa Todi është i malluar për ta dhe shumë i dëshpëruar nga që nuk vijnë dot për ta parë e ngushëlluar.

Vllasi Sotir Loshi u martua me Rinën e Qiric Gazhelit nga Dukati i Vlorës, kanë dy djem e një vajzë: Mihallaqin, Ilian dhe Liljanën.

Mihallaq Vllasi Loshi u martua.

Ilia Vllasi Loshi u martua.

Liljana u martua me Kasem Gremin nga Patosi.

Vajzat e Sotir Loshit:

Andoneta u martua me Dhori Qarrin në Novoselë, kanë 3 djem: Benin, Piron dhe Ilirin.

Mellania u martua me Loli Kozma Nasin në Poro, kanë dy djem e një vajzë, Roberti, Margariti dhe Enkelejda.

Ana u martua me Themi Petro Dashin në Delisuf, kanë dy djem e dy vajza: Elidona, Dorjani, Shpresa dhe Astriti.

Liza u martua, me burrin e parë ka një djalë Gentin, me burrin e dytë, Pandi Kriston, ka dy djem. Kanë emigruar familjarisht në Greqi.

Shënim: Në Vlorë janë edhe Marko e Llazi Loshi, po nga Loshajt e Poros. Këta ikën të vegjël në Vlorë, që nga viti 1930 apo më shpejtë. Atje u shtuan me shumë djem e vajza.

DHORI LOSHI

Dhori Jorgji Loshi kish marrë Marien e Koçi Zhezhës nga Gryka dhe kanë dy djem e një vajzë: Palin, Janin dhe Katen.

Pal Dhori Loshi u martua me Sena Uan Zakën nga Zhuka, kanë 3 djem e një vajzë: Trifonin, Andrean, Stavren dhe Vangjelinën.

Trifon Pali Loshi u martua me gruan e parë Orfan Mino Dashi nga Gryka, kanë një djalë, Saimirin. Me gruan e dytë, Anën nga Marinëza e Fierit, kanë një vajzë.

Andrea Pali Loshi u martua me Gjenovefa Kito Gjonçarin nga Zhuka, nuk kanë lindur fëmijë. Kanë marrë një djalë të Kristaq Koli Zakës dhe e kanë birësuar ligjërisht, quhet Mario Andrea Loshi, i datëlindjes 16.08.2002.

Stavri Pali Loshi u martua me Gjenovefa Jani Rragazin nga Lushnja, kanë dy djem: Ledi dhe Ermali.

Vangjelina Pali Loshi u martua me Andon Monen në Levan të Fierit, kanë një djalë e dy vajza.

Jani Dhori Loshi u martua me Afrovitin nga Dhërmiu, kanë 3 djem, Theodhorin, Rolandin, Vironin dhe dy vajza.

Thodhori Jani Loshi u martua me Linditën nga Marinëza e Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Kristianin dhe Elenën.

Viron Jani Loshi u martua me Silvanën nga Beshishti, kanë dy vajza.

Roland Jani Loshi u martua me Lelenë nga Marinëza, kanë një djalë.

VASIL KOZMA LOSHI

Vasil Loshi u martua me dy gra. Me të parën s'kishte femijë. Me të dytën ka lindur dy vajza: Liria dhe Gona.

Liria është martuar Ndoni Petro Kolën në Poro dhe Gona me Themi Pali Nakën në Poro.

THOMA KOZMA LOSHI

Thoma Loshi u martua me Ksandën e Kroni Çukos nga Porua dhe lindën 4 djem e dy vajza: Kozman, Josifin, Minellën, Pandin, Lirinë dhe Marinën.

Kozma Thoma Loshi u martua me Dashuri Rahman Ramadani nga Maliqi i Korçës, kanë 3 djem e një vajzë, Shkëlzeni, Bedari, Fatjoni dhe Elda.

Josif Thoma Loshi u martua me gruan e parë, Urani Jorgji Tereziun nga Bestrova, ka dy djem e një vajzë: Edin, Bertin dhe Enkelejdën: me gruan e dytë, Drita Mënajn nga Drashovica, ka dy vajza: Linditën dhe Lirinë.

Minella Thoma Loshi u martua me gruan e parë, Katina Vangjel Koçin nga Palasa, ka dy djem: Thoman (Tomi) dhe Leonardin; me gruan e dytë, nga Novosela, aktualisht nuk ka fëmijë, jetojnë në Greqi.

Pandi Thoma Loshi u martua me Zhani Luçi Naçin nga Porua, kanë 3 vajza: Nertilën, Klodetën, Danielën.

Liria vdiq e re, 20 vjeçe, pa u martuar.

Maria u martua me Nelo Çaushin nga Karbunara e Vlorës, kanë dy djem: Markon dhe Nelmirildon.

PALI JORGJI LOSHI

Pali Jorgji Loshi nga Porua ka lënë dy djem: Markon dhe Llazi Loshin. Ata ikën në Vlorë para vitit 1930. Në Vlorë kanë jetuar, e jetojnë pasardhësit e tyre.

Marko Pali Loshi u martua me Urani Lepurin nga Novosela, kanë lënë 4 djem e dy vajza: Minellën, Kristaqin, Ilian, Vason, Jorgjien dhe Kristinën. Të gjithë janë të martuar.

Minella është martuar në Vlorë, Kristaqi në Vlorë, Ilia është martuar të bijën e Pandeli Mitës, Vasua me të bijën e Llazi Matës, Jorgjia u martua me Pandeli Hyson nga Novosela dhe Kristina u martua në Himarë.

Llazi Pali Loshi u martua me Kristulla Pilo Semën nga Fieri, kanë lënë 5 djem e një vajzë: Janin, Tokliun, Kozman, Llambin, Vironin dhe Ritën.

Jani Llazi Loshi u martua me Marien nga Libofsha, kanë 3 djem e një vajzë: Ardin, Ilirin, Elidonin dhe Aldën.

Tokli Llazi Loshi u martua me një vajzë nga Kicajt e Libofshës, kanë dy djem e një vajzë: Altinin, Lorencin dhe Dolorezën.

Kozma Llazi Loshi u martua me Olin nga Frakulla, kanë 3 djem: Florianin, Llazarin dhe Benardin.

Viron Llazi Loshi u martua me vajzën e Thoma Mones nga Pish-Poro e Fierit.

Rita Llazi Loshi u martua me një çam në Vlorë.

(Tregoi Petro Sema në datën 15.11.2009).

Në Delisuf ka qenë një Dhimo Loshi, i ardhur nga Kavakllia e Fierit, rreth vitit 1920. Ka jetuar deri në vitin 1930 dhe nuk la fëmijë. nuk kishte të bënte me Loshajt e tjerë të Poros. Jani Llazi Loshi ka biseduar me shumë grekë (arvanitas) me mbiemrin Loshi, në ishullin Poros në Greqi dhe ata i kanë thënë se Loshajt e Poros së Vlorës e kanë origjinën nga Loshajt e ishullit Poros në Greqi. Ata flisnin shqip, arvanitasen e vjetër.

LLAQI KRISTAQ LOSHI, DËLLËNJË

Llaqi Kristaq Loshi është i biri i Kristaq Loshit nga Porua. Kristaqi vdiq i ri, duke lënë vetëm Llaqin e vogël. E shoqja e Kristaq Loshit iku dhe u martua në Pish-Poro duke marrë me vete edhe të birin, Llaqin.

Llaqi u rrit në Pish-Poro të Fierit dhe erdhi në Dëllënjë e u martua me të motrën e Kozma Hudhrës në Dëllënjë dhe kanë lindur një djalë e dy vajza: Viktorin, Natashën dhe Teutën.

Viktor Llaqi Loshi është martuar me Shqiponja Pilo Stefën nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë.

Natasha Llaqi Loshi është martuar me Thoma Andrea Kërrin në Delisuf.

Teuta Llaqi Loshi është martuar në Topojë.

SOTIR LLAMBRO

Sotir Llambro Mojallia është martuar me Gona Jorgji Matën në Poro. Sotiri është nga Delisufi por ka ardhur në Poro para 50 vjetëve dhe ka qenë kuadër i Kooperativës Bujqësore në Poro, që kur ajo u formua në vitin 1956, dhe deri sa doli në pension.

Sotir Llambro Mojallia

Sotiri me Gonën kanë lindur e rritur një djalë e dy vajza: Vasilin, Natashën dhe Linditën.

Vasil Sotir Llambro është martuar me Andoneta Llazi Llambron nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Almin dhe Marinën.

Natasha S. Llambro u martua me Kosta Kallogjerin nga Saranda, kanë një djalë e një vajzë: Erjonin dhe Marcelën.

Lida S. Llambro u martua me Nesti Peço Qarrin nga Porua, kanë Eneon, Kostandinën dhe Marion.

Sotiri iku familjarisht në Tiranë në vitin 1980. Të gjithë fëmijët kanë emigruar në Greqi.

Sotir Llambro, Goni, e shoqja dhe Vita me Llazi Hajdinin

LLAZI KOLI LLAMBRO (BALLUKU)

Llazi është i biri i Koli Ballukut, nga Berati. E ëma, Dafina, ka qenë e martuar më parë me Koli Ballukun dhe me të ka lindur Llazin. Llazin ajo e solli te Prendi, ky u rrit te Prendi, por nuk është biri i tij.

Dafina Llambro

Llazi Llambro

Llazi u martua me Llambrini Koven nga Pish-Porua e Fierit. Kanë 3 djem e 3 vajza: Arqilen, Nikon, Xhoxhin, Savetën, Andonetën dhe Mondën.

Arqile Llazi Llambro është martuar me Margarita Vasil Kungulli nga Porua, kanë një djalë e 4 vajza: Marigleni, Alma, Zamira, Eva dhe Elona.

Niko Llazi Llambro u martua me Gjena Vasil Peçon, kanë një djalë e një vajzë: Ilirin dhe Lidën.

Xhoxhi Llazi Llambro u martua me Drita Peti Matën nga Marinëza.

Vajzat e Llazi Llambros:

Saveta u martua me Arqile Llazi Qarri, Poro.

Andoneta u martua me Vasil Sotir Llambron, Poro, kanë një djalë e një vajzë.

Monda u martua dhe ka një djalë e një vajzë.

NISO LLAMBRO

Niso Llambro Llupi dhe një motër e tij që vdiq e vogël, erdhi prapa të ëmës, kur ajo u martua për herë të dytë me Themi Nakën në Delisuf. Sina ishte nga Ristajt e Shamogjinës. Ishte martuar me Llambro Llupin dhe, nga andej, solli Nison në Delisuf, te Themi Naka.

Me Themi Nakën ajo lindi edhe Todin, Marien e Uraninë.

Te Themi Naka gjeti dy djem, Palin dhe Vlashin. Kur vdiq Themi Naka, Sina mori djemtë saj, Nison dhe Todin, e shkoi në Grykë dhe ndërtoi shtëpi të re ku jetoi e i martoi djemtë. Sina ka qenë grua trime, rrinte me kobure në brez ... !

Niso Llambro u martua me Athinanë e Vasil Gjonit nga Dëllënja dhe me të lindi 4 djem e 3 vajza: Filin, Pilon, Luçin, Petraqin, Kristinën, Valentinën dhe Donikën.

Fili Niso Llambro u martua me Kristina Ndini Zhazhani nga Gryka, kanë 3 djem e dy vajza: Albertin, Dritanin, Bledarin, Mimozën dhe Lauretën.

Albert Fili Llambro u martua me Irena Fili Sollakun nga Semani, kanë një djalë, Kristin dhe një vajzë.

Dritan Fili Llambro u martua me Aulona Arqile Ll. Llambron nga Porua, kanë një djalë, Filipin.

Bledar Fili Llambro u martua me një gjermane, jetojnë në Gjermani.

Moza F. Llambrua u martua me Ludi Lamajn në Vlorë.

Laureta është në Itali.

Pilo Niso Llambro u martua me Arta Gjonin nga Portëza e Fierit, kanë një djalë e dy vajza: Taulantin, Lejdën dhe Oltën. Banojnë në Tiranë, por kanë emigruar.

Taulant Pilo Llambro u martua me një spanjolle. Aktualisht nuk ka fëmijë.

Luçi Niso Llambrua u martua me Farie Laze Mullain nga Treblova, kanë dy djem, Denisin, Arsenin dhe një vajzë.

Petraq Niso Llambrua u martua me Donika Petro Memecin nga Porua, kanë dy djem, Fatjonin, Amarildon dhe dy vajza.

ZOI MATA DHE MITI MATA

Zoi Mata la Uan Matën dhe Dafinën. Miti Mata la Jorgjin dhe Spiron. Spirua shkoi asqer dhe nuk u kthye më.

Uan Zoi Mata u martua me Kostandinën nga Lengajt e Fierit. Kanë lënë Kristullën, Nikon, Lion, Tolin, Lirinë dhe Marien.

Marie Uan Mata u martua me Lip Lalën në Kuçovë, kanë lënë dy fëmijë: Llukanin dhe Vasilikën.

Kristulla Uan Mata u martua me Niko Gavanin nga Vunoi i Himarës, banojnë në Babicë, të Vlorës. Kanë 4 fëmijë: 3 djem e një vajzë: Fjodorin, Piron, Bertin dhe Rajmondën.

Niko Uan Mata u martua me Evina Miti Bozon nga Kolonja e Lushnjës, kanë lindur një djalë e një vajzë: Bertin dhe Zamirën, banojnë në Fier.

Lio Uan Mata u martua me Vangjelina Andrea Davidhin nga Zhuka, kanë lindur një djalë: Petraqin. Liua u mbyt aksidentalisht në det, kur ishte ushtar në Himarë, në vitin 1953, dhe Vangjelina la djalin te gjyshi, Uan Mata dhe iku e u martua me Todi Kolën, në Poro.

Petraq Lio Mata u martua.

Toli Uan Mata u martua me Milla Stavre Moçkën nga Porua, kanë 3 djem e një vajzë: Nestin, Dritanin, Gramozin dhe Vjollcën.

Nesti Toli Mata u martua me Flora Koli Qarrin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë.

Dritan Toli Mata u martua me Mozën nga Vlora.

Gramoz Toli Mata u martua.

Liri Uan Mata vdiq e pa martuar, ishte mësuese në fshat.

Dafina, motra e Uan Matës (ose Dafa), u martua në Vlorë me Jorgji Sinjën nga Berati dhe ka lindur dy djem: Thoma Jorgjin dhe Miti Jorgjin.

Shënim: Gruaja e Uan Matës kishte edhe dy motra të tjera, Linën, gruaja e Nasi Përrit nga Zhuka dhe Vala, gruaja e Taqo Grekut në Aliban. Këto 3 motra, Kostandinja, Lina dhe Vala ishin bijat e Lengut nga Fieri. Kur vdiq babai tyre në Fier, Lëngu, e ëma e këtyre vajzave u martua me Naqe Helmin në Dëllënjë, por nuk lindi fëmijë me të.

JORGJI MITI MATA

Jorgji Miti Mata ishte kushëri parë me Uan Matën. Ishte i martuar me Dafinën e Davidh Ristës nga Qenasi i Fierit. Kanë 3 vajza e një djalë: Gonin, Millën, Orfaninë, dhe Nonda Mata.

Goni Jorgji Mata u martua me Sotir L1ambron nga Delisufi-Poro, kanë një djalë e dy vajza.

Nonda Mata

Orfania Jorgji Mata u martua me Josif Uan Lepurin në Delisuf.

Nonda Jorgji Mata u martua me Kristina Leksi Mërtirin nga Alibani dhe kanë 8 fëmijë: Liljanën, Jorgjin, Lizën, Aleksandrin, Agronin, Verën, Ilirin dhe Brunën.

Liljana u martua me Loni Stavri Subashin në Zvëmec, kanë një djalë e një vajzë.

Jorgji Nonda Mata u martua me Tatjana Thoma Ll. Hudhrën nga Porua, kanë dy djem, Oltin dhe Loranin.

Aleksandër N. Mata u martua me Mira Themi Mbyetin nga Delisufi, kanë dy vajza: Kristinën dhe Vangjelinën.

Agron N. Mata u martua me Elvira Llambi Kola Mitraj në Poro, kanë dy djem: Nondën dhe Orestin.

Liza Nonda Mata u martua me Albert Miço Moçkën në Poro, kanë 3 vajza.

Vera N. Mata u martua në Vlorë me Ferdinand Bega Boçaj nga Ramica, kanë dy djem e një vajzë.

Ilir Nonda Mata u martua me Egla Filip Trifon Kolën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Fabion dhe Linën.

Bruna N. Mata u martua me Renci Nasho Subashin në Zvëmec. Kanë një djalë e një vajzë.

LLUKAN LALA (MATA)

Llukan Lip Lala është i biri i Lip Lalës nga Kuçova, por në Poro njihet Llukan Mata, sepse ka ardhur te gjyshi, Uan Mata. Këtu u rrit se i vdiq nëna e tij që ishte bija e Uan Matës nga Porua.

Maria vdiq e re dhe la një djalë e një vajzë, Llukanin dhe Vasilikën. Llukanin e mori gjyshi, e rriti dhe e martoi në Poro, me të bijën e Thanas Kola (Mitraj).

Lluka Lipi Lala u martua me Milla Thanas Kolën dhe kanë 5 fëmijë, dy djem e 3 vajza: Artanin, Marion, Valbonën, Silvanën, Lauretën.

Artani u martua me një italiane dhe ka një djalë, Lukan.

Mario u martua me Nertila Llambi Lepurin nga Novosela, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Valbona u martua me Meço Matodashajn nga Smokthina.

Silvana u martua me Jani Gërdhuqin nga Bestrova.

Laureta u martua me Kozma Bakën në Aliban.

LLAMBRO MARINA

Llambro Marina është banor i vjetër në Poro. Ai u martua me një grua të ve nga Frakulla, me të ëmën e Uan Marinës, që e mori prapa, po në fakt është Uan Hëna dhe jo Uan Marina, siç njihen edhe djemtë e tij sot në Poro.

Kristo Marina

Llambro Marina la dy djem e një vajzë: Kriston, Kozman dhe një vajzë, Marie, që e kish marrë grua Qiric Gjonçari në Zhukë.

Kristo Llambro Marina u martua me Naunkën nga Pojani i Fierit dhe kanë 4 vajza: Konxhen, Neftën, Silën dhe Zoicën.

Konxhia u martua me Stefan Kronin në Kryegjatë-Pojan, Fier.

Nefta u martua me Pano Naqo Kola (Mitraj) në Poro.

Sila u martua me Thoma Qorrin në Delisuf.

Zoica u martua me Koçi Dashin në Delisuf.

Xha Kristua nuk la djem. Birësoi një djalë që e mori në brefotrof po ai nuk jetoi, për pak javë vdiq. Kristo Llambro Marina nuk ka pasardhës meshkuj.

KOZMA LLAMBRO MARINA

Kozmai sa u martua, u sëmur e vdiq, nuk la fëmijë. Kishte marrë për grua të bijën e Xoxi Rrungajës nga Dëllënja (Xoxi Shurdhit). Nusja iku te i ati në Dëllënjë dhe u martua me Stavre Fani Moçkën, në Poro.

Shënim: Vangjel Marina e Lio Marina, dhe gjithë djemtë e tyre, nuk janë nga fisi Marina, por Hëna.

Uan Marina (në fakt është Uan Hëna). Është Hëna sepse e ëma e solli prapa, te Llambro Marina në Poro, të cilin e kishte me Koli Hënën, mbiemrin në të vërtetë është Hëna.

Uan Koli Marina u martua me Dafinën nga fisi i Linajve të Frakullës dhe lindën dy djem e një vajzë: Vangjelin, Lijon dhe Vidën.

Vangjel Uan Marina u martua me Vitoren, të bijën e Sako Moçkës nga Porua, dhe lindën 9 fëmijë: 4 djem e 5 vajza: Llazin, Apostolin, Piron, Blenadrin, Elenin, Llambrininë, Neftën, Uraninë dhe Mirandën.

Llazi Vangjel Marina

Llazi Vangjel Marina u martua me Luiza Thoma Loni Helmin nga Dëllënja, dhe kanë një djalë e 4 vajza: Ervinin, Julindën, Anilën, Enerjetën dhe Renatën.

Ervin Llazi Marina u martua me një italiane, Amalja, dhe aktualisht kanë dy vajza, Françeska dhe Erika.

Apostol Vangjel Marina u martua me Drita Niso Thanon nga Porua, kanë 3 djem: Arjanin, Saimirin dhe Redianin.

Piro Vangjel Marina u martua me Valbona Mehdi Hoxhën nga Gërneci, kanë dy djem e një vajzë: Aleksandrin, Arsenin dhe Lidën.

Bledar Vangjel Marina u martua me Rovena Pandi Thanon nga Pish-Porua, kanë një djalë e një vajzë: Danielin dhe Vitorian.

Vajzat e Vangjel Marinës:

Eleni u martua me Mihal Dhori Monen në Poro.

Urania u martua me Thanas Ristën në Novoselë.

Nefta Vangjel Marina u martua me Llazar Mino Nakën në Delisuf.

Llambrinia u martua me Miço Vangjel Lepurin në Poro.

Miranda aktualisht është beqare.

LIO UAN MARINA

Lio Uan Marina u martua me Kristina Miti Leshin nga Mifoli dhe kanë lindur 4 djem e dy vajza: Thoman, Petraqin, Lefterin, Kristaqin, Milikën dhe Lirinë.

Thoma Lio Marina u martua me Milla Miti Dashin nga Delisufi, kanë një djalë e 3 vajza: Thanasin, Vasilikën, Shpresën dhe Donikën.

Vasilika Thoma Marina u martua me Fredi Loni Ristën në Novoselë.

Shpresa Thoma Marina u martua me Mondi Kozma Nasin nga Porua, aktualisht kanë një vajzë.

Thanasi e Donika aktualisht janë beqarë.

Petraq Lio Marina u martua me Leni Dule Hoxhën nga Gërneci, kanë 3 djem: Erjonin, Robertin, Nikollën.

Lefter Lio Marina u martua me Afërdita Stavre Semën nga Pish-Porua, kanë dy vajza: Kristinën dhe Andonetën.

Kristaq Lio Marina u martua me Dhoksie Tako Koçi nga Dëllënja, kanë 3 djem: Mateon, Andrean dhe Ilirianin.

Vajzat e Lio Marinës:

Milika u martua me Toli Fili Bërdallin, në Poro.

Liria u martua me Niko Lako Kolonjarin, në Poro.

VIDA UAN MARINA

Vida u martua me Fili Llukë Loshin, në Poro, kanë një djalë e 5 vajza: Kristaqin, Violetën, Rajmondën, Elcën, Florikën, Almën.

LAZE HËNA

Laze Koli Hëna erdhi nga Frakulla në Poro. E solli Uan Marina se e kishte vëlla. Të dy ishin djemtë e Koli Hënës nga Frakulla. Kur vdiq Koli Hëna, e shoqja që ishte bijë nga Hudhrajt e Dëllënjës, la në Frakull Llazin (Lazen) që ishte më i madh se Uani dhe erdhi në Poro e u martua me Llambro Marinën, duke marrë me vete edhe djalin më të vogël, Uanin. Uani u rrit te baba Qafori Llambro Marina dhe mori mbiemrin Marina. Me vonë, kur Uan Marina ishte më në gjendje ekonomike se i vëllai, Lazja, që ishte në Frakull, ndërhyri dhe e solli në Poro familjarisht dhe ai u vendos në shtëpi afër Kolajve, në fund të fshatit, Marinë. Aty pranë kishin ara edhe Marinajt, edhe Hajdinajt, edhe Kolajt nga perëndimi. Tokat ishin disa të mira dhe xha Lazia aty ndenji disa vite, sa rrojti vetë dhe e shoqja.

Laze Hëna la dy vajza: Licën dhe Janën.

Lica u martua me Kol Liço në Dëllënjë dhe la një vajzë, Kristinën e cila u martua me Loni Mërtirin në Pish-Poro. Ndërsa Jana e Laze Hënës mori burrin brenda, me të cilin bëri dy vajza, Dhoksien dhe Fanien dhe vdiq shpejtë. Jana u martua përsëri me Vasil Prifti në Poro duke marrë dhe dy vajzat me vete. Pas kësaj martese, Jana vdiq, kurse vajzat e saj i rriti Uan Marina në Poro, sepse i kishte mbesa.

Djemtë e Lices, që lindi me Rrapi Stronin, dhe Kristinën, që lindi me Koli Liçon janë quajtur deri vonë me xha Uanin dhe me djemtë e tij, Vangjel e Lio Marinën si kushërinj. Jani me Kristinën kanë jetuar në Vlorë. Loni ka qenë polic për shumë vjet, dhe në Vlorë ka djemtë e tij.

Vajza tjetër e Laze Hënës, Jana, u martua me Pali Minon (mesa thonë ky ishte nga Vlora) dhe lindën dy vajza: Dhoksien dhe Fanien. Pali Minua vdiq. Edhe prindërit e Janës, (Lazia) kishin vdekur. Jana mori vajzat e saj dhe u martua me Vasil Kozma Priftin në Poro dhe jetuan afro 10 vjet bashkë. Jana e mbylli jetën shpejt. Fëmijë nuk lindën. Vajzat, i mori xha Uan Marina, i cili i rriti dhe i martoi, Dhoksien me Niso Kristo Mojallinë dhe Fanien me Llazi Qiric Garron, Poro.

Uan Marina hodhi dorën e i mori dy bonjakët se i kishte vajzat e mbesës së tij, vajzat e Janës së Laze Hënës që atë e kishin vëlla me nënë e baba.

DAVIDH MBYETI, DELISUF

Me prejardhje nga Mbyeti i Fierit. Davidhi Mbyeti u martua me Goren dhe kanë lindur Taqon, Kolin dhe Sijën.

Taqo D. Mbyeti u martua me Evgjeni Dhimitër Kërrin, nga Gryka, kanë lindur 3 djem e 4 vajza: Themiun, Dhimitraqin, Llambin, Elvirën, Lidën, Valentinën dhe Elkën.

Themi Taqi Mbyeti u martua me Violeta Llazi Plakun nga Delisufi, kanë 4 vajza dhe një djalë: Marjetën, Brunildën, Anilën, Jonadën dhe Ervisin.

Marjeta u martua me Aleksandër Nonda Matën në Poro.

Brunilda u martua me Leonard Fani Moçkën në Poro.

Anila u martua me Eduard Leko Kostandin Jankën në Poro.

Ervisi aktualisht është beqar.

Dhimitraq Taqo Mbyeti u martua me Mellani Pali Memecin, kanë dy djem e 3 vajza.

Sije Davidh Mbyeti u martua me Zoi Daiun në Nartë.

Fëmijët e Dhimitraq Taqo Mbyetit:

Klajdi, aktualisht është beqar.

Andre Dh. Mbyeti, aktualisht është beqar.

Florida u martua me Ilia Leksi Shytin në Poro.

Mimoza u martua me Arben Rrapin në Fitore, Novoselë.

Ermira u martua.

Llambi Taqi Mbyeti u martua me Florida Pano Kolën (Mitraj) në Poro, kanë 3 djem: Demirin, Amoreun dhe Kristianin, aktualisht janë beqarë.

Vajzat e Taqo Mbyetit:

Elvira u martua me Vangjel Golemin në Babicë.

Lida u martua me Petraq Lame Monen në Pish-Poro.

Valentina u martua me Piro Silon në Pish-Poro.

Elka u martua me Vasillaq Rrungajën në Dëllënjë.

KOL MBYETI

Kol Davidh Mbyeti u martua me Kristina Mane Dashin nga Gryka, kanë lindur 6 djem, Theodhorin, Piron, Mihallaqin, Astritin, Lefterin, Ligorin dhe 3 vajza, Vangjelinën dhe dy të tjera.

Theodhor Koli Mbyeti u martua me Luiza Jani Lerën nga Delisufi, kanë dy djem: Mariusin dhe Ligorin.

Piro Koli Mbyeti u martua me Natasha Dervish Dalipin nga Peshkëpia e Vlorës, kanë dy djem: Ledianin dhe Nikollën.

Mihallaq Koli Mbyeti u martua me Vasilika Ndoni Markun në Delisuf, kanë 4 vajza: Sonilën, Kristinën, Manielën dhe Marikën.

Astrit Koli Mbyeti u martua me Albana Metajn nga Ferrasi, kanë dy djem: Markon dhe Jorgjin.

Lefter Koli Mbyeti u martua me Lida Toli F. Bërdallin në Poro, kanë një djalë e një vajzë: Antonion dhe Vangjelinën.

(Lefteri u vra me makinë dhe i la fëmijët fare të vegjël).

Ligor Koli Mbyeti u vra aksidentalisht në Itali, ishte beqar.
Vangjelina Koli Mbyeti u mbyt në lumin e vjetër kur ishte 7-8 vjeçe.

KOÇI THOMA MBYETI, DELISUF

Koçi Th. Mbyeti u martua me Ndinen nga Selenica me të cilën nuk lindi fëmijë dhe u divorcuar. Mandej u martua me Olimbi Thanas Mitron nga Delisufi, kanë 5 djem e 3 vajza.

Theodhoriu u martua me Anila Kondakçiun nga Vërria e Fierit, kanë dy djem: Tomin dhe Stefanin.

Minua u martua me Vojsava Alushin nga Selenica, kanë 3 vajza: Dorinën, Xhasinën dhe Stelën.

Arturi u martua me një vajzë nga Myrtajt nga Trevllazëri, kanë një djalë e një vajzë: Dorianin, dhe Xhoxhën.

Iliriani u martua me Marcela Llazi Zakën nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë: Kostandinin dhe Glorian.

Vajzat e Koçi Mbyetit:
Milla u martua me Leonidha Naun Gjonçari nga Delisufi.
Xhulieta aktualisht është beqare.
Vasilika aktualisht është beqare.
(Tregoi Milla Gjonçari 40 vjeçe).

Vajzat e Thoma Mbyetit:
Vita ishte martuar me Miti Dokon në Aliban.
Fina ishte martuar me Miço Uan Priftin në Poro.
Kate ishte martuar me Kozma Markun, vdiq në lindje.

LAKO MBYETI NË DËLLËNJË

Lako Mbyeti ishte i vjetër në Dëllënjë. Është një fis me Mbyetallarët e Delisufit.

Lako Mbyeti ishte i martuar me Dafinën, e bija e Koli Priftit nga Zhuka. Ata lanë 3 djem: Mitin, Petraqin dhe Koçin, si dhe dy vajza: Dhorën dhe Dhoksien.

Miti Lako Mbyeti u martua dy herë por gratë nuk i ndenjën, u divorcuan shpejtë. Miti mbeti pa fëmijë dhe vdiq në moshë të thyer.

Petraqi u mbyt në lum, në moshë të re.

Koçi Lako Mbyeti u martua me Zanën dhe kanë 2 djem: Artanin dhe Mirin (kanë emigruar).

Nëna e Lako Mbyetit ishte e bija e Jorgji Semës, motra e Papa Lekos.

LABO QISHA

Në Dëllënjë ka pas qenë edhe një Labo Qisha i cili la vetëm një vajzë, Viqen, që e kish marrë Kozma Dumi nga Vlora.

Kozma Dumi erdhi në Dëllënjë rreth viteve 1938–1939 dhe, pas pak viteve, iku përsëri në Vlorë. Ai kishte 3 djem: Jani Dumin dhe dy të tjerë, një nga të cilët u mbyt në det në ato vite. Jani ka banuar në Skelë të Vlorës, në Lagjen Kume.

UAN KOZMA MBYETI, DELISUF

Me prejardhje nga Mbyeti i Fierit. Atje e kanë pasur mbiemrin Liço.

Uan Kozma Mbyeti u martua me Urani Davidhin, kanë lindur dy djem e 4 vajza: Vangjelin, Luçin, Neftën, Leonorën, Margaritën, Jorgjien.

Vangjel Uan Mbyeti u martua me Gore Kozma Sillo nga Pish-Porua, kanë 4 djem e 5 vajza: Vasilin, Edisonin, Kreshnikun, Voltisin, Tatjanën, Teftën, Artën, Rudinën dhe Suzanën.

Vasil Vangjel Mbyeti u martua me Djana Vangjel Çobanin nga Sheqishtja, kanë dy djem: Juldenin dhe Vangjelin.

Edison V. Mbyeti u martua me Majlinda Stavre Thanasin nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë: Xhonlulën dhe Ediolën.

Kreshnik V. Mbyeti u martua me Olsida Skënder Canaj nga Vlora, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Voltisti aktualisht është beqar.

Tatjana V. Mbyeti u martua me Themi Çobankën në Sheqishtë, Fier.

Arta u martua me Saliko Mezurin, Babicë, Vlorë.

Tefta u martua me Halim Bidon në Rreth Fikth, Fier.

Rudina u martua me Vllasi Lefter Lëngun në Vlorë.

Suzana u martua dhe u divorcua, ka një vajzë.

LUÇI UANI MBYETI

Luçi Uani Mbyeti u martua me Kristina Perikli Gjonçarin nga Zhuka, kanë një djalë e 3 vajza: Gentianin, Luizën, Floretën, Shpresën.

Gentian Luçi Mbyeti u martua me një ruse, aktualisht ka një djalë, Kristianin.

Luiza Luçi Mbyeti u martua me Shkëlqim Mazen në Vlorë. Është nga fisi i Heroit të Popullit Kanan Maze, luftëtar i 1920-ës.

Flutura Luçi Mbyeti u martua me Lila Petro Gjonçari në Poro.

Shpresa aktualisht është beqare.

Vajzat e Uani Mbyetit:

Nefta u martua me Thoma Loni Helmin në Dëllënjë.

Leonora u martua me Gori Uani Lepurin në Delisuf.

Margarita u martua me Lio Miti Çunin në Dëllënjë.

Jorgjia u martua me Aristir Llazi Hudhrën në Poro.

Shënim: Urania, gruaja e Uan Mbyetit, e kishte vëlla Vangjel Fitën në Vlorë. Ai e kish mbiemrin Fite ose Thomai. Siç njihet me dokumente se këtë mbiemër mbajnë sot djemtë e xha Vangjelit në Vlorë, tani pse kjo nënë Urania të ketë ardhur nga mbiemri Davidhi?

Pse i vëllai i saj Vangjel Fitja ose Thomai nuk e kanë mbiemrin Davidhi ose ajo Fite ose Thomai? Këtë s'e shpjegon askush.

MITI KOSTANDIN MËHILLI

Miti K. Mëhilli ishte nga Bubullima e Lushnjës, ka ardhur në Poro kur u martua me Ristanën, të bijën e Tonçi Gjinit. Ai ishte njeri pa njeri. Ishte rritur me të keq nëpër dyert e botës, e argat aty-këtu ku gjente punë.

Duke ikur andej-këndej përfundoi në Nartë. Jani Shtetua nga Narta ndërmjetësoi dhe e ndihmoi që u martua me Ristanën e Tonçi Gjinit në Poro.

Miti K. Mëhilli, bashkë me Ristanën, lindën 10 fëmijë: Koçin, Rrapin, Vllasin, Vangjelin, Marien, Llambrininë, Thanasullën, Vasilikën, Evgjeninë dhe Natashën.

Koçi Miti Mëhilli u martua me Eli Ligor Subashin nga Zvërneci, kanë dy djem e dy vajza: Adrianin, Arbenin, Majlindën dhe Irenën.

Koçi Miti Mëhilli

Adrian Koçi Mëhilli u martua me Majlinda Niko V. Kolën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Ligorin dhe Majtilën.

Arben Koçi Mëhilli u martua me Majlinda Hajdar Ferkon nga Plyku, kanë një vajzë: Elicën.

Majlinda Koçi Mëhilli u martua me Agim Llaq Lepurin nga Porua.

Irena Koçi Mëhilli u martua me Altin Llukan Profkën në Seman, Fier.

Rrapi Miti Mëhilli u martua me Vita Subashin nga Zvërneci, kanë 4 vajza: Sofikën, Naunkën dhe dy të tjera.

Vllasi Miti Mëhilli u martua me Neti Sotir Gjonin nga Dëllënja, kanë dy djem dhe një vajzë, Altini, Gaqi dhe Irma.

Vangjel Miti Mëhilli u martua me Vasilika Fekon nga Lapardhaja e Vlorës, kanë dy vajza e një djalë: Miltionin, Merisin dhe Xhulianën.

LAMI MARKU, DËLLËNJË

Nipërit e tij thonë se Lami Marku e ka origjinën nga Berati.

Lami Marku gruan e parë e kishte nga Çunajt, në fshatin e tij Dëllënjë, ndërsa gruan e dytë e kishte nga Semani.

Xha Lami, la 3 djem e 3 vajza. Me gruan e parë kishte Katen që mori Tonçi Kola në Poro, ndërsa të gjithë të tjerët i kishte me gruan e dytë: Janin, Vllasin, Gorin, Nijen dhe Margën.

Jani Lami Marku u martua me Ngjelën e Joti Kolës nga Porua dhe lindën 3 djem e 6 vajza: Andrean, Llambin, Sotirin, Silën, Lirën, Kristinën, Mirandën, Donikën dhe Linditën.

Andrea Jani Marku u martua me Natasha Janaq Hilën nga Mifoli dhe kanë një djalë e dy vajza: Agronin, Marjanën dhe Anilën.

Llambi J. Marku u martua me Marigo Llazi Rrungajën nga Dëllënjë, kanë një djalë e dy vajza: Agimin, Erjonën dhe Vangjelinën.

Agim Llambi Marku u martua me Eljona Ilia Lerën nga Delisufi, kanë një djalë, Davidhin.

Erjona u martua me Besnik Vangjel Pilon, Pish-Poro.

Sotir Jani Marku u martua me Anila Pilo Hajdinin nga Porua, kanë dy djem: Arjanin dhe Aldon.

Sila Jani Marku u martua me Llazi Thoma Dashin.

Liria u martua me Koli Janaq Qarrin në Aliban.

Kristina u martua me Fili Thoma Gjindalin në Delisuf.

Miranda Jani Marku u martua me Dhimitraq Kroni Mitrushin (Baba) në Dëllënjë.

Donika Jani Marku u martua me Nonda Llazi Naçin në Poro.

Lindita u martua me Niko Koçi Kërrin në Delisuf.

VLLASI LAMI MARKU

Vllasi Lami Marku u martua me Marie Llazi Hudhrën nga Gryka, kanë dy djem e 7 vajza: Spiron, Koçin.

Parashqevija u martua me Gjergji Golemin në Verri.

Dhoksia u martua me Spiro Loni Nakën në Dëllënjë.

Andoneta u martua me Lipi Moçkën në Novoselë.

Liria u martua me Pano Leko Ndinin në Dëllënjë.

Natasha u martua me Rrapin në Topojë.

Moza u martua me Raqi Lule në Topojë.

Valbona u martua me Lili Rinën në Topojë.

Spirua u martua me Milla Thoma Helmin në Dëllënjë, kanë një djalë e dy vajza: Xhulianin, Manjolën dhe Kledën.

Koçi Vllasi Marku është i martuar.

GORI LAMI MARKU

Gori Lami Marku u martua me Tina Thanas Bushin nga Dëllënja, kanë dy djem e 6 vajza: Panon, Nikon, Milikën, Sofien, Florikën, Gjenovefën, Elcën dhe Lizën.

Pano Gori Marku u martua me Jorgjie Miti Todin nga Dëllënja, kanë një djalë e 3 vajza: Edin, Kledën, Nertilën dhe Kristinën.

Edi Pano G. Marku u martua në Topojë, ka një vajzë.
Niko Gori Marku u martua me Linditën nga Selenica dhe kanë një djalë e një vajzë.

Vajzat e Gori Markut:
Milika u martua me Stavre Lalën në Mifol.
Sofia u martua me Spiro Hyson në Novoselë.
Florika u martua me Stavre Qarrin në Mifol.
Gjenovefa u martua me Marko Tashin në Fier.
Elca u martua me Maks Karroqen në Verri, Fier.
Liza u martua në Vaso Miti Zakën në Dëllënjë.

Vajzat e Lami Markut nga Dëllënja:
Katja u martua me Tonçi Kolën në Poro.
Nija u martua me Rrapi Caushin në Fier.
Marga u martua me Thanas Vrushi në Delisuf.

Shënim: Të gjithë janë rritur me fukarallëk të madh, sepse edhe prindërit u vdiqën e i lanë të vegjël. Gori ka punuar me vite të tërë te Kungujt dhe në shtëpi të tjera. Margën e rriti Pali Zarikua dhe e martoi te Thanas Vrushi në Delisuf.

VANGJEL LAMI MARKU

Vangjel Lami Marku është i datëlindjes 1930, më i vogli nga djemtë e Lamit. Shkoi në Shtyllas të Fierit, derë më derë, duke punuar. U martua me një vajzë nga Përmeti dhe ka punuar në fermën e Levanit. Ka fëmijë, po nuk u dimë emrat.

KOSTANDIN MARKU, ZHUKË

Kostandin Marku ka ardhur në Zhukë nga Sheqishtja e Fierit dhe u martua me Liken, motrën e Llazi Kovës nga Gryka, dhe lanë 3 fëmijë: Todi, Gjena dhe Zoica.

Kostandini vdiq shpejt dhe e shoqja, Likja, u martua për herë të dytë me Loni Zarik Markun (tjetër Marku) në Daullas të Fierit, me të cilin lindi Kristaqin dhe Fanien.

Dy vajzat e Kostandin Markut u martuan në Grecalli të Fierit. Gjena u martua me Thoma Bushin, Zoica u martua me Kozman, por ajo vdiq shpejt e nuk la fëmijë.

Todi Kostandin Marku shkoi në Vlorë dhe u martua 3 herë. Me gruan e parë u divorcua shpejt, ndërsa me gruan e dytë, Pulien nga Devolajt e Beratit, ka një djalë e 3 vajza: Koçon, Xhulianën, Luçien dhe Elcën.

Koço Todi Marku u martua me Moza Gjergji (Gjeko) Nakën nga Dëllënja por që banon në Novoselë, dhe ka 2 vajza, jetojnë në Itali.

Todi ka edhe një djalë që ia ka dhënë të vëllait, Kristaqit, i cili e ka birësuar me dokumente të rregullta, që mban emrin Jorgo Kristaq Marku. Në të vërtetë ai është djali i Todit.

Kristaq Loni Marku është vëlla me nënë me Todi Kostandin Markun nga Zhuka, Loni Marku ishte nga Daullasi i Fierit. E ëma e Kristaqit, Likja nga Kovet e Grykës, kur i vdiq burri i parë, Kostandin Marku në Zhukë, u martua me Loni Markun dhe me të lindi Kristaqin dhe Fanien.

Kristaq Loni Marku u martua me Athina Tasi Doracin nga Frakulla, por nuk lindën fëmijë. Pas 30 e ca vjet martese, Athinaja vdiq pa fëmijë dhe Kristaqi u martua një vajzë të madhe në moshë, Veronika Taqo Moçka nga Novosela. Edhe ajo nuk ka lindur fëmijë me të. Jetojnë në Vlorë.

Kristaqi birësoi një djalë që mori te i vëllai, Todi K. Marku me emrin Jorgo Kristaq Marku.

Jorgo Kristaq Marku u martua me Afërdita Sotën nga Fieri, kanë një djalë e një vajzë: Joandron dhe Elonën.

Joandro aktualisht është beqar, ndërsa Elona aktualisht studion në Universitet, në Itali.

Jorgua, me fëmijët e gruan, jetojnë në Itali.

MARKAJT E GRYKËS

Kanë qenë 5 vëllezër: Kozmai, Lili, Llazi, Vangjeli, dhe një që ishte në Durrës. Babai i tyre quhej Jani.

Kozma Jani Marku u martua dy herë. Gruaja e parë, Katja, e bija e Thoma Mbyetit nga Delisufi, lindi 3 djem, Lefin, Ndonin dhe Nikon, kurse gruaja e dytë, Gjena nga Stringajt e Frakullës, e motra e Todi dhe e Llambi Stingës, lindi Milikën, Kristaqin, Petraqin, Dhimitraqin dhe Piron.

Gjena solli nga Rista i Novoselës 4 fëmijë të tjerë, Dhorin, Naunkën, Kiun, Vllasin. Ata u rritën në Grykë e në Delisuf dhe shkuan në fermën e Fitores dhe atje banojnë.

Fëmijët e Kozmait:

Lefi Kozma Marku u martua me Pulije Ristan Hudhrën nga Gryka, kanë 5 djem e 5 vajza: Bledin, Agimin, Golin, Aurelin, Mondin, Florën, Mirën, Katerinën, Linditën dhe Liljanën.

Bledi Lefi Marku u martua me Zoica Stavre Plakun nga Delisufi, kanë 3 vajza: Grorielën, Lorin dhe Starën.

Agim Lefi Marku u martua me Rozeta Harrilla Papën nga Shënpjetri i Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Xhulion dhe Anxhelën.

Aurel Lefi Marku u martua me Blertën nga Lushnja, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Mondi Lefi Marku u martua me Lina Agronin nga Bishani, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Kola Jan Marku u martua me vajzën e Lon Toles nga Gryka i cili ka qenë polic në Durrës ku edhe i ka fëmijët.

Vajzat e Lefi Markut:

Mira u martua me Piro Katen në Sheq Marinëz.

Flora u martua me Tomi Micin në Shënpjetër.

Katerina u martua me një grek.

Ndoni Kozma Marku u martua me Pavlina Naun Kostën nga Çuka e Sarandës, kanë 3 djem e dy vajza: Benin, Gentin, Ilirin, Vasilikën dhe Bonën.

Beni Ndoni Marku u martua me Elca Llazi Kungullin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Fabion dhe Valentinën.

Genti Ndini Marku u martua me Ida Mihal Priftin, kanë një djalë e një vajzë: Roberton dhe Paulën.

Ilir Ndini Marku u martua me Selda Sade Mbyetin nga Pish-Porua, aktualisht nuk kanë fëmijë.

Niko Kozma Marku u martua me Lumturi Thanas Jorgjin nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Elvinin, Betën dhe Etlevën. Nikua është marrë nga Naun Liçua në Dëllënjë për ta rritur dhe tani quhet Niko Liço, banon në Dëllënjë.

Milika Kozma Marku u martua me Vasil Koli Koçit në Poro, kanë një djalë e 3 vajza.

Petraq Kozma Marku u martua me Farfurinë nga, Novosela, kanë dy djem.

Kristaq Kozma Marku u martua me Vita Fili Bërdallin nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Ervinin, Anilën dhe Donikën.

Dhimitraq Kozma Marku u martua me Bardha Selam Cetën, kanë një djalë e një vajzë:

Erjonin dhe Ildën.

Spiro Kozma Marku u martua me Llamba Sotir Doçin nga fshati Fitore, Novoselë, kanë një djalë, Eugenin.

Shënim: Dhori, Kiu, Naunka dhe Vllasi janë nga fisi Rista dhe banojnë në Novoselë.

LILI JANI MARKU, GRYKË

Lili Jani Marku u martua me Llambën nga Roskoveci, lanë 3 djem e 3 vajza: Raqin, Koçin, Thomain, Letën, Donikën dhe Artën.

Raqi Lili Marku u martua me Marie Kozma Guberen në Vlorë, me origjinë nga Armeni, ka një djalë.

Koçi vdiq i rritur por i pamartuar.

Thoma Lili Marku u martua në Vlorë me Mbarimen, kanë një djalë e një vajzë: Ervisin dhe Fatjonën. Vdiq i ri.

Llazi Jani Marku u martua me Lena Liço Thanon dhe me të lindën dy vajza: Nolën dhe Likën.

Nola u martua në Berat dhe Lika u martua me Niko Qiric Garron nga Porua, kanë 4 djem e një vajzë.

Llazi Marku u mbyt aksidentalisht në lumin e vjetër duke i lënë vajzat e vogla. E shoqja, Lena, e detyruar, u martua me Ristan Thoman i ardhur nga Muçaj i Fierit, i cili solli edhe ai një djalë, Zoin.

Vangjel Jani Marku u martua me Dafinën nga Pish-Porua, motër me Gonen që kish marrë Loni Sika nga Porua. Vangjeli me Dafinën kanë 2–3 fëmijë dhe jetojnë në Vlorë. Vangjeli u divorcua me Dafinën dhe mori një grua tjetër nga Gjirokastra, me të nuk lindi fëmijë. Vangjeli iku në Vlorë pas viti 1955 dhe atje jetoi deri sa vdiq.

Shënim: Vëllai i 5^{të} i Markajve të Grykës iku në Durrës që i vogël. Atje është martuar ka dhe fëmijë. Nuk ua dimë emrat.

SOTIR TODO MËRTIRI

Todo Mërtiri ka ardhur nga Libohova e Gjirokastrës dhe u vendos në Gorrisht të Vlorës, Bashkë me vëllezërit e tij. Më vonë u shpërngulën prej aty dhe, rreth vitit 1820 apo 1870, shkuan ca në Vlorë dhe ca në Aliban të Vlorës. Dhe sot e kësaj dite, vendi në Gorrisht ku kanë banuar, quhet Lagja Mërtiri. Todo Mërtiri u vendos në Aliban dhe u martua me Tana Themi Rrungaja nga Zhuka. Pasi vdiq Todo në Aliban, Tana mori me vete djalin e vogël, të vetmin fëmijë, Sotir, dhe u vendos me shtëpi në Zhukë, pranë të atit, Themi Rrungaja. Kur u rrit Sotir Todo Mërtiri u martua me Pulije Llukë Goni nga Delisufi, me të cilin lindi vetëm një djalë, Thoma Mërtiri.

Thoma Sotir Mërtiri u martua me Sijen e Mihal Çunit nga Sheq-Dëllënja, me të cilën lindën 4 djem dhe dy vajzë: Piron, Vllasin, Vasillaqin, Sotirin, Elën dhe Margaritën. Për mosmarrëveshje midis tyre, Thomai u divorcua me Sijen dhe u martua me Jana Pilo Thanasi nga Dëllënja, me të cilën lindën 3 djem e 3 vajza: Arqilen, Dhimitraqi, Roberti, Donika, Leonora dhe Afërdita. Por Jana pruri tek Thomai dhe dy vajza, Kristulla dhe Margarita, të cilat i kishte me martesën e saj të parë me Vasil Kungullin, i cili pësoi aksident me makinë me pasojë vdekje.

Thoma Sotir Mërtiri

Fëmijët e Thomait tashmë janë të martuar dhe me fëmijë.

Piro Thoma Mërtiri u martua me Athina Uani Jano nga Fieri, lindën e rritën dy djem e një vajzë: Elidonin, Alketin, dhe Gentiana. Në vitin 2000 emigroi familjarisht në Boston të Amerikës. Atje u sëmur e vdiq para kohe.

Piro Thoma Mërtiri

Elidon Piro Mërtiri u martua me Juliana Ibro.

Gentiana Piro Mërtiri u martua me Alfred Veli Gjoleka në Fier.

Alket Piro Mërtiri është fejuar me një vajzë amerikane.

Vllasi Thoma Mërtiri u martua me gruan e parë, Margarita Niko Dila nga Porua, kanë dy vajza e një djalë: Admantin, Erietën dhe Joridën. Margarita u sëmur e vdiq. Vllasi mori një grua tjetër nga Bushati i Shkodrës, Xhuliana, me të cilën nuk ka fëmijë, por ajo solli me vete një djalin e saj, Armandon të cilin e kishte me burrin e parë.

Vllasi Thoma Mërtiri

Erjeta Vllas Mërtiri u martua me një italian, Mikele Paskuale Colona, kanë dy vajza.

Admant Vllas Mërtiri u martua me Bela Rrok Rrotani nga Bushati i Shkodrës, ende nuk kanë fëmijë.

Jorida Vllas Mërtiri u martua me Gëzim Stavre Naka nga Mifoli, kanë një vajzë, jetojnë në Itali.

Vasillaq Thoma Mërtiri u martua me Dafina Tonç Kola, nga Porua, kanë dy djem e dy vajza: Artanin, Erjonin, Ermira dhe Boranën.

Artan Vasillaq Mërtiri u martua me Elvira Fani Gjonçarin nga Porua, kanë një djalë, Vasillaq Mërtiri dhe tre vajza, Greta, Kristjana dhe Eneida.

Erjon Vasillaq Mërtiri u martua me një italiane, Livjana me të cilën ka një vajzë, Dafne.

Ermira Vasillaq Mërtiri u martua me Raqi Perikli Kola nga Porua, kanë dy vajza, jetojnë në Itali.

Naun Gjonçari, Llazi Hajdini, Vllasi Mërtiri

Borana aktualisht është beqare.

Sotir Thoma Mërtiri u martua me Lumturinë nga Divjaka, kanë dy djem, Arnoldin dhe Emilin, janë ende beqar.

Ela Thoma Mërtiri u martua me Miço Jani Hudhra nga Dëllënja.

Arqile Thoma Mërtiri u martua me Vjollca Tol Mata nga Porua me të cilën lindi një djalë, Dorianin, u divorcua dhe u martua me Kozetën nga Lezhani (Qishë Bardhë) me të cilën lindi Tomin.

Dhimitraq Thoma Mërtiri u martua me Natasha Lio Kungullin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Julianin dhe Lorenën.

Juliani u martua me Viola Trifon Moçka në Poro.

Lorena Dhimitraq Mërtiri u martua me Besnik Thoma Hudhra, kanë një djalë, Thoman, jetojnë në Itali.

Robert Thoma Mërtiri u martua me Mimoza Llambi Mitraj në Poro, kanë dy vajza: Marinelën dhe Anën, jetojnë në Greqi.

Donika Th. Mërtiri u martua me Jorgaq Llazi Sheqin në Poro. Lindën 3 fëmijë, Miri, Ervini dhe Denisa.

Leonora Thoma Mërtiri u martua me Dhimitër Kozma Rredhin në Llakatund, kanë dy fëmijë, Stilianon dhe Aldon.

Afërdita Thoma Mërtiri u martua me Thoma Stavre Thanon në Poro, kanë dy fëmijë, Panajotin dhe Stelën, jetojnë në Greqi.

Margarita Thoma Mërtiri u martua me Agim Hysin nga Sllatinja e Skraparit, banojnë në Tiranë, kanë një djalë e një vajzë, Altinin dhe Fjoralbën.

KRONI MITRUSH DYLGJERI, DËLLËNJË

Kroni Mitrushi ka ardhur i vogël me nënën te Mihal Baba. Kur vdiq i shoqi i Patros, Mitrush Dylgjeri, ajo mori Kronin dhe u martua me një tjetër burrë nga Bishani i Fierit dhe me atë lindi një vajzë, Katen.

Por edhe burri nga Bishani u mbyt në lumë dhe kjo mori dy fëmijët e u martua në Dëllënjë me Hali Babën. Me Hali (ose Mihal Babën) lindi dy djem: Todin, dhe Rako Babën.

Patra, nëna e Kron Mitrushit dhe e Kates, ishte nga Semani.

Katja u martua me Uan Liçon në Dëllënjë.

Kron Mitrush Dylgjeri u martua me Ksandën, të bijën e Nasi Gegës nga Delisufi dhe lindën 4 djem e dy vajza: Vllasin, Peçon, Dhimitrin, Lenën dhe Fanien. Një djalë, më i madhi, para Vllasit, u vra aksidentalisht.

Vllas Kroni Mitrushi u martua me Rita Rrapi Spiron nga Pish-Porua e Fierit dhe kanë një djalë e 3 vajza: Agronin, Lidën, Artën dhe Anilën.

Agron Vllasi Mitrushi u martua me Stela Çukon nga Pish-Porua dhe kanë një djalë, Valerion.

Lida V. Mitrushi u martua me Nesti Thanas Moçkën në Novoselë.

Arta u martua me Fredi Barjam Çelën në Selenicë.

Anila u martua me Nikon nga Gjirokastra.

PEÇO KRONI MITRUSHI

U martua me Neta Miço Gjoni nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Spiron, Mirelën dhe Irmën.

Spiro Peço Mitrushi u martua në Fier dhe banon në Fier.

Mirela u martua në Fier.

Irma u martua me Goni Xhoxhi Çunin në Dëllënjë.

Dhimitraq Kron Mitrushi u martua me Miranda Jani Markun nga Dëllënja, kanë 4 djem: Markon, Besnikun, Orestin dhe Arditin.

Lena Kroni Mitrushi u martua me Gjergji (Gjeko) Loni Nakën në Dëllënjë.

Fania u martua me Miti Kostandin Dhamon në Pish-Poro.

Shënim: Ksanda, e shoqja e xha Kroni Mitrushit, kishte një motër, Lule njihej, të bijat e Nasi Gegës, nga Delisufi. Lulja kishte dy vajza Pulien, që kish marrë Jano Garrua, grua të parë, dhe Neftën, që kish marrë Lama Përri në Dëllënjë.

Lulja u martua 3 herë. Burri i parë ishte Uan Garrua që la Pulien dhe Neftën, pastaj ajo mori edhe Todi Biserrin, edhe Kristo Dafinën, por nuk ndenji shumë me ta. Shkoi te Lamo Përri, tek e bija, Nefta dhe, kur vdiq Lamo Përri, ajo iku në Vlorë me gjithë Neftën. Nefta u martua me Kristaj Baraj nga Kuçi i Vlorës, dhe lindi Miçon (siç thotë i biri Neftës Miço Baraj). Mëmë Lulja jetoi shumë dhe vdiq në Vlorë.

LEKS MEMECI

Me origjinë nga Libofsha. Atje kanë pasur mbiemrin Prifti. Xha Leksi ka qenë martuar me Margën dhe kanë lindur Palin dhe Vangjelin.

Pali Leks Memeci u martua me Dafinën e Mit Lerës nga Gryka dhe kanë lindur, Sotirin, Dhorin, Spiron, Mellaninë, Donikën, Letën dhe Lirinë.

Sotir Pal Memeci u martua me Viktori Koço Korron nga Mursia e Delvinës, kanë 3 djem e 2 vajza: Alketin, Vasilin, Armandon, Almën dhe Elicën.

Alma Sotir Memeci u martua me Sotir Leonidha Qarrin në Mifol, kanë dy djem.

Të tjerët aktualisht janë beqarë.

Dhori vdiq beqar.

Spiro Pal Memeci u martua me Floreta Lil Kokallën nga Ramica, por janë në Orikum, dhe kanë dy djem e dy vajza: Klodianin, Donaldon, Entelën dhe Besianin.

Spiro Memeci me të shoqen, Floretën dhe Llazi Hajdini

Entela Spiro Memeci u martua me Ardian Istref Hoxhën në Bishan të Vlorës, kanë një djalë.

Të tjerët janë beqarë.

Mellani Pal Memeci u martua me Dhimitër Taqo Mbyetin në Delisuf.

Leta Pal Memeci u martua me Stefan Petro Moçkën në Novoselë.

Donika P. Memeci u martua me Dhimitraq Vangjel Gegën në Delisuf.

Liri P. Memeci u martua me Bert Lio Kola Mitraj në Poro.

VANGJEL LEKS MEMECI

U martua me Kristina Nushi (greke nga Janina. Këtë e gjeti në Jalli, Niso Llambrua i cili e rriti dhe e martoi me Vangjel Memecin).

Vangjeli me Kristinën kanë 3 djem e dy vajza: Trifonin, Mihallaqin, Thoman, Lenën dhe Natashën.

Trifon Vangjel Memeci u martua me Zanën nga Dukati, kanë dy vajza. Zana ka sjellë me vete një djalë, Armando Memeci. Vajzat e Trifonit janë, Ana dhe Tereza. Ana është martuar në Elbasan, ka një djalë dhe një vajzë. Armando dhe Tereza aktualisht janë beqarë.

Mihallaq Vangjel Memeci u martua me Fairenë nga Llakatundi, kanë një djalë, Vangjelin, dhe dy vajza.

Thoma Vangjel Memeci u martua në Urën-Vajgurore, kanë dy djem e një vajzë, janë në Greqi.

Shënim: Të gjithë fëmijët e Vangjelit kanë bërë dokumente greke se nënën e kanë greke, nga Janina.

Kristina ka lënë porosi që kur të vdesë ta sjellin në Shqipëri e ta varrosin te i shoqi, Vangjel Memeci në Akërni, se atje kanë banuar disa vjet.

Vajzat e Vangjelit:

Lena V. Memeci u martua me Razinë nga Zhapokika e Beratit, kanë 4 fëmijë, një djalë,

Fatjoni dhe 3 vajza.

Natasha Vangjel Memeci u martua me Remziun nga Zhapokika e Beratit, kanë dy djem e një vajzë.

Shënim: Kur erdhën disa familje greke në vitin 1944 në Poro, si muhaxhirë, erdhi dhe Kristina e vogël, por s'kishte njeri të saj, ishte fare e vogël, 5–6 vjeçe. E mori mëmë Sina në shtëpi të saj dhe e rriti, pastaj e martoi me Vangjel Memecin në Grykë. Mëmë Sina ishte nëna e Niso Llambros dhe e Todi Nakës.

Këto mi ka treguar Spiro Memeci dhe gruaja e tij, Florika Kokalla në Delisuf, në Maj të vitit 2009.

UAN MILE

Uan Zogu Mile është nga Voskopoja e Korçës. Ka banuar ca kohë në Aliban, pastaj, u ngul në Poro.

Zogu ishte martuar me Patron. Ata lanë tre fëmijë: Uanin, Pulien dhe Konxhen.

Konxhia u martua me Miti Bërdallin në Poro.

Pulija u martua me Kol Hoxharën në Vlorë.

Pandel Uan Mile

Uan Mile ka lënë 4 djem e 4 vajza: Pandelin, Vllasin, Nikon, Tolin, Dhoksien, Athinanë, Nelin dhe Valën.

Pandeli Uan Mile u martua me Kristina Qirjaq Kriston nga Pish-Porua e Fierit. Kanë dy djem e dy vajza: Bertin, Kleanthin, Mirandën dhe Evën.

Berti P. Mile u martua me Xhulia Kol Moçkën nga Porua dhe kanë dy vajza: Theodhorën dhe Olimbinë.

Klenathi P. Mile u martua me Rezarta Trifon M. Gjonçarin nga Porua dhe kanë një djalë e një vajzë; Marion dhe Kristinën.

Miranda P. Mile u martua me Thoma Naun Thanën në Poro.

Eva martua me Lluka Themi Minon në Vlorë.

VLLASI UAN MILE

Vllasi U. Mile u martua me Drita Loni Nakën nga Ferrasi i Fierit, kanë dy djem, Mondin, Vason dhe dy vajza.

Vllasi U. Mile me Dritën, të shoqen, dhe djali i tyre, Mondi

Mondi V. Mile u martua me Monda Thoma Lepurin nga Porua dhe kanë një djalë e një vajzë: Orestin dhe Hedrën.

Vaso Vllasi Mile u martua me Vjollcën nga Elbasani, ka dy djem: Gerin dhe Vllasin.

Niko Uan Mile u martua me Leta Llazi Sheqin nga Porua, kanë 3 djem e dy vajza: Agronin, Alketin, Albinin, Anidën dhe Joridën.

Agron Niko Mile u martua me Elvira Thanas Plakun nga Dëllënja dhe kanë një djalë e një vajzë, Thanasin e Nikollën.

Alket Niko Mile u martua me Vera Thoma Thanasin nga Dëllënja dhe kanë një djalë e një vajzë: Nikollën dhe Anën.

Albini aktualisht është beqar.

TOLI UAN MILE

Toli Uani Mile u martua me Marien nga Himara dhe kanë një djalë dhe 4 vajza: Janin, Lauretën, Majlindën, Klejdën dhe Manjolën.

Jani Toli Mile u martua me Aurora Thanas Sheqin nga Porua.

Laureta T. Mile u martua me Angjelo Taton nga Himara.

Manjola T. Mile u martua me Ilia Zhongun nga Gjirokastra.

Klejda T. Mile, aktualisht pa martuar.

PETRO LLAMBRO MEMECI

Nëna e Petro Llambro Memecit ishte nga fisi i Zhezhajve në Grykë. Pas vdekjes së Llambros, ajo mori dy fëmijët, Petron dhe Varvarën, e u martua me Kozma Ristan Nasi në Poro.

Petro Ll. Memeci erdhi i vogël prapa të ëmës tek Kozma Ristan Nasi, i cili e kishte grua të dytë.

Petrua, kur u rrit, u martua me Ristanën, të bijën e Zoi Çukos, vajzë e vetme. Lindën 6 fëmijë, 3 djem e 3 vajza: Dhimitraqin, Llazin, Trifonin, Kristullën, Donikën dhe Valentinën.

Dhimitraq Petro Memeci u martua me Athina Petro Gjonçarin nga Zhuka, kanë një djalë e 3 vajza: Erjonin, Esmeraldën, Enkelejdën dhe Eristelën. Të katër fëmijëve emrat ua ka zgjedhur vetë Mitaqi me germën e parë "E".

Dhimitraq Petro Memeci

Llazi Petro Memeci nuk është martuar akoma. Ka shtëpinë e tij, bën jetë të mirë, por i vetëm. Në shoqëri është i rregullt.

Varvara Llambro Memeci u martua me Petro Mustaqin në Shamogjinë, ka fëmijë.

Trifon P. Memeci u martua por u divorcua, aktualisht ka një vajzë.

Vajzat e Petro Memecit:

Kristulla u martua me Jani Thoma Hoxharën në Poro.

Donika u martua me Petraq (Niko) Llazi Llambron në Poro.

Valentina është martuar në Shkodër.

Shënim: Petro Memeci kishte një motër me nënë e babë, Varvarën. Ajo u martua në Aliban, por aksidentalisht u plagos në një këmbë me çifte nga i kunati i saj, se kjo i doli para kur ai po grindej me vëllain e tij. Kjo, për të mos ndodhur ndonjë vrasje, u fut në mes që ta ndalonte, mirëpo ai e shkrepi çiften dhe plagosi atë në gjurin e këmbës. Nga kjo goditje këmba iu bë gangrenë dhe shpejt nga plaga vdiq. Ka lënë një vajzë.

Petro Memecit i shoshnin edhe Petro Zhezha sepse, kur vdiq i ati, Llambrua, nëna e tij me Petron dhe një vajzë të vogël, shkoi te i vëllai Zhezha në Grykë, pastaj shkoi te e ëma që u martua me Kozma Ristan Nasin. Por ishte Memeci dhe me këtë mbiemër mbeti ai dhe fëmijët e tij.

THANAS MITRO

Mitrua ka qenë çoban me origjinë, i ardhur nga Greqia në Korçë. Në Korçë i lindën dy djem, Thanasi dhe Jorgua. Jorgua vdiq në Korçë, i ri pa u martuar. Ndërsa Thanasi erdhi në Poro tek Monajt, sepse i kishte dajallarë. Mitrua kishte marrë të motrën e Vasil Mones në Poro.

Mitrua dhe Vasili, dy kunetër, merreshin më shumë me tregti me Italinë.

Vasil Monia kishte 3 motra: një e kish marrë Mitrua, një Joti Papaj në Nartë (jeton në Zhukë) dhe një e kish marrë Mino Suku në Fier.

(Këto i ka treguar Miti Th. Mitrua 70 vjeç në dhjetor të vitit 2008).

Thanas Mitrua ishte martuar me Qirjaqen, të bijën e Kristo Lepurit nga Novosela dhe me të lindi një djalë e 3 vajza: Mitin, Gjenën, Ritën dhe Olimbinë.

Më e madhja ishte Gjena, pastaj Rita, Olimbia dhe në fund Miti Mitrua.

Miti Thanas Mitro u martua me Liri Mitre Lekajn nga Dukati, u lindën 4 fëmijë: Miranda, Zhaneta, Pandeliu dhe Marjeta.

Miranda Miti Mitra u martua me një grek në Greqi me të cilin ka 3 fëmijë.

Zhaneta M. Mitro u martua me Petro Dukon në Patos.

Pandeli M. Mitra u martua me Anila Lili Katiun në Pojan, ka një djalë e një vajzë: Kledisjanin dhe Ervisën, banon në Sheq të Fierit.

Marjeta M. Mitro u martua me një grek, jetojnë në Greqi.

Vajzat e Thanas Mitros:

Gjena u martua me Todi Mata në Mesarak të Armenit; ka 3 djem, Pilon, Andrenë, Sotirin dhe dy vajza.

Rita u martua me Petro Kolën, me të cilin ka lindur Sotirin dhe Natashën. Ajo solli me vete te Petro Kola edhe Leonidha Miti Jankën, dhe Kozma Thoma Palin.

Olimbi Th. Mitro u martua me Koçi Th. Mbyetin në Delisuf dhe lindi 5 djem e dy vajza: Minon, Xhoxhin, Arturin, Fatmirin, Ilirjanin, Donikën, (ose Milla), Xhulietën dhe Vasilikën.

MOÇKALLARËT

Sipas thënieve të Thoma Moçkës, Moçkallarët e kanë prejardhjen nga Voskopoja e Korçës, të ardhur në Hysoverdhë, pastaj ata kanë lëvizur në Vlorë, në Dukat, në Novoselë, në Zvërnec dhe, pastaj, në Poro. Në Zvërnec ata kanë pasur tokën e tyre deri në vitin 1946, vit kur u bë Reforma Agrare.

Më i vjetri i këtij fisi që mbahet mend ka qenë Kozma Moçka, jo ky i sotmi. Kozma Moçka i hershëm la 4 djem e një vajzë: Markon, Sakon, Fanin, Jotin dhe Falanë.

Marko Kozma Moçka kish marrë të bijën e Dush Qarrit nga Porua dhe me të lindën një vajzë: Vasilikën, që martua në Ferras. Markua nuk la djem që emri i tij të mos harrohet, por ai do të mbahet mend në këtë fis të madh si një burrë nga më të urtit e më besimtar të krahinës. Ka qënë një njeri shumë i drejtë, nuk kishte shkollë por, si njeri me zemër e shpirt të pastër, i ishte besuar kujdestaria e kishës së Shën Kollit, e vetmja kishë në këto 4–5 fshatra të zonës së poshtme të Myzeqesë, për të cilën ai ka dhënë një kontribut të madh në ndërtimin e mirëmbajtjen e saj. Merita është e gjithë popullit, në radhë të parë, në ndërtimin e saj, por edhe e Markos, që ishte për shumë e shumë vite kujdestar ose Ipitrop, siç quhej atëherë.

Sako Kozma Moçka la dy djem e dy vajza: Kostandin Vangjelin, Margën dhe Vitoren.

Kostandin Sako Moçka u martua me Ksanda Tasi Qorrin nga Delisufi, kanë 4 djem, Janin, Peçon, Llazin, Trifonin dhe 3 vajza.

Jani Kostandin Moçka u martua me Evrinomi Gori Limo nga Frakulla, kanë dy djem e një vajzë: Arbenin, Lavdërimin dhe Rajmondën.

Arben Jani Moçka u martua me Donika Thoma Helmin nga Dëllënja, kanë një djalë e një vajzë: Aldon dhe Albanën.

Lavdërim Jani Moçka u martua me Rajmonda Sulo Tefën nga Xhafzeza e Elbasanit, kanë një djalë e një vajzë: Françeskon dhe Aleksian.

Rajmonda Jani Moçka u martua me Ligor Lamo Kostën në Delisuf.

Peço Kostandin Moçka u martua me Evrinomi Pilo Laskën nga Mifoli, kanë 3 djem e 5 vajza: Fredin, Taçin, Ilirin, Alketën, Elonën, Silvanën, Anilën dhe Elisabetën.

Fredi Peço Moçka u martua me Blerta Ligor Lepurin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Lukonin dhe Rikën.

Taçi Peço Moçka u martua me Irena Hetem Çamin nga fshati Fitore, Novoselë, kanë dy djem: Xhonin dhe Simonin.

Ilir Peço Moçka u martua me Alma Bashkim Arshi Bullën nga Bishani, kanë një djalë e dy vajza: Danon, Graçielën dhe Xhulianën.

Vajzat e Peço Moçkës:

Silvana u martua me Llaqi Jani Kungullin, në Poro.

Alketa u martua me një italian.

Dena u martua me një italian.

Anila u martua me Altin Vasil Koçin, në Poro.

Eli u martua me një italian.

Trifon Kostandin Moçka u martua me Llamba Petro Thanon nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Florencin, Elfridën, Erdiolën.

Florenc Trifon Moçka u martua me Drita Vasil M. Dashin nga Delisufi, aktualisht nuk

kanë fëmijë.

Elfrida Trifon Moçka u martua me Eduard Llambi Kolën (Mitraj), kanë dy djem.

Erdiola Trifon Moçka u martua me Xhulian Miço Mërtiri në Poro.

Llazi Kostandin Moçka u martua me Andoneta Trifon Kola nga Porua, gruaja e parë, kanë dy djem dhe një vajzë: Arturin, Erjonin, Teutën. Gruaja e dytë, Leonora, është nga Fieri.

Artur Llazi Moçka u martua me Kozetën nga Sheqishtja e Fierit, ka një djalë e një vajzë: Mateon dhe Marcelën.

Erjon Llazi Moçka është i martuar dhe ka një djalë, Matheon.

Teuta Llazi Moçka u martua me Pandi Priftin në Marinëz të Fierit, kanë një djalë e një vajzë.

Shënim: Markua birësoi një djalë, por ai nuk ndenji me të, ai ishte Nasi Katrua, por dhe vetë Nasi nuk la fëmijë.

Fala Kozma Moçka u martua me Kozma Loshin në Poro, lindi dy djem e dy vajza: Vasilin, Thoman, Lenën dhe Konxhen.

VANGJEL SAKO MOÇKA

Vangjel Sako Moçka është martuar dy herë. Gruaja e parë ishte Djella e Kron Koçit nga Dëllënja, por ajo vdiq brenda vitit, në moshën 18 vjeçare, e nuk la fëmijë, gruaja e dytë ishte Dhora e Naun Kolës nga Porua e cila ka lindur 3 djem e dy vajza: Nikon, Sokratin, Mihalin, Kristinën dhe Jorgjien.

Niko Vangjel Moçka u martua me Flora Lili Qarrin nga Alibani, kanë dy djem e një vajzë: Saimirin, Aleksandrin dhe Valbonën.

Sokrat Vangjel Moçka u martua me Zhani Kiço Janën nga Libofsha, kanë një djalë e një vajzë: Leonardin e Majlindën.

Mihal Vangjel Moçka u martua me Lena Lolon nga Saranda, kanë një djalë e një vajzë: Vangjelin e Dhorën.

Kristina Vangjel Moçka u martua me Stafan Lami Rrapin në Fitore.

Jorgjie Vangjel Moçka u martua me Kristaq Miti Kërrin në Delisuf.

Marga Sako Moçka u martua me Nasi Pali Shytin në Poro.

Vitorja e Sako Moçkës u martua me Vangjel Uan Marinën në Poro.

FANI KOZMA MOÇKA

Fani Kozma Moçka ka lënë Lion dhe Stavren.

Lio Kozma Moçka u martua me Vasili Pali Vanin nga Porua, kanë lindur 6 djem e një vajzë: Kozman, Miçon, Sotirin, Fanin, Markon, Harrillën dhe Uraninë.

Kozma Lio Moçka u martua me Gjena Llukë Prifti nga Pish-Porua, kanë 3 djem e 5 vajza: Themiun, Spiron, Artanin, Likën, Lirën, Marjanën, Natashën, Mirandën.

Thimi (ose Themi) Kozma Moçka u martua me Evgjeni Sotën (motra e Llazi Sotës nga Vlora), kanë 3 djem: Ilirin, Dorianin dhe Ardin.

Kozma Moçka

Spiro Kozma Moçka u martua me Vjollca Gjergji Naçin nga Frakulla, kanë dy vajza.

Ardian Kozma Moçka u martua me Monda Sotir Priftin (Papa Sotiri), kanë një djalë e dy vajza.

Miço Lio Moçka u martua me Kate Lili Lepurin, kanë 4 djem e dy vajza: Golin, Vasilin, Arbenin, Viktorin, Netin dhe Dritën.

Goli M. Moçka u martua me Donika Jorgji Bërdallin nga Porua.

Vasil M. Moçka u martua me vajzën e Todi Sikos nga Porua.

Arben M. Moçka u martua me Liza Nonda Matën nga Porua.

Viron Miço Moçka u martua me Albanën.

Sotir Moçka

Neti M. Moçka është martuar.

Drita M. Moçka është martuar.

Marko Lio Moçka u martua me Milla Naun Nasin nga Porua, kanë dy djem.

Sotir Lio Moçka u martua me Dhora Kristo Lipi nga Beshishti, kanë një djalë, Nestin e dy vajza.

Nesti Sotir Moçka u martua me Naunka Foni Dashin nga Delisufi, kanë 3 vajza.

Fani Lio Moçka u martua me Fala Vasil Kolën nga Porua, kanë dy djem: Viktorin dhe Nardin.

Harrilla Lio Moçka u martua me Gjena Petro Sikon nga Porua, kanë një djalë, Nestin e dy vajza, Vasilikën dhe një tjetër.

STAVRE FANI MOÇKA

Stavre Fani Moçka ishte i martuar më parë më një grua, me të cilën ka një vajzë, Gonën, që është martuar me Llazi Malon në Aliban. Gruaja e dytë është e bija e Xoxi Rrungajës, dhe me atë ka 8 fëmijë: (dy herë nga dy binjakë). Thoman, Millën, Raqin, Thanasin, Jorgjin, Pandeliun, Vangjelinën dhe Finën.

Thoma Stavre Moçka u martua me Zoica Koli Kondën nga Zhuka, kanë 3 djem e një vajzë: Teodorin, Ardianin, Gentin, Eglantinën.

Teodor Th. Moçka është martuar.

Ardian Th. Moçka është martuar.

Raqi Moçka

Eglantina Th. Moçka është martuar.

Raqi Stavre Moçka u martua me Fotini Priftin nga Novosela, kanë fëmijë.

Thanas Stavre Moçka u martua me Janulla Llambro Lepurin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë.

Pandeli Stavre Moçka u martua me Vali Thoma Lepurin nga Porua.

Jorgji Stavre Moçka u martua me Neti Mino Nakën nga Delisufi.

JOTI MOÇKA

Joti Moçka la dy djem e një vajzë: Kolin, Palin dhe Çantën.

Çanta u martua me Trifon Nasi Kiçon në Poro.

Koli Joti Moçka u martua me Marie Dhori Kungullin nga Porua, kanë 3 djem e 3 vajza: Llambin, Nestin, Minellën, Adelinën, Elcën, Xhulin.

Llambi Koli Moçka u martua me Krisulla Fiqiri Lamajn nga Trevllazëri, (Selenica), kanë një djalë e dy vajza: Kristin, Erminën, Sidorelën.

Nesti Koli Moçka u martua me Merita Miti Dokon nga Pish-Porua, kanë dy djem e një vajzë: Kleanthin, Milianon, Erjonën.

Adelina Koli Moçka u martua me Nasi Simonin në Himarë.

Elca Koli Moçka u martua me djalin e Halil Zemanit në Vlorë. Me të u divorcua dhe u martua me një grek, jeton në Greqi.

Xhuli Koli Moçka u martua me Berti Pandeli Milen në Poro.

PALI MOÇKA

Pali Joti Moçka u martua me Lenën, vajza e Nasi Nakës nga Dëllënja. Vdiq e re, nuk la fëmijë. Pali mori grua të dytë nga fshatrat e Fierit, dhe me të lindi dy vajza. U divorcuan, më vonë Pali u martua me një grua nga Selenica, Katina Bombaj. Ajo solli te Pali dy vajza. Me Palin lindi një djalë e një vajzë, banojnë në Novoselë.

QIRJAQ MONÇE

Qirjaq Monçe kishte Varvarën për grua dhe lindën dy vajza, njërën, të madhen, e martuan në Pish-Poro dhe, të voglën, Marien, e mori për grua Miti Jorgji në Poro, në vitin 1944–1945.

Ai ishte nga Vlora, vëlla me Thoma Jorgjin, nipërit e Uan Matës.

Miti Jorgji me Marien lindën 5 djem e një vajzë. Një djalë i Mitit dhe i Maries, më i madhi, quhet Fani Miti Jorgji.

Djemtë e Mitit banojnë në Vlorë: Fani, Sotiraqi, Vangjeli, Ladi, Berti dhe Vefi. Babai i Mitit ishte Jorgji nga Sinja e Beratit. Nëna e Mitit ishte Dafa, motra e Uan Matës nga Porua.

MONAJT

Mihal Mone më ka treguar:

Monajt e kanë origjinën nga Lekli i Tepelenës. Kanë qenë 3 vëllezër: Dushi, Dhimitri dhe Mani. Të tre kanë qenë blegtorë të mirë dhe u vendosën fillimisht në Mifol.

Në Mifol e vunë ekonominë përpara, se ishin edhe punëtorë, edhe blegtorë të mirë, por edhe si njerëz shpirtmirë, dhe fituan respektin nga të gjithë njerëzit aty ku banonin, dhe më gjerë. Diku në afërsi të Urës së Lumit të Vjosës, ndërtuan një han ku strehoheshin kafshë, njerëz udhëtarë e hallexhinj. Me atë punë u njohën edhe më mirë, mirëpo lindën edhe kundërshtarë nga smira e keqe, sidomos tek disa agallarë. Dhe kështu hynë në konflikt dhe, për grindje me ta, ikën fare me gjithë bagëtitë dhe u vendosën në Poro, pikërisht aty afër Pishës, ku themelet e shtëpive të tyre kanë qenë deri vonë, që njihen si "shtëpitë e Monajve". Aty është edhe lapidari i formimit të Çetës partizane të Myzeqesë.

Dush Mone thuhet se ka lënë Jani Monen. Jani Monia u martua me të bijën e njërit nga Loshajt e Poros dhe la 3 djem: Vasilin, Lilin dhe Lonin.

Vasil Jani Mone la 7 vajza: Naunkën, Savetën, Dhoksinë, Llambën, Ollgën, Vitorinë dhe Vangjelinën.

Naunka u martua me Llambi Liçon në Vlorë.

Saveta u martua me Sotir Semën në Vlorë.

Dhoksia u martua me Llambi Argjendarin në Fier.

Llamba u martua në Vlorë. Vitoria u martua me Tomi Rrapushin në Vlorë. Vangjelina u martua me Kristaq Sotën në Fier.

Ollga u martua me Pandi Toskën në Fier.

LILI MONE

Lili Jani Mone u martua me Sofien e Naqo Kungullit nga Porua dhe lanë 3 vajza: Zoicën, që u martua me Lili Çomën në Vlorë, Melpon, që mori Llazi Naqo Kolën (Mitraj) nga Porua dhe Lirinë, që u martua me Foni Fanin në Nartë.

LONI JANI MONE

U martua me Aspasi Rrungajën nga Zhuka dhe kanë lënë 2 djem e një vajzë: Nikon, Harrillën, dhe Androniqin.

Loni Jan Mone

Harrilla Loni Mone

Loni Mone ishte njeri me shkollë dhe me influencë në Myzeqe. Gjatë Lëvizjes NÇL, me formimin e Çetës partizane të Myzeqesë, u zgjodh komandant i saj. Shkoi në luftë dhe u vra heroikisht, në afërsi të Ramicës. Eshtrat e tij ndodhen në varrezat e dëshmorëve të Kombit në Tiranë, në një radhë me Heronjtë e LNÇL.

Niko Loni Mone (Dr. Farmacist) u martua me Vasilikën nga Libohova dhe kanë një djalë, Leonardin dhe një vajzë.

Harrilla Loni Mone, mjek patolog, u martua me Desantina nga Lezha dhe kanë një vajzë, Inën.

Androniqi Loni Mone u martua me Pandi Paguzi nga Delvina dhe kanë dy djem: Janaqin dhe Armandon. Të tre fëmijët e Loni Mones banojnë në Tiranë.

DHIMITËR MONE

Dhimitër Mone u martua me një vajzë nga Sotajt e Fierit, Vasilikën, dhe lanë 4 djem: Dhorin, Petron, Spiron dhe Avramin.

Avrami vdiq i ri, i pa u martuar.

Dhori u martua me Ristanën nga Leprajt e Novoselës; kanë lënë një djalë e 4 vajza: Mihalin, Marinaqin, Sotirën, Neftën dhe Milikën.

Mihal Dhori Mone u martua me Eleni Vangjel Marinën nga Porua dhe kanë dy djem e një vajzë: Gramozin, Albinin, dhe Rajmondën.

Mihal Dhori Mone

Rajmonda Mihal Mone u martua me Harrilla Piro Priftin nga Zhuka, banon në Vlorë. Djemtë e Mihal Mones janë beqarë. Marinaqi Dhori Mone është martuar me Llazar Mërkurin në Vlorë dhe ka një djalë, Llambin.

Sotira Dhori Mone u martua me Vangjel Niko Simonin në Vlorë, (Niko Simoni është i biri i Simon Gegës nga Porua, iku i vogël në Vlorë).

Tefta Dhori Mone u martua me Rrapi Pufin në Pojan.

Milika Dhori Mone u martua me Jorgji M. Gjonçarin në Poro.

PETRO MONE

Petro Mone u martua me Kostandina Sotir Gjonçarin nga Zhuka, kanë lënë një vajzë, Luizën. (Lindi dhe 4 fëmijë të tjerë, por nuk rrojtën). Nga që s'kishin djalë, e birësuan një me emrin Dhimitër Petro Mone. (Në jetën e përditshme thirret e njihet me emrin Koçi Mone).

Luiza Petro Mone u martua me Filip Qarrin në Novoselë; kanë dy djem e dy vajza: Sokolin, Vangjelin, Mirën dhe Almën.

Sokol Filip Qarri u martua me Liljana Hetem Çobon nga Mifoli.

Vangjeli u martua me një nënshtetase italiane.

Mira u martua me Avni Sherifin nga Cakrani.

Alma u martua me Fiqiri Nurajn nga Fieri.

Koçi Mone u martua me mbesën e Llazi Rrungajës nga Dëllënja, dhe ka dy vajza, Mirelën dhe Artën. Gruan e dytë Koçi Mone e ka nga Pojani, ka një vajzë, Lidën dhe një djalë, Erionin.

Erjoni u martua me një nënshtetase italiane dhe ka një djalë e një vajzë: Dhimitrin dhe Arsidën.

Mirela Koçi Mone u martua me një nënshtetas italian.

Arta u martua me Niko Matën në Lushnjë.

Ilda u martua me Astrit Xhemil Aliajn në Bishan.

SPIRO DHIMITËR MONE

Spiro Mone u martua me Dhoksie Davidhin nga Fieri. Lanë vetëm një vajzë, Rinën, e cila u martua në Fier.

MANE MONE

Xha Mania kishte marrë për grua Viqen, motrën e Llazi Jankës nga Porua. Lanë një djalë e dy vajza: Pandelin, Fotinën dhe Ristanën.

Fotinia u martua me Vasil Sukullin në Fier.

Ristana u martua në Fier (fisi Tavanxhiu).

Pandeli Mane Mone (Pano Mani Mone) u martua me Katerina Qorrin nga Delisufi, lanë një djalë, Janin. Me gruan e dytë, Katerinën nga Narta, e bija e Dhimitër Diamantit, ka një djalë e një vajzë: Vangjelin dhe Pulien, i flasin shkurt, Neli.

Jani Pano Mone u martua me Dhorën nga Alibani kanë dy djem, Ilirin, Erjonin dhe 4 vajza, një nga të cilat është Liljana.

Iliri Jani Mone vdiq i ri. U vra aksidentalisht në Greqi.

Juliana u martua në Shtyllas të Fierit.

Vangjel Pano Mone u martua me Dhora Fili Çukon nga Porua, ka 3 djem, Renaton, Lelën dhe një tjetër. Aktualisht të tre djemtë janë beqar.

KRISTO TASI MOJALLIA

Kristo Tasi Mojallia ka ardhur nga Mojallia e Fierit dhe është martuar me Jana Gori Shimën nga Gryka, nga fisi i Shimajve nuk ka ndonjë në zonën tonë. Kristua me Janën kanë lënë Nison dhe Kozman. Kristua vdiq i ri.

Niso Kristo Mojallia u martua me Dhoksie Pali Minon, mbesa e Laze Hënës, dhe kanë lënë dy djem e 5 vajza: Vasilin, Filipin, Millën, Gjenovefën, Milikën, Elisabetën dhe Nolën.

Vasil Niso Mojallia u martua me Bule Haxhi Krogjin në Akërni, kanë një djalë.

Filip Niso Mojallia u martua me Tanën, kanë 3 djem.

Milla Niso Mojallia u martua me Miço Taqo Hyson nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Arbenin dhe Shpresën.

Gjenovefa N. Mojallia u martua në Bishan në fisin Toja, kanë një djalë.

Milika u martua me Nesti Qarrin, kanë dy djem e një vajzë.

Elisabeta u martua me Neim Ismailin, kanë një djalë e dy vajza.

Nola u martua me Artur Priftin, kanë një djalë.

KOZMA KRISTO MOJALLIA

Kozma K. Mojallia u martua me Naunka Dhori Kungullin nga Porua, kanë 3 djem e një vajzë: Minellën, Lonin, Petraqin, Rajmondën.



Kozma Mojallia

Minella Kozma Mojallia u martua me Donika Pilo Lepurin nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Saimirin, Ervinin dhe Erin.

Loni Kozma Mojallia u martua me Andoneta Miço Moçkën nga Porua, kanë dy djem: Eraldin dhe Klodianin.

Rajmonda K. Mojallia u martua me Fitim Qëndron nga Bishani, kanë një djalë e dy vajzë, Maksimiljani, Danjela dhe Albana.

Petraq K. Mojallia u martua me Flora Fili Loshin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Kriston dhe Dorinën.

Kanë qenë dy Niso Mojallia, një i biri i Kristos në Poro dhe tjetri i biri i Kronit në Delisuf.

GORI SHIMA, GRYKË

Gori Shima ka qënë banor i hershëm në Grykë, por nuk ka pasur djem. Kjo familje u shua.

Gori Shima la vetëm një vajzë. Këtë e mori Kristo Mojallia dhe ajo ka lindur Nison dhe Kozman. Mojallinjtë banojnë në Poro.

KRONI MOJALLIA, DELISUF

Kroni ka ardhur i vogël, me nënën e tij, e cila ishte e martuar te Mëhilli në fshatrat e Fierit. Kur i vdiq i shoqi, i ati Kronit, ajo iku dhe erdhi te i vëllai në Delisuf dhe nuk u martua më. Ai u rrit te daja i tij, Vasil Mojallia, dhe prandaj mori edhe mbiemrin Mojallia, por në fakt e ka pasur mbiemrin Mëhilli.

Kur u rrit Kroni, u martua me Viqen (Parashqevinë) e Naqo Helmit nga Dëllënja, dhe ka lënë një djalë e një vajzë, Niso Mojallinë dhe Savën.

Nisua u martua me Silën e Qirjaq Titit dhe ka 3 djem një vajzë: Janaqin, Tolin, Fredin, dhe Androniqin.

Sava (ose Vojsava) u martua me Pilo K. Priftin nga Porua. La Sotirin, Gjenën, Marien, Neftën, Ristanën, Sofien dhe Aretinë.

Shënim: Kroni u vra gabimisht nga italianët, në rrugë kur vinte nga Vlora. Në Panaja u ndesh me hajdutët që i kishin vjedhur bagëtitë në Delisuf. Ky njohu bagëtitë e tija dhe u grind e u rrah me hajdutët. Aty ndërhynë ushtarët italianë dhe u hapën zjarr, por gabimisht vranë Kronin, të cilët u detyruan ta shpërblejnë familjen e Kronit.

LONI VASIL MOJALLIA

Vasil Mojallia ishte nga Mojallia e Fierit. Vasili me gruan e parë la dy fëmijë, Llambron dhe Senën. Me gruan e dytë, Parashqevinë (Viqen) nga Ristajt, të bijën e Kito Ristës nga Alibani, lindën 4 fëmijë, Kostandinin, Ngjelën, Lonin dhe Ksandën.

Loni Vasil Mojallia

Kostandin Vasil Mojallia vdiq i ri, 19 vjeç, nga hemorragjia cerebrale. Ka qenë djalë shumë i zoti e, për këtë, i gjithë fshati edhe zona mori pjesë në varrimin e tij. Fshati mbajti zi për tre vjet rresht. Për tre vjet nuk bënë asnjë ceremoni gëzimi, fejesa apo martesa. Kaq shumë i pikëlloi të gjithë ky djalë.

Ngjela e Vasil Mojallisë u martua me Miti Bushin në Dëllënjë, vëllain e Thanas Bushit. Me të nuk lindën fëmijë. Familja e Bushit i detyroi të ndaheshin sepse ajo nuk lindte. Iku dhe shkoi te prindërit e, më pas, u martua në Peshtan të Fierit, me një tjetër Bushi, por ai vdiq shpejt e kjo erdhi prapë te prindërit e nuk u martua më, deri sa u plak e vdiq te Mojallinjtë në Delisuf.

Loni Vasil Mojallia u martua me gruan e parë, Marien Koli Loshin, motrën e Llukë Loshit nga Porua. Ajo vdiq e re. Pas kësaj, Loni Mojallia mori Marien e Taqo Grekut nga Alibani. Ajo ishte e ve. Maria e Taqi Grekut ishte e martuar më parë me Gori Thoma Mbyeti në Delisuf dhe kish lindur një djalë me të, por Gori dhe djali vdiqën dhe ajo iku e mori Loni Mojallinë.

Loni me Marie Grekun kanë 6 fëmijë: 3 djem e 3 vajza.

Spiro Loni Mojallia u martua me gruan e parë nga Elbasani, kanë një djalë e dy vajza, jetojnë në Greqi. Me gruan e dytë, nga Shkodra, ka një vajzë, jetojnë në Amerikë.

Jorgji Loni Mojallia u martua me Vangjelina Vasil Gegën, kanë dy djem e 4 vajza.

Liri Loni Mojallia u martua me Vasil Miti Dashin në Delisuf, kanë një djalë e 4 vajza.

Donika Loni Mojallia u martua me Nesti Sallakun në Pish-Poro, kanë dy djem.

Vangjel Loni Mojallia u martua me Liri Stefan Kronin nga Pojani, kanë dy djem e një vajzë.

Monda Loni Mojallia u martua me Kadri Lalaj në Patos.

MITRAJT (OSE KOLA)

Kolajt ose Mitrajt kanë ardhur vonë në Poro. Ishin krahë pune dhe, me forcën e agallarëve, ndoqën Simon Gegën nga tokat e tij në Grykë, në anë të Vjosës dhe u vendosën këta. Simon Gega ishte plak dhe nuk kishte forca që t'u rezistonte. Djemtë i kishte të vegjël. Dhimitri e Nikua, shkuan në Grykë Pishë.

Nga pleqtë më të vjetër të Kolajve mbahet mend Mitrua. Ky la disa djem: Zoin, Naunin, Lolin, Thoman e të tjerë.

Zoi Kola la Trifonin, Nauni la 4 vajza, Loli la dy djem e vajza, Naqua la 4 djem.

Zoi (Kola) Mitraj la Trifonin.

Trifon Kola u martua me Finen e Petro Kostës nga Delisufi, lindën dy djem, Lion e Filin, dhe 4 vajza.

Lio Trifon (Kola) Mitraj u martua me Noli Pilo Garron nga Porua, kanë lindur 4 vajza. Fatkeqësisht vajzat u rritën por nuk u kanë jetuar.

Fili Trifon Kola u martua me Lika Kol Komini nga Mifoli dhe kanë një djalë e 3 vajza: Fjordin, Meritën, Eglantinën dhe një tjetër.

Nga Naqe (Kola) Mitraj janë lindur 4 djem: Thanasi, Llazi, Panua dhe Todi.

Thanas Naqo Mitraj u martua me Gjena Thoma Minen nga Pish Porua dhe kanë vetëm një vajzë: Mellaninë (Millën). Ajo u martua me Llukë Lalën.

Llazi Naqi Mitraj u martua me Melpo Lili Monen nga Porua, kanë 3 djem e një vajzë: Dhimitraqin, Minellën, Sokratin dhe Nomin.

Dhimitraq Llazi Mitraj u martua me Vasilika Llazi Garron nga Porua dhe kanë dy djem e dy vajza: Aldin, Amarildon, Robenën dhe Blerinën.

Nomi Llazi Mitraj u martua me Arqile Priftin në Novoselë.

Minella Llazi Mitraj u martua me Lira Petro Thanën nga Porua, kanë 3 djem: Olsin, Gentin dhe Taulantin.

Sokrat Llazi Mitraj u martua me Miranda Themi Dokon nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Ermalin, Andonetën (binjakë) dhe Rominën.

Pano Naqo Mitraj u martua me Nefta Kristo Marinën nga Porua, kanë 6 djem e 6 vajza: Golin, Lejën, Naqon, Ilirin, Vironin, Fredin, Mondën, Valentinën, Gonën, Florikën, Vasilikën dhe Vjollcën.

Goli Pano Mitraj u martua me Monika Andon P. Kolën nga Porua, kanë dy djem, Aleksandrin e Albanon dhe 4 vajza.

Leja Pano Mitraj u martua me Shpresa Sotir Vrushin nga Delisufi, kanë një djalë e dy vajza: Stefanin, Sonilën, dhe Lorenën.

Naqo Pano Mitraj u martua me Farfurinë nga Martina e Fierit, kanë dy djem: Romeon dhe Markelin.

Ilir Pano Mitraj u martua me Alketën nga Pojani, kanë 3 djem: Panajotin, Joanin dhe Geraldin.

Vironi dhe Fredi aktualisht janë beqarë.

Vajzat e Pano Mitros (Kolës):

Valentina u martua me Nikon në Pish-Poro.

Monda u martua me Maksi Gjekën në Grecalli.

Gona u martua me Harrilla Toskën në Pish-Poro.

Florika u martua me Llambi Taqo Mbyetin në Delisuf.

Vasilika u martua me Arti Themi Nakën në Poro.

Vjollca, aktualisht është beqare.

TODI NAQO MITRAJ

Todi Naqo Mitraj u martua me Vangjelina Andre Davidhin nga Zhuka, kanë lindur 5 djem: Apostolin, Dhimitrin, Anestin, Piron, Mikelin.



Llazi Hajdini me shokët e miqtë e tij, Todi Kola, Stavre Thano, Vangjelina e Todit dhe djali i tyre, në vitin 2009

Apostol Todi Mitraj u martua me Polikseni Dhimitër Naunin, nga Çuka e Sarandës. Ka Arbenin, etj.

Arben Apostol Todi Mitraj, martuar me Kozeta Pilo Hajdini në Poro.

Dhimitër Todi Mitraj u martua me Natasha Kito Gjonçarin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Andrin dhe Elcën.

Anesti Todi Mitraj u martua me Andoneta Llazi Dashin nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë, Todin, Thanasin dhe Marien.

Piro Todi Mitraj u martua me Zana Miço Ristën nga Porua.

Mikel Todi Mitraj u martua me Laureta Lio Gjonin nga Dëllënja, kanë dy djem: Kostën dhe Ilian.

THOMA MITRAJ (KOLA)

Thoma Mitraj ka lënë 3 djem: Llambin, Lekon, dhe Tomin.

Llambi Thoma Mitraj u martua me Dafina Kil Gjokën

nga Pish-Porua e Fierit, kanë dy djem e 3 vajza: Vangjelin, Edin, Mirandën, Mozën dhe Elvirën.

Vangjel Llambi Mitraj u martua me Vangjelina Jorgji Tikën (Kungulli) nga Porua, kanë dy djem e një vajzë.

Edi Llambi Mitraj u martua me Lida Trifon Moçkën nga Porua, kanë një djalë: Edin.

Elvira Llambi Mitraj u martua me Agron Nonda Matën në Poro.

Leko Thoma Mitraj u martua me Vangjelina Thoma Çukon nga Bishani i Fierit, kanë 3 djem e 3 vajza: Milianon, Armandon, Gentianin, Teutën, Anilën, Erjelën.

Miliano Leko Mitraj u martua me Leta Kristaq Th. Davidhin nga Porua, kanë një djalë: Aleksin. Armando L. Mitraj u martua me Irma Petritin, aktualisht s'ka fëmijë.

Genti L. Mitraj u martua me Shqiponja Meleq Danajn, kanë një djalë: Gentianin.

Anila L. Mitraj u martua me Mihallaq Koli Hoxharën në Poro.

Erjola L. Mitraj u martua me Loni Kozma L. Priftin në Poro.

Tomi Thoma Mitraj u martua me Milika Fili Bërdallin nga Porua, kanë një djalë e 3 vajza: Ardin, Shpresën, Letën, Irmën.

Ardi aktualisht është beqar.

Leta u martua në Libofshë.

Shpresa u martua me Jani Vllasi Mitrushin në Dëllënjë.

Irma u martua në Frashër, Fier.

KITO LOLI KOLA (MITRAJ)

Kito Loli Kola u martua me Ndine Monen nga Qenasi i Fierit. Kanë lindur 4 djem e dy vajza: Fanin, Leonidhën, Petraqin, Ilian, Kristullën, Lirën.

Fani Kito Mitraj (Kola) u martua me Anastasi Çukon nga Semani, kanë dy djem e një vajzë: Miçon, (Besnik-Niku), Klodianin, Lauretën.

Miço Fani Mitraj u martua me Rovena Thoma Plakun

nga Dëllënja, kanë një vajzë.

Klodian Fani Mitraj u martua në Sheq të Fierit, aktualisht s'kanë fëmijë.

Kristina Kito Kola u martua me Miço Thomain nga Pish-Porua.

Lira u martua me Llazi Dokon në Pish-Poro.

Laureta u martua me Artur Koroveshin në Petovë të Fierit.

Petraq Kito Kola u martua me Marjana Koli Lulen nga Qarri, Fier, kanë 3 vajza: Brunën, Flumën, Anxhelën.

Bruna Petraq Kola (Mitraj) u martua me Ilia Thimjo L. Moçkën në Poro.

Ilia Kito Kola (Mitraj) u martua me Drita Pilo Bërdalli në Poro, kanë dy djem e dy vajza: Fatjonin, Kristaqin, Anjezën, dhe Enidën.

Të tjerët, aktualisht janë pamartuar.

PERIKLI LOLI KOLA (MITRAJ)

Perikli Loli Kola është martuar me Sika Bonaj nga Pish-Porua, kanë lindur 3 djem e dy vajza: Astritin, Dhimitraqin, Edmondin, Shpresën dhe Donikën.

Astrit Perikli Kola u martua me Elca Fili Loshin nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Arjelin, Shkëlzenin dhe Erinën.

Dhimitraq P. Kola u martua me Mira Vasillaq Mërtirin nga Porua, kanë dy vajza: Xhulian dhe Klarën.

Edmond P. Kola u martua me Entela Vangjel Lulen nga Qarri, Fier, kanë një djalë e një vajzë: Periklin dhe Lorenën.

Shpresa P. Kola u martua me Thoma Jani Hudhrën nga Dëllënja, kanë dy djem e dy vajza.

Donika P. Kola u martua me Themi Mihal Gjonçarin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë.

Leonidha Kito Kola u martua me Vangjelina Jota Lepurin nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Dorianin, Irmën dhe Erjonën.

Irma Leonidha K. Kola u martua me Kristaq Kosta Çukon në Sarandë. Dorjani dhe Erjona, aktualisht nuk janë martuar.

NAUN KOLA (MITRAJ)

Xha Naun Kola la vetëm 4 vajza. Me gruan e parë lindi vetëm një vajzë, Sotirën, e cila u martua me Vasil Mihal Çunin në Dëllënjë.

Me gruan e dytë, e cila e kishte Kristo Vani dhe kish lënë Kalien që mori Vangjel Kungulli, lindën dhe 3 vajza të tjera, Vasilikën, Dhorën, dhe Ngjelën.

Sotira u martua me Vasil M. Çunin në Dëllënjë.

Vasilika u martua me Marko Hyso në Novoselë.
Ngjela u martua me Thoma Ristanin në Poro.
Dhora u martua me Vangjel Moçkën në Poro.

VASIL JOSIF KOLA (MITRAJ)

Sotir V. Kola (Mitraj)

Vasili u martua me Dafina Leksi Dashin nga Gryka dhe lindën: Jorgjin, Sotirin, Nikon, Lion, Linën, Neftën, Aretinë, Valën dhe Falanë.

Jorgji mbeti i pa u martuar.

Sotir Vasil Kola u martua me Lina Pilo Dilën, kanë një djalë e dy vajza: Mihallaqin, që është martuar me Valbona Vangjel Rrungajën nga Zhuka, kanë një vajzë.

Niko V. Kola u martua me Sofie Pali Nakën nga Porua, kanë një djalë e 4 vajza: Fatmirin, Lidën, Marikën, Luljetën dhe Zamirën.

Lio Vasil Kola u martua me Lira Vangjel Veron nga Bestrova, kanë 4 djem: Bertin, Josifin, Astritin, Ilirin dhe një vajzë, Enrieta.

Berti Lio Kola u martua me Lira Pal Memecin nga Delisufi, kanë një djalë e dy vajza: Vasilin, Xhuanën, Marielën.

Josifi dhe Iliri janë martuar me greke, jetojnë në Greqi.

Astrit Lio Kola u martua me Marcela Thoma Plaku nga Porua, kanë një djalë, Gentin dhe një vajzë.

Shënim: Të gjithë Kolajt tani mbajnë mbiemrin Mitraj (nga emri i stërgjyshit).

PAPA SPIRO NAÇI

Papa Spirua thoshte se janë 7 breza priftërinjsh. Ai tregonte se origjinën e kanë nga Vokopola e Beratit.

Papa Spiro Naçi

Nga burrat njihet gjyshi i papa Spiros, Marko Naçi. Markua la papa Nikollën dhe 3 çupa, njëra u martua në Nartë, një u martua në Zvërnec te Subashajt dhe e treta në Vlorë, te Papapanot.

Edhe papa Nikolla la vetëm një djalë, papa Spiro Naçin. Papa Spirua jetoi deri në vitin 1955.

Papa Spiro Naçi e kishte marrë gruan nga Moçkallarët e Novoselës dhe lanë 4 djem e një vajzë: Llazin, Lijon, Sotirin, Janin dhe Kristullën.

Llazi Spiro Naçi, u martua me Vida Nakën nga Pish-Porua dhe kanë 3 djem e dy vajza: Mitaqin, Nondën, Kristaqin, Sofikën dhe Nolin.

Mitaqi Llazi Naçi u martua me Natasha Andon Xhongun nga Selenica dhe kanë dy djem e një vajzë: Alfredin, Aleksandrin dhe Brunildën.

Llazi Naçi, e shoqja, Vida dhe i biri i tyre më Nusen, Natashën

Brunilda Mitaq Naçi u martua me Mariglen Zoi Thomain në Delisuf. Djemtë, aktualisht janë beqarë. Janë në Greqi familjarisht. Brunilda me të shoqin janë në Itali.

Nonda Llazi Naçi u martua me Donika Jani Marku nga Dëllënja dhe kanë dy djem: Erigerton dhe Leonardin. Familjarisht janë në Greqi.

Kristaq Llazi Naçi u martua me Liljana Pandi Bombaj nga Selenica kanë një djalë e dy vajza: Xhulianon, Loredën dhe Kristianën. Sofika Llazi Naçi u martua me Niko Jorgji Bërdallin në Poro dhe kanë dy djem e dy vajza: Arjanin, Alqin, Majlindën dhe Aulonën.

Noli Llazi Naçi u martua me Polikron Xhoxhin në Topojë të Fierit.

LIO SPIRO NAÇI

Lio Spiro Naçi u martua me Neftali Naun Dokon nga Frakulla dhe kanë lindur 4 djem e 4 vajza: Vangjelin, Spiron, Andrean, Minellën, Ritën, Athinanë, Vefin dhe Dritën.

Vangjel Lio Naçi u martua me Noli Miti Daja nga Fieri dhe kanë dy djem, Genti dhe Iliri. Aktualisht të dy janë beqarë. Sot jetojnë dhe punojnë familjarisht në Greqi.

Spiro Lio Naçi u martua me gruan e parë nga Tirana, është divorcuar, por ka një djalë me të, Vani Veliu, banon në Tiranë. Spirua ka marrë tjetër grua nga Muzina, Delvinë, Athina Dankën. Me të nuk ka fëmijë, jetojnë dhe punojnë në Greqi.

Andrea Lio Naçi u martua në Tiranë me Neta Bektash Shametin nga Tepelena. Kanë dy vajza: Aurorën dhe Albën. Andrea punonte në minierën e Valiasit në Tiranë dhe ishte punëtor i dalluar, por aksidentalisht plasën tubat e gazit dhe miniera u mbyt me gaz ku u rrezikuan të vdisnin shumë punëtorë. Andrea, me iniciativën e tij, u fut në drejtim të shokëve që po mbyteshin nga gazi dhe dy e nga dy nxori nga zona e gazit shumë punëtorë të mbetur e të rraskapitur nga asfiksimi. Duke u futur disa herë për shpëtimin e shokëve, ai mbeti vet brenda dhe vdiq në minierë. Të gjithë shokët e tij që i nxori, shpëtuan se morën ndihmën e shpejtë nga punonjësit e specializuar.

Për t'u theksuar është se atë ditë ishte një kohë e keqe me shi që nuk pushoi fare për gjithë ditën. Të gjithë njerëzit që erdhën dhe e sollën një natë më parë, ikën e erdhën prapë të nesërmen nga Tirana me autobus. Mbi 50 veta u fundosën në ujë e baltë pranë kasolles së prindërve të Andrea Lio Naçit. Ngjarje më të hidhur e më të dëshpëruar se ajo, njerëzit nuk kishin parë. Vetë shokët e tij e futën në shtëpi me arkivolin që e sollën nga Tirana dhe prapë vetë ata e ngritën në krah e nuk lanë asnjë ta ngrinte të vdekurin, por të gjithë duke qarë, më shumë se vetë prindërit e motrat e tij e vëllezërit e çuan në varrezat e fshatit. Për aktin heroik të Andrea që tregoi në shpëtimin e jetës së shumë shokëve në minierë duhej jo vetëm të flitej aty në varrim, por duhej që të dilnin edhe me propozim që akti i tij të vlerësohej shumë e të nderohej. Një tjetër përshtypje të madhe që bëri në popull, ishte edhe qëndrimi i nuses së Andreas në varrimin e të shoqit. Ajo, përveç lotëve që derdhi, duke qarë si asnjë grua tjetër, u betua te koka e tij se nuk do të martohej dhe se vajzat e Andreas do t'i rriste vetë e për këtë betim ajo hoqi këpucën e re nga këmba e saj dhe ia hodhi burrit të saj në varr. Shenjë e veçantë kjo që njerëzve u bëri mjaft përshtypje të madhe besnikërie ndaj burrit. Në zonën tonë as kish ndodhur një fenomen i tillë deri atë ditë dhe as tani pas 20 e ca viteve. Qëndrova pak, duke e përshkruar këtë ngjarje sepse është rast shumë i rrallë që një djalë i ri të rrezikohet vet e të japë jetën për të shpëtuar të tjerët. Po si ky ishte edhe rasti i Ilia Kici Dashit nga Gryka që shpëtoi shokët dhe anijen luftarake në portin e Durrësit e për vete u dogj i tëri dhe për atë akt që bëri me propozim të Ministrisë Mbrojtjes, Kuvendi Popullor e shpalli "Hero i Popullit". Besnikëria e Nuses së Andreas vërtetohet se ajo ishte 20 vjeçe atëherë dhe vërtet deri sot që kanë kaluar edhe 20 vjet nuk është martuar, por punon e rrit vajzat e saj të bukura si molla.

Minella Lio Naçi u martua me Landa Alush Hazizaj nga Skrapari, ka një djalë e një vajzë: Andrean dhe Nevjolën. Minella banon familjarisht në Tiranë.

Vajzat e Lio Naçit:

Rita u dashurua me Petrit Neki Hasllanin në Poro, por familja nuk i la të martoheshin. Mbeti shtatzanë me Petritin dhe lindi një vajzë, Florën. Ajo u rrit nga Rita dhe prindërit

e saj dhe u martua në Tiranë me Gëzim Hoxhën. Edhe Rita u martua në Tiranë me Xhemil Zenelin dhe më të lindi një djalë e 4 vajza: Artanin, Silvanën, Sulenën, Xhinën dhe Arjanën. Tani ajo ka emigruar me fëmijët e saj.

Athina Lio Naçi është martuar në Tiranë me Pandi Sikon.

Vefi është martuar me një italian në Itali.

Drita është martuar me Arianin në Tiranë, ka një djalë dhe dy vajza.

Sotir Spiro Naçi u martua me Vasilika Tin Dashin nga Gryka dhe kanë dy djem e dy vajza: Thoman, Lekën, Gjenën dhe Veronikën.

Sotir Naçi me mbesën, Nolin

Tomi Sotir Naçi u martua me Rajmonda Thoma Qorrin nga Delisufi dhe kanë dy djem e një vajzë: Nikollaqin, Arjanin dhe Anxhelën.

Leka Sotir Naçi u martua me Donika Niso Llambron nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Anestin, Shpresën dhe Vasilikën.

Gjena u martua me Miço Sotir Qarrin në Mifol kanë një djalë e dy vajza: Lefterin, Gjenovefën dhe Alketën.

Veronika Sotir Naçi u martua me Trifon Llazin Qarri në Mifol dhe kanë Mondin, Enkelejdën dhe Etlevën.

Jani Spiro Naçi u martua me Jorgjie Nasi Minen nga Pish-Porua e Fierit dhe kanë 4 djem: Petraqin, Llambin, Josifin dhe Yllin.

Jani S. Naçi

Petraq Jani Naçi u martua me Kristina Lio Koçin nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Vasillaqin, Fatjonin dhe Eriseldën.

Llambi lani Naçi u martua me Violeta Ristan Gegën nga Delisufi dhe kanë dy djem e një vajzë: Viktorin, Marcelin dhe Dorjanën.

Josif Jani Naçi u martua me Marjeta Toska nga Llakatundi dhe kanë një djalë e një vajzë: Janin dhe Jorgjien.

Ylli Jani Naçi, me gruan e parë nga Daullasi, Milda Nikolla Sako, ka dy djem: Jorgon dhe Kriston. Ylli u divorcua me Mildën dhe u martua me një vajzë nga Ferrasi, Akselën e Rrapi Prendit. Prej 15–16 vjetësh banojnë në Greqi. Të katër djemtë e Janit janë në emigracion: një në Itali e 3 në Greqi. Jani ka vdekur në vitin 2005.

Kristulla Spiro Naçi u martua me Pilo Bërdallin, Poro.

KOSTANDIN NASI NAÇI

Nasi Naçi kishte ardhur në Frakull nga Gjirokastra, me një tufë bagëti. Aty u martua me Lulen nga fisi i papa Spiro Naçit nga Porua. (Nasi Naçi ishte nga Gjirokastra, ndërsa papa Spirua me origjinë nga Vokopola e Beratit, pra tjetër fis).

Nasi Naçi me Lulen kanë dy djem, Kostandinin dhe një djalë tjetër që vdiq më 1913 nga gripi spanjoll, si dhe një vajzë që u martua në Vlorë dhe lindi Josif Simonin.

I ati i Kostandinit, Nasi Naçi, vdiq shpejt dhe Lulja, me Kostandinin e vogël, erdhi te papa Spiro Naçi, se e kish kushëri. Kostandin Naçi u martua me Dafinën nga Beshishti dhe lindi Llaqi Naçin.

Në vitin1944, Kostandini u martua me Janullën, një grua e ve, që kish ardhur muhaxhire nga Greqia bashkë me disa familje greke nga fshatrat e Janinës të shpërngulur nga lufta dhe që ishin ngulur në Poro. Me Janullën Kostandini pati 3 vajza: Sofien, Kristullën dhe Vangjelinën. Në vitin 1950, Llaqi Kostandin Naçi shkoi në Vlorë, u punësua dhe i tërhoqi edhe babanë, njerkën dhe 3 motrat.

Llaqi Kostandin Naçi, në vitin 1957 u martua me Mene Dhori Hajdinin dhe kanë 4 djem e një vajzë: Arqilen, Natashën, Leonardin, Gjergjin dhe Thomain. Banojnë në Vlorë që nga viti 1950.

Llaqi Naçi me të shoqen, Menin

Arqile Llaqi Naçi u martua me Meri Lolo Kuçulin nga Dhërmiu, e cila lindi dy vajza, Florin dhe Inën.

Natasha Llaqi Naçi u martua me Baçi Mustafarajn në Vlorë dhe kanë 3 djem: Hetemin, Bledarin dhe Klenisin.

Leonard Llaqi Naçi u martua me Leonora Llaqi Lio Prroin nga Vlora dhe kanë një vajzë.

Gjergji Llaqi Naçi u martua me Emiljana Llukë Ramën nga Fieri, kanë dy djem: Enrin dhe Leandron.

Thoma (Tomi) Llaqi Naçi u martua me Laureta Manush Trokën nga Vlora, kanë një djalë.

Shënim: Leja, Gjergji dhe Tomi kanë emigruar në Greqi.

LUÇI (PALUSHI) LEKSI NAÇI

Luçi Naçi nga Frakulla u martua me Lenën e Kije Rrungajës nga Zhuka, kanë lindur dy djem e 3 vajza: Kozman, Llambin, Savetën, Neftën dhe Zhanetën.

Kozma Luçi Naçi u martua me Gore Pilo Matën nga Matkëza e Fierit, kanë një djalë e dy vajza: Edmondin, Rudinën dhe Elenën.

Edmond Kozma Naçi u martua me Shpresa Thoma Marinën nga Porua, kanë një vajzë.

Rudina Kozma Naçi u martua me Lorenc Jani Kungullin nga Porua.

Eleni K. Naçi u martua me Astrit Tako Todi Koten në Dëllënjë.

Llambi Luçi Naçi u martua me Mirela Dhimitër Simonin nga Beshishti, kanë dy djem e dy vajza: Odisenë, Palushin, Erjodën, dhe Inën.

Vajzat e Luçi Naçit:

Saveta u martua me Vasil Trushi Kolën në Poro.

Nefta u martua me Margarit Themi Nushin në Mifol.

Zhaneta u martua me Pandeli Thoma Loshin në Vlorë.

PILO NDINI (GJONÇA)

Pilo Ndini dhe Leko Ndini ishin vëllezër. Më parë mbiemrin e kanë pasur Gjonça. Pilo Ndini u martua me Lina Bushin nga Dëllënja, (motra e Thanas Bushit), ka një vajzë: Mellaninë. Kanë adoptuar një djalë, quhet Vasil Pilo Ndini.

Mellania është martuar me Koçi Naun Thanasin në Dëllënjë.

Vasil Pilo Ndini është martuar me Liri Nasi Helmin, dhe kanë dy djem e një vajzë, ndër të cilët, Vanin dhe Aurorën.

LEKO NDINI (GJONÇA)

Leko Ndini u martua me Llambrini Priftin nga Novosela. Ka dy djem e një vajzë: Llazin, Pandin dhe Letën.

Llazi vdiq i ri.

Pandi L. Ndini u martua me Lina Vllasi Markun nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë: Rezartin, Sokolin dhe Enkelejdën.

Zarti Pandi Ndini u martua me një nga Topoja e Fierit, ka një djalë.

Leta Leko Ndini u martua me Fili Vasil Çunin në Dëllënjë. Ka dy djem e 4 vajza: Naunin, Ilirin, Nastën, Ritën, Sofikën dhe Netën.

NDONI NASI GEGA,DËLLËNJË

Ndoni Nasi Gega u martua me Vita Uan Thanon nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Vason dhe Adelinën.



Ndoni Nasi Gega me djalin e tij, Vason

Vaso Andon Gega u martua me Gjena Llazi Dokon nga

Pish-Poro, ka një djalë, Bledin e 3 vajza.

Adelina A. Gega është martuar me Thoma P. Gjonin në Dëllënjë.

VANGJEL LONI NDINI LLUPI, GRYKË

Vangjel Loni Toli Ndini Llupi është rritur në Grykë, dhe u martua me Kristina Llazi Kove nga Gryka. Kanë 4 djem e 3 vajza: Dhimitrin, Arqilen, Todin, Aleksin, Katerinën, Gelantinën dhe Mondën.

Vangjel Ndini

Loni Toli kish marrë Uraninë, të bijën e Gori Gjindalit në Delisuf, kishte dy djem, Vangjelin e Thanasin, dhe dy vajza.

Arqile Vangjel Ndini u martua me Andoneta Njazi Bellon nga Smokthina, kanë një djalë e një vajzë: Kriston dhe Adelën.

Katerina Vangjel Ndini u martua me Agron Resulin nga Treblova Vlorë, kanë një djalë e një vajzë: Admirin dhe Ketjanën.

Fëmijët e tjerë të Vangjelit, aktualisht janë të pamartuar.

Të gjithë janë të rritur në moshë, Vangjeli e Kristina janë njerëz respektuar nga shoqëria, edhe fëmijët shumë të rregullt.

THANAS LONI NDINI

Thanas Loni Ndini (ose Llupi) u martua me Sila Llambro Demën nga Bunavia, kanë 3 djem: Mondin, Vasillaqin dhe Ardin. (Ardi vdiq, u dogj aksidentalisht në Greqi në punë, i pa martuar).

Mondi u martua me vajzën e Kordhajve nga Bestrova, ka dy vajza.

Vasillaqi u martua me një vajzë nga Patosi, jetojnë në Greqi.

LONI NAKA, DËLLËNJË

Në Dëllënjë kanë qenë dy vëllezër, Loni dhe Nasi Naka, të ardhur nga Havaleasi i Fierit. Me Nakajt e Delisufit janë kushërinj. Nakajt e Delisufit i morën ata të Havaleasit dhe i vendosën në Dëllënjë.

Loni Naka ishte i martuar me Zoicën nga Daullasi i Fierit. Kanë 3 djem e 3 vajza: Kristaqin, Gjergjin (Gjekon), Pilon, Llambën, Lirinë dhe Savetën.

Kristaq Loni Naka u martua me Sena Vangjel Hajdinin nga Porua, lindën një djalë dhe 3 vajza: Ladin, Sofikën, Margaritën, Liljanën. Kristaqi vdiq i ri, në moshën 36 vjeç. Fëmijët i la të vegjël fare.

Sena mori të katër fëmijët e u kthye te vëllezërit në Poro. Pas ca kohe, ajo u martua prapë, me Stavre Dilën në Poro, dhe lindi me të edhe një vajzë, Florikën.

Sofika Kristaq Naka u martua me Sotir Nasi Shytin në Poro.

Margarita u martua me Kristaq Kil Gjonçarin në Poro.

Liljana u martua me Tomi Koçi Belinën në Poro.

Djali nuk ka dëshirë që t'i dal emri atij dhe i familjes së tij.

Gjergji (Gjeko) Naka u martua me Lena Kroni Mitrushin nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë: Rajmondin, Vasillaqin dhe Mimozën.

Gjeko Naka me djalin e tij, Vasillaqin

Rajmond Gj. Naka u martua me Lefterin nga Pish-Porua, kanë 2 djem: Leartin dhe Gjergjin.

Vasillaq Gj. Naka u martua me Rajmonda Hysen Bedullaji nga Përmeti, kanë një djalë e një vajzë: Kristianin e Vasilikën.

Mimoza Gjeko Naka u martua me Kostandin Todi K. Markun në Vlorë, kanë dy vajza: Mikelën dhe Markezën.

Gjekua familjarisht banon në Novoselë, që nga viti 1980.

Pilo Loni Naka u martua me Dhoksie Vllasi Markun nga Dëllënja, kanë një djalë e 3 vajza: Arbenin, Marielën, Elcën dhe Shpresën.

Arben Pilo Naka është i martuar.

Mariela u martua me Gëzim Stepën nga Tragjasi.

Elca u martua me një italian, jeton në Itali.

Shpresa u martua me Viktor Jani Papa në Delisuf.

Nasi Naka, vëllai i Loni Nakës



Leko Nasi Naka

Nasi Naka la Lekon dhe Lenën.

Lena u martua me Pali Moçka, Poro.

Leko Nasi Naka u martua me Sofie Veron nga Beshishti, kanë një djalë e 3 vajza: Xhimin, Enkeledën, Alketën dhe një tjetër.

Xhimi Leko Naka u martua me një vajzë nga Bishani, aktualisht kanë një djalë.

Enkeleda u martua me Vangjel Nasi Helmin në Dëllënjë.

Alketa u martua me Miti Dokon në Pish Poro.

Vajzat e Loni Nakës:

Llamba u martua me Stavre Monen në Levan.
Liria u martua me Kristaq Thoma Hyso në Novoselë.
Saveta u martua me Niko Miti Çuni në Dëllënjë.

LLAZI NAKA, DELISUF

Nakajt kanë ardhur nga Zharrëza e Fierit. Llazi Naka la dy djem e dy vajza: Josifin, Lilin, Pulien dhe Marikën.

Marikën e mori vëllai i Mihal Petovës. Me atë lindi një djalë, por ai i vdiq dhe, më pas, vdiq edhe i shoqi. Ajo erdhi te i vëllai, Josifi, në Delisuf.

Pulien e mori Toli Dila në Poro.

Josif Llazi Naka u martua me Vasilika Kristo Qorrin nga Delisufi, lindi 3 djem, Minon, Lipin dhe Vangjelin.

Dhori Hajdini, Josif Naka dhe Loni Helmi

Më pas, Josifi Naka mori grua tjetër, Katerinën e Uan Lepurit dhe, me të, lindi Vangjelin e Pandelin.

Pas vdekjes së Josif Nakës, e shoqja mori djalin e vogël me vete dhe u martua në Seman. Atje lindi djem e vajza.

Mino Josif Naka u martua me Ndine Andrea Rako Koçin nga Dëllënja, kanë 4 djem e 5 vajza: Llazarin, Sotiraqin, Lefterin, Ilirjanin, Neftalinë, Rajmondën, Dritën, Mimozën, Gladiolën.

Llazar Mino Naka u martua me Neftali Vangjel Marinën nga Porua, kanë 3 djem e një vajzë: Ermalin, Andin, Flavion dhe Idën.

Sotiraq Mino Naka u martua me Androniqi Llambi Dashin nga Delisufi, kanë dy djem: Albanon dhe Xhulianon.

Lefter Mino Naka u martua me Lani Alush Malajn, nga Kota Vlorë, kanë dy vajza.

Ilirjan Mino Naka u martua me Floda Sokrat Hudhrën nga Muçaj Fier.

Vajzat e Mino Nakës:

Nefta u martua me Janaq Stavre Moçkën Poro, kanë një djalë e dy vajza.

Monda u martua me Nonda Zoi Stefën, Zvërnec.

Mimoza u martua me Petraq Pano Koven në Delisuf.

Gradiola u martua me Vasil Koçi Kërrin në Delisuf.

Drita u martua me Vangjel Koli Hudhrën në Muçaj, Fier.

Lipi Josif Naka u martua me Rita Zoi Priftin nga Vlora, kanë 3 djem e 4 vajza: Apostolin, Benin, Mirin, Vangjelinën, Vasilikën, Lirën dhe Lidën.

Apostol L. Naka u martua me Nola Jani Papën, kanë një djalë e 3 vajza.

Beni u martua me italiane.

Miri u martua në Sheqishtë, kanë një djalë, Filipin.

Vangjelina u martua me Namikun në Vlorë.

Vasilika u martua, dhe ka një djalë e një vajzë.

Lira u martua me Minella Pilo Lepurin në Poro.

Lida u martua me Paskal Semën në Topojë, ka dy vajza.

Vangjel Josif Naka u martua me Gjena Kije Qorri nga Delisufi, kanë 4 djem e një vajzë: Ladin, Josifin, Eduardin, Altinin dhe Nikoletën.

Ladi V. Naka u martua me Etlevën, vajza e Marko Lijo Moçkën në Poro.

Josif V. Naka aktualisht është i pamartuar.

Eduardi u martua me Nomi Sotën nga Delisufi.

Nikoleta u martua me Pandi Hudhrën në Muçaj, Fier.

TODI THEMI NAKA

Todi Themi Naka është martuar me Ollga Tini Dashin nga Gryka, kanë lindur 3 djem e 5 vajza: Thoman, Xhoxhin (Jorgo), Viktorin, Ristanën (Tana), Lirën, Lidën, Silën dhe Zamirën.

Thoma (Tomi) Todi Naka u martua me Vjollca Petanin në Frakull, kanë dy djem e dy vajza.

Xhoxhi Todi Naka u martua me Fatmira Bedri Toja në Akërni (nga Bishani), kanë një vajzë.

Viktor Todi Naka u martua me Gladiola Hysen Baxha në Novoselë, kanë një vajzë.

Vajzat e Todi Nakës:

Ristana (Tana) është martuar me Jani Lijo Gjonçari në Novoselë.

Sila është martuar me Janaq (Naku) Filip Hyso në Novoselë, kanë një djalë dhe një vajzë, Brunon dhe Antonelën.

Lira është martuar me Dhimitraq Papa në Nartë.

Linda është martuar me Aristir Lil Qarri në Aliban.

Zamira është martuar me Pavli Thanas Hyso në Novoselë, kanë një vajzë dhe një djalë.

THEMI NAKA, DELISUF

Nakajt janë të vjetër në Delisuf. Themi Naka me gruan e parë ka lindur Palin dhe Vlash Nakën. Kur mori gruan e dytë, mëmë Sinën, lindi edhe Todin.

Pas disa vjetëve Themi Naka vdiq, dhe Mëmë Sina Mori djemtë e saj, Niso Llambron dhe Todin që e lindi aty, dhe shkoi në Grykë. Atje ndërtuan shtëpi dhe u rritën e u martuan edhe djemtë.

Pali e Vlashi Naka mbetën në shtëpinë e babës dhe aty u martuan.

Pali Naka u martua me Katerina Jankën, motrën e Sotir Jankës nga Porua, lindën 4 djem e 7 vajza: Panon, Llambin, Themiun, Thoman, Ritën, Marien, Athinanë, Sofien, Ristanën, Uraninë dhe Vitorian.

Pano Pali Naka u martua me Liri Loni Kolën nga Qenasi, kanë 3 djem: Edmondin, Minellën dhe Vasillaqin. Liria solli te Pano Naka dy djem që i kishte lindur me burrin e parë, Aleksandrin dhe Piro Kolën. Të dy ata u rritën e u martuan në Çukë të Sarandës.

Pano Naka me gruan e tij, Liri Kola

Edmond Pano Naka u martua me Marjeta Peço Priftin nga Porua, kanë 3 djem: Ilirjanin, Emiljanon dhe Eldisonin.

Minella Pano Naka u martua me Anila Thoma Gjonin nga Dëllënja, kanë dy djem: Panajotin dhe Thoman.

Vasillaq Pano Naka u martua me Kadrie Qamil Xhelaj nga Roskoveci, kanë 3 vajza: Sarën, Silvën dhe Suelën.

Tomi Pali Naka u martua me Lefteri Milon nga Palasa. Nuk lindën fëmijë, por kanë marrë një djalë dhe e kanë birësuar me emrin Llukan Thoma Naka.

Llukani është martuar me Mondën nga fshati Lapardha i Vlorës, kanë dy djem: Tomon dhe një tjetër.

Themi Pali Naka (i ri) u martua me Gonen e Vasil Loshit nga Porua. Ka një djalë dhe tri vajza: Arti, Mirela, Enkelejda dhe Entela.

Vlashi Themi Naka, vëllai i Pali Nakës

Vlashi Naka u martua me Melpon nga Gjirokastra, lindën 4 djem dhe një vajzë: Vason, Janin, Thanasin, Kiçon dhe Olën.

Vasua është martuar me Letën e Vasil Xamos nga Novosela.

Jani u martua me një vajzë çame nga Vlora.

Thanasi u martua me Letën nga Mifoli.

Kiçua u martua në Gjirokastër dhe atje banon.

Vajzat e Pali Nakës:

Rita u martua me Petro Thanon në Poro.

Maria u martua me Jani Banin në Ferras, Fier.

Sofia u martua me Niko Kolën në Poro.

Ristana u martua me Kristaq Kriston në Pish-Poro.

Urania u martua me Pilo Hajdinin në Poro.

Athinaja u martua me Gori Anastasin në Novoselë.

Vitorja u martua me Leonidha Dokon në Aliban.

RISTAN NASI

Ristan Nasi erdhi në Poro nga Libofsha, la 4 djem: Kozman, Thoman, Vasilin dhe Janon. Vasili vdiq i vogël në vitin 1914.

Kozmai ishte më i madhi. Nëna u vdiq e i la të vegjël Thoman e Janon. Janon e mori Petro Garrua në Poro dhe e birësoi, e rriti dhe e martoi me të mbesën e tij, vajzën e të vëllait, Uan Garros, Pulien (dhe mëmë e Lule Nasi Gegës).

Kozma Ristan Nasi u martua dy herë. Me të parën nuk pati fëmijë, me të dytën, bijë nga Zhezhajt e Grykës. Ajo solli një djalë me vete Petro Memecin. Me këtë, Kozmai ka 5 djem e një vajzë: Sofien, Naunin, Miçon, Lolin, Vangjelin dhe Nison. Vangjeli dhe Nisua vdiqën të vegjël.

Sofia u martua me Lio Ristën në Zhukë.

Naun K. Nasi u martua me Sika Andon Dhamon nga Pish-Poro dhe kanë 9 fëmijë: Kozman, Palin, Fredin, Alketin, Harrillën, Millën, Gjenën, Donikën dhe Luljetën.

Kozma Naun Nasi u martua me një vajzë nga Çuka e Sarandës. Ka fëmijë.

Pali Naun Nasi u martua me Alma Sotir Kondën në Poro dhe ka një djalë e 5 vajza.

Fredi Naun Nasi u martua me Marcela Mino Lepurin, ka një djalë e një vajzë, Klejdin dhe Sofien.

Alket Naun Nasi u martua me Blerta Tokli Dilën nga Porua. Ka dy vajza.

Harrilla aktualisht është beqar.

Vajzat e Naunit janë martuar të gjitha.

Miço Kozma Nasi u martua me Sofie Dhamon nga Pish-Porua dhe kanë 3 djem e një vajzë: Vllasin, Aleksin, Eduardin dhe Ritën.

Vllas Miço Nasi u martua me Djanën nga Lepenica dhe ka një djalë, Emiljanon, dhe dy vajza.

Aleks Miço Nasi u martua me Florika Stavre Dilën nga Porua dhe ka një djalë e një vajzë.

Edmondi aktualisht është beqar.

Rita u martua në Novoselë.

Loli Kozma Nasi u martua me Milla Sotir Loshin nga Porua, ka dy djem e një vajzë: Robertin, Margaritin, dhe Enkelejdën.

Roberto Loli Nasi u martua me Mirela Llazi Mbyetin nga Delisufi dhe kanë një djalë, Skerdin.

Enkelejda u martua te Çukajt e Bishanit të Fierit.

THOMA RISTAN NASI

Thoma Nasi me gruan e tij, Vangjelinën

Martuar me Vangjelina Naun Kolën nga Porua, dhe kanë lënë 4 djem e një vajzë, Neftën, Tokliun, Pilon, Gjergjin dhe Laken.

Nefta u martua me Todi Miti Çunin nga Dëllënja, banojnë në Poro.

Tokli Th. Nasi u martua me Gjena Fili Bërdalli nga Porua dhe kanë një djalë e dy vajza: Yllin, Xhulin, Shpresën.

Ylli Tokli Nasi u martua me Rudina Miço

Hudhrën nga Dëllënja. Ka 3 vajza: Uedin, Stelën dhe Aleksien.

Tokli Nasi me Llazi Hajdinin

Pilo Thoma Nasi u martua me Kristina Koli Zakën nga Zhuka, kanë dy djem e dy vajza: Lorencin, Altionin, Valbonën dhe Anilën.

Lorenc Pilo Nasi u martua me Anidën nga Frashëri i Fierit, ka një vajzë, Anxhelën.

Altioni aktualisht është beqar.

Valbona Pilo Nasi u martua në Sheqishtë të Fierit.

Anila Pilo Nasi u martua në Marinëz të Fierit.

Gjergj (Xheka) Thoma Nasi u martua me Vasilika Vangjel Dhamon nga Pish Porua, ka dy djem e një vajzë: Emiljanon, Eraldin dhe Erën.

Erald Gjergj Nasi u martua me Edën nga Pish Porua e Fierit, kanë një djalë, Tomën.

Llazi (Lakja) Thoma Nasi u martua me Mira Myrteza Xhelaj nga Bishani, kanë 3 vajza: Angjelën, Liljanën dhe Emën.

JANI JOTI PAPAJ

Joti Papaj ishte nga Narta. Në Zhukë ka ardhur nga Narta, para vitit 1930. Është marrë më tepër me peshkim sesa me bujqësi. Joti Papaj ka lënë vetëm një djalë, Janin. Nëna e Janit, Vasillua ishte nga Palasa.

Jani Joti Papaj

Jani Joti Papaj u martua me Naunka Jani Ristën nga Alibani, (nëna e kësaj ishte Gjena nga Fisi i Stringajve nga Frakulla, që kish marrë edhe Kozma Marku pas Jani Ristës dhe ka Dhori Ristën vëlla).

Jani Papa me Naunkën kanë lindur 6 femijë: 3 djem e 3 vajza: Gjergjin, Viktorin, Jordanin, Liljanën, Dritën dhe Leonorën, janë martuar të gjithë dhe jetojnë në Itali e Greqi.

Gjergji Jani Papaj u martua me Zamira Arqile Llambron nga Porua, kanë dy djem: Iredianin dhe Gentin.

Viktor Jani Papaj u martua me Shpresa Pilo Loni Nakën nga Dëllënja, kanë dy vajza, Alketën dhe Elisën.

Jordan Jani Papaj u martua me Enkelejda Vangjel Sotir Shytin nga Pish-Porua (Sotiri është nga Zhuka), kanë një djalë, Joeni.

THOMA PALASA (DËLLËNJË)

Thoma Palasa erdhi në Dëllënjë dhe punoi gjithë jetën, deri në pleqëri, te Lon Liço. Punoi si ai, rriti gjithë fëmijët e Lonit e të Naunit e, më në fund, kur vdiq, u varros te Vidhat e Shën Harallambit me një ceremoni të thjeshtë. Varri i tij ka mbetur vetëm te kisha, sepse disa të tjerë që u varrosën aty disa vite më pas, njerëzit e tyre i hoqën e i kaluan në varrezat e reja të fshatit.

Unë nuk e kam njohur këtë burrë të mirë, por me indinjatë të madhe e them: Mjerë ata njerëz që s'kanë se kush të kujdesohet, dhe lum ata që kanë njerëz e pasardhës!

Shpresoj se thirrja ime do të dëgjohet dhe xha Thoma Palasa do të qetësohet te Selvitë e bukura, bashkë me shokët e miqtë e tij të fshatit, Dëllënjë.

MIHAL SPIRO PETOVA

Gori dhe Trifon Thoma Petova më thanë se, gjyshi i babait tonë, Spiro Petova ka ardhur nga Maqedonia, nga një fshat që quhet Petova. Ka vërtetë apo s'ka një fshat të tillë sot atje, këtë nuk e dimë që të vërtetohet që ata janë prej andej.

Spirua në atë kohë erdhi 10 vjeç, me gjithë xhaxhain e tij, dhe u vendosën në Petovë të Fierit. Tani kjo mund të jetë më se e vërtetë, sepse kanë marrë mbiemrin nga fshati ku kanë qenë, Petovë.

Spirua la Mihalin si djalë, edhe ky lindi në Petovë. U rrit e punonte si usta, duke ndërtuar kasolle e shtëpi të thjeshta të fshatarëve të Myzeqesë, fshat më fshat. U martua në Dëllënjë dhe mbeti në këtë fshat.

Në Dëllënjë mori për grua Patron, motrën e Loni Liços dhe me të lindi 3 djem e një vajzë: Vasilikën, Thoman, Spiron dhe Kozman.

Vasilika u martua në Dëllënjë me Rrapi Zakën dhe lindi 4 djem e dy vajza: Mitin, Llazin, Llambin, Petron, Milikën dhe Letën.

Thoma Mihal Petova u martua me Varvarën e Pilo Thanasit nga Dëllënja, lindën 3 djem e 4 vajza: Trifonin, Dhorin, Gorin, Kristinën, Fanien, Sofikën dhe Donikën.

Trifon Thoma Petova u martua me Andoneta Miti Qosen nga Berati, kanë dy djem e një vajzë: Rolandin, Ilirin dhe Kozetën.

Roland Trifon Petova u martua me Mimoza Mehmet Haxhinë nga Tropoja, kanë dy djem: Anxhelon dhe Florianin. Trifoni ka jetuar gjithë kohën në Durrës dhe ka punuar me Marinën Tregtare Durrës. Fëmijët kanë emigruar në Itali.

Dhori Thoma Petova vdiq djalë i ri.

Gori Thoma Petova u martua me Leonora Like Rrapin nga Topoja e Fierit. Kanë dy djem e një vajzë: Arjanin, Klodianin dhe Edmirën.

Arjan Gori Petova u martua me Irena Muharrem Demirin nga Kavaja me origjinë, por kanë banuar në Elbasan. Arjani ka një vajzë, Sindi.

Klodiani aktualisht është beqar.

Edmira u martua me Shpëtim Barjanin nga Kosova, por banojnë në Elbasan.

Edhe Gori ka banuar e punuar në Elbasan shumë vite. Këtu pleqëruan. Babai e nëna e tyre, Thomai e Varvara, aty vdiqën.

Vajzat e Thoma Petovës:

Kristina u martua me Petro Xhaferin nga Tepelena.

Fania vdiq e re, në moshën 14 vjeçe.

Sofika u martua me Stefan Meksin nga Saranda, kanë emigruar në Greqi.

Donika u martua në Elbasan me Arbenin, kanë 3 fëmijë.

Shënim: Xha Thomai pas Çlirimit, familjarisht ka jetuar e punuar në fermën Fitore, Novoselë, Vlorë dhe kur Gori, i biri u strehua në Elbasan me punë e shtëpi, mori edhe pleqtë, të cilët atje mbyllën jetën e tyre në pleqëri të mirë.

Ndërsa djali tjetër, Trifoni, është larguar që i vogël në shkollë e u strehua në Durrës. Kanë qenë njerëz të mirë e buzëqeshur.

SPIRO MIHAL PETOVA

Spiro Mihal Petova ishte martuar me Vala Jani Rredhin nga Mifoli, kanë dy djem e 5 vajza: Mihalin, Mirin, Andonetën, Letën, Lizën, Leonorën dhe Dezdemonën.

Mihal Spiro Petova u martua me një vajzë nga Lushnja, kanë dy vajza. Kanë emigruar në Itali.

Miri Pilo Petova e ka marrë nusen në Lushnjë, ka një djalë. Që të dy janë familjarisht në Itali. Edhe vajzat e Pilo Petovës janë martuar të gjitha.

KOZMA MIHAL PETOVA

Kozma Mihal Petova u martua në Vlorë me Kristinën nga lagjja Vrenes. Lindën 3 vajza: Elcën, Mirandën dhe Florën.

Elca K. Petova u martua me Xhevitin nga Fushë-Kruja, banojnë në Tiranë.

Miranda K. Petova u martua me Luftarin nga Oshtima e Vlorës, kanë një djalë, banon në Vlorë.

Flora K. Petova u martua me Luigjin nga Patosi, kanë emigruar në Amerikë.

Kur Kozmai ishte 65 vjeç, i vdiq gruaja, Kristina. Vajzat i kishte të martuara e të larguara. Mbeti pa njeri në shtëpi, u detyrua të marrë një grua tjetër, me dy vajza, Hënën nga Trevllazëri, nuk lindi fëmijë. Ai pleqëroi me Hënën si mos më mirë. Kozmai vdiq në vitin 2007. Ai ka punuar e jetuar gjithë jetën në Vlorë.

LAMO PËRRI, DËLLËNJË

Thonë se Lamo Përri u martua me të bijën e Dhori Nakës me Sotirën nga Mifoli. Me atë lindi një djalë e një vajzë: Dhimitraqin dhe Letën.

Dhimitraq Lamo Përri u martua me Leonora Vangjel Tankun nga Shtyllasi i Fierit dhe ka një djalë, Armandon dhe një vajzë.

Leta Lamo Përri është martuar me Llambi Spiron në Pish-Poro.

Dhe pas kësaj, Lamo Perri mori Neftën e Lules, që e kish me Uani Garron nga Porua.

Lamua me Neftën lindën dy vajza: Lirinë dhe Marien. Kur ai vdiq, Nefta mori vajzat e shkoi në Vlorë. Në Vlorë Nefta u martua me Kristaq Baraj dhe u lindën një djalë e një vajzë: Miçon dhe Mondën.

Dy vajzat që kishte me Lamon, Liria dhe Maria, u rritën e u bënë vajza të mira dhe të dyja u martuan në Vlorë, e të dyja i morën burrat arsimtarë.

Liri Lamo Perri u martua me Miltiadh Dallën nga fshatrat e Gjirokastrës, ndërsa Maria u martua me Kujtim Hodon nga Gërneci i Vlorës. Që të dy janë mësues.

Lulja, nëna e Neftës, rrojti me Neftën në Dëllënjë e në Vlorë. Vdiq në moshë të madhe. Ajo kishte edhe një vajzë më të madhe se Nefta, Pulien. Këtë e kish martuar me Jano Garron në Poro, por ajo nuk jetoi gjatë. Lindi një djalë me Janon dhe të dy vdiqën. Janua pas asaj mori një tjetër nga Vlora, motrën e Jorgji Sotës.

Nefta e Lamo Përrit u martua me Kristaq Baraj në Vlorë dhe lindi një djalë e një vajzë: Miço Baraj dhe Rajmondën.

Rajmondën e martuan me Viran Devolen në Vlorë, me origjinë nga Berati. Vironi e kishte teze, motrën e nënës, gruan e Todi Kostandin Markut nga Zhuka.

Miço Kristaq Baraj (Djali i Neftës) u martua dhe ka dy vajza e një djalë. Kanë emigruar në Greqi. Atje jeton edhe Nefta.

Miçua i Neftës ka mbajtur miqësi me Vllasi Kroni Mitrushin dhe djemtë e tjerë, si kushërinj që janë në të vërtetë, sepse Lulja dhe Ksanda e Kronit ishin motra, bijat e Nasi Gegës nga Delisufi.

KRISTO PËRRI (STEFA)

Origjina e Përrajve është Myzeqare.

Kristo Përri u martua me Sofien e Prendi Koçit nga Porua, kanë 4 djem e një vajzë: Panon, Llazin, Vangjelin, Pilon dhe Marinaqin.

Pano Kristo Përri u martua me Dhimitrulla Shikon nga Derviçani i Gjirokastrës, kanë një djalë: Lefterin.

Lefter Pano Përri u martua me Adelinën nga Frashëri i Fierit, kanë dy vajza: Marjetën dhe Dhimitrën.

Llazi Kristo Stefa (Përri) u martua me Ksanda Jorgo Makuçin nga Derviçani i Gjirokastrës, kanë 3 vajza: Luljetën, Floretën dhe Mirelën.

Luljeta Llazi Stefa u martua me Irakli Naçin nga Frakulla.

Floreta Llazi Stefa u martua me Berti Dokon në Pish-Poro.

Mirela Llazi Stefa u martua me Nikollaq Simon në Derviçan.

PILO KRISTO STEFA (PERRI)

Pilo K. Stefa u martua me Vangjelina Josif Babën në Dëllënjë, kanë dy djem e një vajzë: Fatmirin, Agimin, Shqiponjën, Elcën dhe Djanën.

Fatmir Pilo Stefa u martua me Vjollca Semën nga Ferrasi, kanë dy vajza: Angjelinën dhe Klarën.

Agimi Pano Stefa u martua me Djana Llazi Petushin nga Sheq-Marinëza e Fierit.

Shqiponja u martua me Viktor Llaqi Loshin në Dëllënjë.

Elca u martua me Ardian Prokop Davidhin në Poro.

Djana u martua me Ervin Kiço Kuçin në Frashër, Fier.

VANGJEL KRISTO PËRRI (STEFA)

Vangjel K. Përri u martua me Tana Pavllo Qesarin nga Qeparoi i Himarës, ka një djalë e një vajzë: Palin dhe Linditën.

Pali Vangjel Përri (ose Stefa) është martuar me një vajzë nga Himara dhe banon në Himarë.

Lindita u martua në Qish Bardhë të Vlorës.

Marinaqi Kristo Përri është martuar me Niko Sollakun në Pish-Pora të Fierit.

Kanë qenë edhe Dhimitër Përri e Thanas Përri në Zhukë, por ata janë shuar. Dhimitri pati marrë grua te Vanajt në Poro, por nuk la fëmijë. Thanas Përri kishte Linën nga Lengajt e Fierit (motër me Kostandinën e Uani Matës). Lina me Nasi Përrin lanë një vajzë, Kristinën që u martua në Vlorë me Stavre Mone, berber.

Kristina Përri ka Nashon, Jorgjin dhe Luçianon.

Dhimitër Përri është tjetër fis dhe Dhimitër Kalia është tjetër. Dhimitër Kalia, ose Trifoni, shkoi në Fier dhe la 7 fëmijë, Kiçon, financier, Janin, Gorin, Peçon, Todin, Sofien dhe Gjenën.

I ati i Dhimitër e Nasi Përrit ishte Joti Përri.

Dhimitër Trifonit i thoshin Dhimitër Kalia, ngaqë ajo njihej më shumë në shoqëri, ka qenë grua shumë e zonja.

GORI DHE LEKO SIMON PLAKU

Prejardhjen e kanë nga Korça, kanë shkuar disa kohë në Risili pastaj në Memkaj të Fierit, nga Memkaj kanë ardhur në Poro rreth viteve 1885–1890. Të dy vëllezërit kanë qenë shumë të mirë e shumë punëtorë.

Gori Simon Plaku u martua me Sofie Dokon nga Dëllënja (motra e Uan Dokos) dhe lindën dy vajza: Llamba dhe Naunka; kishin edhe një djalë por u vdiq fare i vogël.

Llamba u martua me Nasi Babën në Skelë të Vlorës.

Naunka u martua me Pilo Hilën në Vlorë.

Leko Simon Plaku u martua me Dafina Kristo Shytin nga Porua dhe me të lindën një vajzë, Kristinën që u martua me Fili Bërdalli në Poro. Gruaja e dytë ishte Urania, e bija e Lili Priftit nga Porua, me të lindi 4 djem: Pilon, Llazin, Thoman dhe Nikon.

Pilo Leko Plaku u martua me Dhoksie Taqo Hyson nga Porua, nuk lindën fëmijë. Birësuan një djalë të marrë në shtëpinë e fëmijës me emrin Agim, por ia kthyen emrin Jorgaq. Jorgji u rrit, u martua dhe ka edhe fëmijë. Pilua iku familjarisht në fermë në Novoselë dhe aty e mbylli jetën. Djali i tyre i birësuar, Jorgji Pilo Plaku, i ka trajtuar e mbajtur pleqtë shumë mirë, më mirë se të ishte biri i tyre. Pilua u varros në kishën e Mifolit.

LLAZI LEKO PLAKU

Llazi u martua me Luftare Xhipe Mersinin nga Vajza e Vlorës, kanë një djalë e 3 vajza: Detjonin (emrin e vuri vetë Llazi, Deti Jon), Donikën, Burbuqen dhe Mirelën.

Detjoni aktualisht është beqar.

Donika u martua me Ruzhdi Zotaj nga Brataj. Ata kishin një vajzë por u vra aksidentalisht nga makina, duke ikur nga dora e gjyshit, Llazi Plakut, para shtëpisë, para syve të tij. Llazi, nga kjo ngjarje, pësoi tronditje të thellë shpirtërore dhe nuk jetoi shumë ditë pas vdekjes së mbesës së vogël. Ai vdiq pa dalë në pension.

Burbuqja u martua me Fredin nga Berati, kanë një djalë e një vajzë.

Mirela u martua me Thanasin në Vlorë.

Thoma Leko Plaku u martua me Dhoksie Dhori Priftin nga Novosela, kanë dy djem e një vajzë: Gëzimin, Martinin, dhe Marcelën.

Gëzim Thoma Plaku u martua me Jorida Toli Mbyetin nga Delisufi, kanë një djalë e një vajzë: Xhoelin dhe Xhosikën, jetojnë në Itali.

Martin Thoma Plaku u martua me Florida Naqo V. Vrushin nga Delisufi, kanë një djalë: Romeon.

Marcela Th. Plaku u martua me Astrit Lijo Kola (Mitraj) Poro. Astriti u aksidentua në punë në Itali, ka prerë një dorë.

NIKO LEKO PLAKU

Niko Leko Plaku u martua me Andoneta Koli Qarrin nga Porua, kanë 3 djem e një vajzë: Serjozhën, Arbenin, Ermirin dhe Mirelën.

Serjozha Niko Plaku u martua me Enkelejda Themi Moçkën nga Novosela, kanë një djalë e një vajzë: Mateon dhe Andonetën.

Arben Niko Plaku u martua me Rovena Fani Th. Qorrin nga Delisufi, kanë dy djem: Kejsonin dhe Aljesin.

Ervin Niko Plaku u martua me Isida Ilia Jani Kerrin nga Delisufi, kanë një djalë e një

vajzë: Gabrielin dhe Florën.

Shënim: Simoni kishte edhe 3 vëllezër të tjerë: Llazin, Spiron dhe Janin. Jani ndenji në Memkaj, 3 erdhën në Skrofotinë më 1914. Në Skrofotinë vdiqën Llazi e Spirua, nga kolera apo gripi spanjoll, Simoni erdhi në Poro, u martua me Ngjelën dhe u lindën Gori e Lekua.

LLAZI MITI PLAKU, DELISUF

Kishte vëlla edhe Qirjaq Plakun në Dëllënjë. Ata kishin edhe një motër, Çeven që kish marrë Spiro Vrushi në Delisuf.

Llazi Miti Plakun e mori të vogël dhe e rriti Pano Përroi se nuk kishte fëmijë. Ai e rriti dhe e martoi. I flisnin edhe Llazi Pano, por në të vërtetë është Llazi Miti Plaku.

Llazi Miti Plaku u martua me Urani Miti Lera nga Gryka (motra e Nasi e Kozma Lerës) dhe bashkë kanë lënë 3 djem e 4 vajza: Stavren, Petraqin (Peçon), Llambin, Marien, Angjelinën (Dhorën), Aretinë dhe Violetën.

Stavre Llazi Plaku u martua me Donika Vangjel Kostën nga Çuka e Sarandës dhe kanë dy djem e 3 vajza: Pandin, Kleon, Elën, Sofikën dhe Nicën.

Pandi Stavre Plaku është martuar me Alma Aliaj nga Bishani i Vlorës, kanë një djalë.

Ela Stavre Plaku është martuar me Leja Pali Gjonin në Dëllënjë.

Sofika Stavre Plaku u martua me një grek dhe janë në Greqi.

Nica Stavre Plaku është martuar me Bledi Lefi Markun në Delisuf.

Petraq Llazi Plaku (Peçua) është martuar me Burbuqe Ullirajn nga Vezhdanishti i Vlorës dhe kanë dy djem: Gjergjin dhe Gëzimin.

Petraqi është divorcuar me Burbuqen dhe ka marrë grua të dytë Sofikën nga Korça. Kanë emigruar në Amerikë.

Gjergji Petraq Plaku është martuar me një greke.

Petraq Llazi Plaku ka edhe 3 vajza me gruan e parë, Burbuqen. Ka Mondën, Enirelën dhe Zanën.

Monda Petraq Plaku është martuar me një grek dhe ka një vajzë, jetojnë në Greqi.

Zana aktualisht është beqare.

Llambi Llazi Plaku është martuar me Donika Kozma Rrungajën nga Zhuka dhe kanë dy djem e dy vajza: Erlin, Donaldon, Amalindën dhe Sentalinën.

Amalinda Llambi Plaku është martuar me Emiliano Vasil Kerrin në Delisuf. Të tjerët aktualisht janë beqar.

Vajzat e Llazi Plakut:

Maria është martuar me Perikli Sotën në Vlorë.

Aretia është martuar me Trifon Tini Dashin në Delisuf dhe kanë dy djem e dy vajza: Vladimirin, Arbenin, Naunkën dhe Jetmirën.

Angjelina (Dhora) është martuar me Vasillaq Miço Kostën në Delisuf dhe kanë 3 djem e 3 vajza. Vasillaqi vdiq i ri, Dhora emigroi në Itali, bashkë me fëmijët. Atje i rriti dhe i martoi me shqiptarë. U martua dhe vetë me një italian.

Violeta Llazi Plaku është martuar me Themi Taqo Mbyetin në Delisuf dhe kanë 4 vajza e një djalë.

QIRJAQ MITI PLAKU

Qirjaq Miti Plaku u martua me Marga Nasi Gegën nga Delisufi, lanë 7 djem e 4 vajza: Todin, Pilon, Thanasin, Llambin, Vasilin, Paskalin, Dhimitraqin, Netën, Evën, Elenën dhe Donikën.

Todi Q. Plaku u martua me Katerina Sotir Thanasin nga Dëllënja, kanë një djalë, Fatjonin e 4 vajza: Afërditën, Florën, Alketën dhe Frosinën.

Pilo Q. Plaku u martua me Vangjelina Kozma Hudhrën nga Dëllënja, kanë një djalë, Edin e dy vajza: Lidën dhe Entelën.

Edi Pilo Plaku u martua me Arbana Prokop Davidhin nga Zhuka, kanë një djalë, Emanuelin.

Thanas Q. Plaku u martua me Kaliopi Kristo Rrapin nga Fitore. Kanë një djalë, Ergustin dhe 3 vajza: Elvirën, Valentinën dhe Rovenën.

Ergust Thanas Plaku u martua me Anita Hali Lijo Ristën nga Zhuka.

Llambi Q. Plaku u martua me Monda Llambi Paragonin nga Lushnja, kanë një djalë, Leonidhën dhe një vajzë, Matildën.

Vasil Q. Plaku u martua me Liri Nasi Helmin nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë: Ritvanin, Lorencin dhe Aurorën.

Paskal Q. Plaku u martua me Marga Fili Çunin nga Dëllënja, kanë një djalë, Olderin dhe një vajzë, Ermirën.

Dhimitraq Q. Plaku u martua me Lindita Niko Gjonin nga Dëllënja, kanë një djalë, Marjon dhe një vajzë, Margaritën.

Katër vajzat e Qirjaq Miti Plakut:

Andoneta u martua me Stavri Semën në Pish-Poro.

Eva u martua me Taku Todi Koten (Stefa) në Dëllënjë.

Elena u martua me Lefter Pilo Shytin në Poro.

Donika u martua me Sotir Vasil Helmin në Dëllënjë.

VANGJEL MITI PISHA

Vangjeli kishte ardhur në Poro nga fshatrat e Lushnjes.

Vangjel Miti Pisha ka jetuar afër pyllit të Pishës pranë Fraksos. Ishte martuar me Liken nga Bakajt në Aliban dhe kishte djem e vajza.

Vangjeli vdiq i ri dhe gruaja iku në Frakull, ku u martua me Llazi Kaçallin që punonte si shërbëtor në kishën e fshatit Frakull.

Një djalë të Likes, që e kishte me Vangjel Pishën, e mori dhe e birësoi Uan Toska në Fier.

Uan Toska kishte grua, motrën e Sotir Gjonçarit nga Novosela, Jorgjien, por ajo nuk lindi fëmijë dhe, me ndërhyrjen e të vëllait, Sotir Spiro Gjonçari, mori djalin e Vangjel Pishës dhe e birësoi në Fier. Djalin e quajnë Aristir Uan Toska. Në fakt është djali i Vangjel Miti Pishës nga Porua.

Uan Toska ishte nga Fieri, por Sotir Spirua i mori në Tiranë, se atëherë ai kish kredi, ishte oficer dhe prokuror dhe i sistemoi me punë në Uzinën e Traktorëve të dy, Uanin si traktorist dhe Jorgjien si punëtore. Drejtori i Uzinës në atë kohë ishte Pilo Peristeri një nga partizanët e parë të Korçës dhe me pozitë partie në Tiranë.

Uan Toska e rriti Aristirin shumë mirë, i dha shkollë e zanat. Aristir Toska (djali i Vangjel Pishës) u martua me një vajzë nga Patosi, ka 2-3 djem, banojnë në Tiranë.

PAPA KOZMA PRIFTI (THERECKA)

Papa Kozma Prifti e ka pasur mbiemrin Therecka. Thonë se e ka origjinën nga Kozara e Beratit. Ka ardhur në Poro dhe shërbeu në kishën e Shën Kollit tërë jetën.

Papa Kozmai la 4 djem: Lilin, Uanin, Vasilin dhe Pilon. Ai kish grua motrën e Koli Lepurit.

Lili Kozma Prifti u martua tri herë. E para ishte nga Gjonçajt e Mifolit. Me këtë u lind një vajzë Urania, që kish marrë Leko Plaku në Poro. Gruaja e dytë ishte nga Markajt, ajo la vetëm një vajzë, Sofien, që ish martuar me Petro Kolën (Lala) nga Porua. Gruan e tretë Lili e mori nga Gjirokastra (Motra e Kozma Shajkos, ish oficer në Vlorë). Ajo nuk jetoi shumë me Lil Priftin, se ai vdiq e ajo iku në Vlorë.

Vasil Kozma Prifti u martua në moshë madhore me një grua të ve me dy vajza, të bijën e Laze Hënës që ishte martuar një herë me Pali Minon dhe kish lindur dy vajza Dhoksien dhe Fanien.

Jana, e bija e Laze Hënës, nuk lindi fëmijë me Vasil Priftin. Pas ca kohësh vdiq. Dy vajzat e Janës, që kish me Pal Minon, i mori Uan Marina se i kish mbesa (Laze Hëna e kish vëlla, ishin djemtë e Koli Hënës nga Frakulla), dhe i rriti e martoi, Dhoksien me Niso Kristo Mojallinë dhe Fanien me Llazi Qiric Garron në Poro.

Vasil Prifti u martua përsëri me një grua të ve, me 3 vajza të vogla, të shoqen e Uan Sotës nga Zhuka, i cili u vra partizan. Ajo quhej Gora, motra e Mihal Petro e Vangjel Priftit. Vajzat e Gores së Uan Sotës ishin: Niqi, Nefta dhe Liria.

Vasil Prifti me Goren e Priftajve lindën një djalë, por nuk rrojti shumë. Gora iku nga Vasil Prifti e u martua përsëri në Vlorë me Çaushin nga Vranishti. Vajzat e Gores, që kish me Uan Sotën, i mori shteti në shtëpinë e fëmijës, u rritën, u shkolluan, u martuan me burra të mirë e jetojnë në Tiranë. Njëra nga vajzat e Uan Sotës dhe të Gores, Niqi, ka qenë në organet drejtuese të Vlorës dhe deputete e zonës së Myzeqesë.

UAN KOZMA PRIFTI

Uan Prifti u martua me Sofie Rako Koçin nga Dëllënja dhe kanë lënë 4 djem: Llazin, Miçon, Kozman dhe Peçon.

Llazi Uan Prifti u martua me Jorgjien nga Stringajt e Frakullës (motra e Todi dhe Llambi Stringës që banojnë në Vlorë), dhe me atë lindën dy djem e dy vajza: Mihalin, Lefterin, Letën dhe Dritën.

Llazi Prifti me të ëmën, Sofien dhe i vëllai, Peçua

Mihal Llazi Prifti u martua me Noli Koli Zaka nga Zhuka dhe kanë 4 vajza e një djalë: Aurelën, Idën, Letën, Xhulietën dhe Llazarin.

Lefter (Pandeli) Llaz Prifti u martua me Vjollca Xhezmi Liçi nga Vlora (nga Kanina) dhe kanë 4 djem: Gilbertin, Leonidhën, Everestin dhe Denisin.

Leta Llazi Prifti u martua me Zoi Pjetrin në Bishan, Fier.

Drita Llazi Prifti u martua me Nesti Doçin nga Pish-Porua, kanë një djalë, Elionin.

Miço Uan Prifti u martua me Dafina Thoma Mbyetin nga Delisufi, dhe kanë dy vajza e një djalë:. Donikën, Menin dhe Aleksandrin.

Donika u martua në Aliban.

Meni u martua në Pish-Poro.

Aleksandër M. Prifti u martua me Albanën nga Vlora dhe kanë dy djem e një vajzë: Marion, Enean dhe Sarën.

KOZMA UAN PRIFTI

Kozma Uan Prifti u martua me Marien, të bijën e Petro Kolës nga Gryka dhe kanë 5 djem e 3 vajza: Vladimirin, Danin, Taulantin, Eduardin, Fatmirin, Vitorien, Vjollcën, dhe një tjetër.

Kozma Uan Prifti

Vladimir Kozma Prifti u martua me Flora Petro Shtëmbarin nga Vlora dhe kanë dy vajza: Marien dhe Aretinë.

Dani Kozma Prifti u martua me Entela Sotir Shqepën nga Semani dhe kanë një djalë e një vajzë: Valentinën dhe Kristinën.

Eduard Kozma Prifti u martua me Eljona Filip Todin nga Dëllënja dhe kanë një vajzë, Sofien.

Fatmir Kozma Prifti u martua me vajzën e Bujar Meminë nga Vlora, ka dy vajza.

Vjollca Kozma Prifti u martua në Pish-Poro.

Vitori Kozma Prifti u martua me Kujtimin nga Dëllënja ka një djalë, Luisin.

PEÇO UAN PRIFTI

Peço Uan Prifti u martua me Vefi Dhori Dhimën nga Vlora dhe kanë dy djem e 3 vajza: Pirro, Kristaq, Miranda, Marjeta dhe Elvira.

Piro Peço Prifti u martua me Sonila Arqile Devian nga Sheq-Marinëza e Fierit, dhe kanë një djalë e dy vajza: Gabrielin, Aleksandrën dhe Kristianën.

Kristaq Peço Prifti u martua me Jona Lipi Milon nga Mojallia e Fierit, kanë një djalë, Kadion.

Vajzat e Peço Priftit:

Miranda është martuar me Ligor Markun në Daullas, Fier.

Marjeta u martua me Mondi Pano Nakën në Poro.

Elvira u martua në Grecalli, Fier.

PILO KOZMA PRIFTI

Pilo Kozma Prifti u martua me Vojsava Kroni Mojallinë nga Delisufi, kanë 6 vajza e një djalë: Gjenën, Ristanën, Neftën, Marien, Sofien, Aretinë, dhe Sotirin.

Ristana u martua në Pish-Poro, Fier.

Nefta u martua në Sheq Marinëz.

Maria u martua në Divjakë.

Sofia u martua në Vlorë.

Aretia u martua në Pish-Poro.

PAPA SOTIR PILO PRIFTI

Sotir Pilo Prifti u martua me Bardhën nga Treblova e Vlorës, kanë një djalë e 3 vajza: Arbi, Enerjeta, Monda dhe një tjetër.

Papa Sotir Prifti

Monda është martuar me Ardian Kozma Moçkën, Poro.

Shënim: Sotiri u vesh prift pas vitit 1992 dhe shërben në kishën Poros. Ai shkoi në shkollën teologjike që hapi dhespoti grek, Janullatos, dhe kryen detyrën në 2-3 fshatrat Poro, Zhukë Dëllënjë, Delisuf. Ka trashëguar detyrën e gjyshit të tij se edhe ai, ati i babait) ishte Prift në Poro.

NISO PRIFTI DHE, KUSHËRIRI I TIJ, KOLI PRIFTI (ZHUKË)

Ata ishin kushërinj, banorë të vjetër në Zhukë. Thonë se i ati i tyre ka qenë prift, por në Poro nuk ka qenë, mundet diku tjetër.

Koli Prifti la dy vajza, Dafinën, që kishte marrë Lako Mbyetin në Dëllënjë, dhe Uraninë që kish marrë Andre Rako Koçi në Dëllënjë.

Dafina me Lako Mbyetin lanë Mitin, Koçin, Dhoksinë dhe Dhorën.

Urania e Andrea Rako Koçit la Kristullën dhe Ndinen, më vonë me Petro Sikon la Vasilin dhe Gjenën e Harrilla Moçkës në Poro.

Niso Prifti la Vasilin, Piron, Fanien dhe Konxhen.

Vasil Niso Prifti u martua me Uraninë nga Mojallinjtë e Delisufit (e bija e Llambros dhe motra e Sotir Llambros) dhe kanë lënë Dhimitrin, Pandelin, Marinaqin, Lirinë, Mondën, Mozën dhe Androniqin.

Dhimitër Vasil Prifti u martua me Fanie Petro Markon nga Llakatundi, kanë një djalë, Artin, 4 vajza, Merita, Majlinda, Briselda dhe Bora.

Arti Dhimitër Prifti u martua me Shpresa Monen nga Pishë Porua, kanë një djalë, Amarildon, dhe dy vajza, Stefania dhe Miranda.

Merita u martua me Arben Gorea në Akërni.

Majlinda u martua me Ylli Priftin në Novoselë, e cila vdiq dhe ka lënë dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë.

Biselda dhe Bora aktualisht janë beqare.

Pandeli Vasil Prifti u martua me Valentina Rako Gjeçin nga Topoja, kanë Andin, Vasillaqin, Klajdin, Llukën, Jetmirën, Senadën dhe Danielën.

PIRO NISO PRIFTI

Piro Niso Prifti u martua me Sofie Kol Gjonçarin nga Porua, kanë lënë Nikon, Lilën.

Niko Piro Prifti u martua me Lidën nga Vlora dhe kanë dy djem, Sokolin dhe Ernestin dhe dy vajza, Evllon dhe Letën.

Lila Piro Prifti u martua me Monda Mihal Monen, nga Porua. Kanë dy fëmijë, një djalë, Xhulion dhe një vajzë.

LONI MITI PRIFTI

Loni Miti Prifti ishte martuar me Katerina Bushin nga Beshishti dhe kanë Petron, Kozman dhe Sotirën.

Petro Loni Prifti ishte martuar me gruan e parë nga Pish-Porua, e cila u vra nga një bombë që ishte futur në një kopaçe druri të kalbur dhe ajo e kish vënë në zjarrin e kazanit që lante rrobat në oborr të shtëpisë, në Dëllënjë. Bomba plasi nga zjarri dhe vrau vetëm atë që ishte aty duke larë rrobat.

Petro L. Prifti mori tjetër grua, Fotina Konomin nga Dukati dhe me të ka dy djem e 3 vajza: Nikon, Agronin, Liljanën, Natashën dhe Shpresën.

Niko Petro Prifti u martua me Mimoza Loni Çukon nga Sheqishtja e Fierit.

Agroni aktualisht është beqar.

Shënim: Petro Prifti u vra aksidentalisht nga lokomotiva e trenit në Levan, në moshën 60 vjeçare.

KOZMA LONI PRIFTI, DËLLËNJË PORO

Kozma L. Prifti është martuar me Dafina Spiro Babën nga Dëllënja, kanë 6 djem dhe tre vajza: Miçon, Sokratin, Arbenin Gramozin, Elidonin, Lorencin, Ristanën, Sotirën dhe Parashqevinë.

Miço Kozma Prifti u martua me Donika Miti Pjetrin nga Qarri i Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Simonin dhe Fabjonën.

Sokrat Kozma Prifti u martua me Lindita Sotir Pone nga Sheqishtja e Fierit.

Arben Kozma Prifti u martua me Mimoza Kristaq Naçin nga Sheqishtja.

Gramoz K. Prifti u martua me Erjona Leko Kolën nga Porua, aktualisht ka Kozman e vogël.

Elidon K. Prifti u martua me Sonila Miço Kolën nga Kolkondasi i Fierit, ka një djalë, Danielin.

Lorenc K. Prifti u martua me Pranvera Myrteza Balajn, ka një djalë, Leonardin.

Ristana Lon Prifti u martua me Tako Gegën në Delisuf.

Sotira Lon Prifti u martua me Pano Koçin në Dëllënjë.

Parashqevi Lon Prifti u martua me Gaqi Moçkën në Novoselë.

LILI NDINI SALLAKUN, DELISUF

Lili Ndoni Sallaku u martua me Ndine Miti Priftin nga Dëllënja, kanë lindur dy djem e 3 vajza: Sotirin, Llazin, Kristinën, Filen dhe Ollgën.

Sotir Lili Sallaku u martua me Androniqi Miti Kolën nga Vlora, kanë 6 vajza: Marjanën, Shpresën, Donikën, Entelën, Dritën dhe Mirelën.

Marjana Sotir Sallaku u martua me Naun Vangjel Hudhrën nga Delisufi.

Shpresa u martua me Arqile Pano Kola (Mitraj) në Poro.

Donika u martua me Ramizin në Ruzhdie të Mallakastrës.

Entela u martua në Shën Pjetër, Fier.

Drita u martua me Viktor Kozma Hudhrën nga Dëllënja.

Mirela u martua në Sheq, Fier.

Llazi Lili Sallaku u martua me Lena Vangjel Veron nga Bestrova, kanë 3 djem: Alketin, Aurelin dhe Saimirin.

Aurel Sotir Sallaku u martua me Verën nga Topoja, kanë një djalë e dy vajza: Emanuelin, Esmeraldën dhe Sidorelën.

Alket Sotir Sallaku u martua me Donika Vllasi Dashin nga Delisufi, kanë dy djem: Donaldin dhe Adrianin.

DUSHI SEMA, ZHUKË

Ka lënë Jorgji e Miti Semën dhe dy vajza. Fisi Sema duhet të jetë nga Semajt e Levanit, por Sema ka edhe në fshatin Seman, edhe në Fier. Kjo më tepër duhet të jetë më e saktë, më afër me ata të Levanit.

Jorgji Dush Sema

Jorgji Sema ishte martuar me Lulen nga Priftajt e Mbrostarit të Fierit. Dushi kish të bënte edhe me Kordhishajt e Pish Poros, si gjak. Edhe Llambro Sema në Levan ishte vjehrri i Mino Qorrit në Delisuf dhe vjehrri i Kostandin Qarrit në Novoselë. Pra mund të jenë një gjak si Semanak.

Jorgji Sema ishte vendosur në Zhukë, pranë Lumit të Vjetër, pikërisht aty ku më vonë agallarët e fshatit ngritën koçekët e bereqetit që grumbullonin nga fshatrat që kishin marrë dhe që më vonë, pas Çlirimit, ata koçekë u shndërruan si komandë e mbrojtjes bregdetare. Pra, në këtë vend, u lindën djemtë e Jorgji Semës, Aleksi e Lili, si dhe dy vajzat, nëna e Lako Mbyetit nga Dëllënja dhe nëna e Uan Lepurit në Delisuf.

Jorgji Sema ishte njeri me horizont dhe donte që edhe djemtë t'i dërgonte në shkollë dhe Leksin mundi ta dërgonte në Berat, në shkollë greke, ku ai mundi të bëjë 5 klasë greqisht, ndërsa djali tjetër i Jorgjit u mor me forcë nga ushtria Austro-Hungareze, i mobilizuar me gjithë kafshën e samarit të shtëpisë, për transportin e materialeve ushtarake për nevojat e luftës. Dhe Lili, bashkë me të tjerë fshatarë, thonë se vajti deri te Shkëmbi i Kavajës dhe s'u pa më, humbi pa nam, pa nishan. Nuk u kthye më në fshatin e Zhukës. U vra, a si ndodhi, asnjë haber nuk mori Jorgji në Zhukë.

Aleks Sema, pasi bëri 5 klasë shkollë greke në Berat, erdhi në Vlorë dhe hapi një han të vogël për strehimin e kafshëve që vinin në Vlorë nga fshatra të ndryshme të rrethit, pikërisht aty ku sot është rruga Kryq te Sahati i Vlorës, (aty ku është ndërtuar pallati 5 kate). Mbi han, në katin e dytë, Aleksi kishte edhe shtëpinë. Këtë punë e bëri nga viti 1920 deri në vitin 1931, apo 1932 se, pastaj plasi kriza ekonomike dhe s'kishte punë. Në këtë kohë Lekua u vesh prift, sepse kishte disa klasë greke, dhe shkoi në Zhukë, në fshatin lindjes. Aty shërbeu në kishën e Shën Kollit të Poros me norie (zonë) për fshatrat Zhukë Delisuf e Dëllënjë, kurse Poron e Grykën i kishte Papa Spirua nga Porua. Dhe të gjitha ritet fetare si, pagëzimet e vdekjet, bëheshin në kishën e Shën Kollit në Poro. E vetmja kishë që ka qenë atëherë në të gjithë këto 3–4 fshatrat e zonës së poshtme të Myzeqesë së Vogël. Pra, Papa Lekua e mbylli hanin dhe iku në Zhukë familjarisht dhe banoi diku aferë qendrës së fshatit, në Zhukë, sepse, në tokat e tij, të Xha Jorgji Semës, ishin ngritur koçekët e misrit të bejlerëve.



Papa Leksi Sema

Në vitin 1943, Papa Lekua iku prapë familjarisht në Vlorë, dhe e filloi punën si prift që ishte në kishën e Shën Todhrit në Vlorë me norije disa lagje të Vlorës. Në kishën e Shën Vllasit kishte priftërinj të tjerë. Aty Papa Lekua punoi dhe u shërbeu besimtarëve ortodoks deri sa u mbyllën kishat, në vitin 1967.

Papa Lekua, i datëlindjes 1890–1976, thamë që ishte martuar me Pulien nga Grekajt e

Alibanit dhe lindën e rritën 3 djem e dy vajza Sotirin, Kozman, Palin, Kleopatrën dhe Neftalinë.

Sotir Leksi Sema ishte nxënës i shkollës Tregtare dhe, si shumë nxënës të saj, edhe ai u lidh me lëvizjen çlirimtare dhe doli partizan.

Major Sotir Sema

Mbas Çlirimit ishte oficer dhe ka punuar në Ministrinë e Mbrojtjes, në Prapavijë, dhe gjithnjë ka banuar në Tiranë. Në Vlorë, dhe në Myzeqenë e Vlorës, ka pasur shumë shokë të fëmijërisë, dhe të Lëvizjes NÇL e partizanë, të cilët i kujton me dashuri e respekt, si ata që janë gjallë e ata që nuk jetojnë më. Vetë Sotiri tani, në vitin 2009, është gati 88 vjeç, me shëndet të mirë e me kujtesë të mrekullueshme, për të cilin vajzat dhe djali i larguar në Kanada, tregojnë kujdes të madh që ai të pleqërojë sa më mirë, ndonëse i vetmuar në shtëpinë e tij ngaqë gruaja e ka lënë para 7–8 vjetëve, ka vdekur.

Xha Sotiri ishte martuar me Savetën, bija e Vasil Mones nga Porua e Vlorës. Kanë dy vajza e një djalë: Leonorën, Natashën dhe Gjergjin.

Sotiri me Savetën, i arsimuan të tre fëmijët e u dhanë zanate. Dy vajzat kanë mbaruar shkollë të lartë, njëra për arsimin e tjetra për mjekësi, dhe punojnë, Leonora mësuese dhe Natasha mjeke patologe. Ndërsa Gjergji ka punuar radioteknik e tani ka emigruar në Kanada.

Leonora S. Sema u martua me Thoma Dedën nga Dropulli, edhe ai arsimtar, kanë dy vajza: Evën dhe Eneidën,banojnë në Tiranë. Vajzat e Leonorës aktualisht janë beqare.

Natasha S. Sema u martua me Kristofor Çavon nga Çatista e Gjirokastrës dhe kanë një djalë e një vajzë: Elvisin dhe Irvën, banojnë në Tiranë.

Gjergji S. Sema mbaroi shkollën për radioteknik, u martua me Valbonën, bijën e Andreas nga Gjirokastra, edhe kjo me shkollë të lartë stomatologe, kanë dy djem: Elsonin, Gentin, ata vazhdojnë shkollë në Kanada. Sotiri lutet e dëshiron që edhe ata të rriten me shëndet të mirë, të mbarojnë shkolla të larta dhe të bëhen njerëz të mirë, më shumë se gjyshi e babagjyshi i tyre, dhe, kur të vijnë ndonjëherë, le të kujtojnë, të paktën me një qiri, sepse janë stërnipër të Priftit.

KOZMA LEKSI SEMA

Është martuar me Aleksandrën nga Dukati, kanë një djalë e 3 vajza: Rolandin, Vangjelinën, Vjollcën e Antigonin.

Pali Sema me të shoqen, Hajdhica Gjikoka

Rolandi aktualisht është beqar.

Vangjelina është e martuar me Servet Kabellon.

Vjollca u martua në Dhërmi.

Antigoni u martua me Aliun në Vlorë, me origjinë nga Korça.

Pali Leksi Sema, djali i tretë i Papa Lekos, një djalë nga më të mirët, por, mund të them edhe më fatkeqi. U martua dy herë, sepse e para, Hajdhica nga Gjikokajt e Dukatit, vdiq e re dhe nuk lindi, të paktën një fëmijë. Por edhe gruaja e dytë që mori, Luçi (Pali), e bija e Fani Agarit nga Vlora, nuk mundi t'i lindte një trashëgimtar Palit, i cili e mbylli shpejt jetën e tij.

U vra aksidentalisht me makinë, kur ishte me shërbim në Tepelenë.

Pali, me punën dhe sjelljen e tij, kish fituar zemrat dhe respektin e shumë shokëve dhe vlonjatëve.

Vajzat e Papa Leksi Semës në Vlorë:
Kleopatra u martua me Thoma Babën në Vlorë.
Neftalia u martua me Koçi Palolin në Fier.
Që të dyja kanë djem e vajza.

MITI DUSHI SEMA

Miti Dushi Sema u martua me Sofie Mërtirin nga Mifoli (halla e Thoma Mërtirit) dhe ka lënë Llaqi Semën dhe Ngjelën.

Llaqi Miti Sema u martua me Varvara Xamon nga Alibani, kanë 3 djem e një vajzë: Mitin, Pandin, Arqilen dhe Kristinën.

Kristina u martua me Josif Pushin nga Berati, kanë një djalë, Arjani Prof. Doktor hematolog dhe vajza, Nevila, avokate, të dy jetojnë në Tiranë.

Miti Llaqi Sema ka dy djem: Gentin dhe Valentinon, një në Tiranë e një në Londër.

Arqile Llaqi Sema ka dy djem, janë guzhinjerë në Tiranë.

Pandi Llaqi Sema ka një djalë e një vajzë, janë në Greqi.

Motra e Llaqi Semës, Vangjelina, u martua me Caci Moravën në Vlorë, kanë lënë Toli Moravën. Toli nuk la fëmijë.

Toli Caci Morava ka birësuar dy djem, njëri ishte djali i Vasil Marinit dhe një nip i Vasil Marinit.

LILI JORGJI SEMA

Humbi pa nam pa nishan. Atë e mobilizoi ushtria Austro-Hungareze, që ishte vendosur nga ana e Vjosës prej Fierit, dhe luftonte kundër Italisë nga ana e Vlorës. Në atë kohë, ajo mori disa fshatarë me kuajt e tyre për të transportuar materialet e luftës. Kështu shkoi edhe Lili i Jorgji Semës, në vitet 1917–1918 dhe thonë se vajti deri te shkëmbi i Kavajës me gjithë kafshën e tij e pastaj nuk u pa më.

Shënim: Të dhënat për të gjithë Semajt i mora nga Sotir Sema 88 vjeç në maj 2009, në Tiranë.

LLUKË SIKA

Nuk ka të bëjë me Petro Sikon në Poro. Ai është Sika dhe Petrua është Siko (Ciringiri).

Llukë Sika ka lënë Loni Sikën. Loni Sika u martua me Gonën nga Pish-Porua dhe kanë 4 fëmijë dy djem e dy vajza: Llazin, Vllasin, Uraninë dhe Sofikën.

Llazi Loni Sika u martua dhe ka një djalë, Ermalin. Gruaja i vdiq e re, dhe djalin e rriti gjyshja, Goni dhe vetë i ati, Llazi.

Urani Loni Sika u martua me Kostandin Peti Lerën nga Gryka, dhe kanë dy djem e një vajzë, Kastriotin, Vasillaqin dhe Marjanën.

Kostandin Lera ka vdekur. Kanë banuar në Vlorë, që nga viti 1950.

Djemtë e Kostandinit me të ëmën, Uraninë, banojnë në Amerikë.

Lon Sika ka dy djem e dy vajza: Llazi, Vllasi, Urania dhe Sofika.

Vllasi u martua me Engjëllushen nga Kanina dhe kanë dy djem; Felikun dhe Xhovanin.

Sofika u martua me Artan Bakallin në Tiranë.

Ermal Llazi Sika martuar me Brikena Caushin nga Memaliaj.

KRISTO KOZMA SOTA

Kristo dhe Uan Sota ishin vëllezër, djem të Kozma Sota të ardhur në Zhukë nga Libofsha.

Kristo K. Sota la dy djem e një vajzë: Lijon, Llazin dhe Dafinën.

Dafinën e kish marrë Thoma Davidhi në Zhukë.

Uan Kristo Sota u martua me Goren, motrën e Petro Mihalit dhe Vangjel Priftit. (Ata ishin ca kohë në Zhukë, u thoshin me mbiemrin edhe Qoromidhja. Më pas ikën në Vlorë). Uani Sota me Gorën lindën 3 vajza: Neftën, Niqin dhe Lirinë.

Uani K. Sota, i datëlindjes 1910, shkoi partizan. Është dëshmor i LNÇL.

Gora mori 3 vajzat dhe u martua me Vasil Priftin në Poro, por shpejt u nda me atë. Me Vasilin lindi një djalë, por nuk i rrojti shumë. Djali vdiq i ri.

Tre vajzat e Uani Sotës e të Gores i mori shteti e i shpuri në Shtëpinë e Fëmijës ku u rritën dhe u arsimuan, edhe me arsim të lartë. Gora u martua përsëri me Caushin nga Vranishti, kanë jetuar në Vlorë. Ato u rritën u arsimuan dhe u martuan me djem shumë të mirë.

Niqi ka kryer disa punë shtetërore në rrethin e Vlorës. Ka qenë edhe deputete e zonës së Myzeqesë së Vlorës. Niqin e kujton me respekt e gjithë zona e Poros.

Llazi Kristo Sota u martua 2 herë. Të parën mori të motrën e Petro Mones, e cila vdiq e re dhe nuk la fëmijë. Mori grua të dytë, motrën e Trush Kolës nga Porua, por edhe ajo vdiq e re e nuk la fëmijë. Edhe Llazi K. Sota vdiq po nga kolera.

Lio K. Sota u martua dy herë. E para nuk la fëmijë. E dyta është Llamba e Tilo Belinës nga Porua. Me Llambën Liua ka dy djem e 5 vajza: Naunin, Kristaqin, Vitën, Kristinën, Donikën, Aretinë dhe Elcën.

Lio K. Sota

Naun Lio Sota u martua me Shpresa Koli Hudhrën ka 3 djem e një vajzë: Mariglenin, Armandon, Andrean dhe Brunën.

Bruna e Naun Lio Sotës është martuar me Edmond Vangjel Nakën nga Delisufi.

Të tre djemtë e Naun Sotës aktualisht janë beqarë.

Kristo Lio Sota u martua me Ana Trifon Kopilin nga Bishani i Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Gabrielin dhe Elestinën.

Nefta u martua me Ndriko Nakuçi nga Përmeti.

Vita Lio Sota u martua me Koçi Pali Gjonin në Dëllënjë, kanë dy djem e dy vajza.

Kristina Lio Sota u martua me Pandeli Llazi Priftin, kanë 4 djem, Eltoni, Admiri, Elioti dhe Ermali.

Donika Lio Sota u martua me Sotiraq Pilo Thanon në Muçaj të Fierit, kanë një djalë e dy vajza, Skerdi, Xhoana, Ina.

Elca Lio Sota u martua me Ligor Thoma Gjindalin në Delisuf, kanë tre fëmijë, Sandri, Eliada dhe Flutura.

Aretia Lio Sota u martua me Arqile Ylli Priftin në Aliban, kanë dy djem, Xhulion dhe Lulian.

Vajzat e Uani Sotës:

Nefta u martua me Ndreko Nakuçi nga Përmeti, kanë një djalë e dy vajza, jetojnë në

Tiranë.

Niqi u martua me Drini Shtyllën nga Korça, Kanë dy vajza, jetojnë në Tiranë.

Liria u martua me Kozma Ragazi nga Berati, ka dy djem e një vajzë, banojnë në Lushnjë.

PETRO VANGJEL SIKO (ÇIRINGIRI)

Vangjel Siko (Ciringiri), me origjinë nga Babunja e Lushnjes, la një djalë dhe tre vajza, Petron, një vajzë e mori Llukë Sheqi në Poro, një Tas Baba në Dëllënjë dhe u martua në Mifol.

Petro Vangjel Siko u martua të bijën e Themi Mara në Frakull dhe me të u lindën 3 djem e 3 vajza: Todin, Kiton dhe Tokliun, Ndinen, Valën dhe Fanien. Ata i kishte me gruan e parë, e cila vdiq e re, dhe Petro Siko mori një tjetër grua të ve, Uraninë e Koli Priftit nga Zhuka, dhe bëri me të edhe një djalë e një vajzë: Vasilin dhe Gjenën.

Todi Petro Siko u martua me Ristana Kozma Çunin nga Sheqi i Dëllënjës dhe kanë 4 djem e 5 vajza: Tomin, Apostolin, Leonardin, Vangjelin, Violetën, Marjanën, Sofien, Elcën dhe Valbonën.

Tomi Todi Siko u martua me Valbonën dhe kanë 3 djem: Petron, Kolën dhe Kostën.

Apostol Todi Siko u martua me Almën nga Selenica dhe kanë dy djem.

Leonard Todi Siko u martua me një greke dhe ka dy djem, banojnë në Greqi.

Vangjel Todi Siko u martua me një vajzë nga Mifoli dhe kanë një djalë.

Kito Petro Siko

Kito Petro Siko u martua me Vangjeli Sotën nga Vlora (motra e Llaz Sotës) dhe kanë dy djem e një vajzë: Aristirin, Elidonin dhe Almën.

Aristiri Kito Siko u martua me Esmanë nga Frakulla dhe kanë dy djem: Edin dhe një tjetër.

Elidon Kito Siko u martua në Kërkovë.

Alma Kito Siko u martua me Minellën në Topojë.

VASIL PETRO SIKO

Vasil Petro Siko u martua me Vitori Llazi Shytin nga Porua dhe kanë dy djem e një vajzë: Arturin, Erjonin, dhe Mirelën.

Vasil P. Siko

Artur Vasil Siko është martuar me Enkela Xhoxhi K. Jankën nga Porua dhe kanë një djalë e një vajzë: Gabrielin dhe Sirenën.

Erjon Vasil Siko aktualisht është beqar.

Mirela Vasil Siko u martua me Aleksandër Sotir Dukën në Vlorë.

Vajzat e Petro Sikos:

Ndinja u martua me Jorgji Tike Kungullin në Poro.

Vala u martua me Jani Golemin në Vlorë.

Fania u martua me Neki Yzeir Asllanin në Poro.

Gjena Petro Siko u martua me Harrilla Moçkën, Poro.

KOLI STEFA, GRYKË

Koli Stefa ka jetuar në Grykë, kishte 3 fëmijë, dy djem e një vajzë. Vetë vdiq para vitit 1950. Vitet 1946–1951, deri sa u bë Kooperativa Bujqësore, kanë qenë vite shumë të vështira për këtë familje. Edhe e shoqja e Koli Stefës, si shumë të tjerë, vajti një ditë në Vlorë për të blerë bukë misri, në një dyqan të vetëm në Vlorë. Mori a s'mori atë ditë, kur u kthye për në fshat, në këmbë që nga Vlora, 5–6 orë rrugë në këmbë, me gjithë vajzën e saj 10–12 vjeçe, humbi rrugën në pyllin e Pishës në darkë vonë, dhe nuk u drejtua ose të orientohej mirë se e zuri nata pa u futur në rrugën e fshatit dhe mori drejtimin tjetër për tutje në Jugë drejtim të Hirit të Madh.

Tërë natën u sorollat kot së koti, u lodhën e mbetën të dyja, nënë e bijë, të mbledhura grusht nga të ftohtit dhe vdiqën të dyja bashkë. Ishte dimër dhe vendi ishte i ngrirë në minus 5–6 apo ndoshta dhe 10°C nën zero. Kështu ka ndodhur në të vërtetë me ato viktima të viteve 1950. Mbeten dy djemtë e Kolit pa nënë e pa motër. Nisua e Miti ikën në Vlorë e zunë punë, u martuan e u shtuan.

Niso Koli Stefa u martua me vajzën e Gori Thanos (Patates) dhe me të lindi 3–4 fëmijë, po vetë Nisua u katandis keq. U dënua disa vjet, e kur doli pas shumë vjetësh në moshë të kaluar, gruaja e tij dhe fëmijët e braktisën. Vdiq nën kujdesin e të vëllait. Gruaja e tij dhe fëmijët kanë qenë në Vlorë, por nuk dihet se ku janë e si janë sot.

Miti Koli Stefa u martua me vajzën e Qiric Gjonçarit nga Zhuka, lindën 4 fëmijë me Ollgën, dy djem e dy vajza shumë të mirë. Dy vajzat i martuan në Vlorë me djem të mirë, një djalë u vdiq i ri, 16–17 vjeç, tjetri, Beni rreth 40 vjeç, ende nuk është martuar. Miti e Ollga kanë qenë njerëz shumë të rregullt në jetë. Vdiqën që të dy afër e afër, rreth moshës 60 vjeçare, në Vlorë.

RISTAJT, ZHUKË

Të ardhur nga Lushnja, në Mifol, pastaj në Zhukë. Më i vjetri nga Ristajt ka qenë Uan Rista, me gruan e tij nga Tirana, lanë Andrenë, Zoicën dhe Ristanën. Andrea, Zoica e Ristana ikën nga Zhuka, u martuan e jetuan në Tiranë. Andrea punoi shofer në Tiranë.

Spiro Rista ishte biri i Kozma Priftit, kushëri me Uan Ristën që la Andrenë, Zoicën dhe Ristanën. Nga gjyshi Rist Prifti morën mbiemrin Rista, duke përdorur emrin e gjyshit për mbiemër. Kështu u mbeti Rista e jo Prifti.

Spiro Rista ishte martuar me gruan e parë nga Mifoli, motra e Kol Rredhit, dhe la vetëm Taqo Ristën. Më vonë Spirua mori gruan e dytë, Janën, motrën e Leksi Kërrit nga Gryka dhe lindën dy djem e dy vajza: Lijon, Nikon, Kristinën dhe një tjetër.

Taqo Spiro Rista u martua me Dafina Pal Qorrin, nga Delisufi dhe kanë lënë: Miçon, Gjenin, Vangjelinën dhe Andonetën.

Miço Taqo Rista u martua me Kristina Jani Leshin nga Porua, kanë një djalë e 3 vajza: Artanin, Mimozën, Zanën dhe Teutën.

Artan Miço Rista u martua me Bruna Piro Milon në Bishan të Fierit, kanë një djalë, Xhulion.

Mimoza u martua me Lefi Jorgji Bërdallin, ka dy vajza.

Zana u martua me Spiro Todi Kola, Poro.

Teuta u martua me Pali Petro Gjonçari, Poro.

Gjeni Taqi Rista u martua me Monda Miço Lulen nga Qarri, Fier, kanë dy djem e një vajza: Arjanin, Florianin dhe Irvën.

Lio Spiro Rista

Arjan Gjeni Rista u martua me Selda Nasi Zhazhanin nga Delisufi.

Lio Spiro Rista u martua me Sofien e Kozma Ristanit nga Porua, kanë dy djem e 3 vajza: Halin, Piron, Kristinën, Letën dhe Mirandën.

Hali (Mihali) Lio Rista u martua me Leta Banin nga Selenica, kanë dy djem e 4 vajza: Erdin, Ardin, Klodianën, Blertën, Ertilën dhe Anën.

Piro Lio Rista u martua me Vjollca Fili Bërdallin nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Gentin, Artin dhe Fridën.

Klodiana u martua me Peçi Gjokën, Pish-Poro.

Blerta u martua me Vini Niko Liçon.

Ertila dhe Ana aktualisht janë beqare.

NIKO SPIRO RISTA

U martua me gruan e parë, Dafina Leksi Naçin, nga Frakulla, kanë një djalë e dy vajza: Arqilen, Marinaqin dhe Luljetën.

Nikua mori për grua të dytë, Izminin e Fane Caraj nga Nivica e Sarandës , por ajo nuk lindi fëmijë.

Arqile Niko Rista u martua me Bardha Xhevit Buzin nga Plyku, kanë një vajzë, Lauretën.

Marinaqi Niko Rista u martua me Pandeli Naun Thanasin në Dëllënjë.

Luljeta Niko Rista u martua në Akërni, me Petraq Xhafer Novruzin me origjinë nga

Vajza e Vlorës.

Katerina Spiro Rista u martua me Jota Lili Lepurin, ka 3 djem e dy vajza.

LEKSI RREDHI, GRYKË

Leksi Rredhi la dy djem e dy vajza: Mitin, Vllasin, Ksandën dhe Marikën.

Marika ishte martuar me Taku Semanjakun, në Fier.

Ksanda ishte martuar me Llazi Llukë Sheqin në Poro.

Miti Leksi Rredhi (Meçi) u martua në Labovë të Gjirokastrës dhe ka 6 djem e një vajzë: Lekon, Artanin, Çomen, Pandelin dhe Sofoklin. Të gjithë janë të larguar në Greqi. Janë martuar të gjithë.

Vllasi Leksi Rredhi (tani e kanë mbiemrin Meçi) u martua me Vergon nga Gjirokastra. Ka 4 djem dhe dy vajza: Sotirin, Llambin, Filipin, Stavrin, Aretinë dhe Rajmondën. Sotir V. Meçi u martua me një vajzë nga Fieri, kanë dy djem e një vajzë.

Llambi V. Meçi u martua në Fier me një nga Skela e Vlorës.

Filipi u martua me Vangjelina Koli Qarrin nga Porua, kanë dy vajza.

Stavri V. Meçi u martua me një vajzë nga Vlora, kanë një djalë e një vajzë.

Aretia u martua me Agronin në Vlorë.

Rajmonda u martua me Anesti Daiun në Nartë.

VLASH KOZMA RREDHI

Vlash Kozma Rredhi ishte nga Gryka, punoi disa vjet te Jano Garrua, djalë i pamartuar.

Para luftës 1940 iku nga Porua. Më vonë, pas vitit 1960, mësuam se ishte në Sarandë. Është martuar dhe ka djem e vajza në Sarandë. Ka punuar në Port, vdiq në Sarandë.

Vlashi u martua me një minoritare nga fshatrat e Sarandës, Vergulla Vasil Mici. Ka lënë dy djem e dy vajza, Kostandini, Vasili, Aleksandra dhe Margarita.

Kostandini u martua me Dhimitrulla Jani Thimio nga Vromeroi i Sarandës. Ka një vajzë. Jeton në Greqi.

Aleksandra u martua me Luan Shkëmbin nga Këlcyra. Kanë katër djem: Iliri, Tofiku, Saimiri dhe Elsido.

Shënim: Nëna e Vlash Rredhit ishte nga Moçkallarët e Poros.

RRUNGENJTË

Origjina e Rrungenjve është në Erseka.

Më i vjetri ka qenë Lamo Rrungaja, dhe ka lënë dy djem, Themiun, Mitin dhe dy vajza.

Themi Lamo Rrungaja la 4 vajza, djem nuk la. Njëra u martua me Miti Semën dhe la Llaqi e Vangjel Semën. Një tjetër u martua në Sop të Fierit me një prift, la dy djem, njëri prej të cilëve u vesh prift, si i ati, i cili quhej papa Zoi.

Një tjetër u martua në Zhukë me të atin e Sotir Mërtirit dhe ata lanë Sotirin. Sotiri me Pulien lanë një djalë, Thoma Mërtiri. Ai kish marrë Pulije Gonin nga Zhuka e, më vonë, ajo mori Llazi Zarikon në Zhukë.

E katërta u martua në Dëllënjë me të atin e Xoxi Shurdhit. Babai i Xoxit vdiq i ri dhe e ëma iku, mori djalin, Xoxin, dhe shkoi te i jati. Xoxi u rrit te Themi Rrungaja dhe prandaj mori mbiemrin Rrungaja. Thonë se nuk ishin një gjak.

Pra, të katër vajzat e Themi Rrungajës, një me Miti Semën, një në Sop te Prifti, një në Mifol, me Gor Mërtiri dhe një në Dëllënjë (këto të dhëna janë sipas Jorgji Pilo Rrungaja).

Kurse Llazi Rrungaja, i biri i Xoxit, thotë:

Xoxi erdhi me nënën te Rrungenjtë se i vdiq i jati. E ëma e Xoxit u martua prapë në Dëllënjë me hyzmeqarin e Rrungenjve, Mitrush Shurdhi, dhe Xoxi kur u rrit iku nga dajat dhe shkoi te nëna e baba Qafor Mitrush Shurdhit, por mbiemrin ia regjistruan Rrungaja.

Rrungaja nuk kishte djalë. Babai i Xoxit njihet se është i regjistruar në Gjendjen Civile Kroni, por me mbiemrin e Rrungajave të Zhukës, në fakt e kishte e ëma e Xoxit.

Dhe kështu, djemtë e Xoxi Rrungajës në Dëllënjë, mbajnë këtë mbiemër, ndërsa gjyshi i tyre, Kroni, është origjinal, por mbiemrin nuk ia dinë si e ka pasur andej nga fshatrat e Lushnjës.

Pilo Rrungaja, Zoi Hyso, Mihal Greku dhe Uan Toska ishin baxhanak, kishin marrë 4 motrat e Sotir Spiros (Gjonçari)

Vala e Gor Rrungajës u martua me Papa Lip Lepurin në Novoselë.

MITI LAMO RRUNGAJA

Miti Rrungaja gruan e kish nga fshatrat e Lushnjës dhe me të lindi dy djem: Gorin dhe Kijën. Vajza nuk la.

Gori Miti Rrungaja u martua me Filen nga Grekajt e Alibanit. Këta kanë lindur një djalë e 4 vajza: Pilo Rrungajën, Aspasinë, Ndinen, Valën dhe Ristanën.

Ndinja u martua me Koço Daiun në Nartë.

Aspasia u martua me Loni Monen në Poro.

Ristana u martua me Llazi Dakon në Zvërnec.

Pilo Gor Rrungaja u martua me Athina Spiro Gjonçarin nga Mifoli, kanë lënë 4 djem e një vajzë: Nison, Llaqin, Jorgjin, Vangjelin dhe Evlloqinë.

Niso Pilo Rrungaja u martua dy herë; gruaja e dytë ishte Urania e Kristo Lipit nga Beshishti (Ajo ka motër edhe Dhorën e Sotir L. Moçkës, në Poro). Nisua me Uraninë kanë lindur dy djem e dy vajza: Ligorin, Pandelin, Sotirën dhe Leonorën.

Ligor Niso Rrungaja u martua me Vangjelina Lamo Kostën nga Delisufi, kanë një djalë e dy vajza: Armandon, Emirën, dhe Silvanën.

Pandeli Niso Rrungaja u martua me Kozeta Pëllumb Mangën nga Përmeti, kanë 3 vajza: Besianën, Erisën dhe Erjonën.

Sotira u martua me Nelo Uan Dokon, Dëllënjë.

Leonora u martua me Fredi Gjeçin, në Havaleas, Fier.

LLAQI PILO RRUNGAJA

U martua me Patro Thoma Minen nga Pish-Porua e Fierit dhe kanë 3 djem e një vajzë: Vasillaqin, Theodhorin, Petron dhe Lidën.

Vasillaq Llaqi Rrungaja u martua me Nikoleta Vangjel Nakën nga Delisufi, kanë një djalë e një vajzë: Eltonin dhe Xhulietën.

Thodhori Ll. Rrungaja u martua me Moza Llambi Dashi nga Delisufi, kanë një djalë: Patrikën.

Petraq Llaqi Rrungaja u martua me Rita Koç Kërri nga Delisufi, kanë një djalë dhe dy vajza: Fabion, Fluturën dhe Françeskën.

Lida Ll. Rrungaja u martua me Kastriot Dokon në Tepelenë.

Jorgji Pilo Rrungaja u martua me Vangjelina Taqo Ristën nga Zhuka, kanë një djalë e 3 vajza: Erjonin, Violetën, Yllkën dhe Rajmondën.

Erjon Jorgji Rrungaja u martua me Oltana Kristaq Lulen, Qarr Fier.

Violeta J. Rrungaja u martua me Berti Jani Hudhrën në Dëllënjë.

Yllka J. Rrungaja u martua me Fredi Thanas Vrushin në Delisuf.

Rajmonda J. Rrungaja u martua me Aranit Vlashi Danon në Pish Poro.

VANGJEL PILO RRUNGAJA

U martua me Stamata Papën nga Mursia e Sarandës, kanë 5 djem e 3 vajza: Eduardin, Lefterin, Spiron, Dhimitrin, Kostën, Dhuratën, Bonën dhe Brunën.

Eduard Vangjel Rrungaja u martua me Zanën nga Bishani, s'kanë fëmijë.

Lefter V. Rrungaja u martua me Marjana Jani Andrea Marku nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza.

Tre djemtë e tjerë aktualisht janë beqarë.

Dhurata V. Rrungaja u martua me Lushin nga Mursia e Sarandës.

Bona V. Rrungaja u martua me Llaqi Sotir Kolën (Mitraj) në Poro.

Bruna V. Rrungaja u martua me Ilia Lulen në Qarr të Fierit.

Evlloqi Pilo Rrungaja u martua me Josif Monen në Vlorë, kanë dy vajza: Meritën dhe Ardianën.

Merita u martua me Arqile Çurin nga Palasa.

Ardiana u martua me Vangjelin në Sarandë.

KIJE (PERIKLI) MITI RRUNGAJA

Kije Rrungaja ishte martuar me Ksandën nga Jagodina e Fierit dhe me të kanë lindur 3 djem e një vajzë: Lonin, Koçin, Lenën dhe Palin. Pali u vra nga kuajt duke shirë grurin në lëmë, ishte djalë i ri. Për Koçin mu lutën të mos shkruaj.

Loni Kije Rrungaja u martua me Ksanda Damon nga Pish Porua, kanë lindur një djalë dhe 3 vajza: Kozman, Kristinën, Sijen dhe Kaliopin.

Kristina u martua me Llambi Kapon (Teneqexhiu) në Vlorë.

Sija u martua në Skelë, Vlorë me Gori Liçon.

Kaliopi u martua me Petro Lepurin në Delisuf.

Kozma Loni Rrungaja u martua me File Koli Gjonçarin nga Porua, kanë lënë 3 djem e 4 vajza: Nikon, Fanin, Sotiraqin, Netën, Natashën, Violetën, Donikën.

Niko Kozma Rrungaja u martua me Lenën nga Çuka e Sarandës, kanë dy djem e një vajzë: Vasilin, Gjergjin, Anitën dhe Lauretën.

Vasili Niko Rrungaja u martua me Donika Llambi Gjatën nga Pish Porua, kanë dy djem: Kevin dhe Aleksin.

Fani Kozma Rrungaja u martua me Pulije Pandeli Monen nga Porua, kanë 4 djem e një vajzë: Arbrin, Florianin, Vilsonin, Ardianin dhe Albanën.

Arbri u martua me një italiane.

Albana u martua me Ilia Minella Shteton nga Narta.

Të tjerët aktualisht janë beqarë.

Sotir Kozma Rrungaja është i martuar.

Vajzat e Kozma Rrungajës:

Donika u martua me Llambi Llazar Panon në Delisuf.

Leta u martua me Petraq Ndini Zhazhanin në Delisuf.

Natasha Kozma Rrungaja u martua me Petraqin në Selenicë.

Vangjelina u martua me Mustafa Zaden nga Pogradeci.

Andoneta u martua në Delisuf.

Lena Kije Rrungaja u martua me Luçi Naçin në Frakull të Fierit, por erdhën familjarisht në Zhukë për të pleqëruar prindërit e Lenës dhe mbetën në Zhukë për gjithnjë.

LLAZI XOXI RRUNGAJA

Llazi Rrungaja është biri i Xoxi Kroni Rrungajës. Xoxi erdhi i vogël në Zhukë, bashkë me të ëmën e tij, sepse babai, Kroni, vdiq në fshatrat e Lushnjës. Nëna e Xoxit kishte të bënte me Rrungenjtë e Zhukës, prandaj u mbështet tek ata. Themi Rrungaja, djalin e vogël, Xoxin e regjistroi si djalin e tij me mbiemrin e tij XOXI KRONI RRUNGAJA me qëllim që ta kishte si djalë të birësuar. E ëma e Xoxit u martua me një nga Rrungenjtë dhe shkuan me banim në Dëllënjë. Ky që mori të jëmën e Xoxit e kishte mbiemrin Shurdhi. Nëna e Xoxit nuk lindi fëmijë me Shurdhin.

Llazi Rrungaja me gruan e tij, Vita

Edhe Xoxi erdhi te baba Qafor Shurdhi dhe te e ëma, në Dëllënjë, pra nuk ndenji te Themi Rrungaja që e birësoi se nuk kishte djalë. (Themi Rrungaja kishte 4 vajza). Tani Xoxi u rrit në Dëllënjë te Shurdhi, por mbiemri i mbeti Rrungaja. Ndërsa emri i babës, Kroni, nuk iu ndërrua në regjistrat e gjendjes civile.

Xoxi Kroni Rrungaja u martua me Kalien e Thoma Qarrit nga Novosela dhe pati 3 djem e 4 vajza: Llazi, Nasi,Vangjeli, Vasilika, Lena, Sofia dhe Aretia.

Llazi Xoxi Rrungaja u martua me Vita Uan Dokon nga Pish Porua e Fieri dhe kanë dy djem e 4 vajza: Thoman, Filipin, Llambën, Gonën, Natashën dhe Mondën.

Thoma Llazi Rrungaja u martua me Vangjelina Jani Toskën nga Pish Porua, kanë 4 djem: Marion, Altinin, Leonidhën dhe Eltonin.

Filipi Llazi Rrungaja u martua me Lida Tas Mërtirin nga Mifoli, kanë një djalë e dy vajza: Klajdin, Irenën dhe Rominën.

Vajzat e Llazi Rrungajës:
Llamba u martua me Todi Dhimo nga Sheqmarinëza.
Gona u martua me Llambi Jan Marko nga Dëllënja.
Natasha u martua me Nonda Lepuri në Poro.
Monda u martua me Niko Sotir Bushi (Hila).

Nasi Xoxi Rrungaja u martua me Kristina Llazi Hudhrën nga Dëllënja, kanë 5 djem: Dhimitrin, Aleksandrin, Arqilen, Vasilin dhe Koçin.

Dhimitraqi u martua me Liljana Jani Papën nga Delisufi, kanë një djalë, Oltin e një vajzë, Greta.

Aleksandri u martua me Moza Nasi Helmin nga Dëllënja, kanë dy djem e një vajzë: Dhimitrin, Arqilen dhe Vasilikën.

Arqilea u martua me Keta nga Sheqmarinëza.

Vasua u martua me vajzën e Taqo Mbyetit nga Delisufi.

Koçi u martua me Alma Vasillaq Kosta në Delisuf.

Vangjel Xoxi Rrungaja u martua me Sofie Peti Lerën nga Gryka, kanë 3 djem e dy vajza: Minella, Kastrioti, Beni, Donika dhe Liljana.

Minella V. Rrungaja u martua me Irva Minella Toskën nga Pish Porua, kanë dy vajza,

Maria dhe Anita.

Beni u martua me Eva Tasi Dhamon nga Pish Porua, kanë një vajzë, Sofien.

Shënim: Për prejardhjen e Xoxit, i biri, Llazi Rrungaja 80 vjeçar thotë ato që shkruam më lart. Ndërsa Jorgji Pilo Rrungaja thotë ndryshe. Le t'u besojmë më mirë atyre fjalëve që thotë Llazi Rrungaja.

LLUKË QARRI

Më i vjetri nga Qarrajt ka qenë Llukë Qarri nga Piluri i Himarës. Lluka jetoi ca kohë në Dukat me bagëti. Atje ra në konflikt me dukatasit për çështje kullote dhe iku e vajti në Risili. Pas ca kohe iku edhe nga Risilia dhe erdhi në Poro. Rrugës duke ardhur me bagëti për në Poro, la në Mifol një djalë hyzmeqar, Qirjaqin. Një tjetër djalë e dërgoi hyzmeqar në Cakran të Fierit, një tjetër djalë e la në Aliban, Kozman. Me dy të tjerë erdhi në Poro. Me dy djemtë që erdhi në Poro, Kriston dhe Dushin, u sistemuan përgjithmonë në Poro. Këtu, në Poro, gjeti kullota e toka të mira dhe u forcua ekonomikisht.

Dushi Llukë Qarri la vetëm një vajzë, atë që mori Marko Moçka në Poro. Ajo la vetëm një vajzë, Vasilikën e cila u martua në Ferras.

Kristo Llukë Qarri la Kostandinin, Vasilin dhe Stasën, e cila u martua te Priftajt në Dëllënjë.

Ndin (Kostandin) Kristo Qarri u martua me Katen e Koli Moçkës në Novoselë. Katja kishte një vëlla në Vlorë, Sotir Moçka, dhe ai ka lënë një djalë e dy vajza: Petraqin dhe Elin.

Ndino Qarri la 3 djem e dy vajza: Margën, që u martua me Taqo Hyson në Poro, dhe Naunkën, që u martua me Kristaq Bakën në Vlorë.

Pra, Ndino Qarri la Llambin, Llazin, Petron (Peçon), Margën dhe Naunkën.

Vasil Kristo Qarri u martua me Finën e Naqo Kungullit dhe lanë dy djem e dy vajza: Kolin, Miçon, Silën dhe Galinën.

Fina (Naqo Kungulli) Qarri, nëna e Kolit, Miços dhe Galinës

Roland Qarri

Sila u martua me Ndino Rrushin në Frakull, ndërsa Galina u martua me Sotir Dukën në Vlorë.

Vasil Qarri, Margën dhe Naunkën i kishte me gruan e parë, Lulen e Uan Lalës nga Mifoli.

Koli Vasil Qarri u martua me Dafinën dhe lindën 9 vajza. Birësuan një djalë, ai quhet Roland Koli Qarri.

Vajzat e Kolit:

Liria u martua me Toli Llambro Lepurin në Poro.

Milika u martua me Zalo Matrakun nga Korça.

Marjana u martua me Gogo Naçin në Himarë.

Florika u martua me Anesti Toli Matën në Poro.

Arsinoja u martua me Filip Llazi Meçin në Vlorë.

Thanasulla u martua me Spiro Matën në Marinëz, Fier.

Aleksandra u martua Arqile Rrapi Pishën, burri i parë, dhe me Pandeli Gjergji në Vlorë, burri i dytë.

Andoneta u martua me Niko Leko Plakun në Poro.

Roland Koli Qarri (i birësuar) u martua me Zoicën e Petro Gjonçarit nga Zhuka dhe ka një djalë, Maksi dhe dy vajza.

Maksi Roland Qarri u martua me Aida Thoma Kërrin nga Delisufi, dhe kanë një djalë, Aleksin.

MIÇO VASIL QARRI

Miço Vasil Qarri u martua me Sotirën nga Bestrova, dhe kanë një djalë e 3 vajza: Jorgjin, Margaritën Evgjeninë dhe Vjollcën.

Jorgaq Miço Qarri u martua me Luli Petanin nga Frakulla, dhe kanë një djalë, Armalindo.

Margarita u martua me Piro Thanas Anastasi (Djella) në Novoselë.

Evgjenia është e martuar.

Vjollca është e martuar.

Shënim: Miçua u largua nga Porua familjarisht dhe banon në Novoselë, që nga viti 1970.

Edhe Sila me Ndino Rrushin kanë djem e vajza.

Galina me Sotir Dukën kanë: Rinën, Mitaqin, Todin, Filipin, Grigorin dhe një tjetër.

Llambi Ndino Qarri u martua me Sofie Zoi Konomi nga Frakulla. Kanë lënë 3 djem e një vajzë Aristiri, Aleksandri, Odisea dhe Djana.

Llambi Qarri

Aristir Ll. Qarri u martua me Violeta Selam Gjeçi nga Kanina dhe kanë një djalë, Ervinin.

Aleksandri Ll. Qarri u martua me Violeta Ismet Dautin nga Ramica, dhe kanë një djalë, Flavio.

Odise Ll. Qarri u martua me Natasha Koço Gjatën nga Delvina, kanë birësuar një djalë, Ervinin.

Djana Ll. Qarri u martua me Lefter Doracin në Bishan.

LLAZI NDINO QARRI

Llazi Ndino Qorri u martua me Vasilika Uan Laskën nga Mifoli, ka dy djem e një vajzë: Arqilen, Benetin, dhe Elcën.

Arqile Llazi Qarri u martua me Saveta Llaz Llambron nga Porua, kanë një djalë e dy vajza: Astritin, Suelën dhe Vaninën.

Benet Llaz Qarri aktualisht është beqar.

Elca Llaz Qarri u martua me Vasil Vangjel Simonin nga Beshishti, ka dy djem e një vajzë.

Para shkollës, Llazi Qarri dhe Llazi Hajdini, dy nxënës të kësaj shkolle, më pas Llazi Qarri edhe mësues në këtë shkollë

Petro (Peço) Ndino Qarri u martua me Andoneta Zoi Priftin nga Vlora, ka 4 djem e dy vajza: Raqin, Kleanthin, Nestin, Eltonin, Teftën e Rajmondën.

Raqi Peço Qarri u martua me Vitore Dedën nga Lezha, kanë dy vajza: Lirinë dhe Nedën, banojnë në Tiranë.

Kleanthi Peço Qarri u martua me Qeribanë nga Selenica.

Nesti Peço Qarri u martua me Lindita Sotir Llambron nga Porua, kanë dy djem: Encion (Kostandinin, bashkuar dy emra) dhe Marion.

Elton Peço Qarri u martua me Anën, irlandeze.

Tefta Peço Qarri u martua me Dhimitër Lloji Andrean nga Narta, ka dy vajza.

Rajmonda Peço Qarri u martua me Kamber Hoxhën nga Tërbaçi, ka dy vajza.

QORRAJT
(Kanë qenë me mbiemrin Strone)

Kanë ardhur nga Gjirokastra, në Strone të Beratit dhe më pas në Delisuf. Më i vjetri ka qenë Sotir Strone (Qorri). Kanë marrë mbiemrin Qorri, sepse Sotirit i nxori syrin me bri një dash kur po e therte, në një festë fetare në shtëpi. Nga kjo, që mbeti me një sy, i thoshin Sotir Qorri. Disa pasardhës e kanë kthyer mbiemrin Sotiri.

Sotir Qorri la 5 djem e një vajzë: Tasin, Palin, Kriston, Koçin, Xoxin dhe Konxhen. Një kushëri i Sotir Qorrit la Vikon dhe Silën, që kish marrë Vasil Derrollin në Vlorë.

Tasi Qorri la Minon, Kijen, Athinanë, Ristanën, Ksandën, Dhoksien dhe Janën.

Vajzat e Tas Qorrit ishin:

Athinaja u martua me Nasi Kungullin në Poro.

Ristana u martua me Vasil Lepurin në Novoselë.

Ksanda u martua me Kostandin Moçkën në Poro.

Dhoksia, ose Sika, u martua me Mihal Gjonçarin në Poro.

Jana u martua me Vasil Kostën në Delisuf.

Djemtë e Tas Qorrit:

Mino T. Qorri u martua me Marie Llambro Semën nga Levani, kanë lënë Josifin, Thanasin dhe Thoman.

Kija T. Qorri u martua me Pulije Sotir Qarrin nga Novosela, kanë lënë Peçon, Llazin dhe Gjenën.

Josif Mino Qorri u martua me Kristina Trushi Rrapin nga Pish Porua, kanë një djalë, Robertin.

Thoma Mino Qorri u martua me Sila Kristo Marinën nga Porua, kanë dy djem e 3 vajza: Lefterin, Aleksandrin, Rajmondën, Donikën, Linditën.



Thoma Qorri

Lefter Thoma Qorri u martua me Drita Jani Papën nga Delisufi, ka dy djem e një vajzë: Saimirin, Ardianin dhe Matildën.

Aleksandër Thoma Qorri u martua me Jorgjie Thanasin nga Dëllënja, ka dy djem, Thanasin dhe Davidhin.

Rajmonda Thoma Qorri u martua me Tomi Sotir Naçin në Poro.

Lindita Thoma Qorri u martua me Aleksandër Lefter Petro Diamantin në Nartë.

Donika Thoma Qorri u martua me Vasillaq Fili Gegën në Delisuf.

Kije Sotir Qorri u martua me Pulije Sotir Qarrin nga Novosela, kanë lënë Peçon dhe Llazin.

Peço Kije Qorri u martua me Dafina Vangjel Hudhrën nga Delisufi, kanë 4 djem: Apostolin, Xhoxhin, Leonardin dhe Sokolin.

Apostol Peço Qorri u martua me Teuta Gori Lepurin, kanë 3 djem: Kedrin, Altonion dhe një tjetër.

Xhoxhi Peço Qorri u martua me Irma Jonuz Gjonlleshin nga Bishani, Fier, kanë një djalë, Davidin dhe 3 vajza.

Leonard Peço Qorri u martua me Lushka Peço Loshi nga Porua, kanë një vajzë.

Sokol Peço Qorri u martua me Lireta nga Mesapliku.

PALI SOTIR QORRI

Pali Sotir Qorri u martua me Aspasi Koçi Bushin nga Dëllënja (apo nga Gryka), dhe kanë lënë: Llaqin, Qorrin, Finën dhe Lenën.

Fina Pali Qorri u martua me Taqo Spiro Ristën në Zhukë.

Lena u martua me Mihal Lepurin në Poro.

Llaqi Pali Qorri (Sotiri e kanë kthyer mbiemrin), u martua me Sena Leksi Naçin nga Frakulla dhe kanë lënë dy djem e 4 vajza: Dhori, Vangjeli, Violeta, Aretia, Natasha dhe Luiza.

Llaqi Qarri

Dhori Llaqi Sotiri u martua me Gjena Gori Markun nga Dëllënja, kanë dy djem e dy vajza: Fatmirin, Mariglenin, Marjanën dhe Anilën.

Fatmir Dhori Qorri u martua me Yllka Themi Dokon nga Dëllënja, kanë një djalë, Mateon, janë në Itali.

Marigleni aktualisht është beqar.

Marjana u martua me Maksim Noje Hilën nga Dëllënja.

Anila u martua me Alqi Niko Bërdallin në Poro.

Vangjel Llaqi Sotiri (Qorri) u martua me Liljana Gjergji Mbyetin nga Delisufi, kanë 3 djem: Alketin, Eritonin dhe Renaton.

Alket Vangjel Sotiri (Qorri) u martua me Eva Arqile Llambron nga Porua, kanë dy djem e një vajzë: Tomi, Eritoni dhe Renata.

Vajzat e Llaqi Sotirit (Qorri):

Violeta u martua me Mihal Gajën në Vlorë.

Aretia u martua me Marko Kolën në Zvëmec.

Natasha u martua në Fier me Filip Nasi Gjonin.

Luiza u martua me Llazar Miti Sakon në Vlorë.

KRISTO SOTIR QORRI

U martua me motrën e Leksi Kërrit nga Gryka, kanë lënë një djalë e 5 vajza: Thanasin, Nijen, Vasën, Menin, Katjan dhe Llambrininë.

Thanas Kristo Qorri u martua me Marie Naqo Kolën (Mitraj) nga Porua, kanë dy djem: Aristirin, Stefanin, Gjenovefën, Elizën dhe Irenën.

Vajzat e Kije Qorrit:

Nija u martua me Miti Petanin në Frakull.

Vasa u martua me Josif Mino Nakën në Delisuf.

Meni u martua me Vangjel Miti Zakën në Dëllënjë.

Katja u martua me Pandeli Mani Mone në Poro, Fier.

Llambrinia u martua me Ristan Gjergjin në Vlorë.

KOÇI SOTIR QORRI

Koçi Sotir Qorri u martua me motrën e Thoma Mbyetit nga Delisufi, po nuk lanë fëmijë. Rritën Viko Qorrin se atij i kish vdekur nëna shpejt dhe e la të vogël. Vikua ishte i biri i Llambros.

1. Shënim: Një djalë i Sotir Qorrit, Xoxi u vra, pa dashje, në dasmë te Niso Prifti në Zhukë. Xoxi u ndodh aty. Një nga dasmorët, në pije e sipër, në kulmin e qejfit, nxori armën dhe qëlloi, ashtu kot, se i thoshte rakia. Si i dehur që ishte, pa dashje goditi Xoxin dhe vdiq në vend. E morën të vrarin dhe e sollën në shtëpi, por edhe në shtëpinë e tij bëhej dasmë. Martohej një nga vajzat e Sotir Qorrit. Kur e sollën të vrarin, e mbyllën në dhomë dhe nuk u thanë njerëzve deri sa doli vajza, pastaj hapën kujën dhe u morën me të vdekurin. Kështu urdhëroi i madhi i shtëpisë.

2. Shënim: Me mbiemrin Strone ka edhe në Seman. Një Llambro Strone kish marrë Licën e Laze Hënës nga Porua. Atje janë djemtë e tij. Këta mund të jenë një gjak me Tasi Qorrin (Stronen) e Delisufit. Lica, e bija e Laze Hënës, ka qenë e martuar me Koli Liçon në Dëllënjë dhe aty la një vajzë. Lica u martua me Llambro Stronen në Seman. Vajza që lindi Lica në Dëllënjë, u martua me Loni Mërtirin nga Pish-Porua e Fierit.

VIKO LLAMBRO QORRI

Është kushëri me Tasi Qorrin. Vikua u martua me Dafina Josif Gjinin nga Porua. (Nga Gjinajt s'ka asnjë mashkull në Poro).

Vikua me Dafinën ka lënë Miçon, Koçin, Kristinën.

Miti Viko Qorri u martua me Aleksandra Thanas Kazhelin nga Dukati, kanë 3 djem dhe 5 vajza: Kristaqin, Agimin, Besnikun, Valentinën, Dritën, Sofikën, Lumturinë dhe Blerinën.

Kristaq Miti Qorri u martua me Merita Guri Kockën nga Sevasteri, kanë një djalë e një vajzë: Justinon dhe Omiselën.

Agim Miti Qorri u martua me Flora Mishkën nga Mekati i Vlorës, kanë një djalë, Klensi.

Besnik Miti Qorri u martua me Rovena Bullën, s'kanë fëmijë.

Vajzat e Miti Qorrit:

Valentina u martua me Minella Kozma Ngjelon, Aliban.

Drita u martua me Arqile Dhimojanin në Dhërmi.

Sofika u martua me Anesti Josif Lepurin në Delisuf.

Lumturia u martua me Elidon Agron Tafil Xhyherin.

Blerina u martua me Agim Petro Muçaj në Fier.

KOÇI VIKO QORRI

Koçi Qorri u martua me Kristina Ligor Subashin nga Zvërneci, kanë dy djem e 3 vajza: Mikelin, Florianin, Klodetën, Kozetën dhe Mirën.

Mikel Koçi Qorri u martua në Greqi.

Floriani u martua me Migena Thanas Babën në Dëllënjë.

Kladeta Koçi Qorri u martua dhe u divorcua.

Kozeta u martua me Niko Pulajn në Zvëmec.

Mira aktualisht është beqare.

Kristina Viko Qorri u martua me Gori Gjokën në Pish-Poro, kanë dy djem e një vajzë.

LLUKË SHEQI

Me origjinë nga Mbrostari i Fierit, me mbiemrin Hudhra.

Llukë Sheqi kish marrë gruan nga Babunja e Lushnjës, të bijën e Vangjel Sikos, ose të motrën e Petro Sikos, nga Porua.

Llukë Sheqi la Llazin, Marien dhe një vajzë që u martua në Mifol dhe kish lindur Kristullën që kish marrë Todi Leshin. Dhe Kristulla la Lolën, se u martua me një çam, por shpejt u divorcua.

Kristulla mori çamin se i kish vdekur Todi Leshi në Vlorë, por rriti vajzën, Lolën, të cilën e martoi me Zarif Gjikdhimën nga Përmeti.

Maria Llukë Sheqi u martua me Vangjel Hajdinin në Poro dhe lindën 3 djem e një vajzë.

Llazi Llukë Sheqi u martua me Ksanda Leksi Rredhin nga Gryka dhe lindën 3 djem e 3 vajza: Gorin, Jorgjin, Thanasin, Marien, Uraninë dhe Letën.

Gori Llazi Sheqi u martua me Gjena Peti Lerën nga Gryka dhe kanë një vajzë e 3 djem: Rajmondën, Artin, Gramozin dhe Bledin.

Rajmonda Gori Sheqi u martua me Minella Andon Çunin nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza.

Arti Gori Sheqi u martua me Joana Nebi Sinanin nga Peshkëpia e Vlorës, kanë dy djem: Nikollën dhe Mateon.

Gramoz Gori Sheqi u martua me Joridha Koçi Gushin nga Peshtani i Fierit, kanë një vajzë, Migenën.

Bledi Gori Sheqi u martua me Blerina Gani Laçin nga Durrësi, nuk kanë fëmijë.

Gori Sheqi ka shkuar familjarisht në Vlorë, pas vitit 1996.

Jorgji Llazi Sheqi u martua me Donika Thoma Mërtirin nga Porua, kanë lindur dy djem e një vajzë: Ervinin, Denisën dhe një tjetër.

Donika vdiq në vitin 2007. Jorgji mori një vajzë nga fshatrat e Lushnjës, me këtë s'ka fëmijë.

Thanas Llazi Sheqi u martua me Liljana Koli Koçin nga Porua, kanë 3 vajza e një djalë.

Lindita Th. Sheqi u martua me djalin e Laske Boçi nga Vlora.

Thanas Sheqi me gruan e tij, Liljana Koçi

Silvana Th. Sheqi u martua me djalin e Gor Gjonçarit nga Porua.

Aurora Th. Sheqi u martua me djalin e Toli Miles nga Porua.

Eduard Th. Sheqi aktualisht është beqar.

Vajzat e Llazi Sheqit:

Maria u martua me Todi Babën, me të lindi dy vajza, Silën dhe Kristullën. Todi vdiq shpejt, një vajzë, Silën e rriti i vëllai, Rako Baba në Fier dhe e ka martuar. Vajza tjetër, Kristulla, u martua me Nasho Bakën në Aliban. Me burrin e dytë, Pilo Prifti në Novoselë, ajo lindi vajzën. Maria la një vajzë, Aretinë. Me burrin e tretë, Tonçi Ogari nga Kryegjata, Maria lindi dy djem, Andonin, Leon dhe një vajzë që është martuar te Kërrajt në Delisuf.

Leta Ll. Sheqi u martua me Niko Uan Milen në Poro.

Urani Ll. Sheqi u martua me Llazi Lenën në Aliban.

SHYTI

Papa Miti Shyti ka lënë dy djem: Qiricin dhe Sotirin. Qirici shkoi në Zhukë, Sotiri mbeti në Poro. Thuhet se kanë ardhur në Poro nga Berati. Sotiri la dy djem: Kriston dhe Leksin, ndërsa Qirici la Tefin, Vangjelin dhe Tasin.

Kristua në Poro la Pilon, Llazin dhe Dafinën.

Leksi la Palin dhe një vajzë, e cila ishte martuar me Vangjel Hajdinin, por ajo vdiq nuse e re. Nuk la fëmijë.

Dafina e Kristos u martua me Leko Plakun në Poro. Edhe ajo vdiq e re, la një vajzë Kristinën, që u martua me Fili Bërdallin.

Pali Shyti u martua me Licën, të bijën e Petro Lëngut nga fshatrat e Fierit. La Nasin, Sijen dhe Kolin. Koli vdiq i ri.

Sija u martua në Fier.

Nasi Shyti u martua me Margën e Sako Moçkës nga Porua kanë 3 djem e një vajzë: Filin, Leksin, Sotirin dhe Vitën.

Vita u martua me Leko Leshin në Mifol.

Fili u martua me Dhimitrulla Bejlerin nga Himara dhe kanë dy djem e një vajzë: Arbeni, Alketi e Margarita.

Arben Fili Shyti u martua me Lala Todi Koçulin nga Marinëza dhe kanë dy vajza: Dhimitrullën dhe Aleksandrën. Alketi aktualisht është beqar.

Margarita Fili Shyti u martua me Kiço Merkurin nga Piluri dhe kanë një djalë e një vajzë.

Leksi Nasi Shyti u martua me gruan e parë Drita Ramadan Ademin nga Vlora, (dibrane) dhe ka një djalë, Leonardin, i cili është martuar me vajzën e Niso Thanos nga Porua dhe ka një djalë e një vajzë. Leksi u martua me gruan e dytë, Ollga Kil Gjonçarin nga Porua dhe kanë 3 djem: Eltonin, Ernisin. Ollga ka sjellë te Leksi Shyti edhe një djalë që kishte me burrin e parë në Pish-Poro.

Sotir Nasi Shyti u martua me Sofikën e Kristaq Loni Nakës (bija e Senës) nga Dëllënja dhe kanë 3 djem: Lencin, Leonardin dhe Marjon.

Kristo Sotir Shyti u martua me Dafinën dhe la Pilon dhe Llazin, Dafinën dhe një tjetër.

Pilo Kristo Shyti u martua me Marie Llazi Koven nga Gryka dhe kanë 4 djem e 3 vajza: Janin, Ilian, Kristaqin, Lefterin, Llambën, Silën, Nolin.

Jani Pilo Shyti u martua me Lefteri Petri Kolën nga Porua dhe kanë dy djem e një vajzë: Eduardin, Juliani dhe një tjetër.

Eduard Jani Shyti u martua me Enkelejda Fani Th. Qorrin nga Delisufi dhe kanë një djalë e një vajzë, Kristianën dhe Sarën.

Julian Jani Shyti u martua me Majlinda Llazi Kie Qorri nga Delisufi dhe kanë dy vajza.

Lijo Pilo Shyti u martua me Minushen nga Cakrani i Fierit dhe kanë një djalë e 3 vajza: Aurelin, Anilën, Marcelën dhe një tjetër.

Kristaq Pilo Shyti u martua me Rajmondën nga Kryegjata e Fierit, dhe kanë dy djem e një vajzë: Bledin, Fatmirin dhe Marjalën.

Fredi Kristaq Shyti u martua me Klenisën nga Fieri, dhe kanë dy vajza.

Lefter Pilo Shyti u martua me Eleni Qirjaq Plakun nga Dëllënja, dhe kanë një djalë e dy vajza: Ervinin, Ridën dhe Sejdinën.

Tri vajzat e Pilo Shytit: Llamba, Sila dhe Noli janë martuar në Fier dhe kanë djem e

vajza.

Llazi Kristo Shyti u martua me Lola Gjeko Gjokën nga Pish-Porua dhe kanë një djalë e 4 vajza: Miçon, Tulin, Vitoren, Vangjelinën dhe Andonetën.

Miço Llazi Shyti u martua me Rajmonda Lijo Kungullin nga Porua, dhe kanë një djalë e një vajzë.

Tuli Llazi Shyti, u martua te Hysot në Novoselë.

Vitoria Llazi Shyti u martua me Vasil Petro Sikon.

Lika u martua me Rako Turtullin në Kryegjatë, Fier.

Andoneta Llazi Shyti u martua në Zvëmec.

Në Poro, në lagjen Marinëz, ka banuar disa kohë një Jorgji Shyti, i cili nuk kishte të bënte me shytat e tjerë të Poros. Ai kishte grua Anën dhe ka lënë një djalë e dy vajza, Trifonin, Gonen dhe Konxhen. Nuk dimë se nga ishin. Trifoni ka jetuar në Fier.

QIRIC MITI SHYTI

Qiric Miti Shyti la 3 djem: Tefin, Vangjelin dhe Tasin.

Tefi Qiric Shyti kishte marrë për grua Marien e Kristo Kondës nga Zhuka dhe la dy djem e 4 vajza: Filin, Aristirin, Gjenën, Ristanën, Sijen dhe Katerinën.

Fili Tefi Shyti u martua me Sofie Gori Sollakun nga Pish-Porua dhe kanë 3 djem e një vajzë: Vasillaqin, Dhorin, Adrianin dhe Marcelën.

Vasillaq Fili Shyti u martua me Lindita Hasan Hasanin nga Dhëmblani Tepelenës, kanë një djalë e dy vajza: Geraldin, Silvanën dhe Julin.

Dhori Fili Shyti u martua me Liza Llambro Bregun nga Mifoli, kanë 4 vajza: Marien, Kristinën, Jetmirën dhe Theolidën.

Ardian Fili Shyti u martua me Albana Minella Minon, kanë një djalë e një vajzë: Orestin dhe Paulën.

Marcela është e martuar.

Aristir Tef Shyti u martua me Sulltana Abedin Shegën nga Kuçi i Vlorës dhe kanë një djalë e një vajzë: Albertin dhe Gilbertën; me gruan e dytë Aristiri, kanë një vajzë: Ermira Shyti. Këtë e ka me Arsino Feti Çobankën nga Sheqishtja e Fierit.

Albert Aristir Shyti u martua me Alketa Jani Kordhën nga Vlora, kanë një djalë, Elidonin e dy vajza.

Vajzat e Tefi Shytit:

Gjena u martua me Mihal Priftin në Vlorë.

Ristana u martua me Llazi Priftin nga Mesaraku i Armenit.

Katerina u martua me Paskal Jankën, por vdiq e re, pa fëmijë.

Sija vdiq e re.

Shënim: Fili e Aristiri banojnë familjarisht në Vlorë, që nga viti 1950–1955.

TASI QIRIC SHYTI

Tasi Qiric Shyti u martua me Finën e Taqi Bërdallit nga Porua dhe kanë një djalë e 3 vajza: Kristaqin, Naunkën, Kostandinën dhe një që ishte gjithë kohën e sëmurë, vdiq rreth moshës 20–26 vjeçe, në Zhukë.

Kristaq Tasi Shyti u martua me Margarita Petro Gjonçarin nga Zhuka, kanë 3 djem e 3 vajza: Xhoxhin, Dritanin, Stefanin, Lauretën, Aleksandrën dhe Kladitën.



Kristaq Shyti

Xhoxhi Kristaq Shyti u martua me Rovena Mitaq Llazi Kolën (ose Mitraj) nga Porua, kanë dy djem: Emiljanon dhe Mikardon.

Dritan Kristaq Shyti u martua me një moldave në Itali. S'ka femijë.

Stefan Kristaq Shyti u martua me Enerjeta Tori Dhimën nga Marinëza e Fierit, kanë një djalë e dy vajza: Kristaqin, Klarën dhe Katerinën.

Laureta K. Shyti u martua me Aurel Aleks Qirjakun, nga Korça.

Aleksandra dhe Kladeta aktualisht janë beqare.

Të tre djemtë e Kristaqit kanë emigruar në Itali.

VANGJEL QIRIC SHYTI

Vangjel Qiric Shyti u martua me Tanën e Ndini Leshit nga Porua, kanë dy fëmijë, Sotirin dhe Janën.

Vangjeli vdiq i ri, Tana mori dy fëmijët dhe u martua me Gjeko Gjokën në Pish-Poro të Fierit dhe atje gjeti e lindi fëmijë të tjerë.

Sotir V. Shyti u martua dhe ka 4 djem e një vajzë: Vangjelin, Jorgjin, Vasilin, Piron dhe Letën.

Të gjithë banojnë në Pish-Poro.

Jana V. Shyti u martua me Kozma Vangjel Hajdinin në Poro, kanë lindur një vajzë e 5 djem.

TRIFON TITI (TODI)

Trifon Titi në Dëllënjë është i ardhur nga fshatrat e Fierit. Trifoni ka lënë 4 djem: Mitin, Nasin, Petron dhe Filipin.

Miti Trifon Titi u martua me Kristina Koli Rrushin nga Fieri, kanë 4 djem e dy vajza: Arqilen, Agronin, Nikollën, Arbenin, Jorgjien dhe Florikën.

Arqile Miti Titi u martua me Violeta Todi Manin nga Frashëri Fierit, kanë një djalë e dy vajza: Visin, Valbonën dhe Blerinën.

Agron M. Todi u martua me Alimen nga Fieri, kanë një djalë e një vajzë: Odisenë dhe Sofien.

Nikolla M. Todi u martua me Nelën nga Gjokallia e Fierit, kanë dy vajza: Mikelën dhe Anilën.

Arben M. Todi u martua me Lidën nga Mbyeti i Fierit, kanë një djalë: Andrean.

Jorgjia M. Todi u martua me Pano Gori Markun në Dëllënjë.

Florika M. Todi u martua me Piro Caush Çelën në Poro.

Shënim: Tjetër fis janë Titajt e tjetër Stefajt në Dëllënjë.

NASI TRIFON TITI (TODI)

Nasi Trifon Titi u martua me Katerinën nga Frashëri i Fierit, kanë dy djem e 3 vajza: Dhorin, Aleksandrin, Lefterin, Lidën dhe Marjetën.

Aleksandri u martua me Linën nga Frashëri, kanë 3 djem: Armandon, Lorin dhe Enon.

Petro Trifon Titi u martua në Gjirokastër me Kleopatrën, ka 3 djem e një vajzë: Lilën (Harrilla), Andonin, Sokolin dhe Shpresën.

Lila u martua me Erjonën nga Kruja, kanë një djalë e një vajzë: Ervisin dhe Elisën.

Andon P. Todi u mbyt në det në Otranto, kur u mundua të shkonte në Itali.

Sokoli aktualisht është beqar.

Filip Trifon Titi (Todi) u martua me gruan e parë nga Bularati i Gjirokastrës, kanë një djalë, Kozma Todi, është në Korfuz me nënën. Me gruan e dytë, Marie Petro Hudhra nga Muçaj i Fierit, ka dy vajza: Eljonën dhe Ermirën, ajo ka sjellë një vajzë te Filipi, quhet Sonila, e bija e Arqile Delia.

Sonila u martua me Piro Peço Prifti në Poro.

Eljona u martua me Edmond Kozma Prifti në Poro.

Ermira aktualisht është beqare.

TODI NAUN STEFA

Todi Stefa ka ardhur vonë në Dëllënjë, nga Zhuka. Edhe në Zhukë që ndenji disa kohë, kishte ardhur nga Gryka.

Todi Stefa ishte martuar me Llamba Hila nga Hilajt e Zhukës, kanë lindur 4 djem: Ilian, Takun, Naunin dhe Vangjelin.

Ilia është i martuar dhe ka një djalë e një vajzë.

Taku T. Stefa u martua me Evllon e Qirjaq Plakut nga Dëllënja, kanë një djalë.

Nauni nuk jeton.

Vangjel T. Stefa u martua me Elpiniqin, kanë një djalë e një vajzë.

Shënim: Todi Stefa është vëllai tretë i Stefajve. Ai ka pasur edhe dy vëllezër të tjerë në

Vlorë: Pilo Stefën dhe Llazi Stefën. Ata kanë ikur nga Gryka në Vlorë shumë shpejt dhe janë martuar e shtuar atje, por janë nga Stefajt e Grykës.

JORGJI THANASI, DËLLËNJË

Jorgji Thanasi ka ardhur shpejt në Dëllënjë. Origjina e tij, thonë nipërit, është nga Juba e Durrësit. Thanasi kishte vajtur nga Juba në Babicë, në Xhyherin dhe, pastaj erdhi në Dëllënjë.

Thanasi la Jorgjin si djalë, dhe Jorgji la 4 djem: Gaqin, Mitin, Kozman dhe Pilon.

Gaqi Thanasi nuk la fëmijë.

Miti la Naunin dhe një vajzë që vdiq e re.

Kozmai la Gorin.

Pilua u martua me Çevën e Ndini Bushit, la dy djem e dy vajza: Sotirin, Nasin, Varën dhe Janën.

Naun Mit Thanasi u martua me Vasilika Xoxi Shurdhin nga Dëllënja dhe kanë lënë Kostandinin (Koçin), Stavren, Jorgaqin, Pandelin, Marien, Kristullën dhe Naunkën.

Kostandini (Ndini) u martua me Nije Pilo Gjonçarin në Dëllënjë, ka 6 djem e 4 vajza: Dhimitrin, Lefterin, Sokratin, Artin, Altinin, Fotaqin, Liljanën, Fjorentinën, Evën dhe Vjollcën.

Dhimitër K. Thanasi u martua me Enkeleda Llazi Petushin nga Sheq Marinëza, kanë një djalë e një vajzë: Alesjan dhe Martinon.

Lefter K. Thanasi u martua me Flutura Prençin nga Sheq Marinëza, kanë dy djem: Davidhin dhe Manuelin.

Sokrat K. Thanasi u martua me Entela Vllasi Dashin nga Delisufi, kanë një djalë, Leon.

Arti K. Thanasi u martua me Klodiana Ndini Jorgjin nga Havaleasi i Fierit, kanë një vajzë, Mellaninë.

Altin K. Thanasi u martua me Nertila Nasi Dhamon nga Pish-Porua.

Fotaq K. Thanasi u martua me Danjela Vangjel S. Shytin, nga Pish-Porua.

Vajzat e Naun Thanasit:

Maria u martua me Stavre Trushi Kolën në Poro.

Kristulla u martua me Toli Gjeko Gjokën në Pish-Poro, Fier.

Naunka u martua me Liko Dokon në Pish-Poro.

Sotir Pilo Thanasi u martua me Vala Kristo Përrin nga Dëllënja, kanë lindur 3 djem e 4 vajza: Todin, Panon, Vangjelin, Vidën, Kristinën, Katen dhe Dhoksinë.

Todi S. Thanasi u martua me Gjenën nga Pish Porua, ka një djalë.

Pano S. Thanasi dhe Kate Vasil Helmi nga Dëllënja, kanë dy djem e dy vajza: Piron, Gentin dhe Lolën.

Vangjel S. Thanasi u martua me Ollgën nga Zvërneci, ka dy djem, Gëzimin, Kujtimin dhe dy vajza.

Varvara Pilo Thanasi u martua me Thoma M. Petovën.

Jana Pilo Thanasi u martua me Vasil Kungullin dhe, herën e dytë, me Thoma Mërtiri, në Zhukë.

GORI KOZI THANASI

Gori Kozi Thanasi u martua me Kristulla Spira Thanon nga Porua, kanë lindur 3 djem e 5 vajza: Thoman, Leonidhën, Nikollën, Thanasullën, Evrionin, Ksandën, Teftën dhe

Olimbinë.

Thoma Gori Thanasi u martua me Rita Joti Veron nga Bestrova, kanë dy djem e dy vajza: Mentin, Mandin, Elonën dhe Verën.

Menti Thoma Thanasi u martua në Pish-Poro, kanë një djalë, Serdin dhe një vajzë.

Leonidha Gori Thanasi u martua me Sofien nga Gjirokastra, kanë një djalë e një vajzë: Ligorin dhe Kristinën.

Niko Gori Thanasi u martua me Lenën nga Gjirokastra, kanë 3 vajza: Kristinën, Marien dhe Katerinën.

Thanasulla u martua me Noje Llazi Hilën në Dëllënjë.

Evrioni u martua me Llambi Vasil Helmin në Dëllënjë.

Ksanda u martua me Sotir Kozma Çuni në Dëllënjë.

Olimbia u martua me Kristaq Thanasi në Zvërnec.

E ëma e Gori Thanasit ishte motra e Hali Babës nga Dëllënja,

THANAS PILO THANASI OSE NASI (JORGJI)

Nasi Pilo Thanasi u martua me Dafinën nga Rrapajt e Pish-Poros, kanë 4 djem e dy vajza: Koçin, Xhekën, Palin, Lefterin, Lumturinë dhe një tjetër.

Koçi Nasi Thanasi (Jorgji) u martua me Donika Ristan Gegën nga De1isufi, kanë një djalë e 3 vajza.

Xheka Nasi Jorgji u martua me Milikën nga Babica, kanë dy djem e një vajzë: Kelon, e të tjerë.

Pali Nasi Jorgji u martua me Donika Spiro Babën në Dëllënjë, kanë një djalë e një vajzë.

Lefter Nasi Jorgji u martua me një vajzë nga Tepelena, ka dy djem.

Lumturi Nasi Jorgji u martua me Niko Naun Liçon në Dëllënjë.

STAVRI NAUN THANASI

Stavri Naun Thanasi u martua me Jorgjie Petro Bërdallin nga Porua, kanë 3 djem e 3 vajza: Vladimirin, Ardianin, Agronin, Elvirën, Majlindën dhe Vasilikën.

Vladimiri u martua me Rozina Llazi Rinën, në Topojë, kanë një djalë e një vajzë: Fabion dhe Isabelën.

Ardian S. Thanasi u martua me Bukurie Ymer Hidën nga Elbasani, kanë një djalë e një vajzë: Naunin dhe Alesian.

Agron S. Thanasi u martua me Uljana Pilo Muçarakun nga Topoja, kanë dy djem: Erjonin dhe Xhoxhon.

Elvira Stavri Thanasi u martua me Elinor Gopo në Krutje të Lushnjës.

Majlinda S. Thanasi u martua me Edison V. Mbyetin në Delisuf.

Vasilika S. Thanasi u martua në Elbasan.

Jorgji Naun Thanasi u martua me Gora Spiro Babën në Dëllënjë, kanë një djalë e një vajzë: Dritanin dhe Alketën.

Dritan J. Thanasi u martua me Nertila Filipi Vrushin, nga Baltëza e Fierit, kanë dy djem: Kristianin dhe Jorgon.

Alketa u martua me Aleksandër Tome Qorrin në Delisuf.

Pano Naun Thanasi u martua me Marinaqi Niko Ristën nga Delisufi, kanë një djalë e dy

vajza: Ervinin, Valbonën dhe Aristianën.

GORI DHE SPIRO THANO (NDREKA)

Gori dhe Spiro Thano janë djemtë e Naqe Ndrekës nga Porua. Shtëpia e Naqe Ndrekës ka qenë në hyrje të Poros, nga ana e Vjosës.

Spiro Thano la Naunin dhe Kristullën, e cila u martua me Gor Thanasin në Dëllënjë.

Kur vdiq Naqe Ndreka, e shoqja mori me vete të dy djemtë dhe u martua me Jorgji Thanon në Poro. Gori e Spirua u rritën te Jorgji Thano, prandaj morën mbiemrin Thano.

Gori Thano u martua me Konxhe Koçi Hyso nga Novosela, kanë lënë 3 femijë: Nison, Miçon, dhe Marien.

Niso Gori Thano u martua dy2 herë. Gruaja e parë ishte e bija e Vangjel Gonit nga Zhuka, po shpejt u divorcua. Ajo ishte shtatzënë dhe lindi një djalë, të cilin e rriti gjyshi i tij, i jati i mëmës, Vangjel Goni, dhe e regjistruan me emrin Piro Vangjel Goni. Në të vërtetë ai është djali i Niso Thanos nga Porua.

Nisua mori grua të dytë Ksandën dhe ka 4 djem: Sotirin, Vasillaqin, Viranin, dhe Ligorin.

Sotir Niso Thano u martua me Liljanën e Vangjel Konomit nga Zvërneci, kanë një vajzë, Idën.

Ida Sotir Thano u martua me Nardi Leksi Shytin në Poro, ka një djalë e një vajzë.

Vasillaq Niso Thano u martua me Vasilika Feta Gashin nga Zhuka, ka 3 vajza.

Viron Niso Thano u martua me Rovena Jonuz Gjedeshin nga Bishani i Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Santiagon dhe Aleksandrën.

Ligor Niso Thano u martua me Fatmira Bektash Tocajn nga Llakatundi, kanë një djalë e një vajzë: Vladimirin dhe Kristinën.

MIÇO GORI THANO

Miço Gori Thano u martua me Marinaqi Pali Lalën nga Mifoli, kanë dy djem dhe një vajzë: Artin, Lijon dhe Rajmondën.

Llazi Hajdini dhe Miço Thano

Arti Miço Thano u martua me Tatjana Nasi Helmin nga Dëllënja, kanë dy vajza: Joniden dhe Artanelën.

Lijo Miço Thano u martua me Kristina Vangjel Subashin nga Marineza e Fierit, kanë një djalë e një vajzë: Ermandin dhe Elisabetën.

Rajmonda Miço Thano u martua me Manush Merko Gjonzenelin nga Tragjasi, banojnë në Vlorë.

NAUN SPIRO THANO

Naun Spiro Thano u martua me Fina Llazi Dhamon nga Pish-Porua dhe kanë dy djem e 4 vajza: Thoman, Vangjelin, Melpomenin, Florën, Sofikën dhe Vasilikën.

Thoma Naun Thano u martua me Miranda Pandeli Milen nga Porua, kanë dy djem e dy vajza: Arditin, Foton, Sonilën dhe Elin.

Vangjel Naun Thano u martua me Mirela Feti Brahimin nga Llakatundi, kanë një djalë e dy vajza: Mariusin, Rafaelën, Irenën.

Vajzat e Naun Thanos:

Melpomeni u martua me Marko Koçin në Nartë.

Sofika u martua me Naun Vasil Moçkën në Novoselë.

Flora u martua me Todi Llaqi Karavoqirin në Nartë.

Vasilika u martua me Fatmir Riza Bilalin në Vlorë.

Pra, Gori dhe Spiro Thano, paraardhësit e tyre, kanë qenë me mbiemrin Ndreka dhe jo Thano. Uani e të tjerë janë Thano.

VANGJEL THANO

Vangjel Thano la Uanin dhe Ndinin.

Uan Vangjel Thano la dy vajza, Kristullën dhe Vitën.

Kristulla Uan Thano u martua me Koçi Ristan Belina, në Poro, (Burri i parë), dhe, për herë të dytë, u martua në Pish-Poro.

Vita Uan Thano u martua me Ndoni Nasi Gega në Dëllënjë.

Ndini Vangjel Thano u martua dhe ka lënë një vajzë, Pulien.

MITI JORGJI (QOSE)

E kanë origjinën nga Sinja e Beratit.

Miti Jorgji ka lindur në Vlorë. Ai erdhi si partizan në zonën e Poros dhe lëvizte, sa në një fshat në tjetrin, sipas detyrave që merrte. Ishte djalë i gjallë, por mbeti partizan në Myzeqe.

Mbas Çlirimit, Miti mori detyra në pushtet e u stabilizua dhe me familje.

U martua me Marien, të bijën e Qirjaq Monçes dhe Varvarës.

Miti me Marien lindën 5 djem e një vajzë: Fanin, Sotiraqin, Vangjelin, Ladin, Bertin dhe Vefin.

Maria ka qenë shumë e mirë si njeri.

Miti ndenji në Poro deri në vitin 1956, pastaj iku familjarisht në Vlorë, ku edhe u punësua.

PETRO LIÇO THANO

Petro Thani u martua, me Rita Pali Nakën nga Porua, kanë 3 djem e 4 vajza: Nikon, Vllasin, Tolin, Llambrininë, Lirinë, Donikën dhe Mondën.

Niko P. Thano u martua me Miroshe Prodhimin nga Llakatundi, kanë një djalë e dy vajza: Besnikun, Anën e Edën.

Vllasi Petro Thano u martua me Lida Niko Bërdalli nga Porua, kanë dy djem: Florencin dhe Petron.

Toli P. Thano u martua me Moza Thoma Gogën nga Roskoveci, kanë dy vajza: Margaritën dhe Vitën.

Llambrini P. Thano u martua me Trifon Koli Moçkën në Poro.

Liri P. Thano u martua me Nelo Llazi Kolën (Mitraj) në Poro.

Donika P. Thano u martua me Andrea Bashkën në Sarandë.

Monda P. Thano u martua me Niko Kulën në Himarë.

(Tregoi Rita Thano, 70 vjeçe).

GORI DHE VASIL THANO (PATATJA)

Erdhën familjarisht para Reformës Agrare dhe morën tokë, por nuk ndenjën shumë në Poro. Gori iku më shpejt në Vlorë. Kishte një djalë e një vajzë: Thanasin dhe Fotikën.

Fotika u martua në Vlorë me Niso Koli Stefën nga Gryka, lindën fëmijë, por Nisua u degjenerua nga alkooli dhe Fotika e ndau. Nisua kaloi keq pleqërinë, vdiq në Vlorë nën kujdesin e të vëllait, Miti Stefës.

Thanas Gori Thano ka djem e vajza në Vlorë.

Vasil Thano, kur erdhi në Poro, kishte një vajzë, Naqen, të cilën e martoi në Vlorë me Petrit Daqe nga lagja Çentrale.

Vasili mori Zoicën nga Kërrajt e Grykës, grua të dytë, por ajo nuk lindi fëmijë. Punuan si shërbëtor në kishë dhe, në Poro vdiqën të dy. Ishin njerëz shumë të mirë.

Gori e Vasili ishin vëllezër, nga e kanë origjinën nuk e dimë.

Shënim: Mbiemrin e kanë Thano, jo Patatja. Patate u a ngjitën kot, si paranom.

BRAHO ILJAZI

Braho Iljazi ishte çam dhe erdhi me gjithë dy motrat e plakura e të pamartuar. Dhe të tre nuk u martuan.

Erdhën dhe u vendosën në Pishë në afërsi të Hirit të Madh. Aty ndenjën në kasolle me qepra në dhe, të thurur me zhukë, si shumë kasolle stanesh të tjera. Jetuan disa vjet në stan. Furnizimin me ushqime e bënin në fshat e në qytet. Më vonë u futën në fshat, ndërtuan një shtëpi, kasolle me kashtë dhe aty rrinin më shumë të motrat, po edhe në stan rrinin. Rronin keq, në kushte të vështira higjienike, por nuk pësuan gjë.

NDINO DHE PASKAL GJONI

Erdhën në Poro në vitin 1946, morën tokë nga Reforma Agrare po shpejt e lanë e u larguan. Paskali vdiq pa fëmijë.

Ndinua la një vajzë, Dhoksien, e cila u martua me Kozma Hysi, nga Grecallia e Fierit, nënoficer i mbrojtjes kufitare me shërbim në Zhukë. Ata u larguan dhe shkuan në Fier.

THOMA TUTULANI

Thoma Tutulani (ose Tytërlani) erdhi në Poro por nuk ndenji shumë. Ai më shumë ndenji e punoi si punëtor në pak shtëpi; ishte punëtor i madh. Pas pak kohë u largua.

Zuri punë në Vlorë, bëri shtëpi te përroi që vjen nga Spitali, tek ura e lagjes Vrenes. Sot atje janë ngritur pallate 2–3 kate.

Thomai u martua me një vajzë nga Narta dhe ka dy djem Spiron dhe Thanas Tutulanin, në Vlorë.

Origjinën nuk ia dimë, por duhet të jetë nga Berati.

Ka punuar te Pal Vani dhe te Zoi Çukua, e te të tjerë.

Një vajzë e tij ka qenë mësuese, edhe drejtuese e aksionistëve në Jonufër, dhe kryetare e Gruas në Vlorë.

Mbiemrin Tytërlani ja ngjitën në Poro, nga që kishte zë të fortë dhe këndonte shumë bukur (nga fjala grykë, tytë). Një burim thotë se e ka pasur mbiemrin Kola, një tjetër burim thotë se e ka pasur Gega.

NIKOLLA THANO (GREKU)

Nikolla Thano erdhi në Poro në vitin 1943, siç erdhën shumë familje greke nga fshatrat e Janinës. Ai dhe i kunati i Vasil Blecës. Nuk u kthyen më andej nga kishin ardhur. Ata morën tokë nga Reforma Agrare në Poro dhe u integruan në jetën e vendit. Ndërtuan shtëpi, martuan djemtë e vajzat në fshat dhe e ndërtuan jetën për bukuri, sepse ishin njerëz të mirë e punëtorë të shkëlqyer. Për pak vite, ishin familje shembullore me të gjithë normat e shoqërisë. Nikolla punonte edhe natën me dritën e hënës, ose dhe me fenerë, se nuk i mjaftonte koha me diell. Atij njeriu ia kishin zilinë ata që donin hije, kur ishte koha e punës ose rrinin në shullë e ngroheshin, kur toka e bimët donin shërbim.

Pas viti 1990 fëmijët e Nikollës, edhe pse kanë emigruar të gjithë në Greqi, prapë se prapë venë e vijnë dhe nga ekonomia e tyre nuk heqin dorë, por punojnë edhe këtu edhe atje.

Bravo u qoftë! Njerëzit punëtor, kudo e kurdoherë, nderohen e respektohen.

Nikolla Thano ka lënë dy djem e dy vajza.

Stavre Nikolla Thano u martua me Valën, të bijën e Vasil Kolës (Mitraj) dhe me të kanë lindur 4 djem e një vajzë: Thoman, Kristaqin, Jorgon, Lencin dhe Liljanën.

Thoma Stavre Thano u martua me Afrovitin. Thoma Mërtiri nga Porua, kanë një djalë e një vajzë, Panajotin dhe Stelën.

Kristaq Stavre Thano u martua me Xhulieta Vllasi Belinën nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Stavren dhe Anën.

Jorgo Stavre Thano u martua me Mimoza Vasil K. Koçin nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Spiron dhe Valentinën.

Lorenc Stavre Thano u martua me Marjanën nga Saranda.

Liljana Stavre Thano u martua me Stavre Vangjel Lepurin në Poro.

Siç shihet, të gjitha krushqitë janë bërë me vendas, me shqiptarë. Të gjithë janë në Athinë, por shkojnë e vijnë sa herë që duan. Dera e shtëpisë është gjithmonë e hapur.

KOZMA NIKOLLA THANO

Kozma Nikolla Thano u martua me Vita Tini Dashin nga Delisufi, kanë dy djem e një vajzë: Artanin, Nikon dhe Donën.

Artan Kozma Thano u martua me Majlindën nga Fieri.

Stavrulla Nikolla Thano erdhi në Poro vajzë e vogël, me prindërit e saj; kur u rrit u martua në Poro me Fili Kroni Çukon dhe ka lindur 4 vajza, i ka të martuara të katra.

Një vajzë të madhe ai nuk e solli dot kur erdhi nga Greqia në vitin 1944, por më vonë u lidh me të dhe ajo erdhi në Poro. Më vonë, kur ikën fëmijët, patjetër që u lidhën atje përsëri. Xha Nikolla dhe e shoqja nuk rrojnë më, por fëmijët janë martuar e shtuar. Udhëtimi Poro-Athinë dhe Athinë-Poro për ta, është i pandërprerë.

Barba Nikolla në Poro, në vitin 1943 solli një djalë e një vajzë, në Poro lindi edhe një djalë, kështu që ata lanë pas dy djem dy vajza.

RISTAN PETRO THOMAI, DELISUF

Ristani erdhi nga fshati Muçaj i Fierit e u martua me Lenën e Spiro Thanos nga Porua. Ristani solli një djalë me vete tek Lena dhe, te Lena, gjeti dy vajza, që i kish me burrin e parë, Llazi Marku në Grykë.

Llazi Marku ishte mbytur në Lumë të Vjetër.

Ristani me Lenën i rritën e i martuan fëmijët, Zoin dhe dy vajzat e Lenës, Lirinë dhe Leonorën.

Liria u martua me Niko Qiric Garron në Poro, ka 4 djem e një vajzë.

Leonora u martua me Minella Veriajn në Kuçovë, ka 3 djem.

Ristani me Lenën nuk lindi fëmijë.

Zoji Ristan Thomai u martua me Marinaqi Ndini Zhazhanin nga Gryka, kanë dy djem e dy vajza: Mariglenin, Redin, Shpresën dhe Brunildën.

Mariglen Zoi Thomai u martua me Brunilda Mitaq Naçin nga Porua dhe nuk kanë fëmijë.

Shpresa Zoi Thomai u martua me Dani Mino Jankën në Poro, kanë dy djem: Kleminon dhe Alenin.

Brunilda Zoi Thomai u martua me Robert Myrteza Xhelajn në Bishan të Vlorës, kanë dy djem: Mariusin dhe Llukën.

VRUSHI, DELISUF

E kanë prejardhjen nga Mbrostari i Fierit.

Spiro Llambo Vrushi, me gruan e tij Çevën, kanë lindur 4 fëmijë: Gorin, Thanasin, Vangjelin dhe Todin.

Gori Spiro Vrushi u vra partizan në Jugosllavi, ka qenë i fejuar në Poro. Është dëshmorë i LANÇ-it

Vangjeli u martua me Saveta Spiro Gegën nga Delisufi, kanë dy djem e 3 vajza: Naqon, Nikon, Letën, Lenin dhe Valin.

Naqo Vangjel Vrushi u martua me Lirinë, të bijën e Tasi Kuqit nga Muçaj, Fier, (nga Baltëza), dhe kanë një djalë e dy vajza: Gentianin, Almën dhe Idën.

Niko V. Vrushi u martua me Vjollca Naun Gjonçarin, nga Delisufi, kanë 3 djem: Fatjonin, Arbin dhe Aldon.

Leta V. Vrushi u martua me Llazi Kije Qorrin në Delisuf.

Leni V. Vrushi u martua me Raqi Jani Kërrin në Delisuf.

Vali V. Vrushi u martua dhe ka një vajzë, dhe u divorcua.

Thanas Spiro Vrushi u martua me Marga Lami Markun nga Dëllënja, kanë 5 djem: Thoman, Petraqin, Llambin, Fredin dhe Agimin.

Thoma Thanas Vrushi u martua me Natasha Petro Kolën nga Delisufi, kanë dy djem: Gramozin dhe Adriatikun, aktualisht të dy janë beqarë.

Petraq Th. Vrushi u martua me Sirma Xhevit Boçajn nga Smokthina, kanë një djalë e dy vajza: Redianin, Judmirën dhe Marjadën.

Llambi Thanas Vrushi u martua me Djana Ali Shehun nga Gumenica në Vlorë, kanë një djalë e një vajzë: Minellën dhe Violën.

Agimi Th. Vrushi u martua me Luljeta Niko Kolën (Mitraj) nga Porua, kanë një djalë e një vajzë: Alesion dhe Margaritën.

Todi Vrushi

Todi Spiro Vrushi u martua me Nefta Leksi Kërrin nga Gryka, kanë 3 djem e 3 vajza: Llazarin, Dhimitraqin, Piron, Lizën, Jorgjien dhe Dritën.

Llazar Todi Vrushi u martua me Xhulieta Kopicin nga Lushnja, kanë një vajzë, Edën.

Dhimitraq T. Vrushi u martua me Silvana Koçi Kordhishtin nga Pish-Porua, kanë dy vajza: Liljanën dhe Pelin.

Piro T. Vrushi u martua me Irma Caci Semën, Ferras, kanë dy vajza: Sarën dhe Alecian.

Vajzat e Todi Vrushit:

Liza aktualisht nuk është martuar.

Jorgjia u martua me Agron Priftin në Marinëz, Fier.

Drita u martua me Sokrat Sukun, Tiranë-Marinës, Fier.

Shënim: Spiro Vrushi dhe Lili Sallaku ishin vëllezër me një nënë sepse, kur vdiq Llambro Vrushi, babai i Spiros, nëna e tij u martua me Ndani Sallakun në Pish-Poro dhe atje lindi dy fëmijë: Lilin dhe Sijën që kish marrë, Kristo Liçua në Skelë, Vlorë dhe ajo lindi 6–7 djem e vajza.

Edhe Lili Sallaku erdhi e u vendos në Delisuf. U martua e lindi dy djem e 3 vajza. I thoshin edhe Lili Vrushi, por në fakt ishte Lili Sallaku.

PALI VANI

Shumë i hershëm në Poro.

Pali Vani la dy djem: Kriston dhe Kronin.

Kristo Vani vdiq shpejt e la vetëm një vajzë, Kalien, që u martua me Vangjel Kungullin në Poro. Kalien e rriti Pali Gjonçari, se e kishte mbesë, dhe e martoi me Vangjel Kungullin. E ëma e saj u martua me Naun Kolën në Poro. Edhe atje lindi 3 vajza të tjera.

Kron Vani la dy djem, Lion dhe Pandelin dhe dy vajza: Athinanë dhe Marien.

Athinaja u martua me Mihal Hyson në Novoselë, ka pasur 5 fëmijë, tre vajza e dy djem, Saveta që është martuar me Mihal Furrxhiun në Vlorë, me të cilin ka dy djem e një vajzë Luçiano, Violeta dhe Vangjel); Marika, nuk u martua dhe vdiq në moshën 62 vjeçare; Milto (Miltiadh) i cili u martua me Antigonin (Evrinomin) e Kristaq Anastasi (Djella) më të cilën ka dy djem (Neritan dhe Taulant); Vllasi i cili u martua me Lejla Selmanin me të cilën ka tre fëmijë (Eralda, Toneti dhe Belinda), vdiq nga një sëmundje në moshën 52 vjeç dhe Kristina e cila u martua në Vlorë me Servet Bashaj dhe ka tre fëmijë (Matilda, Armando dhe Gilberta)..

Lio Kroni Vani u martua dy herë. Gruaja e parë, Maria e bija e Miti Çunit nga Sheqi i Dëllënjës. Me të lindi dy vajza: Sofikën dhe Jorgjien. Liua me Marien u divorcuan dhe, secili mori nga një vajzë, Liua Sofikën dhe Maria Jorgjien.

Sofika, megjithëse vajzë shumë e mirë, nuk është martuar. Ka emigruar në Greqi. Jorgjia u martua me një izraelit nga Vlora dhe, pas vitit 1990, banon në Izrael.

Lio Vani mori një tjetër grua, Dhora Gjonçari, e cila ishte e martuar dhe solli një djalë te Liua, Bertin. Me Dhorën e Gjonçajve të Novoselës, Liua lindi djem e vajza. Sot ata janë të martuar me fëmijë dhe kanë emigruar. Një nga djemtë e Lijos, Turi, banon në Vlorë.

Marija, gruaja e parë e Lijo Vanit, u martua me Vasil Llukën (Sheqeri) nga Përmeti dhe me të lindi dy djem e një vajzë, Kostën, Andonin dhe Donikën. Banojnë në Fier.

Marie Kroni Vani u martua me Petro Subashin në Zvëmec dhe la dy djem,

Pandeli Kroni Vani u martua me Neftën, të bijën e Pilo Lepurit nga Porua. Kanë një djalë, Vllasin dhe 4 vajza. Vllasi u martua me një çame në Vlorë. Të katër vajzat, Marga, Leta, Luli dhe Drita, janë martuar në Vlorë dhe kanë djem e vajzë.

Të dy vëllezërit, Liua e Pandeliu, shkuan në Vlorë në vitin 1950 dhe aty pleqëruan.

MITI LAÇKA

Miti Laçka erdhi familjarisht në Poro para vitit 1940 dhe punoi si qishar, në kishën e Shën Kollit në Poro. Kishte tre fëmijë dhe gruan. Miti ishte disi i moshuar, vdiq e u varros në Poro. Me vdekjen e Mitit, plaka mori tre fëmijët dhe shkoi në Kuçovë, ndoshta kishte njerëzit e saj, ose të burrit. Sidoqoftë fëmijët u rritën dhe u martuan në Kuçovë.

Fëmijët e Miti Laçkës ishin: Caci, Vangjeli dhe Fania.

Më duket se Fania ka qenë më e madhja e fëmijëve të Xha Mitit.

Fania e Mitit u martua me Jorgji Ziun, ka banuar në Kuçovë. Jorgji ka qënë ca kohë shofer, për disa vjet ka qenë edhe instruktor i shkollës që nxirrte shoferë. Mbas ca kohësh punoi edhe si shofer autobusi urban Kuçovë-Berat, kanë 2–3 fëmijë, djem e vajza.

Vangjel Laçka u martua dhe ka fëmijë. Ka punuar në sektorin e Naftës dhe ka banuar në Fier. Sa djem e sa vajza ka, nuk e dimë por, me siguri banon në Fier.

Pas vitit 2000, djemtë e Mitit, ose nipërit e tij, u interesuan për varrin e tij dhe i morën eshtrat e i rivarrosën në Kuçovë ose në Fier. Kështu na kanë thënë nipërit e papa Spiros në Poro.

XHAFA

ALI DHE HEKURAN XHAFA

Të dy vëllezër, djemtë e Tafil Xhafës nga Skrapari, sipas tregimit të Kadri Xhafës 80 vjeç, dhe motrës së tij Sila Hekuran Xhafa 70 vjeçe, në datën 15.11.2009, të cilët na thanë se:

Aliu dhe Hekurani erdhën në Grykë nga Frakulla. Në Pish-Poro erdhën rreth vitit 1927 dhe u vendosën në tokat e Spiro Koçi Bushit në Grykë.

Aliu dhe Hekurani kishin edhe një motër, Shaqen.

Shaqja u martua në Boçovë me Veledin Gegën.

Aliu u martua në Bishan, në fisin e Sykajve dhe ka lënë dy djem e një vajzë: Xhaferin, Selmanin dhe Bulen.

Xhafer Ali Tafil Xhafa nuk u martua, vdiq në moshë të madhe në Delisuf.

Selman Ali Tafili iku në Vlorë në moshë të re dhe atje u martua me Rabushe Ymerajn nga Kuçi, kanë lënë 3 djem: Vladimirin, Adrianin dhe Gëzimin.

Vladimiri u martua me një vajzë kosovare në Fier. Nuk kanë lindur femijë, por kanë birësuar një djalë, Gëzimin.

Gëzimi u martua me një vajzë nga Erseka, kanë një djalë e një vajzë.

Adriani u martua në Vlorë me një vajzë çame, kanë lindur dy vajza.

Hekuran Tafili u martua me Gjenën, vajzë e vetme e Spiro Bushit dhe lindën 4 djem e 3 vajza: Kadriun, Shezaiun, Qemalin, Kastriotin, Silën, Marikën dhe Lirinë.

KADRI HEKURAN TAFIL XHAFA

Kadri Hekuran Tafili u martua me Lejla Sefedin Ogiçin nga Alibani dhe lindën 5 djem e një vajzë: Lavdoshin, Tomorrin, Spiron, Luanin, Pajtimin dhe Lumturinë.

Lavdosh Kadri Tafili u martua me Arsinon nga Levani, kanë 3 djem: Dashamirin, Arjanin dhe Ladin.

Tomorr Kadri Tafili u martua me Niqi Gërdhuqin nga Bestrova (me origjinë nga Piluri), kanë një djalë e një vajzë.

Spiro Kadri Tafili u martua me Refie Tofik Karamanin nga Fieri, kanë një djalë e dy vajza: Tolin, Etlevën dhe Mondën.

Luan Kadri Tafili aktualisht është beqar.

Pajtim Kadri Tafili u martua me Lela Safet Ahmetin në Vlorë, kanë një djalë e dy vajza: Luçianon, Anxhelën dhe Paulën.

Lumturi Kadri Tafili u martua me Fatos Hasanin nga Golloborda.

Shezai Hekuran Tafili u martua me gruan e parë, Hiqmete Rexhon nga Sevasteri Vlorë, kanë një djalë, Fatmirin dhe një vajzë. Me gruan e dytë, Elpiniqi Ristan Lamen nga Vlora, Shezaiu ka edhe dy djem e një vajzë: Agronin, Fredin dhe Xhulianën.

Fatmir Shezai Tafili u martua me Mimoza Berberin nga Pogradeci, kanë dy vajza: Aulonën dhe Amantian, banon në Tiranë.

Agron Shezai Tafili u martua me Silvana Muçajn nga Tragjasi, kanë një djalë e një vajzë, banojnë në Vlorë.

Fredi Shezai Tafili u martua me Teuta Stepën nga Tragjasi, kanë dy vajza: Xhulianën dhe një tjetër, banojnë në Vlorë.

Qemal Hekuran Xhafa u martua me Naile Gjinin nga Dibra e Madhe, kanë 3 vajza, Migenën, Artiolën dhe Ledian, banojnë në Tiranë.

Qemal Xhafa me të shoqen, Xhevahire (Naile)

Kastriot Hekuran Tafili u martua me Bardha Isuf Shabani nga Mallakastra, kanë një djalë e një vajzë: Albanon dhe Gjenën, banojnë në Vlorë.

Sila Hekuran Tafili u martua me Maliq Kolumçin nga Radhima, kanë 3 djem e dy vajza: Lirimin. Ermandin, Arbenin, Albinën dhe Mirandën.

Lirim Maliq Kolumçi u martua me Noli Todi Bendajn nga Panajaja, kanë dy djem e një vajzë: Ermalin, Mateon dhe Enxhin.

Mondi Maliq Kolumçi u martua me Edia Qerem Ymerin nga Kuçi, kanë një djalë e një vajzë: Silvin dhe Komidën.

Arben Maliq Kolumçi u martua në Fitore, Novoselë, me Vjollca Ali Raxhin me origjinë nga Peqini.

Albina u martua me Albert Velon nga Çorrushi, Fier.

Miranda u martua me Patriot Tartarin nga Bolena.

Marika Hekuran Tafili u martua me Jorgji Pali Makon në Vlorë, kanë dy djem: Bertin dhe Anestin.

Liri Hekuran Xhafa u martua në Vlorë me Bujar Hamdi Zogajn, kanë një djalë e një vajzë: Enon dhe Majolën, banojnë në Vlorë.

Shënim: Babai Gjenës quhej Spiro Koçi Bushi, nëna e Gjenës quhej Like nga Hysot e Novoselës.

KRISTO XHARUA

Kristo Xharua ka ardhur në Poro nga Juba e Durrësit dhe la dy djem, Uanin, Stasin dhe një vajzë, që e kish marr Loni Liçua në Dëllënjë.

Uan Kristo Xharua u martua me Sofien dhe lanë vetëm një vajzë, Lolën e cila u martua në Fier.

Edhe Stasi Kristo Xharua la vetëm një vajzë. Ajo u martua në Nartë me Petron.

Si Uani dhe Stasi nuk lanë djem. Ata vdiqën në Poro para vitit 1940.

LONI ZAKA NGA MBROSTARI I FIERIT

Loni Zaka u martua me Vojsavën (ose Sava) dhe lanë djem: Uanin, Rrapin, Xoxin dhe Leksin.

U thoshin edhe me mbiemrin Sava, nga emri i nënës së tyre, e cila ishte shumë e dëgjuar, por në të vërtetë janë me mbiemrin Zaka.

Uan Loni Zaka kishte marrë për grua të motrën e Uan Dokos nga Dëllënja, Dafinën. Uan Zaka me Dafinën lindën 6 fëmijë, dy djem e 4 vajza: Kolin, Thanasin, Valën, Senën, Marien dhe Lefterinë.

Vala u martua me Naun Loni Kiçon në Dëllënjë, Sena me Pali Dhori Loshin në Poro, Maria me Vangjel Priftin (Qoromidhen) në Vlorë, dhe Lefteria u martua e Hyqmet Arapi në Vlorë.

Koli Uani Zaka u martua me Vasilikën, të bijën e Vasil Gjonit nga Dëllënja dhe lanë 9 fëmijë, Llambin, Kristaqin, Vefin, Dhimitrullën, Kristinën, Nolin, Donikën, Natashën dhe Mondën.

Llambi Koli Zaka u martua me Leni Kiço Boçerin dhe kanë dy djem e dy vajza: Arjanin, Stefanin, Evën dhe Marien.

Arjan Llambi Zaka u martua në Dëllënjë dhe ka dy djem.

Stefani aktualisht është beqar.

Eva Llambi Zaka u martua me një grek.

Maria aktualisht është beqare.

Kristaq Koli Zaka është martuar dy herë. Me gruan e parë, Mimoza P. Thano nga Pish-Porua, ka një vajzë, quhet Fatjona, ndërsa me gruan e dytë, Kozeta Tozo nga Rusaj e Delvinës, ka dy djem e një vajzë Kolin, Jorgon dhe Xhulin. Me gruan e parë u divorcua.

Vefi Koli Zaka u martua me Vangjel Tasen në Levan të Fierit.

Dhimitrulla Koli Zaka u martua me Vllasi Toskën në Pish-Poro.

Noli Koli Zaka u martua me Mihal Llazi Priftin në Poro.

Donika Koli Zaka u martua me Sotir Nushin në Marinëz të Fierit.

Natasha Koli Zaka u martua me Vasil Thanon në Pish-Poro të Fierit.

Monda Koli Zaka u martua me Josif Titin.

Thanas Uan Zaka u martua me Kristina Kristaq Sotën në Vlorë (dhe shkoi në Vlorë me banim pas vitit 1960), kanë dy djem e 3 vajza: Viktorin, Saj mirin, Zhanin, Vjollcën dhe Mimozën.

Viktor Thanas Zaka u martua me Minushen nga Vlora dhe kanë dy djem: Sandrin dhe një tjetër.

Saimir Thanas Zaka u martua dy herë, me gruan e parë, vajzën e Vasil Degës nga Novosela (divorcuar) ka një vajzë, dhe me gruan e dytë (e huaj, ruse ose rumune) nuk ka fëmijë, banojnë në Itali.

Vajzat e Thanas Zakës:

Zhani u martua në Durrës me Mondi Berberin.

Vjollca u martua me Andon Koli Ziun në Armen të Vlorës.

Mimoza u martua në Selenicë të Vlorës.

Xoxi Loni Zaka ishte martuar me Vasillon nga Narta dhe lanë Neftën me Tolin.

Shënim: Vasillua kish qenë e fejuar më parë me të vëllain e Xoxit, Leksin. Leksi ishte punëtor në Nartë dhe atje u fejua me Vasillon, por Leksi u sëmur e vdiq i pamartuar. Të fejuarën e Leksit e mori i vëllai, Xoxi. (Rast i rrallë ky në këto fshatra, as kishte ndodhur më parë dhe as që ka ndodhur më vonë, deri më sot, që vëllai të martohet me të fejuarën e vëllait.

Toli Xoxi Zaka u martua me një vajzë nga Vlora, por u divorcua shpejt, sepse ajo donte ta merrte në Vlorë, por Tolin nuk e lanë të shkonte.

Nefta Xoxi Zaka u martua me Ristan Gegën nga Delisufi dhe kanë lënë një djalë e 3 vajza: Filipi, Donika, Leta dhe Natasha.

Filip Ristan Gega u martua me Gonen nga Gryka e Semanit të Fierit dhe ka një djalë e dy vajza.

Donika Ristan Gega u martua me Koçi Nasi Jorgjin (Thanasi) në Dëllënjë.

Leta Ristan Gega u martua me Llambi Jani Naçin në Poro.

Natasha Ristan Gega u martua me Raqin në Libofshë të Fierit.

RRAPI LONI ZAKA, DËLLËNJË

Rrapi Zaka kish marrë për grua Vasilinë, të bijën e Mihal Petovës nga Dëllënja dhe me të kishte 4 djem e dy vajza: Mitin, Petron, Llazin, Llambin, Milikën dhe Letën.

Miti Rrapi Zaka u martua me Rina Gogo Çakallin nga Piluri i Himarës, kanë 3 djem e dy vajza: Vason, Jorgjin dhe Sokolin, si dhe Elcën me Rajmondën.

Vaso Miti Zaka u martua me Liza Gori Markun nga Dëllënja, kanë një djalë e dy vajza: Dhimon, Klodetën dhe Florianën.

Jorgji Miti Zaka u martua me Liljana Vangjel Rrungajën, kanë një djalë e një vajzë: Marion dhe Jonën.

Sokol Miti Zaka u martua me Marjetën dhe ka dy vajza.

PETRO RRAPI ZAKA

Petro Rrapi Zaka u martua me Leta Loni Çalamanin nga Bishani i Fierit. Ka dy djem e dy vajza: Vironin, Arjanin, Julianin, Lidën.

Arjani u martua me Leda Naun Ristanin në Qenas Fier, kanë dy djem: Klajdin dhe Inglin.

Vironi u martua me Moza Themiun nga Grecallia Fier, kanë një vajzë, Uriela.

Juli u martua me Raqi Jani Kërrin në Delisuf.

Lida u martua me Gori Priftin në Novoselë.

LLAZI RRAPI ZAKA

Llazi Rrapi Zaka u martua me Margarita Aleks Sotir Ilian, ka dy djem e një vajzë: Arqilen, Ilirin dhe Marcelën.

Arqilea u martua me Bruna Uan Shulin nga Havaleasi i Fierit, kanë dy djem: Elidonin dhe Rudin.

Iliri vdiq beqar, në moshën 23 vjeç.

Marcela u martua me Ilir Koçi Mbyetin në Delisuf.

LLAMBI RRAPI ZAKA

Llambi Rrapi Zaka u martua me Lira Vasil Priftin nga Zhuka, kanë një djalë e një vajzë: Taulantin e Lauretën.

Taulant Zaka u martua me Lolën nga Vajkani i Fierit, ka një djalë, Elisin.

Floreta Llambi Zaka u martua me Sandër Kozma Naçin nga Pojani i Fierit.

Milika Rrapi Zaka u martua me Lili Llazi Koven në Delisuf.

Leta Rrapi Zaka u martua me Hamzan në Vlorë.

NDINI PETRO ZHAZHANI, GRYKË

Ndini Petro Zhazhani ka ardhur në Grykë nga Zhazhani i Beratit. Ndini ka lindur në Grykë rreth vitit 1920.

Ndini Zhazhani u martua me Aretinë nga Mifoli. Kanë jetuar në Nartë dhe në Zvërnec, pastaj në Mifol e më pas në Grykë.

Ndini me Aretinë kanë lindur dy djem e 5 vajza: Thanasin, Petraqin, Kristinën, Ristanën, Sofien, Marinaqin dhe Lirinë.

Thanas Ndini Zhazhani u martua me E1iza Thanas Qorrin nga Delisufi, kanë një djalë e një vajzë: Gerjanin dhe Eriseldën.

Petraq Ndini Zhazhani u martua me Violeta Kozma Rrungajën nga Zhuka, kanë dy djem, Arditin dhe Kostandinin.

Kristina u martua me Filip Niso Llambron në Poro.

Ristana u martua me Nasi Niko Dilën në Poro.

Sofia u martua me Kristaq Babën në Dëllënjë.

Marinaqi u martua me Zoi Ristan Thomain në Delisuf.

Liria u martua me Trifon Miço Kostën në Delisuf.

DY FJALË NDERIMI SI PASTHËNIE PËR LLAZI HAJDININ ...

Ilir BALILI, shkrimtar

Në vargun njerëzve që u janë kushtuar historikëve, prejardhjes të disa fshatrave dhe banorëve të tyre, Llazi Hajdini zë një vend më vete, për tematikën e rrallë e të pasur të interesave pothuaj shkencore.

Sikundër i ka qëmtuar dhe i ka treguar të nënshkruarit ai vetë, interesi iu ngjall rastësisht, atëherë, kur bashkë me mijëra të tjerë emigroi në Greqi. Atje u njoh me bashkëkombës dhe arvanitas, të cilët flisnin shqip. Kjo qe një shtytje që zuri rrënjë në të dhe që u bë vendimtare për veprimtarinë e tij të mëpastajme, sepse një studim i tillë nuk ekziston. Pa punën e tij këmbëngulëse, dashurinë për njerëzit, preokupimin që njerëzit të mos humbasin kurrë, nuk do ta kishin në duar këtë libër serioz. Me zotërimin e gjithanshëm të lëndës së grumbulluar me pasion, autori ka ditur të na japë një pamje të gjallë të atmosferës brenda së cilës lëvizin njerëzit, lindin, martohen, ndahen nga jeta.

Te Llazi Hajdini shohim një njeri bujar, patjetër një dijetar më se të respektuar, që çon përpara një studim në një mënyrë të shënueshme.

Ndër të tjera edhe me anën e kësaj metode kërkimore e me rezultatet ku arriti, ai ka kryer një punë që do të mbetet, ai u ka hapur rrugën brezave të dijes së mëpastajmë.

Interesi për këto lloj studimesh demografike, etnografike, onomastike, toponomastike, do të shtohet.

Me këtë botim ne nderojmë Llazi Hajdinin, në radhë të parë si njeri, një ndjekës të idealeve më të larta të njerëzimit, si humanist i vërtetë që vuri një gur themeli në ndërtesën e studimeve bashkëkohore.

DUKE LEXUAR LIBRIN E LLAZ HAJDINIT

Vllas Mërtiri, Shkrimtar

Libri NJERËZ, DATA, NGJARJE, i autorit Llaz Hajdini, ribotim, është padyshim një angazhim i madh, është një guxim shembullor, që hedh dritë në sektorin demografik, në prejardhjen, lëvizjen dhe shtesat natyrale të popullsisë për pesë fshatrat tanë: Poro, Zhukë, Delisuf, Dëllënjë dhe Grykë, për çdo familje me emra, me cilët janë martuar dhe fëmijët që janë lindur nga ato martesa. Ky libër është me vlera të mëdha njohëse; lexuesi merr vesh dhe njihet me çdo familje të kësaj treve. Sigurisht, autori, në rrëfimet e tij, na paraqet edhe divorcet, për atje ku ato kanë ndodhur; por ai nuk paraqet arsyet pse ato kanë ndodhur, atë le ta dinë personat që kanë pasur probleme të tilla, apo për të tjerë të interesuar, po të duan, dhe le t'i gjejnë në ato familje. Ndërsa autori na tregon vetëm se ato kanë ndodhur. Prandaj, askush s'ka të drejtë të ankohet për këtë. Ai tregon një realitet njohës që nuk mund t'i shmanget.

Nga leximi i librit të fjalë (botim i parë), mund t'ju tregoj dy episode: Një person, tani e merr vesh se e kanë marrë në shtëpinë e fëmijës, kur ata që e kanë rritur, nuk jetojnë më. Ndërsa ai kërkon mbase gjen të ëmën e tij biologjike, po qe se ajo jeton. Apo, personi tjetër, tani merr vesh, që vëllain e ka vetëm nga babai, por jo nga nëna, se askush nuk ia kishte thënë. Kështu, del se sa vlera ka ky libër.

Llazi, ka një memorie shembullore dhe aftësi njohëse. Kjo e ka ndihmuar atë për të realizuar një punë të tillë të madhe, plus vajtja fshat më fshat, shtëpi më shtëpi, për t'i plotësuar e saktësuar të dhënat.

Në botimin e parë të këtij libri, ka shumë mangësi e gabime. Të cilat kanë ndodhur dhe për arsye: Së pari, nga distanca e banimit aktualisht të autorit me vendlindjen, i cili vinte nga Tirana e rrinte me ditë të tëra tek ne, por dhe kontaktet e tij me familjarë të dobët, të cilët, as vet nuk i dinin saktë të dhënat. Së dyti, gabimet e rënda të shtëpisë botuese (shtypshkronjës), që sot nuk kanë asnjë lloj kontrolli. Por ka munguar dhe kontrolli i autorit, pasi ai nuk e dinte punën pa përgjegjësi të tyre, dhe ai nuk e priste.

Nga vërejtjet e shumta që i kanë bërë shokët dhe ndihma konkrete e tyre, si dhe angazhimi i autorit, bënë të mundur plotësimin e mangësive dhe ndreqjen e gabimeve. Kështu që, ribotimi mbetet, pa mëdyshje, një libër me vlera njohëse në fondin e kulturës. Ky libër nuk duhet t'i mungoj asnjë shtëpie të trevës sonë. Llaz Hajdini, me këtë vepër, mbetet një pishtar, i cili rrezaton e hedh dritë mbi gjenezën e trevës sonë. Ky libër do të mbetet një gur në themelet e kulturës për trevën tonë dhe më gjerë.

Indeksi i fiseve në fshatrat Poro, Zhukë, Dëllënjë dhe Delisuf

Hyrje
Parathënie
Shtimi i popullsisë
Shkollat 1918–2008
Priftërinjtë
Kishat

Mbiemri Faqe

B.
Baba
Bani
Belina
Bërdalli
Bicerri
Bleca
Bulla
Bushi

C.
Caku

Ç.
Çala
Çela
Çobo
Çuni
Çuko

D.
Dafina
Dashi
Davidhi
Dila
Doçi
Doko
Daullja

F.
Fite

G.
Garro
Gashi
Gega
Goni

Gj.
Gjini
Gjindali
Gjonçari
Gjoni

H.
Hajdini
Hasllani
Hazizi
Helmi

Hëna
Hila
Hoxhara
Hudhra
Hyso

I. Iljazi
Inati

J. Janka
Janko

K. Karafili
Kërri
Kiço
Konda
Kola
Kosta
Kolonjari
Kungulli
Kove
Koçi

L. Laçka
Lera
Leshi
Lepuri
Liço
Loshi

LL. Llambro
Llupi

M. Mata
Marina
Marku
Memeci
Mërtiri
Mëhilli
Mile
Mbyeti
Mitro
Mitraj
Minga
Mone
Monçe
Moçka
Mitrushi
Mojallia

N. Naka

Naçi
Nasi
Ndini
P. Papa
Palasa
Papulasi
Përri
Pisha
Plaku
Prifti
Q. Qarri
Qorri
R. Rista
Rredhi
Rrungaja
S. Sema
Sika
Siko
Stefa
Sota
Sallaku
Sh. Sheqi
Shkurti
Shima
Shyti
T. Titi
Tutulani
Th. Thano
Thanasi
Thomai
V. Vani
Vrushi
Xh. Xharo
Z Zaka (Sava)
Zh. Zhazhani
Pasthënie
Pamje nga fshati

Tregimtarët për familjet

- Për Babajt - Th. K. Baba
- Për Bleca - St. Thano
- Për Belina - Miti Belina dhe Llamba Sota
- Për Bërdalli - Leja Bërdalli dhe Fili Bërdalli
- Për Biceri - Fili Biceri, Kozma Prifti
- Për Bushi - Barjam H. Bushi
- Për Bulla - Llazi Naçi, Namik Bulla
- Për Beliku - Llazi Naçi
- Për Çala - Pano Çala, Jani Papa
- Për Çela - Kozma Kola
- Për Çuko - Jano Garro, Neta Mitro
- Për Çobo - Pilo Bërdalli
- Për Çuni - Thoma e Ll. Çuni
- Për Dafina - Fili Bërdalli
- Për Dashi - Koçi Dashi
- Për Davidhi - Prokop Davidhi
- Për Doçi - Nesti Doçi
- Për Dila - Stavre Dila
- Për Duka - Jano Garro, Ll. Naçi
- Për Garro - Jano Garro, Marie Garro
- Për Gega - Llazar Gega, Kristina Kosta
- Për Goni - Vllasi Mërtiri
- Për Gjoni - Thoma Gjoni
- Për Gashi - Ismail Gashi
- Për Gjini - Koçi Mëhilli
- Për Gjindali - Vangjel Ndini, Thoma Gjindali
- Për Gjonçari - Kil Gjonçari
- Për Hajdini - Kozma Hajdini
- Për Rista - Niko e Gjena Rista
- Për Rrungaja - Llazi, Jorgji, Niso Rrungaja
- Për Plaku - Thoma Plaku, Pano Koçi
- Për Sema - Sotir Sema
- Për Sika - Gori Sheqi
- Për Siko - Vasil Siko
- Për Simoni - Kristina Dh. Kosta
- Për Stefa - Pandi Stefa
- Për Sota - Lijo Sota
- Për Shyti - Jani, Fili Shyti
- Për Sheqi - Gori Sheqi
- Për N. Thano - Stavre, Miço Thano
- Për Thomai - Lena e Marinaqi Nd. Thomai
- Për Vrushi - Marga dhe Nefta Vrushi

- Për Xharo - Llazi Naçi, J. Garro
- Për Zariko Koçi - Todi Koçi
- Për Zaka - Llazi Zaka
- Për Zhazhani - Ristan Dila
- Për Sallaku - Marga Vrushi
- Për Kove - Pandeli Kove
- Për Mbyeti - Themi Mbyeti
- Për Themi Koçi - Nefta Vrushi